



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

SOFIA  
UNIVERSITY



ST. KLIMENT  
OHRIDSKI  
EST. 1888



AKADEMIA E STUDIMEVE  
ALBANOLOGJIKE



Universiteti - University  
**FEHMI AGANI**  
GJAKOVË

# **KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE**

## **THE INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE**

**“TERMINOLOGJIA E FUSHAVE HUMANE  
DHE PASQYRIMI I SAJ NË FJALORË”**

**“THE TERMINOLOGY OF HUMAN FIELDS  
AND ITS REFLECTION IN DICTIONARIES”**

(Aktet e Konferencës Ndërkombëtare)

Tiranë,  
11 Maj 2023

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë  
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë:  
Konferencë shkencore ndërkombëtare / Universiteti i Tiranës.  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.  
- Tiranë: Graphic Line - 01, 2023.  
344 f. ; 24x17 cm  
Tit. edhe angl.: The terminology of human fields and its  
reflection in dictionaries:  
The international scientific conference.

**ISBN 9789928470744**

1. Gjuhët e huaja 2. Gjuha shqipe 3. Leksikografia 4. Fjalorë terminologjikë  
5. Konferenca  
821.1/9 '374.2 : 81 '373. 46 (062)

***INSTITUCIONET ORGANIZATORE TË KONFERENCËS  
NDËRKOMBËTARE:***

*Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të UT-së,  
Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike;*

***në bashkëpunim me***

*Akademinë e Studimeve Albanologjike,  
Universitetin e Sofies “St. Kliment Ohridski”, Bullgari*

***&***

*Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, Kosovë*

**KORDINATORE E KONFERENCËS:**

Prof. Asoc. Dr. **Eda SHEHU** - FGJH, UT

**BORDI ORGANIZATIV**

Prof. Asoc. Dr. **Adriatik DERJAJ** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Juljana KUME** - IGJL, ASA, Tiranë

Prof. Asoc. Dr. **Raqi BELLO** - FGJH, UT

Prof. Asist. Dr. **Mimoza HASANI PLLANA** - UFAGJ, Kosovë

Dr. **Alban FOÇI** - FGJH, UT

**BORDI SHKENCOR**

Prof. Dr. **Esmeralda KROMIDHA** - FGJH, UT

Prof. Dr. **Agron DURO** - IGJL, ASA, Tirane

Prof. Emeritus **Emil LAFE** - IGJL, ASA, ASHSH

Prof. Dr. **Hëna PASHO** - IGJL, ASA, Tirane

Akad. **Valter MEMISHA** - IGJL, ASA, Tiranë

Prof. Dr. **Artur LAMAJ** - IGJL, ASA, Tiranë

Prof. Asoc. Dr. **Adriatik DERJAJ** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Eda SHEHU** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Raqi BELLO** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Juljana KUME** - IGJL, ASA, Tiranë

Prof. Asoc. Dr. **Rusana HRISTOVA-BEJLERI** - SU “St. Kliment Ohridski”,  
Bullgari

Prof. Asist. Dr. **Mimoza HASANI PLLANA** - UFAGJ, Kosovë

Prof. Asoc. Dr. **Alma PINARI** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Xhemile ABDIU** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Spartak KADIU** - FGJH, UT

Dr. **Alban FOÇI** - FGJH, UT

Dr. **Olena ZOTO** - FGJH, UT

Dr. Kand. **Elvira XHAMANI** - FGJH, UT

## **REDAKSIA**

Prof. Asoc. Dr. **Eda SHEHU** - FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. **Juljana KUME** - IGJL, ASA, Tiranë

Prof. Asoc. Dr. **Adriatik DERJAJ** - FGJH, UT

## PËRMBAJTJA

### ARTIKUJ

<b>Agron Duro &amp; Vilma Proko</b>	<b>11</b>
Referat: Shfaqje të thyerjes së standardit në terminologji	
<b>Juljana Kume &amp; Eda Shehu</b>	<b>22</b>
Referat: Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë terminologjikë	
<b>Arben Skëndaj</b>	<b>37</b>
Leksiku terminologjik dhe përdorimi i tij për qëllime specifike	
<b>Franco Lorenzi &amp; Paola Bonucci &amp; Diana Peppoloni</b>	<b>45</b>
Terminologjia e disa çështjeve gjuhësore midis gjuhësisë, logopedisë dhe didaktikës	
<b>Mimoza Hasani – Pllana</b>	<b>62</b>
Fjalorët bullgarisht-shqip si arritje për lidhjen e Gjuhëve Ballkanike	
<b>Adriatik Derjaj</b>	<b>68</b>
Terminologjia turko-orientale si pjesë e leksikut terminologjik të shqipes	
<b>Flora Nikqi – Gashi &amp; Muharrem Gashi</b>	<b>75</b>
Pasqyrimi i termave në fjalorë dhe përdorimi i tyre në praktikën ligjërimore	
<b>Luljeta Dushi</b>	<b>86</b>
Domethënia e raportit të terminologjisë humane me atë teknike (Fjalori italisht – shqip të 1848 hartuar nga Atë Luca da Monte Giove O. F. M.)	
<b>Evalda Paci</b>	<b>92</b>
Rreth përveçimeve specifike në tekste të liturgjisë së krishterë në gjuhën shqipe (shekujt xvi-xvii)	
<b>Liridona Mehmeti</b>	<b>101</b>
Pasqyrimi i fjalësit të rilindësve në fjalorin e gjuhës shqipe	
<b>Vilma Proko</b>	<b>113</b>
Kontributi i Akad. Pajazit Nushit në hartimin e fjalorëve terminologjikë të psikologjisë në gjuhën shqipe	

<b>Gazmend Krasniqi &amp; Vjollca Osja</b> Probleme të terminologjisë letrare	<b>126</b>
<b>Viola Adhami</b> Terminologjia në tekstet publicitare dhe përkthimi	<b>136</b>
<b>Arta Sula</b> Hulumtime mbi terminologjinë e kritikës tekstuale mesjetare dhe të termave ekleziaste në procesin e mësimdhënies	<b>146</b>
<b>Elda Resmja Molla</b> Rreth veprës së Át Justin Rrotës dhe terminologjisë gjuhësore të përdorur në të	<b>155</b>
<b>Elvira Xhamani</b> Leksiku biblik në veprën e Dostojevskit “Krim dhe ndëshkim”, vështruar në rrafshin përqasës rusisht-shqip	<b>162</b>
<b>Ela Vasi</b> Huazimet në gjuhën shqipe dhe roli i tyre në komunikim	<b>170</b>
<b>Aida Zoto &amp; Isida Metaj (Foçi)</b> Ndikime socio-kulturore terminologjike shqiptare dhe greke në zakone dhe tradita të Krishtlindjeve e Vitit të Ri.	<b>179</b>
<b>Ajten Hajdari – Qamili</b> Njësimi i terminologjisë administrative në mbarë shqipen	<b>188</b>
<b>Eda Shehu</b> Për hartimin e një fjalori terminologjik sistemor përkufizues të së drejtës	<b>207</b>
<b>Alma Pinari</b> <i>Thesari</i> si fushë përdorimi e terminologjisë ekonomike dhe financiare (përvojë përkthimore nga gjuha ruse në shqipe)	<b>220</b>
<b>Olena Zoto &amp; Alma Pinari</b> Probleme të përkthimit të termave juridike nga ukrainishtja në shqip	<b>232</b>
<b>Edona Jahiu</b> Njohja e fjalëve të huaja terminologjike e të përditshme nga të rinjtë: nevoja për përditësim fjalorësh	<b>241</b>

<b>Shkëlqim Millaku &amp; Dardan Vuniqi</b>	<b>253</b>
Roli kuptimor i grupit të fjalëve në terminologjinë e drejtësisë	
<b>Ardita Dylgjeri</b>	<b>266</b>
Kohezioni leksikor në diskursin politik shqiptar	
<b>Fatma Shijaku</b>	<b>282</b>
Një pasqyrë mbi poliseminë në terminologji si të reflektuar në fjalorin anglish-shqip	
<b>Elvana Shtëpani</b>	<b>302</b>
Terminologjia e informatikës në metodat e kërkimit (përballja me sfidat e studentëve të Masterit të vitit të dytë)	
<b>Alba Beqaj</b>	<b>311</b>
Disa elemente të terminologjisë spanjolle në mësimin e gjuhës së huaj	
<b>Sara Draçi</b>	<b>318</b>
Fjalori terminologjik – Mësimdhënia e tij në universitet	
<b>Miranda Veliaj – Ostrosi</b>	<b>326</b>
Gjuha dhe terminologjia të ndikuara nga komunikimi ndërkulturor dhe globalizmi	





## PARATHËNIE

*Më 11 maj 2023, pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës, zhvilloi punimet për herë të parë në fushë të terminologjisë së shkencave humane, konferenca shkencore ndërkombëtare me temë bosht: “Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë” e organizuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të UT-së përkatësisht Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike; Universitetin e Sofies “St. Kliment Ohridski” të Bullgarisë dhe me Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” të Kosovës. Konferenca zhvilloi punimet në prani të një auditori të gjerë akademikësh dhe profesorësh, studiuesish dhe terminologësh, pedagogësh dhe studentësh etj. Gjuhëtarë, terminologë e specialistë të fushave të ndryshme humane të dijes (të drejtësisë, të ekonomisë, të psikologjisë, të shkencave sociale etj.) trajtuan, referuan e diskutuan së bashku në këtë konferencë rreth çështjeve, nënçështjeve përfshirë problematikave gjuhësore, shkencore e teknike të një dege speciale të gjuhësisë, siç është terminologjia e fushave humane në një kontekst sa kombëtar dhe ndërkombëtar.*

*Konferenca përfshiu 4 seksione të ndara në 2 seanca secili. Në të u mbajtën 2 referate dhe 43 kumtesa nga studiues prej Shqipërisë, Bullgarisë, Italisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Gjatë punimeve të saj u prezantuan jo vetëm rezultate të reja të hulumtimit, por edhe u shkëmbyen mendime, këndvështrime e ide të reja kërkimore shkencore mes kapaciteteve të njohura në fushën e leksikut dhe të terminologjisë së fushave humane në marrëdhënie me leksikun e përgjithshëm, terminologjinë shkencore-teknike. Po ashtu, u parashtruan projekte për vijimin e hartimit të fjalorëve terminologjikë dygjuhësh dhe shumëgjuhësh për qëllime përkthimesh si dhe planprojekte për vijimin e hartimit të fjalorëve shpjegues deri në sistemorë me përkufizime.*

*Konferenca shërbeu si pikë takimi mes gjuhëtarëve, terminologëve, specialistëve të fushave përkatëse, mësimdhënësve të institucioneve të arsimit të lartë, studiuesve jo vetëm të botës mbarëshqiptare, por edhe studiuesve të huaj (veçanërisht nga Italia, Bullgaria, etj.); të cilët nëpërmjet studimeve të tyre sollën propozime dhe arritjet e fundit të terminologjisë bashkëkohore ndërkombëtare në fushat humane. Për t’u vlerësuar qe prania e studentëve të nivelit master dhe doktoraturë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të interesuar edhe për leksiko-terminografinë e fjalorëve të fushave humane në gjuhën shqipe dhe atë të huaj gjatë procesit të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.*

*Mbajtja e një konference për terminologjinë e fushave humane në përgjithësi, si dhe pasqyrimi i deritanishëm i kësaj terminologjie në fushat humane të gjuhës*

shqipe, ishte nevojë mëse e domosdoshme për përgjithësimin dhe ballafaqimin e përvojës së fituar deri më sot, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni; ashtu edhe në Bullgari e Itali. Referuesit sollën përvojën e vendit, gjuhës prej nga vinin, praktikës terminologjike dhe terminografike, të studimeve rreth problemeve, arritjeve të kësaj fushe specifike terminologjike dhe më tej, perspektivës për përcaktimin e detyrave konkrete në të ardhmen.

Një falënderim i veçantë shkon për drejtuesen e institucionit organizativ të këtij projekti, Dekanen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së, prof. dr. Esmeralda Kromidha, e cila që në momentin e parë e ka mbështetur dhe nxitur këtë projekt duke i dhënë jetë kësaj iniciative të përbashkët me frymë ndërkombëtare. Ky aktivitet frytëdhënës, që në fazën e parë të tij, është projektideuar në bashkëpunim të ngushtë me Akademinë e Studimeve Albanologjike, bashkëpunim ky i mbështetur veçanërisht nga drejtuesi i këtij institucioni, Rektori akad. Valter Memisha; po ashtu nga institucionet bashkudhëheqëse në këtë projekt, Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” të Kosovës dhe Universitetin e Sofies “St. Kliment Ohridski” të Bullgarisë, të përfaqësuar nga bashkëdrejtueset prof. asist. dr. Mimoza Hasani Pllana dhe prof. asoc. dr. Rusana Hristova-Bejleri; institucione shkencore që me kontributin e tyre të çmuar, i kanë shtuar vlerën këtij aktiviteti sa mbarëshqiptar dhe ndërkombëtar, duke çelur udhën e ndërmarrjeve të përbashkëta shkencore edhe në të ardhmen.

Botimi i materialeve të kësaj konference në këtë përmbledhje (me problematikat, çështjet dhe nënçështjet specifike të trajtuara në të) do të jenë ndihmesë modeste për një rreth të gjerë të interesuarish për terminologjinë, studiuesish që merren posaçërisht me çështje të teorisë së terminologjisë, hartuesve të teksteve mësimore të të gjitha niveleve, hartuesve të fjalorëve terminologjikë e joterminologjikë etj. Gjithashtu, materialet e këtij vëllimi mund të shërbejnë edhe si burim, apo si shtysënxitëse për hulumtime më të thelluara në këtë fushë. Po ashtu, trajtesat e kësaj përmbledhje do t’u shërbejnë edhe studiuesve më të rinj, përfshirë në kualifikimet pasuniversitar, për përgatitjen e temave të masterave e të doktoratave rreth çështjeve të veçanta të leksikut terminologjik dhe dukurive specifike që vihen re në të etj.

Referatat dhe kumtesat të përfshira në këtë përmbledhje janë trajtuar më gjerësisht dhe më hollësisht nga autorët apo referuesit pjesëmarrës në këtë konferencë sesa ato që janë ligjëruar gjatës saj. Redaksia i ka vështruar ato pa bërë ndryshime në idetë e autorëve, duke ndërhyrë në raste të veçanta për çështje drejtshkrimore, në mënjanimin e ndonjë përsëritjeje a në ndonjë formulim jo shumë të qartë, por gjithnjë pa cënuar origjinalitetin, stilin dhe ndihmesën shkencore të autorit. Kjo e rrit edhe më shumë përgjegjësinë tonë për t’iu përkushtuar më shumë kësaj fushe kaq të rëndësishme të gjuhësisë.

REDAKSIA

# SHFAQJE TË THYERJES SË STANDARDIT NË TERMINOLOGJI

**Prof. Dr. Agron Duro**  
Gjuhëtar - terminolog

**Dr. Vilma Proko**  
Instituti i Studimeve Arbëreshe  
E-mail: vilmaproko@yahoo.it

## PËRMBLEDHJE

Në këtë kumtesë trajtohen shfaqjet e thyerjes së standardit gjuhësor në terminologji në kushtet e funksionimit të saj në ligjërimin e specializuar të çdo fushe dije si sistem i mëvetësuar me veçoritë specifike, që e dallon atë nga sistemi leksikor i gjuhës së përgjithshme. Vështruar nga kjo pikëpamje rastet e thyerjes së standardit në terminologji shfaqen në dy dukuri themelore: a) në mbingarkesën e sistemeve terminologjike me terma të huaj, dhe b) në kontradiktat ndërmjet formës shprehëse të koncepteve (termave) dhe të vetë koncepteve. Në këtë të fundit vihen re tre raste: 1) një term / disa koncepte (polisemi, homonimi) *rekrutim* (ushtarësh) / *rekrutim* (punonjësish); 2) një koncept / disa terma (dysorë): *kuvend* / *parlament*; 3) përzierje e kufijve të koncepteve (pseudodysorësi): *shpirt* / *frymë*. Studimi i gjerë dhe i thelluar i këtyre dukurive negative për terminologjinë duhet të gjejë reflekse të forta në praktikën terminologjike për kapërcimin e mangësive që vihen re në çdo terminologji.

**Fjalët çelës:** terminologji, leksik terminologjik, leksik i përgjithshëm, thyerje standarde, termi, koncept, formë, përmbajtje, polisemi – homonimi-a, dysorësi, pseudodysorësi

## MANIFESTATIONS OF THE BREAK-OFF OF STANDARD IN TERMINOLOGY

### ABSTRACT

In this paper there are treated the manifestations of language standard in terminology in the conditions of its functioning in specialized speech of each field of knowledge as an autonomous system with specific particularities, differentiating it from lexical system of general language. Viewed from this point the cases of break-off of standard in terminology are manifested in two basic phenomena: a) in the superloading of the terminological system with foreign terms and b) in the contradiction between the expressing forms of concepts (terms) and the terms themselves. In the last three cases are noticed: 1) one term / several concepts (polysemy – homonymy): *rekrutim* (i ushtarëve) (recruiting of soldiers) / *rekrutim* (i punonjësve) (recruiting of employees); 2) one concept / several terms (*kuvend* / *parlament* (*parlament*)); 3) The mixing of limits of concepts (pseudodoublets): *shpirt* / *frymë* (spirit / ghost). It is necessary that a broad and deep studying of these phenomena is to be done in order for that to find strong reflexes in terminology practice for surmounting the shortages which are noticed in each terminology.

**Keywords:** terminology, terminological lexicon, general lexicon, break-off of standard, term, concept, form, content, polysemy-homonymy, doublet, pseudodoublet.

### A. *Probleme të standardit në terminologji*

Krahasimi i shfaqjes së normës dhe të standardit gjuhësor në leksikun e përgjithshëm dhe në atë terminologjik<sup>1</sup>, që funksionojnë si dy nënsisteme të kundërta brenda sistemit tërësor të shqipes së sotme standarde, nxjerr në pah dy anë të kundërta thelbësore në zbatimin e standardit dhe të normës në format e ligjërimeve të shkruara e të folura, në të cilat funksionojnë këto nënsisteme. Në përdorimin e leksikut të përgjithshëm mund të vërehen në raste të caktuara përthyerje të formave të njësuara në të shkruar (në drejtshkrim) në forma të panjësuar në të folur (në drejtshqiptim). Kështu forma standarde *nënë* (e shkruar), jo kudo shqiptohet sipas formës standarde (të njësuar), si p.sh.: *nanë* (në Shkodër), *nonë* (në Tiranë), *nenë* (në Lushnje), *nëënë* (diku në Vlorë) etj. Në të kundërt me këtë, format shprehëse të ligjërimeve të shkruara e të folura, në të cilat funksionojnë termat e çdo fushe (nënfushe dije) janë të njësuara (të standardizuara) si në anën drejtshkrimore, ashtu dhe në atë drejtshqiptimore. Mosrealizimi i këtij rregulli do të bënte të papranueshëm dhe të mangët ligjërimin e shkruar a të folur, në të cilin funksionojnë edhe termat brenda tij.

Në raste të caktuara përdorimi i formave jostandarde (të panjësuar) në një ligjërim të specializuar të një fushe dije të një terminologjie të dhënë (shkencoretëknike, humane) do të çonte deri në reagim emocional, tallës e shpotitës, njësoj, sikur unë kumtesën time me përmbajtje ligjëruese shkencore, ta filloja me një fjali të tillë: “*Une në kët kumtesën teme kam me ba një përpkje për të trajtu një problem, i cidhi s’ka kenë studiuem deri tash ose e kanë pamë përgjymë.*”

Zbatimi përgjithësisht i plotë i standardit në ligjërimin e specializuar, në të cilin funksionojnë termat e një fushe të caktuar, si në drejtshkrim, ashtu edhe në drejtshqiptim, shtron një çështje me rëndësi metodologjike. Përderisa terminologjia me njësimin e saj në drejtshkrim dhe drejtshqiptim qëndron më lart se standardi i leksikut të përgjithshëm, vështruar nga pikëpamja e ligjërimin (përdorimit) dhe, që paraqet kështu, siç është cilësuar ndonjëherë, *standard i standardit*<sup>2</sup>, *atëherë, ku thyerhet standardi, siç po e quajmë në ligjërimin terminologjik (në ligjërimin e specializuar) dhe, më tej: përse dhe si shfaqen këto thyerje, ç’efekte kanë dhe si kapërcehen në përputhje me specifikat dhe veçoritë e zhvillimit të standardit të standardit në terminologji? Duke u mbështetur në zhvillimet e mëdha të vrullshme të sistemeve terminologjike, shumë më dinamike, se ato të leksikut të përgjithshëm, që shfaqen si faktorë jashtëgjuhësorë e brendagjuhësorë (ose më saktë – ndërkombëtarë dhe kombëtarë), duhet theksuar se përpkjet e për të kapërçyer thyerjet e standardit të standardit në kuadrin e politikës dhe planifikimit*

1 Thomai J., *Fjala, termi dhe norma gjuhësore*, në: “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe- probleme dhe detyra.” (Konferencë shkencore), ASHSH&ASHAK, Tiranë, 2009.

2 Duro A., Proko V., *Probleme të standardit në terminologji* në: “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. (Aktet e konferencës shkencore). IGJL, QSA, “Botimet Albanologjike”. Tiranë, 2011, fq. 486 dhe fq. 493.

të ushtruar në terminologji, duhet të na çojë në orientimin e punës në terminologji drejt një standardi të shkallës së tretë, standardit të standardit të standardit. Kjo ndodh sepse ndryshimet brenda çdo sistemi terminologjik janë të pandërprera, dinamike, dhe, si të tilla, shkaktojnë kontradikta ndërmjet formës dhe përmbajtjes në çdo terminologji, ku format shprehëse të koncepteve (termat) mbeten gjithmonë prapa vetë koncepteve, të cilët kërkojnë gjithnjë të jenë të saktë, të kuptueshëm, të motivueshëm, çka kushtëzon kapërcimin nga një nivel standardi në tjetrin. Kjo është arsyeja se përse e gjithë puna e politikës dhe e planifikimit gjuhësor në terminologji orientohet drejt barazimit të raportit term/koncept, nga ku zgjidhet edhe termi standard, amtar ose/e i huaj. Për rrjedhojë, motivon shfaqjen e një standardi më të lartë, nga standardi i standardit (SS), d.m.th., standard *sui generis*, në standard të standardit të standardit (SSS). Ky kalim pasqyrohet me shembujt e mëposhtëm në dy gjendje: A (SS) dhe B (SSS):

1 2 3 4 5 6  
A (SS): *Aprovimi* i ligjit nga *Parlamenti* për buxhetin e pushtetit *lokal*

1 2 3 4  
(*aprovim, parlament, lokal*); B (SSS): *Miratimi* i ligjit nga *Kuvendi* për buxhetin

5 6  
e pushtetit *vendor* (*miratim, kuvend, vendor*)

(*aprovim – miratim*), *parlament – kuvend, lokal – vendor*).

Siç shihet nga shembujt, në rastin A (SS) kemi 4 terma të huaj (+ buxhet) (1, 3, 4, 6) dhe 2 terma shqip (2, 5), kurse në rastin B (SSS) kemi përkatësisht 2 terma të huaj dhe 4 terma shqip.

Kjo paraqitje dëshmon se zhvillimi i standardit në terminologji është një dukuri dinamike dhe, si e tillë, shkon gjithnjë drejt përsosjes, duke pasqyruar rreptësisht ndryshimet që ndodhin në fushat e dijes, në konceptet dhe pasqyrimin e tyre në termat.


## B. *Dukuri të thyerjes së standardit*

### 1. *Thyerje në shpërpjesëtimet terma të huaj / terma shqip dhe anasjelltas*

Duke e vështruar terminologjinë në marrëdhënie me gjuhët e tjera dhe me gjuhën e dhënë (shqipe) në lidhje me përdorimin e saj nga specialistët në çdo fushë dije në çdo gjuhë, mund të deduktohet se, ata (specialistët), i mendojnë njësoj konceptet që kanë në kokë, pra, konceptet janë universale (ndërgjuhësore), siç mund të thuhet për konceptet “*e drejta, ligj, dekret*,” etj., por që përthihen në forma të ndryshme (d.m.th.) në gjuhën që flasim. Nga ana tjetër, duhet nënvizuar, se ky karakter ndërkombëtar (ndërgjuhësor) i terminologjisë, sigurisht në përmbajtje,

motivohet sidomos nga vendndodhja që ajo zë midis leksikut terminologjik të çdo gjuhe, në të cilën ajo është në kontakt të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë. Vendndodhja e ndërmjetme në periferi të gjuhës ndërmjet leksikut të gjuhës përkatëse dhe leksikut të gjuhëve të tjera, bën që terminologjia të gjendet përherë nën “goditjet” e njëjësive emërtuese (termave) që vijnë nga periferitë e gjuhëve në kontakt të drejtpërdrejtë a të zhdrejtë (larg saj) dhe, duke u futur në zonën periferike të gjuhës përkatëse, sipas rastit, hyjnë (depërtojnë) së bashku me konceptet për të plotësuar boshllëqet në koncepte dhe forma ose si njësi të panevojshme. Prej këtej ato mund të kalojnë edhe në pjesët e tjera të gjuhës, në leksikun e përgjithshëm e në nivelet e tjera. Në fillim ato hyjnë, pa ndryshim forme si dekret, votë dhe pastaj, më tej, i përshtaten modeleve gjuhësore të gjuhës përkatëse (shqipe), sidomos në sistemin fjalëformues, si *votë – votoj – votim, dekret – dekretoj – dekretim* etj. Duke zënë këtë vendndodhje të ndërmjetme terminologjia mund të jetë e rrezikuar nga tepria (mbingarkesa) me elemente emërtuese (terma) që vijnë nga periferia e gjuhëve të tjera dhe që duhet t’i përshtatë, meqë ajo mund të shërbejë si portë për hyrjen përmes saj të çdo elementi të huaj, që mund të përzihet me të, por që mund të depërtojë në drejtim të qendrës, fillimisht në strukturat sintaksore e më tej në atë morfologjike. (Shih skemën).

**access**



Termi *access* (anglez), duke hyrë në periferi kalon në nivelet e tjera si fjalë e zakonshme, duke fituar kuptim tjetër: *akses* (në politikë) si edhe duke depërtuar në sistemin fjalëformues: *aksesoj, aksesim*, pra duke u bërë pronë e gjuhës marrëse

nga gjuha dhënëse (angleze). Po kështu kjo shihet në formát: *format – formatoj – formatues – formatim*.

Pa u futur në përsiatje të thella mund të vetëkuptohet se rasti më fatkeq për terminologjinë do të ishte mbingarkesa e saj me terma të huaj, të cilët krijojnë një cenim (thyerje) të standardit në përmbajtje, ku mbizotërimi i termave të huaj dëmtojnë fizionominë e gjuhës marrëse (shqipe), duke i prishur identitetin e saj, duke krijuar probleme të shumta në të kuptuarit e përmbajtjes së koncepteve, motivimit (paqartësia), të cilat, prej formave të huaja, krijojnë vështirësi edhe nga ana didaktike, meqë e bëjnë të vështirë përvetësimin e tyre nga nxënësit e studentët në shkollë në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Për të kuptuar më në gjerësi thyerjet e standardit në terminologji nga mbingarkesa e tij me terma të huaj ose, edhe nga mbingarkesa me terma shqip (të shqipëruar) do të vështrojmë shumë shkurt se si paraqiten disa shfaqje të saj të drejtpërdrejta dhe reflektet e kundërta të tyre në shpërpjesëtimet *term i huaj / term amtar* dhe anasjelltas (në rastin tonë termi shqip ose i shqipëruar) në disa faza të rëndësishme të formimit të terminologjisë të fushave të caktuara dhe pritshmëritë e mëtejshme në zhvillimin e tyre.

a) *Formimi i terminologjive shqipe në periudhën e Rilindjes Kombëtare (1850–1912)*.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, në kushtet e një pushteti që komandohej nga të huajt, gjuha shqipe ka qenë e shkruar në dialekte dhe alfabetë të ndryshme, çka e bënte të pamundur krijimin e drejtpërdrejtë të terminologjive nën ndikimin e terminologjive të huaja, prandaj ajo në fillimet e saj, e kufizuar në fushat natyrore dhe të sakta dhe për nevojat e shkollës, u formua nga forcat e brendshme përmes kompetencës gjuhësore-kulturore të Rilindësve. Kjo bëri që në terminologjitë e nivelit fillestar të mbizotëronin termat shqip, duke formuar drejtpërdrejt terma të ngritur nga fjalët e zakonshme ose të formuara me brumin leksikor të shqipes dhe modelet e saj fjalëformuese në përshtatje me modelet e huaja, të futura në terminologji përmes koncepteve njohëse të Rilindësve, të arsimuar në shkollat e huaja (turke, greke etj. si N. Frashëri, S. Frashëri, K. Kristoforidhi etj.)<sup>3</sup>. Mbingarkesa e terminologjive shqipe në fillimet e formimit të tyre me terma shqip a të shqipëruara çoi deri në një fare mase në thyerjen e normës terminologjike brendapërbrenda sistemeve terminologjike fillestare (nga fusha e botanikës, matematikës, gjuhësisë etj.), kurse më vonë, me zhvillimin e mëtejshëm të terminologjisë, pjesa më e madhe prej tyre shërbeu për hedhjen e bazave të terminologjive shqipe në tërësinë e sistemeve të tyre. Në përgjithësi mbizotërimi i formimeve terminologjike shqipe çoi në dukurinë e krijimit të një farë *purizmi leksikor*, i cili u kapërcye më vonë

3 Proko V., *Një vëzhgim mbi botimet terminologjike në Periudhën e Pavarësisë*, në: “Zhvillime gjuhësore dhe letrare në Periudhën e Pavarësisë” (Përmbledhje materialesh të Konferencës Shkencore.). Universiteti “Eqrem Çabej” & ASHSH & ASA, Gjirokastër, 2019, fq. 138-147.

me futjen në leksikon terminologjik të termave të huaj kryesisht nga italishtja dhe frëngjishtja. Ndonëse një pjesë prej termave puristë dolën të papërshtatshëm, si:<sup>4</sup> *shkronjëto*, *mësonjëto* (gramatikë), *dheshkronjë* (gjeografi), *kafshëtregonjë* (zoologji), *thëngjill* (karbon), *ujëtore* (hidrogjen) (N. Frashëri), *gjithëmësonjëto* (universitet), *udhë e hekurt* (S. Frashëri) etj., një pjesë arritën të rrënjosen në fondin leksikor të gjuhës dhe të përdoren edhe sot, duke shërbyer edhe si baza fjalëformuese si *kënd*, *rreth*, *shkronjë*, *fjalë* etj.

b) *Formimi i terminologjisë shqipe të periudhës pas Pavarësisë Kombëtare (pas 1912–1944)* në kushtet e mungesës së një terminologjie shqipe në ndonjë fushë të rëndësishme të dijes, siç është terminologjia e së drejtës (administrativo-juridike), e cila mbulohej pothuajse tërësisht nga terminologjia e huaj, si, në këtë rast, nga terminologjia turke dhe qytetarët i kryenin aktet juridike përmes përkthyesve, çka çonte në vështirësi të shumta në kryerjen e tyre. Kjo prani e plotë e termave të huaj (turq), pasqyrohet në mikrotekstin e mëposhtëm, të cilin po e japim edhe të përkthyer nga “shqipja turke” në shqipe:<sup>5</sup> “... *me i qitë një arzuhall rejzit të beledijes bashkë me ilmihaberin e me imza të myftarit të mehallës, i bamë tasdikë edhe në tapi-dajre... ( ... t’i drejtoj një lutje kryetarit të bashkisë së bashku me çertifikatën e vulosur nga kryeplaku i lagjes verifikuar edhe në zyrën e kadastrës ...)*”.

Me përpjekjet dhe ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit shqiptar të sapoformuar nga Ismail Qemali dhe me pjesëmarrjen e personaliteteve të fushave të ndryshme të dijes (Luigj Gurakuqi, Sotir Peçi) u arrit për një kohë relativisht të shkurtër të zëvendësohej terminologjia juridike turke me terma shqip ose të shqipëruar. Prej kujdesit për gjuhën, sidomos të ushtruar nga politika dhe planifikimi gjuhësor në fushën e terminologjisë u arrit njëfarë baraspeshe ndërmjet termave shqip, turq dhe të futur nga italishtja dhe frëngjishtja.

Megjithatë, pavarësisht nga baraspesha e termave shqip me të huaj, e arritur në hallka të veçanta, thyerja e standardit vijoi të vepronte për një kohë të gjatë, e shkaktuar nga dukuria dysorësisë (*nom – ligj*) shumëkuptimisë së termave etj. Për terminologjinë e kësaj fushe vlen të përmendet studimi me shumë vlera, i ndërmarrë nga prof. Emil Lafe<sup>6</sup>, në të cilin ai analizon me hollësi punën e bërë nga Komisia letrare shqipe në Shkodër<sup>7</sup> që nga v. 1915, në hartimin prej saj të një fjalorthi me rreth 360 terma etj., i cili u bë i detyrueshëm të mësohej nga kushdo që punësohej në administratën e kohës.

c) *Norma dhe standardi në rrafshin e politikës së planifikimit gjuhësor në terminologji në fazën e konsolidimit të terminologjive të shqipes dhe të formimit të saj si sistem homogjen dhe i qëndrueshëm (1945–1990).*<sup>8</sup>

4 Pasho H., *Koncepti i Naim Frashërit për leksikon terminologjik* në: “Naim Frashëri dhe kultura shqiptare”, Tiranë, 2001.

5 Dizdari T., *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, (ISESCO), Tiranë, 2005.

6 Lafe E., *Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe*, “Perla”, nr. 2-4 (57), 2010.

7 Shih *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, ASHSH, Tiranë 2008, fq. 1226-1227.

8 Leka F., *Zhvillimi i terminologjisë shkencore-teknike të gjuhës shqipe dhe studimi i saj pas çlirimit*, Sf,



Në kushtet e zhvillimit të terminologjive të fushave të ndryshme të dijës për këtë periudhë, përpjekja e madhe për shqipërimin e tyre, çka, mund të pranohet si lëvizje gjuhësore në fushën e terminologjisë shqipe<sup>9</sup>, çoi në një “ndeshje” ndërmjet termave të huaj (një pjesë e madhe e të cilëve janë në përdorim edhe sot) dhe termave të shqipëruar ose shqip të gjetur në gjuhë si të tillë. Lidhur me këtë terminologji të kësaj faze ka studime e vështrime të gjera e të thella deri nivel monografish. Këtu do të nënvizojmë disa fakte të veçanta, por që kanë vlerë për normën dhe standardin në terminologjinë e kësaj periudhe, në të dyja nënsistemet e saj, në terminologjinë shkencore-teknike dhe në atë të fushave humane. Puna shumë intensive e ndërmarrë nga të gjitha institucionet (IGJL), shkollat e larta, institucionet kërkimore e shkencore të bazës, e drejtuar nga politika dhe planifikimi gjuhësor në terminologji, e ushtruar edhe drejtpërdrejt nga pushteti shtetëror deri ai partiak, bëri që të përpunohen terminologjitë themelore shkencore e teknike, e më rrallë ato të fushave humane. Të parat u mishëruan në fjalorët mbi baza institucionale (rreth 80 nga IGJ dhe Akademia Ushtarake “Skënderbej”) dhe me dhjetëra me baza individuale. Nga kjo punë kolosale u arrit të nxirreshin jashtë gjuhe një sasi e madhe termash të huaj, por që një pjesë e tyre vijoi të sinonimizonte me termat e shqipëruar, të formuar me shumicë, saqë çuan në sistemet e ndryshme shkencore të mbingarkohen me terma të shqipëruar (sidomos nga fjalët të ngritura në terma, të terminologjizuara) kryesisht në shkollën 8-vjeçare dhe të mesme dhe më pak në shkollën e lartë.

Megjithatë, në rrafshin e përgjithshëm në funksionimin real të terminologjive u krijuan dy kontradikta që çuan edhe në thyerjen e standardit në terminologji: 1. mbingarkimi i sistemeve terminologjike me terma shqip ose të shqipëruar të pasqyruar në fjalorët e shumë terminologjike dhe vijimi i mbingarkesës me terma të huaj, sidomos në terminologjinë teknike dhe 2. kontradikta ndërmjet termave standard (shqip ose të huaj), që i përgjigjeshin shprehjes prej termave të kërkesave të saktësisë, qartësisë dhe motivimit të tyre dhe termave jostandarde (shqip ose të huaj) që sinonimizonin, sidomos në literaturën shkencore-teknike. Vargjet dysorë e trisorë më tej kanë mbizotëruar veçanërisht në disa terminologji, të lëna jashtë kujdesit të politikës së planifikimit gjuhësor në terminologji, si p.sh., për “vertebrorë”: *vertebrorë – kurrizorë – kërbishtorë – rruazorë; shtypje – trysni – presion; akselerim – nxitim – shpejtim – përshpejtim; prapaveprim – lidhje e kundërt – fdbek; preciz – i saktë – ekzakt – i përpiktë* etj. Kjo periudhë është quajtur edhe periudha e shfaqjes së *purizmit të dytë*<sup>10</sup> në fushën e terminologjisë shkencore-teknike dhe më e kufizuar në terminologjinë e fushave humane.

d) Në mënyrë të veçantë, nga viti 90-të i shekullit të kaluar e deri në ditët e

1984/4.

9 Duro A., *Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërim* në: “Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, nr. 1, Prishtinë, 2001.

10 Duro A., *Probleme të veprimtarisë terminologjike: standardizimi*, në: “Studime gjuhësore”, QSA, Tiranë, 2012.

sotme<sup>11</sup> vërehet vërshimi i vrullshëm i termave të shumtë, të cilët depërtojnë së bashku me konceptet përkatëse dhe për një kohë të shkurtër plotësojnë sistemet terminologjike, por, duke zënë shumë vende boshe në këto sisteme, i kanë mbingarkuar ato me forma shprehëse të shumta (me terma), të cilat janë përzier me elementet vendëse, ekzistuese ose të sapoformuara, duke krijuar probleme të mëdha në shpërpjesëtime të konsiderueshme në raportet formë/përmbajtje të termave. Kjo mbingarkesë ka çuar në përhapjen e termave të huaj, sidomos të prejardhur nga gjuha angleze, në leksikon e përgjithshëm, nga njëra anë, duke e pasuruar atë, kurse, nga ana tjetër, duke krijuar vështirësi në përvetësimin e tyre dhe përdorimin në procesin e komunikimit të zakonshëm nga masa jospecialiste.

Termet e huaj si elemente leksikore gjuhësore janë bërë si gjuhë e dytë në funksionimin e tyre në fusha të caktuara si, në politikë, sociologji, ekonomi etj. që paraqiten si produkt (formim) gjuhësor dytësor, i cilësuar si shqiplish (shqipe – angleze në analogji me frençlish, kinlish etj. në gjuhë të tjera, ku ndihet ndikimi në to i fjalëve angleze). Këtu po sjellim vetëm një shembull, i cili dëshmon për refleksat negative nga prania e tyre kaq me shumicë, saqë i zënë frymën ligjërimin shqip, siç mund të shihet në fjalinë e mëposhtme: “Në këtë *uërkshop asistoi menaxheri i divizionit të distribucionit të kateringut*, i cili *prezantoi një draft të lançuar nga Bordi i Drejtorëve për rekrutimin e punonjësve të rinj.*”

Lidhur me këtë mikrotest mund të përbënin objekt analize të veçantë termat dykonceptësh, që takohen në dy fusha të ndryshme, si: *divizion* (usht. – ek.), *lançoj* (usht. (– *raketën*) dhe ek. (– *draftin*), *rekrutim* (usht. (– *i ushtarëve të rinj*) dhe ek. (– *i të rinj*). Mbingarkesa të tilla (disa shumë të rralla në përdorim dhe me semantikë të paqartë: *uërkshop*, *katering*) vërehen në formulime të teksteve (shkresave) zyrtare, në shtyp, në media, në shkrime shkencore a teknike etj. Këtu, me këtë rast, mund të përmendnim një fakt domethënës: Siç është bërë e njohur, nxënësit e maturës, në vitin shkollor që shkoi, në provimet me shkrim në gjuhën shqipe dhe në atë angleze, kishin bërë më pak gabime të niveleve të ndryshme gjuhësore në anglishte, se sa në shqipe. Prej kësaj del se nxënësit, sikurse të tjerë që njohin anglishten, kanë filluar të mendojnë anglisht (duke krijuar të ashtuquajturën shqipnglishten (shqipnglishten) dhe të shkruajnë shqip dhe shqipnglisht (shqipnglisht). Anglishtja ka filluar të futet dhe në sistemin gramatikor. Kështu, në analogji me strukturën angleze *This is Peter* thuhet në shqip *Ky është Agim* në vend të *Agimi*, ose: *Agim tha* në vend të *Agimi tha* etj.

Interes do të përbënte ndërkalimi i mikrotestit të mësipërm në shqipe, i cili do të merrte formën e përkthimit shqipnglisht shqip: *Në këtë seminar pune mori pjesë menaxheri (administratori) i sektorit të shpërndarjes së furnizimit me ushqime, i cili paraqiti një draft (paraprojekt), të propozuar nga Bordi i Drejtorëve për punësimin e punonjësve të rinj.*


11 Shih: “Terminologjia në shkencat e ligjërimin” (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare. Përmbledhje materialesh), Universiteti “Aleksandër Xhuvani”&FHF, UT&FF, UP), Elbasan, 2014.

## 2. Thyerje të shfaqura në kontradiktat formë/përmbajtje

Në shumë raste ndodh që termat anglezë (kryesisht këta) u shtohen çifteve dhe vargjeve dysore (ku një koncept shprehet me disa terma), të cilat duke formuar mikrosisteme paradigmatiche të termave të lidhur në bazë të koncepteve të njëjtë, të përbashkëta ose të afërt, krijojnë një gjendje kaotike dhe pështjelluese në disa fusha të caktuara terminologjike.

Po sjellim vetëm disa shembuj tipikë: Dikur termi i huaj *influencë* ka qenë zëvendësuar nga termi shqip *ndikim*, kurse, më vonë (edhe sot), termi anglez *impakt*, po nxjerr jashtë gjuhë ose e bën rrallë të përdorshëm si termin e huaj *influencë*, ashtu edhe atë shqip, *ndikim*. Po kështu krahas *firmos* dhe *nënshkruaj* (më të njëjtën përmbajtje konceptore) po futet termi anglez *signatoj*; Po kështu në vend të *azhurnoj* dhe *përditësoj* jo rrallë ndeshet termi anglez *apdetoj*.

Një varg shembujsh të tjerë (shih skemën) nxjerr në pah përplasjet e termave shqip dhe të huaj (kryesisht anglezë) në lidhjet konceptore të shprehura prej tyre. Kështu në vend të termit shqip *sigurim* (*sigurimi* i shtetit) sot përdoret *siguri* (forcat e *sigurisë*), kurse nga *sigurim* me kuptim negativ është formuar *sigurimës*. Mirëpo, termi *sigurim* (i fushës së *sigurisë*) bie ndesh po me *sigurim* (p.sh. *sigurim* pensioni) (ekon.). Duke shkuar më tej, sot, si dysor (me të njëjtin kuptim) për *siguri* (dikur *sigurim*) përdoret edhe *inteligjencë* (forcat e *inteligjencës* = *forcat e sigurimit* = *forcat e sigurisë*). Kjo e fundit (*inteligjencë*) është e ardhur prej anglishtes *intelligence service*, që, kjo nga ana e vet, lidhet me (AIQ = CIA). Duhet përmendur këtu, se në shqipe *inteligjencë* përdoret në kuptimin e emrit shumë *intelektualë*, që, realisht *inteligjencë* në Fjalorin e Shqipes (2006), për këtë kuptim, përdoret *inteligjencie* (= *intelektualët*), e huazuar prej rusishtes (*inteligencie*), por që ngatërrohet me *inteligjencë*. Termi *inteligjencë* përdoret edhe në informatikë i prejardhur nga anglishtja: *inteligjenca artificiale* (*artificial intelligence*). Përveç kësaj, krahas *forcat e inteligjencës* përdoret edhe *forcat inteligjente*. (Në anglishte *inteligjent* = *smart*). Lidhur me *inteligjent* përdoret *pajisje inteligjente* (*pajisje smart*), *inteligjent* = *i zgjuar* = *smart* / në anglishte).



Lidhje të tilla kaotike pështjelluese vihen re jo rrallë, sidomos sot në terminologjitë e fushave humane (politike, ekonomike, etj.). Prej këtej mund të deduktohet se qendra e rëndesës së zhvillimeve gjuhësore të leksikut të terminologjive të shqipes duhet të kalojë në terminologjitë e fushave humane. Megjithatë, duhet nënvizuar, se disa terminologji të fushave humane janë tradicionalisht të mbingarkuara me terma të huaj, jo vetëm anglezë, por edhe nga italishtja, frëngjishtja e ndonjë tjetër. Kështu, p.sh., kjo mund të vërehet në disa fjalorë si: *Fjalor shpjegues i psikanalizës*<sup>12</sup>, *Leksikon i psikologjisë*<sup>13</sup>, *Fjalor i feve*<sup>14</sup>, *Fjalor i filozofisë*<sup>15</sup>, *Fjalor i sociologjisë*<sup>16</sup>, në të cilët pothuajse rreth 80-90% të termësive (fjalësive terminologjike) përbëhen nga terma të huaj.

Gjithçka që trajtuam më sipër vë si detyrë që edhe fokusi i studimeve terminologjike shqipe duhet orientuar drejt terminologjisë së fushave humane, e cila, gjykuar sipas gjendjes së saj të sotme dhe zhvillimeve reale, paraqitet më

12 Nushi P., *Fjalor shpjegues i psikanalizës*, ASHAK, Prishtinë, 2010.

13 Nushi P., *Leksikon i psikologjisë*, 2 vëll., ASHAK, Prishtinë, 2014.

14 Myrtezai E., *Fjalor i feve*, "Rilindja", Prishtinë, 2000.

15 Myrtezai E., *Fjalor i filozofisë*, "Toena", Tiranë, 2007.

16 Sacca A., *Fjalor i sociologjisë*, "Almera", Tiranë, 2009.

problematike sesa terminologjia e fushave shkencore-teknike. Kësaj të fundit, për një kohë të gjatë, gjatë disa dhjetëvjeçarëve, i është kushtuar një vëmendje e veçantë, çka pasqyrohet në studimet e shumta rreth saj, fjalorëve të hartuar jo vetëm me baza individuale, por edhe institucionale, çka nuk e shohim në terminologjitë e fushave humane në të cilën vërehen mangësi të mëdha. Drejt kësaj duhet intensifikuar me shumë politika dhe planifikimi gjuhësor në këtë fushë për ta ngritur atë në një nivel cilësisht të lartë, çka bën të domosdoshëm drejtimin nga një qendër e vetme, bashkëveprimin e forcave shkencore në rang kombëtar e ndërkombëtar, bashkëveprimin e specialistëve me gjuhëtarët, pa të cilën s'mund të arrihen rezultatet e pritura.

## BIBLIOGRAFIA:

- DIZDARI T., (2005): *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, (ISESCO), Tiranë.
- DURO A., (2001) : *Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërim* në: “Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, nr. 1, Prishtinë.
- DURO A., (2012): *Probleme të veprimtarisë terminologjike: standardizimi*, në: “Studime gjuhësore”, QSA, IGJL, “Botimet Albanologjike”, Tiranë.
- DURO A., PROKO V., (2011): *Probleme të standardit në terminologji* në: “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. (Aktet e konferencës shkencore). QSA, IGJL, “Botimet Albanologjike”. Tiranë.
- (2008): *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, ASHSH, Tiranë, fq. 1226-1227.
- LAFE E., (2010): *Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe*, “Perla”, Nr. 2-4 (57).
- LEKAF., (1984): *Zhvillimi i terminologjisë shkencore-teknike të gjuhës shqipe dhe studimi i saj pas çlirimit*, “Studime filologjike”, nr. 4, Tiranë.
- MYRTEZAI E., (2000): *Fjalor i feve*, “Rilindja”, Prishtinë.
- MYRTEZAI E., (2007): *Fjalor i filozofisë*, “Toena”, Tiranë.
- NUSHI P., (2010): *Fjalor shpjegues i psikanalizës*, ASHAK, Prishtinë.
- NUSHI P., (2014) : *Leksikon i psikologjisë*, 2 vëll., ASHAK, Prishtinë.
- PASHO H., (2001): *Koncepti i Naim Frashërit për leksikon terminologjik në vëllimin “Naim Frashëri dhe kultura shqiptare”*, Tiranë.
- PROKO V., (2019): *Një vëzhgim mbi botimet terminologjike në Periudhën e Pavarësisë*, në: Konferenca Shkencore Kombëtare “Zhvillime gjuhësore dhe letrare në Periudhën e Pavarësisë (përmbledhje materiale)”. Universiteti “Eqrem Çabej” & ASHSH & ASA, Gjirokastër.
- SACCA A., (2009) : *Fjalor i sociologjisë*, “Almera”, Tiranë.
- (2014): “Terminologjia në shkencat e ligjërimin” (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare. Përmbledhje materiale). Universiteti “Aleksandër Xhuvani”&FHF, UT&FF, UP), Elbasan.
- THOMAI J., (2009): *Fjala, termi dhe norma gjuhësore*, në: “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-probleme dhe detyra”. (Konferencë shkencore), ASHSH&ASHAK, Tiranë.

# TERMINOLOGJIA E FUSHAVE HUMANE DHE PASQYRIMI I SAJ NË FJALORË TERMINOLOGJIKË

**Prof. Asoc. Dr. Juljana Kume**

Akademia e Studimeve Albanologjike

E-mail: juljana\_kume@yahoo.com

**Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu**

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: eda.shehu@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Përshkrim i hollësishëm sinkro dhe diakronik i hulumtimeve të deritanishme terminologjike në gjuhën shqipe si në fushën e terminologjisë tekniko-shkencore dhe atë humane dhe qasja analizuese teorike dhe praktike e tyre (referuar veçanërisht veprave leksikografike të gjuhëve speciale) përbëjnë boshtin e këtij referati me qëllim sa informues dhe planifikues për vijimin e ecurisë së punës që i pret terminologut specialist dhe gjuhëtarit terminolog. Hulumtimi zë fill me analizimin e kuadrit të sistemit leksikor tërësor të gjuhës standarde shqipe, që mundësohet edhe nga funksionimi i dy sistemeve terminologjike të mëvetësuar në kundërvënie nga njëri-tjetri (terminologjia tekniko-shkencore dhe e fushave humane), por që njëkohësisht i kundërvihen sistemit leksikor të gjuhës së përgjithshme.

Qëllimi specifik i këtij referati, nisur edhe nga tema bosht e konferencës është nxjerrja në pah e *vendit* dhe *identitetit* të terminologjisë së fushave humane, pasi deri më sot kësaj terminologjie në krahasim me terminologjinë e fushave *shkencore –teknike* nuk i është dhënë vendi që i takon, pasi ajo është trajtuar herë më gjerë dhe herë më ngusht, shpesh brenda rrethit të leksikut politiko-shoqëror. Trajtimi i kësaj terminologjie në lidhje me sistemin tërësor të gjuhës dhe me nënfushat që përfshihen brenda saj, të cilat janë në kundërvënie si me sistemin tjetër jashtë tij (shkencor-teknik) ashtu edhe brenda nënfushave të vetë sistemit, për shkak të diferencimit të tyre në varësi të sistemeve të koncepteve që shërbejnë si rrahë kufizues, që njëkohësisht ndajnë me kufi të caktuar njërën nënfushë nga tjetra. Diferencimi midis sistemeve vërtetohet nga ballafaqimi faktik-ilustrues i fushave dhe nënfushave të dy sistemeve kryesore terminologjike të dijes, ndikimi që ushtrojnë sistemet konceptore në ndarjen e fushave dhe nënfushave. Po aq interes shfaq parashtrimi i specifikave, dukurive dhe mangësive të terminologjisë së kësaj fushe (terminologjia e fushave humane), përfshirë këtu paraqitjen skematike, hierarkike dhe sistimore jo vetëm të kësaj fushe terminologjike, por të gjithë sistemit leksikor të gjuhës shqipe. Referimi në pjesën e fundit të tij vijon me nënçështjen: zhvillime e probleme në gjendjen e arrirë dhe prespektiva e detyra për të ardhmen.

**Fjalët çelës:** terminologjia tekniko-shkencore; terminologjia e fushave humane; sistemet konceptore; sistemi leksiko-terminologjik i gjuhës shqipe; nënfushat, etj.

## HUMAN FIELDS TERMINOLOGY AND ITS REFLECTION IN TERMINOLOGICAL DICTIONARIES

### ABSTRACT

Detailed synchro and diachronic description of research in the terminology of the Albanian language up nowadays as in the technical-scientific and human terminology fields and the theoretical and practical analytical approach (specifically referred to lexicographic works of special languages) constitute the main objective of this scientific reference with the specific informational and planning objective for the progress of the theoretical and practical terminology work (in the Albanian) of the specialist terminologist and the terminological linguist. The research begins with the analysis of the framework of the overall lexical system of the standard Albanian language, which is made possible by the operation of two terminological systems acquired in opposition to each other (the technical-scientific terminology and the humanities terminology), but which are simultaneously opposed to the system general language lexicon.

The specific goal of this article, starting out from the main topic of the conference, is the *highlighting of the place and the identity* of the terminology of the human fields. Until now this terminology compared to the terminology of the *scientific-technical* field, it is not given the place and it has been treated sometimes more broadly and sometimes more narrowly, often within the circle of the political-social lexicon. The treatment of this terminology (human field) in relation to the overall system of the language and the subfields that are included within it, which is in contrast with the other system outside it (scientific-technical) and within the subfields of the system itself, due to their differentiation in depending on systems of concepts that serve as limiting circles, which simultaneously separate one subfield from another with a certain limit. The differentiation between the systems is proven by the factual-illustrative confrontation of the fields and subfields of the two main terminological systems of knowledge, the influence that conceptual systems exert on the division of fields and subfields. Equally interesting is the presentation of the specifics, phenomena and disadvantages of the terminology of this field, including the schematic, hierarchical and systematic presentation not only of this terminological field, but of the entire lexical system of the Albanian language. This publication in its last part continues with the sub-topic: developments and problems in the current situation and the perspective and tasks for the future.

**Keywords:** technical-scientific terminology; the humanities terminology; conceptual systems; Albanian lexical system; subfields, etc.

### A. Vendi dhe identiteti në leksikon e gjuhës

Leksiku terminologjik i fushave humane në gjuhën shqipe, sikurse në çdo gjuhë tjetër, përbën një sistem njësisish leksikore të specializuara (terma njëfjalësh dhe terma togfjalësh) dhe, i mevetësuar si i tillë, i kundërvihet sistemit tjetër terminologjik, siç është terminologjia shkencore-teknike<sup>1</sup> ose, siç është quajtur, edhe tekniko-shkencore<sup>2</sup>. Të dyja këto sisteme, që funksionojnë si nënsisteme në kuadër të sistemit leksikor tërësor të gjuhës standarde shqipe, i kundërvihen

1 Duro A., Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe përmbajtjes), Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009, pikërisht këtu përdoret termi “terminologjia shkencore - teknike”

2 Leka F., Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore, Tiranë, 1983.

nga ana tjetër, sistemit leksikor të gjuhës së përgjithshme. Duhet nënvijëzuar se, pavarësisht nga anët e përbashkëta me terminologjinë e fushave shkencore-teknike, kjo terminologji është vështruar e trajtuar kryesisht brenda rrethit të leksikut politiko-shoqëror, gjë që i ka dhënë këtij të fundit statusin e një leksiku më të gjerë, duke përfshirë në të edhe leksikun terminologjik të fushave humane. Kështu, prof. Miço Samara<sup>3</sup> në veprën e tij “Leksiku politiko-shoqëror”, në kuadrin e trajtimit të leksikut të përgjithshëm politiko-shoqëror (terma dhe joterma) vështron edhe terma të terminologjisë humane, sidomos nga fusha e politikës dhe sociologjisë. Duke u nisur nga etimologjia e termelementit “human” mund të shihet se ky termelement identifikohet me “njerëzor” (“human” – “njeri”), që do të përafrohej me termin tjetër “antropologjik” (në kuptimin e sotëm të këtij termi).

Duke e vështruar këtë terminologji herë më gjerë dhe herë më ngushtë, nuk i është dhënë asaj vendi që i takon, duke e përfshirë atë, nga njëra anë, edhe në sistemin e fushave të tjera, duke e konceptuar më të ngushtë nga sa mendohej, dhe, nga ana tjetër, të veçuar si sistem i mëvetësuar, i identifikuar me kufij ndarës të përcaktuar përkundër sistemit tjetër, atij shkencor-teknik, pra, duke e pranuar atë si një sistem real njësisht, që i përgjigjet një sistemi konceptor të nënfushave përkatëse, d.m.th., si një sistem terminologjik *sui generis*. Nisur nga ky këndvështrim, do të theksonim se, ashtu sikurse identifikohet deri më sot terminologjia shkencore teknike, që ka si objekt pasqyrimin e sistemeve (nënsistemeve) të fushave natyrore (pra, si objekt *natyrën*) (zool., bot., mjek.), fushat e sakta (*mat., gjeom., kimi*) dhe atë teknike (*ndër., elek., mek.*), po kështu, edhe kjo terminologji, duhet pranuar si sistem leksikor i mëvetësuar, që shpreh koncepte të specializuara që lidhen me tri baza: fushat e mendimit (*fe, filozofi, logjikë*), fusha e shpirtit njerëzor (*psikologji, letërsi, art*) dhe ato shoqërore, së bashku me njeriun, si qenie shoqërore në marrëdhënie me këtë të fundit, me nënfusha të tilla, si: *historinë, sociologjinë, politikën, pedagogjinë, ekonominë, jurisprudencën (të drejtën)* dhe ndonjë fushë tjetër me karakter e natyrë komplekse, si *gjuhësinë, arkeologjinë, antropologjinë*. Po këtu mund të futen edhe fusha të ndërmjetme, si, *etnologjia, gjeopolitika, sociolinguistika, psikolinguistika*, etj.

E vështruar në mënyrë të përgjithshme, kjo terminologji mund paraqitet në lidhje me sistemin tërësor të gjuhës dhe në marrëdhënie me nënfusha që përfshihen në të. Gjithashtu, mund të vërehet se kjo terminologji ka anë të përbashkëta në format shprehëse të përmbajtjes së koncepteve prej njësisive që i përbëjnë ato (termave), por që kundërvihen si brenda, ashtu edhe jashtë tyre nga ana e diferencimit të nënfushave në varësi të sistemeve të koncepteve që shërbejnë si rathë kufizues, të cilat ndajnë me kufi të caktuar njërën nënfushë nga tjetra. Kështu, në vartësi të rrethit kufizues të sistemeve të termave mund të kalojmë nga termat dhe prej këtyre tek fushat (nënfushat: *shpirt, frymë (fe); mendim, arsyesim (logj.); kujtesë, logjikë (psik.)*, etj. Nëpërmjet tyre mund të zbulojmë karakterin, përmbajtjen themelore të dy terminologjive në kundërvënie njëra me tjetrën. Kështu, p.sh. ndërmjet dy

3 Samara M., Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe (vështrim leksikologjik e leksikografik), Tiranë, 2008.



grupime termash mund të zbulohen qartë përmbajtjet konceptore, të përkundërta, të ndryshme brendapërbrenda secilit grup termash në përputhje me nënfushat, të cilave ata u përkasin:

**Terminologjia shkencore-teknike:** *kënd, rreth (gjeom.), numër, barazim (mat.), shpend, kafshë, zoq (zool.), njeri (si qenie natyrore), sy, këmbë (mjek.), rrymë, llambë (elek.), celular, fjalëkalim (kompj.), etj.,* si emërtime konkrete, por edhe emërtime abstrakte me përmbajtje konkretësie: *vizatim, të ushqyerit, etj.*

**Terminologjia e fushave humane:** *fymë, shpirt (fe), ide, koncept (filoz.), të menduarit, gjykim (logj.), folje, ndajfolje (gjuh.), ligj, e drejtë (jur.), etj.*

Si veçori themelore e përbashkët ndërmjet dy terminologjive është pikërisht prania e termave që shprehin koncepte të specializuara, si edhe fushat përkatëse, që identifikojnë termat si brenda dy sistemeve të mëdha të ndryshme, kurse si veçori themelore dalluese janë pikërisht përmbajtjet konceptore në kundërvënie me njëra-tjetrën: në terminologjinë shkencore-teknike shprehjen prej *termave të përmbajtjeve konceptore relativisht konkrete, të përcaktuara, të identifikueshme*, kurse në terminologjinë e fushave humane shprehjen prej *termave të përmbajtjeve konceptore relativisht abstrakte, me kufij të papërcaktuar qartë ndërmjet koncepteve, me kalime konceptesh nga njëra fushë në tjetrën*. Këtu për konkretizim po sjellim të shëmbëllsuar rastin e funksionimit të termit “njeri”:<sup>4</sup> në fe: “*qenie e Zotit*”, në filoz.: “*qenie që mendon*”, në sociologji: “*qenie shoqërore*”. Megjithatë, brendapërbrenda një fushe, termi nga pikëpamja e mbajtjes konceptore vështrohet nga anë të ndryshme, si një koncept i vagëllyer me shumë këndvështrime brenda një përmbajtje konceptore të vetme, si p.sh. “demokraci” sipas “Fjalorit politik”: a. “sundimi i shumicës” b. “barazi politike” c. “sundim me përfaqësim”<sup>5</sup>. Me këtë rast mund të sjellim si shembull ndonjë rast, kur edhe terma që kundërvihen në kuptime të caktuara mund të identifikohen (njëjtësohen) ose e kundërta, kjo vihet re sidomos kur mund të krahasojmë ndonjë term të kuptimeve të sotëm me atë të periudhës së diktaturës tek ne, si p.sh.: termin demokraci me diktaturë. Kështu, p.sh. në periudhën e komunizmit qarkullonte parulla e afishuar në shumë vende: “**Diktatura e proletariatit – forma më e lartë e demokracisë**”. Siç del nga thënia e mësipërme termi diktaturë (e proletariatit) identifikohet (barazohet) me termin demokraci, e kuptuar në mënyrën, që diktaturë e proletariatit përfaqësonte shumicën (popullin shumicë), që si i tillë kishte të drejtën të sundonte pakicën, pra, si shumicë, si popull është demokraci, meqë demokraci = fjala / qeverisja e popullit (gjykuar edhe nga etimologjia dhe historia e formimit të saj nga Aristoteli). Po ashtu edhe fjalët që në vështrimin e përdorimit të zakonshëm duken konkrete, si terma, si shprehëse së koncepteve shkencore, janë abstraktë si: *liri, demokraci, politikë, shoqëri, etj.* Gjithashtu, edhe në praktikën ligjërimore (media, publicistikë) takojmë: *terma të politikës, të së drejtës, sociologjisë, antropologjisë, etj.* Ky fakt, që shpreh edhe


4 Myrtezai E., Fjalor i filozofisë, Tiranë, 2007.

5 Jain Mc Lean., Fjalori i politikës, Oxford, Tiranë, 1996.


specifikën e kësaj terminologjie, bën të domosdoshme vështrimin dhe trajtimin e thellë, të gjerë të termave të saj nga ana e *përmbajtjes* dhe e *formës*, të katalogjizimit të tyre në fjalorë jo vetëm që përdoren nga specialistët e fushave përkatëse, por edhe në praktikën ligjërimore të zakonshme. Kjo gjë mund të vërehet në shtyp, në gazeta, revista, në shkrimet e specialistëve, por që, kur shkruhen për publikun e gjerë, ata përbëjnë problem nga ana e të kuptuarit nga njerëzit e zakonshëm, siç mund të shihet tek termat edhe në shtypin e përditshëm p.sh.: *inflacion, deflacion, remitancë, recesion, introvers*, etj. Disa prej tyre kuptohen vetëm nga specialistët e fushës, shumica, nga njerëzit e zakonshëm, përdoren pa u kuptuar ose të kuptuara përafërsisht edhe kur përdoren si togfjalësha si p.sh.: *aminsti fiskale, kredi e butë, politikë informale, demokraci funksionale* etj. Sidomos këtu duhet të përmenden cilësorët në kombinim me gjymtyrë të ndryshëm, si: *informal* (zonë informale), *paradoksal* (situatë paradoksale) të përdorura shpesh nga specialistët, analistët në shkrimet e tyre në shtyp, në media, etj.)

Duke u nisur edhe nga qëllimi që i kemi vënë vetes në këtë referat, për të nxjerrë në pah edhe vendin dhe identitetin e kësaj terminologjie, do të paraqesim skematikisht në mënyrë të përmbledhur lidhjet e saj hierarkike dhe sistimore me të gjithë sistemin leksikor të gjuhës standarde shqipe, si edhe atë të veçuar në mënyrë më të diferencuar në fusha, nënfusha e ndonjëra edhe në mikrofusha.


### 1. Paraqitje skematike tërësore (Skema 1)



(Skema 2)



(Skema 3)



### 3.1. Lidhjet ndërmjet fushave

a. Fushat (nënfusha ndërmjetëse): *ekonomi politike, sociolinguistikë, etnolinguistikë, etj.*

b. Fushat (nënfusha) e derivuara (të prejardhura): **Ekonomi:** tregti > marketing; financë > biznes, banking.

c. Fusha (nënfusha) të integruara: **Histori + fusha:** *histori e filozofisë, histori e fesë, histori e sociologjisë, etj.*

Paraqitja e skematizuar dhe e strukturuar e vendit dhe e identitetit të terminologjisë së fushave humane (sikurse mund të vërehet edhe për terminologjinë shkencore-teknike) shërben në mënyrë të veçantë për të monitoruar<sup>6</sup> gjithë këtë terminologji në vështrimin dhe vlerësimin e gjendjes, funksionimit, zhvillimit e saj të diferencuar sipas fushave (nënfushave) përkatëse, për të veçuar e për t'u fokusuar

<sup>6</sup> Shih për këtë problem: Duro A., “Studime gjuhësore 1”, Tiranë 2012 & “Studime gjuhësore 2”, Tiranë 2018.

në përpunimin, sistemimin dhe shqipërimin e saj në fushat (nënfushat) përparësore, për katalogjizimin në fjalorë të tipave të ndryshëm në bazë të lëndës leksikore të mbledhur që qarkullon në fushat e saj. Po ashtu, ajo vlen për grumbullimin dhe sistemimin e saj në databaza për t'u përpunuar me metoda kompjuterike me mjetet e teknologjisë së sotme, sidomos fjalorët shpjegues (përkufizues) sistemorë etj.

## B. Zhvillime dhe probleme në gjendjen e arrirë

Siç është theksuar më sipër, ndonëse kjo terminologji në zhvillimin e saj ka ecur paralel me terminologjinë si motër, atë shkencore-teknike, vëmendja, studimi dhe katalogjizimi i saj nuk mund të ishin të njëjtë me atë shkencore-teknike për arsyen kryesore, se kjo e fundit terminologjia shkencore-teknike përbënte sikurse edhe përbën, një fushë veprimtarie praktike shumë problematike (zhvillimi shumë intensive sidomos i shkencave natyrore, teknike, që çojnë në rritjen sasiore të vrullshme të kësaj terminologjie, sidomos në depërtimin e termave të huaj, etj.). Me këtë shpjegohen studimet e shumta orinetuar nga kjo fushë, si fjalorët e shumtë të hartuar në rrugë institucionale (rreth 70)<sup>7</sup> dhe vetjake (me dhjetëra të tillë).

Megjithatë, në mënyrë shumë të përmbledhur, mund të nënvizohet se realisht, historikisht, terminologjia e fushave humane zë fill në formë të shkruar qysh në veprat e autorëve të vjetër, tek Buzuku e më vonë tek Budi, Bogdani, ku tek Bogdani gjejmë një varg termash nga fusha e fesë (*teologjia e liturgjia*). Po kështu më vonë depërtojnë nga fusha të tjera, historia, arti, etj. Një varg termash nga nënfushat humane pasqyrohen në Fjalorin e Frang Bardhit<sup>8</sup>, si nga fusha e fesë p.sh.: *bekim, engjëll, frymë, kishë, lutje, referim, uratë* (rreth 44 terma); nga fusha e drejtësisë: *ankim, dëshmi, ligj* (rreth 28 terma); po kështu nga fusha e *tregtisë, edukimit, gjuhësisë* p.sh.: *gjuhë, fjalë, emër, etj.* Ndonëse në terminologjinë shkencore-teknike, sidomos në shkencat natyrore e të sakta, hidhen bazat fillestare qysh në Rilindjen kombëtare (*bot., zool., mat.*), terminologjia e fushave humane u zhvillua në mënyrë të njëanshme, kryesisht në fushën e *gjuhësisë, jurisprudencës, ekonomisë*<sup>9</sup>. Këtu vlen të përmendet puna e bërë nga Komsia e Shkodrës (1916)<sup>10</sup>, e cila hartoi dhe Fjalorthin e parë të terminologjisë shqipe në termat e fushës së të drejtës (*administratës shtetërore*), ku u pasqyrua një listë termash të administratës shtetërore me rreth 360 njësi, ku mbizotëronin termat shqip dhe të shqipëruar, para termave turke. “Komsia e Shkodrës” hodhi themelet e një terminologjie me bazë shqipe, duke nxjerrë jashtë gjuhe terminologjinë turke të kësaj fushe. Zhvillimi i saj i mëtejshëm i përket hapjes së shkollave shqipe të arsimit të mesëm (për terminologjinë e *gjuhësisë, psikologjisë, pedagogjisë, ekonomisë, të së drejtës*)

7 Proko V., Martiri I., Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra, Bibliografi e terminologjisë, Tiranë, 2009, fq. 243-296.

8 Për më shumë referuar: Duro A., Proko V., Studime gjuhësore I, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012, fq. 186.

9 Pasho H., Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017, fq. 101-201.

10 Lafe E., revista “Perla”, Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe, 2010/2-4, Tiranë.

dhe më vonë të arsimit të lartë, ku u përhap kjo terminologji pasqyruar në lëndët përkatëse dhe në fjalorë. Puna e kufizuar në drejtim të kësaj terminologjie deri në ditët e sotme mishërohet në fjalorët e pakët, përqëndruar kryesisht në fushat e *gjuhësisë, ekonomisë, të së drejtës dhe më rrallë të psikologjisë, filozofisë, politikës, fesë*. Ajo është e orientuar kryesisht në fjalorët shpjegues, rrallë të shoqëruar me terma të huaj, si *fjalori i politikës, i sociologjisë* e ndonjë tjetër. Mund të pohohet, gjithashtu, se puna në këtë fushë ndonëse e kufizuar, është orientuar sidomos në drejtim të studimeve të mirëfillta shkencore lidhur me gjendjen, zhvillimit dhe funksionimin e saj dhe në organizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore.

Përsa i përket studimit dhe funksionimit të kësaj terminologjie, duhet drejtuar vëmendja në një *varg veçorish* të saj, krahasuar me terminologjinë shkencore-teknike, që lidhen me të njëjtën dukuri, por që dallohen nga format e shfaqjes së tyre sidomos në anën e lidhjes në format e përmbajtjes, marrëdhëniet e termave njëri me tjetrin në sistemin dhe mikrosistemin e lidhjeve konceptore, në të cilat ndërthuren dukuri të anës semantike të termave që shfaqen si mangësi të leksikut terminologjik edhe në fushat humane, sidomos në gjuhës, ekonomi, e drejta etj., (polisemisë, sinonimisë, dysorësisë, pseudodysorësisë, etj.).

Më poshtë po sjellim dukuri në paraqitje të sintetizuar:

1. Lidhjet e termave njëfjalëshe në mikrosisteme në bazë të një termi, që shërben si bërthama e mikrosistemit termformues si tek: *shtet, ligj, votë, gjyq, politikë, demokraci, popull*, etj. Tek termi *ligj* (sipas çerdhes së tij): *ligjor/e – ligjësoj – ligjësim – ligjësi – ligjshëm, nënligjor, ligjvënës, ligjbërës, i paligjshëm*, etj. Po kështu tek termi: *politikë – politik/e – politika – politikbërës – politizoj – politizim – politizuar* etj. *Fal – falem – falje – faltar – faltore – i falur (të); shtet – shtetëror – nënshtetas – nënshtetësi – nënshtetëror*, etj.

2. Lidhje të elementit të përcaktuar me atë përcaktues, gjë që krijon togfjalësha të shumtë me bërthamë elementin e përcaktuar. Kështu me *ligj*<sup>11</sup> formohen togfjalëshat (dygjymtyrësh): *ligj themelor, ligj vendor, ligj penal, ligj parlamentar, ligj i pagesës, ligj i trashëgimisë*, etj. Togfjalësha shumëgjymtyrësh me termin bazë *ligj*: *ligj i kompensimit të punonjësve, ligje pa fuqi prapavepruese, ligj për ndreqjen e gabimeve, ligj për thyerjen e të drejtës së punës, ligj kundra shitjes së mallrave nën kosto, ligj për afatet kohore (të veprimeve ligjore), ligje për ndarjen e pasurisë pa testament*, etj. ...<sup>12</sup> Në një lidhje të tillë togfjalëshi i thjeshtë (dygjymtyrësh ose dyfjalësh) me atë të zgjeruar (shumëgjymtyrësh ose shumëfjalësh) përbëjnë pjesën mbizotëruese të kombinimeve togfjalësore. Mund të vërehet se mesatarisht çdo sistem terminologjik mund të ketë 80% të përbërjes terma togfjalësha, sikurse mund të vërehet edhe në terminologjinë shkencore-teknike.

11 Buza L, Delija Sh., Tabaku E., Fjalor terminologjik për drejtësinë (ang-shq, shq-ang), Tiranë, 2006.

12 Po aty, po ato.

3. Kalime të termave që shërbejnë si termelemente të togfjalëshave (ose fjalëve diturore) nga njëri sistem kryesor në tjetrin (nga ai shkencor-teknik në atë human), të cilët në kombinim me termelementin tjetër formojnë terma togfjalësh të ndryshëm të sistemit përkatës. Këtu vërehen dy raste: a) termelemente të përcaktuar si: *pjesë, kusht, gjendje, afat, pozicion* (vendndodhje), *dukuri*, etj.; *gjendje agregate* (shk.-tek.), *gjendje stanjacioni* (amullie) (kimi); *kusht teknik* (shk.-tek.); *kusht paraparak* (jur.). b) term elemente përcaktuese, kryesisht mbiemra: *i madh, i vogël, i rëndë, i lehtë, i thjeshtë, i ndërlikuar*, si: *plug i rëndë* (shk.-tek.), *dënim i rëndë*, etj.

4. Nga ana e termformimit mund të takohen terma kompozita, të cilët shquhen për motivueshmëri të lartë të përbërjes konceptore të termit p.sh.: *shtetrrëthim, shtetformim, politikëbërje, taksapagues, azilkërkuues, llogaridhënie, vendimmarrës* etj. Këtu mund të përfshihen terma të prejardhur me përbërje parashtesore, prapashtesore, si edhe elemente fjalëformuese ndërshtesore (infixe), si *pandëshkueshmëri* (pa - ndëshkueshm - ëri); *përmbarimor* (për – mbar –im -or), *kushtetutshmëri, këshillimor, përmbarimore, këmbimore* (shkëmbim valutor), etj.

Po paraqesim të njehsuara në formë statistikore aftësinë termkombinuëse të njëjësive që shfaqen si temelemente të përcaktuara, por edhe përcaktuese, të vështruara në strukturën fjalësore të disa termave, si: ligj, aftësi, pjesë; ligjor, demokratik, popullor nga disa nënfusha si: ligj (jur.) – 18 togfjalësha; ligjpenal, ligj i huaj, etj.; e drejtë (jur.) – 80 togfjalësha; demokraci (pol.) – togfjalësha. Po kështu termoelementi përcaktues: ligjor-e, demokratik-e, politik-e.

Në disa raste mund të vërehet se termat togfjalësh (dy e mbidygjymtyrësh) përbëjnë sasinë mbizotëruese të fjalëve. Kështu në fjalorin e “Termave të planifikimit” nga 758 terma ka vetëm 8 terma njëfjalësh, 236 dyfjalësh dhe 514 mbidyfjalësh. Kjo mund të vërehet edhe në disa fjalorë të tjerë, sidomos të serisë terminologjike, si tek termat e së drejtës<sup>13</sup>. Kjo dëshmon se për një mbingarkesë të

13 1. **Terminologjia e së drejtës ndërkombëtare (shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-italisht)**. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Sektori i Terminologjisë, Tiranë, 1970. Hartues: Arben Puto, Dhori Samsuri, Qamil Çaçi (specialistë); Ferdinand Leka, Lirak Dodbiba, Mahir Domi, Pashko Geci, Sofika Morcka (gjuhëtarë). Redaktorë: Andrea Nathanaili, Arben Puto, Lirak Dodbiba, Sofika Morcka, Vangjel Meksi.

2. **Fjalor i termave të së drejtës (shqip frëngjisht-rusisht)**. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i Terminologjisë dhe i Kulturës së Gjuhës, Tiranë, 1986, 496 f. Hartues: prof. Andrea Nathanaili, doc. Vangjel Meksi, kand. shk. juridike Zejnullah Ballanca, doc. Paskal Haxhi (juristë); bashk. vj. shk. Lirak Dodbiba, Sofika Morcka, Ferdinand Leka, Hëna Pasho, Veli Bici (gjuhëtarë). Redaktorë: Sofika Morcka, bashk. vj. shk. Lirak Dodbiba, Paskal Haxhi, Dhimitër Evangjeli.

3. **Fjalor terminologjik për drejtësinë (shqip-anglisht, anglisht-shqip), Tiranë, 2002, 237 Hartues: KALO Përparim, Çausi Arben, Dado Vilsa, Shehi Ardiana.**

4. **Fjalor terminologjik juridik** (me 7000 terma juridikë). Hartues: OSMANI Afrim, Shkup, 2004.

5. **Terminologjia e së drejtës ndërkombëtare (shqip-serbokroatisht-rusisht-anglisht-italisht)**, Prishtinë, 1970, 286. Hartues: Samsuri Dhori, Çaçi Qamil.

6. **Fjalor terminologjik juridik (serbokroatisht-shqip)**. Prishtinë, 1979, 181 + 10 fq.

7. **Fjalor i terminologjisë juridike (anglisht-shqip; shqip-anglisht)**; Laë dictionary (English-Albanian);

disa fjalorëve me terma togfjalësh, të cilët me ripunimin e tyre duhen reduktuar në masë të ndjeshme, meqë kjo mbingarkesë (tepri me terma!) e bën të pavlefshëm shfrytëzimin e tyre nga përdoruesi, siç e ka dëshmuar edhe politika e shfrytëzimit të kufizuar të tyre.

5. Disa formime që rezultojnë si kalime të njëjës kategori leksiko-gramatikore në tjetrën: a) **pjesore > mbiemër > emër**: *dënuar > i dënuar/i; arrestuar > i arrestuar > i arrestuar/i*. Të tilla formime takohen në numër të madh në këtë terminologji b) **mbiemër > emër në gjininë femërore**: *e vërtetë > e vërteta; e bukur > e bukura; e shëmtuar > e shëmtuara; e shenjtë > e shenjta; logjik-e > logjik/ja* (“ana logjike”); *historike > historikja*, etj.

6. Lidhur me *fjalorët terminologjikë* mund të nënvizohet se ata janë të tipave shpjegues (enciklopedik-terminologjik) me ose pa gjuhë të huaja, hartuar kryesisht nga specialistët e fushave përkatëse pa bashkëpunuar me gjuhëtarët, prandaj në ta vihen re mangësi të theksuara të karakterit gjuhësor (kryesisht sintaksor), të ngarkesës së tyre me terma të huaj, pa aktivizuar termat shqip ose të shqipëruar, si dhe të paraqitjes së termave, përkufizimet e tyre dhe shpjegimet përkatëse me paraqitjen leksimore të pastrukuruar nga ana terminografike, pra përfshirjen e termave nomenklaturorë shumëgjymtyrëshe, madje emërtime historike. Për fjalorët e hartuar para viteve ‘90 mund të vërehen edhe formime të politizuara.

### **Nga ana e mangësive vërehen:**

7. Marrëdhënie dysore, kryesisht të termave shqip (të shqipëruar) në të huaj ku në disa raste del si i parë termi i huaj, kurse në raste të tjera termi shqip ose të dy përdoren paralel p.sh.: *miratim/aprovim; kuvend/parlament*, etj. Po ashtu vijojmë me: *kusht/konditë; mjedis/ambjent, dukuri/fenomen* etj.

8. Marrëdhënie termash si pseudodysorë, me kufij të papërcaktuar, ku njëri përdoret në vend të tjetrit, por që realisht duhen pranuar si terma të ndryshëm p.sh.: *shpirt/frymë, jurisprudencë/e drejta/ drejtësia, nocion/koncept/ide; prodhim/produkt; human /humanitar/shoqëror/social; lider/lidership/udhëheqës* etj.

Mangësi të theksuara vërehen sidomos në pasqyrimin në ta të termave togfjalësh të zgjeruar (shumëgjymtyrësh) në nivelin e gjysmëpërkufizimeve veçarisht në fjalorët e fushave të ekonomisë, të së drejtës dhe atë politik. Këtu gjej rastin të përmend disa prej tyre, në fushë të ekonomisë: *derdhje e tepricës së të ardhurave neto të ndërmarjes në buxhet* (prej nga mund të nxirrim dy deri në tri terma togfjalësh dy ose trigjymtyrësh, si normë standarde në terminologji si:

---

Albanian–English). Hartues: Hasani Shefije, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1998, 386.

8. **Fjalorth terminologjik i të drejtave të njeriut (Terma dhe shprehje bazë të të drejtave të njeriut (shqip-anglisht; anglisht-shqip)**; Human Rights Glossary (Essential Human Rights Terms and Phrases in Albanian/English; English/ Albanian). Hartues: Methasani Eralda, Mushkolaj Gjylieta, (në bashkëpunim/in consultation ëith Theodore S. Orlin dhe/and Paolo Fontani), UNESCO, Tiranë, 2002, 323.

*derdhje e të ardhurave neto; derdhje neto në buxhet; etj.); shkelje dispozitash në monopolin e tregtisë së jashtme, etj. Në fushë të së drejtës: dorëzim tek armiku i forcave ushtarake dhe mjeteve të luftimit; e drejtë e padisë në kuptimin procedural; marrje në punë në pajtim me nevojat e shoqërisë, etj.*

- Terma të politizuar në përmbajtjen e tyre konceptore. Në Fjalorin e ekonomisë: *ligji i zhvillimit të pabarabartë ekonomik e politik të vendosur kapitalist në periudhën e kapitalizmit; drejtim unik i ndërmarrjes socialiste; shtetëzim socialist i mjeteve të prodhimit, etj.*

Në terminologjinë e së drejtës: *pleniumi i Gjykatës së Lartë; përvetësim i pasurisë socialiste të vënë në dorë gabimisht rastësisht, Partia e Punës e Shqipërisë, grabitje e pasurisë socialiste, etj.*

Në Fjalorin e termave të pedagogjisë, takohen edhe emërtime të veçanta brenda teksteve shpjeguese të termave si *parti, plenium, socializëm, socialist, komunist*, si dhe shprehje tematike (data ngjarjesh), emra personalitetesh në fushat e pedagogjisë. Mund të përmendim emërtime e shprehje të tilla si: *Fjala e 7 Marsit e shokut Enver, kontrolli punëtor e fshatar në arsim, lëndët e marksist-leninizmit në shkollë, boshti ideologjik marksist-leninist.*

- Mbizotërimi i termave të huaj, sidomos të atyre që janë barsvlerësuar në shqip si *princip, abuzim.*

- Futja pa vend e termave anglezë: *implementim, apdejtim, event, fizibilitet, alono, bekgraund, lobim, menaxhim, etj.*

- Mosaktivizimi i termave shqip ose të shqipëruar që përdoren (janë futur) në përdorim në literaturën e fushave përkatëse ose që përdoren rrallë në praktikën ligjërimore: *rrezik (risk), miratim (aprovim), kusht (konditë).*

9. Vlen të përmenden një varg konferencash shkencore të posaçme në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni për gjendjen dhe zhvillimin e terminologjisë shqipe të fushave të ndryshme të dijes (përfshirë terminologjinë shkencore-teknike dhe më pak e trajtuar ajo e fushave humane). Ndërkaq, tubime shkencore me temë të ngushtë bosht *gjuha e specializuar në fushat humane dhe trajtimi i probleme teorike e praktike të saj* janë më të pakta në numër. Nga sa kemi mundur të eidentojmë, së bashku me konferencën e sotme mund të citojmë disa prej tyre:

1. Dy konferenca për terminologjinë fetare në Kosovë dhe në Shqipëri (Prishtinë, 1995. Tiranë, 2005).

2. Konferenca për “Gjendjen dhe zhvillimin e terminologjisë shqipe”, Tiranë (2009).



### 3. Konferenca terminologjike në shkencat e ligjërimit, Elbasan (2012)

Lidhur me problemet e detyrat e terminologjisë (veçanërisht asaj shkencore-teknike) janë mbajtur kumtesa dhe referate pothuajse në të gjitha veprimtaritë shkencore (konferenca, simpoziume) për çështje lidhur me leksikon terminologjik të shqipes të mbajtura në Shqipëri në Kosovë dhe Maqedoni. Duhet përmendur një varg studiuesish të njohur në fushën e terminologjisë, të cilët kanë trajtuar dhe probleme të teorisë dhe praktikës terminologjike si L. Dodbiba, F. Leka, H. Pasho, A. Duro. Në Kosovë: P. Nushi, H. Gorani, N. Caka, G. Pllana etj.

Nuk duhet lënë pa u përmendur, emrat e një varg autorësh, të cilët me studimet e tyre në veprimtaritë shkencore që kanë organizuar posaçërisht për terminologjinë kanë dhënë dhënë kontribut edhe për probleme të fushave humane, veçanërisht për gjuhësinë (Sh. Rrokaj, V. Bello); për psikologjinë (P. Nushi); për ekonominë (H. Pasho, H. Gorani); për drejtësinë (S. Titini); për fenë (E. Murtezai); për letërsinë (R. Kryeziu), etj.

Një drejtim tjetër i studimeve në fushën e terminologjisë përbëjnë punimet në nivel monografish, ku trajtohen në mënyrë të gjerë e të thellë çështje të veçanta të terminologjisë, të teorisë së saj, praktikës së përdorimit të termave, të funksionimit në gjuhën shqipe, duke bërë përjasje në raste të caktuara edhe me gjuhë të tjera. Kështu në tërësinë e tyre, në mënyrë të përafërt, deri në ditët e sotme janë hartuar rreth 15 punime, një pjesë e tyre janë të botuara. Si autorë veprash të botuara mund të përmendim: F. Leka, A. Duro, H. Pasho, H. Çipuri, V. Proko (në Shqipëri); N. Roshi, Shkëlqim Kuqo, Sh. Hasani (Shefkijë), H. Gorani etj.

Një ndër kontributet më me vlerë, të cilat nxjerrin në pah në mënyrë të veçantë veprimtarinë praktike në fushën e terminologjisë, siç janë fjalorët terminologjikë të shumtë, të hartuar nga specialistë në bashkëpunim me gjuhëtarë (sidomos fjalorët e serisë terminologjike (rreth 33) nga specialistë të veçantë etj. Në fushën e terminologjisë shkencore teknike janë me dhjetra, kurse në nënfushat humane janë hartuar në numër më të kufizuar. Nga sa kemi mundur të hetojmë mbizotërojnë fushat<sup>14</sup>: e gjuhësisë; e ekonomisë; e së drejtës; e letërsisë; e psikologjisë; e fesë etj.

#### 14 Fjalorë terminologjikë të fushave humane të hartuar nga autorë të veçantë ose grup autorësh:

- Bozhigradi M., Pasho H., (1983): Fjalor i termave të ekonomisë politike (sh-fr-rus), Tiranë.
- Caushi T.: Fjalor i estetikës.
- Dodbiba L., Leka F., Morcka S., (1973): Fjalor i terminologjisë së drejtësisë (shq-rus-fr).
- Ekrem M., (2000): Fjalor i feve, Rilindja, Prishtinë.
- Ekrem M., (2007): Fjalor i filozofisë, Toena, Tiranë.
- Elsie R., (2005): Leksiku i kulturës popullore shqiptare, Tiranë.
- Fjalor terminologjik juridik serbokroatisht-shqip, Prishtinë, 1979.
- Gjergj Zh., (1965): Fjalorth termash letrarë (për nxënësit e shkollave të mesme), Tiranë.
- Hajrullah G., (1973): Fjalor i terminologjisë ekonomike, Prishtinë.
- Kalaja E., (2010): Fjalor i marrëveshjes së stabilizim asocimit (shqip-anglisht, anglisht-shqip),

Numri i tyre i kufizuar nxjerr si detyrë për specialistët dhe gjuhëtarët, që të aktivizohen në mënyrë të veçantë për ndërmarrjen në të ardhmen jo vetëm për hartimin e fjalorëve të rinj, por edhe për të përditësuar edhe fjalorët ekzistues, sidomos duke i zhveshur nga politizimet, të cilat kanë mbetur nga e kaluara për t'i pasuruar me informacion të ri, veshtruar ky problem sidomos në kushtet e zhvillimeve të vrullshme të terminologjisë, hapjes së Shqipërisë me botën, etj.

### C. Prespektiva e detyra për të ardhmen

Situatë e re e krijuar këto më shumë se 30 vite pluralizëm në vendin tonë, hapja me botën, dukurinë e globalizmit kundër lokalizmit ka zgjeruar shumë anë sasiore të kësaj terminologjie ku mbizotërojnë termat togfjalësh për konceptet e reja që vijnë nga bota e jashtme e që depërtojnë në *kulturë, politikë, ekonomi, në të drejtën*, në termat e huaj vecanërisht nga *anglishtja*.

Gjithë kjo kërkon evidentim të gjendjes, mbledhjen e lëndës me metoda elektronike, përpunimin dhe sistemimin e saj, si dhe pasqyrim në fjalorët e tipave të ndryshëm, por, gjithmonë duke bashkëpunuar specialistët me gjuhëtarët.

Në të ardhmen përveç punës studimore, kërkimore-shkencore rreth kësaj terminologjie, sidomos në fushën e *fesë, politikës, psikologjisë, ekonomisë, të së drejtës*, kërkohet orientim i praktikës terminologjike në organizimin e mekanizmave e hallkave të përfshira në politikën dhe planifikimin gjuhësor në këtë fushë, për

---

Ministria e Integritimit, Tiranë.

- L. Dodbiba, F. Leka, S. Morcka, (1974): Fjalor i terminologjisë së gjuhësisë.
- Leka F., Podgorica F., Hoxha S., (1972): Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, Tiranë.
- Nase Ll., (1982): Fjalor i termave të bibliotekës dhe të bibliografisë (shq-fr-rus), Tiranë.
- Pajazit N., (1987): Fjalor i psikologjisë, Prishtinë.
- Pëllumbi S., Spahiu F., (1974): Fjalor i filozofisë, Tiranë.
- Ramadan S., (1965): Fjalorth etnomuzikologjik në veprën Folklori muzikor shqiptar (morfologjia), Tiranë.
- Sacca Antonio (Mineu Elda) (2009): Fjalor i Sociologjisë “Almera”, Tiranë.
- Samsuri Dh., Çaçi Q.: Terminologjia e së drejtës ndërkombëtare (shqip-rus-fr-ang-it), Prishtinë.
- Shefik O., (1983): Fjalor i pedagogjisë, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë.
- Xoxa J., Kostallari A., (1965): Terminologjia e letërsisë (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë.

#### **Fjalorë të serisë terminologjike (IGJL) në fushë të shkencave humane:**

- Fjalor i së drejtës (shqip-fr-rus.), 1986.
- Fjalor i ekonomisë politike, 1983
- Fjalor i financës, 1985
- Fjalor i planifikimit, 1988
- Fjalor i tregtisë së jashtme, 1989
- Fjalor i tregtisë së brendshme, 1999
- Fjalor i bankës, 2014
- Fjalor i termave të gjuhësisë (shq-rus-fr-ang-gjer-it), Tiranë, 1975.
- Fjalor i termave të tregtisë së jashtme (shq-fr-rus), Tiranë, 1976.
- Fjalor i filozofisë, Tiranë, 1982.

drejtimin ndaj saj të vëmendjes së opinionit shoqëror deri në atë shtetëror.

Kështu del e nevojshme një bashkëveprim e bashkërendim i punës së specialistëve dhe gjuhëtarëve për katalogjizimin e kësaj terminologjie në fjalorë të tipave të ndryshëm, nëpërmjet krijimit të një nënkomisioni që mund të funksionojë atë në kuadrin e një **Komisioni Qendror** të varur nga Akademia e Shkencave dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, duke përfshirë degë e nëndegë të lidhura me katedrat e fushave përkatëse të shkollave të larta, me institucionet kërkimore-shkencore dhe specialistët e bazës.

Si detyrë kryesore e këtij **Nënkomisioni** do të ishte evidentimi i kësaj terminologjie që qarkullon në *media, publicistikë, tekste mësimore* deri në *praktikën ligjërimore*, hedhja e lëndës në databaza elektronike, duke synuar fillimisht në hartimin e një glosari njësisish të termave bazë dhe më tej sipas një plani të caktuar në hartimin e fjalorëve të fushave të veçanta, të tipave të ndryshëm, fillimisht duke orientuar punën drejt fjalorëve dygjuhësh për qëllime përkthimesh dhe më tej në ata shpjegues deri në sistemorë me përkufizime.

## BIBLIOGRAFIA:

- BUZA L, DELIJA Sh., TABAKU E., (2006): Fjalor terminologjik për drejtësinë (ang-shq, shq-ang), Tiranë.
- DURO A., (2009): Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe përmbajtjes), Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- DURO A., (2012): Studime gjuhësore 1, Tiranë.
- DURO A., (2018): Studime gjuhësore 2, Tiranë.
- DURO A., PROKO V., (2012): Studime gjuhësore 1, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, f. 186.
- JAIN MC LEAN., (1996): Fjalori i politikës, Oxford, Tiranë.
- LAFE E., (2010/2-4), revista “Perla”, Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe, Tiranë.
- LEKA F., (1983): Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore, Tiranë.
- MYRTEZAI E., (2007): Fjalor i filozofisë, Tiranë.
- PASHO H., (2017): Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, f. 101-201.
- PROKO V., MARTIRI I., (2009): Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra, Bibliografi e terminologjisë, Tiranë, f. 243-296.
- SAMARA M., (2008): Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe (vështrim leksikologjik e leksikografik), Tiranë.

### **Fjalorë terminologjikë të fushave humane të hartuar nga autorë të veçantë ose grup autorësh:**

- BOZHIGRADI M., PASHO H., (1983): Fjalor i termave të ekonomisë politike (sh-fr-rus), Tiranë.
- CAUSHI T.: Fjalor i estetikës.
- DODBIBA L., LEKA F., MORCKA S., (1973): Fjalor i terminologjisë së drejtësisë (shq-rus-fr).
- EKREM M., (2000): Fjalor i feve, Rilindja, Prishtinë.
- EKREM M., (2007): Fjalor i filozofisë, Toena, Tiranë.
- ELSIE R., (2005): Leksiku i kulturës popullore shqiptare, Tiranë.
- Fjalor terminologjik juridik serbokroatisht-shqip, Prishtinë, 1979.
- GJERGJ ZH., (1965): Fjalorth termash letrarë (për nxënësit e shkollave të mesme), Tiranë.
- HAJRULLAH G., (1973): Fjalor i terminologjisë ekonomike, Prishtinë.
- KALAJA E., (2010): Fjalor i marrëveshjes së stabilizim asocimit (shqip-anglisht, anglisht-shqip), Ministria e Integritimit, Tiranë.
- L. DODBIBA, F. LEKA, S. MORCKA, (1974): Fjalor i terminologjisë së gjuhësisë.
- LEKA F., PODGORICA F., HOXHA S., (1972): Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, Tiranë.
- NASE LL., (1982): Fjalor i termave të bibliotekës dhe të bibliografisë (shq-fr-rus), Tiranë.
- PAJAZIT N., (1987): Fjalor i psikologjisë, Prishtinë.
- PËLLUMBI S., SPAHIU F., (1974): Fjalor i filozofisë, Tiranë.
- RAMADAN S., (1965): Fjalorth etnomuzikologjik në veprën Folklori muzikor shqiptar (morfolgjia), Tiranë.
- SACCA ANTONIO (Mineu Elda) (2009): Fjalor i Sociologjisë “Almera”, Tiranë.
- SAMSURI DH., ÇAÇI Q.: Terminologjia e së drejtës ndërkombëtare (shqip-rus-fr-ang-it), Prishtinë.
- SHEFIK O., (1983): Fjalor i pedagogjisë, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë.
- XOXA J., KOSTALLARI A., (1965): Terminologjia e letërsisë (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë.

### **Fjalorë të serisë terminologjike (IGJL) në fushë të shkencave humane:**

- Fjalor i së drejtës (shqip-fr-rus.), 1986.
- Fjalor i ekonomisë politike, 1983.
- Fjalor i financës, 1985.
- Fjalor i planifikimit, 1988.
- Fjalor i tregtisë së jashtme, 1989.
- Fjalor i tregtisë së brendshme, 1999.
- Fjalor i bankës, 2014.
- Fjalor i termave të gjuhësisë (shq-rus-fr-ang-gjer-it), Tiranë, 1975.
- Fjalor i termave të tregtisë së jashtme (shq-fr-rus), Tiranë, 1976.
- Fjalor i filozofisë, Tiranë, 1982.

# LESIKU TERMINOLOGJIK PJESË E LESEIKUT TË NJË GJUHE DHE ÇDO GJUHE NË PËRGJITHËSI, SI PJESE E VEÇANTË, QË PËRDORET PËR QËLLIME SPECIFIKE

**Prof. Dr. Arben Skëndaj**

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: arskendaj@hotmail.com

## PËRMBLEDHJE

Leksiku terminologjik përdoret kryesisht nga specialistë dhe profesionistë të shkencave të të dy grupimeve kryesore si ato shoqërore ashtu edhe ato ekzakte. Leksik, që jo vetëm i konceptuar specifik si sferë përdorimi, por edhe specifik, mund ta quanim për natyrën e tij, që futet në fjalorin e një gjuhe, mënyrën se si justifikohet dhe administrohet nga aspekte të ndryshme gramatikore në strukturat e gjuhës. Nga natyra e saj, si fjalor terminologjik, ky leksik ka arsye të ndryshme nga ato të leksikut normal, që të krijohet dhe problematikat e tij të jetesës leksiko-semantike janë të ndryshme nga ato të leksikut normal. Ky fjalor për sa i përket etimologjisë, shkaqeve leksikore, që e kanë krijuar dhe tipologjinë e statusit të tij të leksikalizuar në leksikun tërësor, janë të ndryshme dhe nuk është e thënë, që të kenë të njëjtën rrugë dhe rezultat leksiko-semantik. Leksiku terminologjik nuk krijon një gramatikë të vetën, por i nënshtrohet rregullave gramatikore ( fonetike, morfologjike dhe sintaksore ) të asaj gjuhe në të cilën ekziston. Ka raste, që ky leksik mund të krijohet thjesht duke u shtuar një strukture poli-semantike te një fjalë, që ekziston në një gjuhe, por mundet edhe që të krijohet një fjalë e re mono-semantike me kuptimin terminologjik, që e justifikon këtë fjalë në leksik. Për sa i përket sasisë të këtij sasisë të këtij leksiku terminologjik në fusha të caktuara, qoftë ato shoqërore, qoftë ato ekzakte ka situata të ndryshme; ka fusha, që kanë shumë leksik, por ka edhe fusha, që kanë relativisht leksik jo shumë të madh, kjo varet nga natyra e fushës shkencore. Edhe natyra semantike e tyre nuk është njëlloj për të gjithë këto fjalë terminologjike, në disa fusha kemi situata semantike të vështira abstrakte dhe prej tyre ka edhe terma të thjeshtë, që mund t'i dijë edhe publiku i zakonshëm. Interesi i drejtpërdrejtë i këtij leksiku terminologjik kuptohet, që është logjikisht në interesin e specialistëve dhe një pjesë e vogël fare e këtij leksiku interferohet edhe në jetën e përditshme. Ky leksik terminologjik merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e literaturës specifike në fusha të caktuara, si në atë të shkruar ashtu edhe në atë të folur. Kjo literaturë është e mbushur me terma specifikë, që janë themelore në shpjegimin e fenomeneve specifike, shkencore dhe njohja e mire e këtij leksiku ndihmon në kuptimin e shkencave të ndryshme. Vlen të thuhet, që ky leksik edhe pse është terminologjik dhe specifik në literaturë nuk mund të mos përdoret për të shpjeguar ndryshe veçse me strukturën mbështetëse gjuhësore, d.m.th. me fonetikën, morfologjinë, sintaksën dhe leksikun kaq të domosdoshëm për të ndërtuar fjalitë dhe llogjikën arsyetuese. Ky leksik nuk mund të krijojë një gramatikë të vetën, por i nënshtrohet asaj ekzistuese, rregullave të saj.

**Fjalët çelës:** leksik, terminologjik, semantik, gjuha

## TERMINOLOGICAL LEXICON PART OF THE LEXICON OF A LANGUAGE AND ANY LANGUAGE IN GENERAL AS A PARTICULAR PART USED FOR SPECIFIC PURPOSES

### ABSTRACT

The terminological lexicon is mainly used by specialists and professionals of the sciences of both the main social and exact groups. Lexicon, which is not only specifically conceived as a sphere of use, but also specific, we could call it for its nature, which is included in the dictionary of a language, the way it is justified and administered by different grammatical aspects in the structures of the language. By its nature, as a terminological dictionary, this lexicon has reasons different from those of the normal lexicon, to be created and its lexical-semantic problems are different from those of the normal lexicon. This dictionary in terms of etymology, lexical causes, which have created the typology of its status of lexicalized in the overall lexicon, are different and it is not said that they have the same path and lexical-semantic result. The terminological lexicon does not create its own grammar, but is subject to the grammatical rules (phonetic, morphological and syntactic) of the language in which it exists. There are cases that this lexicon can be created simply by adding a polysemantic structure to a single word that exists in a language, but it is also possible to create a new monosemantic word with a terminological meaning that justifies this word in the lexicon. In terms of the amount of this terminological lexicon in certain fields, either social or exact, there are different situations; there are fields that have a lot of lexicon, but there are also fields that have a relatively not very large lexicon, it depends on the nature of the scientific field. Even their semantic nature is not the same for all these terminological words, in some areas we have a difficult, abstract semantic situation and among them there are also terms simple, that even the common public can know. The direct interest of this terminological lexicon is understood, which is logically in the interest of specialists and a small part of this lexicon is also interreferred in people's daily life. This terminological lexicon takes on a special importance in the context of specific literature in certain fields, both written and spoken. This literature is full of specific terms, which are fundamental in the explanation of specific scientific phenomena, and a good knowledge of this lexicon helps in understanding different sciences. It is worth saying that this lexicon although it is terminological and specific in the literature it cannot but be used to explain otherwise than with the supporting linguistic structure, i.e. with phonetics, morphology, syntax and lexis so necessary to build sentences and reasoning logic. This lexicon cannot create its own grammar, but is subject to the existing one, its rules.

**Keywords:** lexical, terminological, semantic, language

Fjalori është tërësia e fjalëve nga ana semantike dhe jo vetëm, por edhe nga ana kulturore e historike etj. të një gjuhe të caktuar. Leksiku është pasuri e një gjuhe, e një kombi. Gjuha shqipe nga pikëpamja e origjinalitetit përfaqëson një model gjuhe unik, sepse gjuha e një populli, që nga ana numerike është i vogël dhe për çudi i ndodhur në udhëkryq të qytetërimeve klasike asaj greke dhe romake ( latine ) nuk është asimiluar dhe kjo tregon një potencialitet dhe arsenal të madh gjuhësor origjinal. Pa llogaritur këtu kohën e gjatë disashekullore të pushtimit otoman rreth 450 vite, që midis dëmeve të shumëfishta dhe të pallogaritshme, në shumë plane, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj. arriti të shpëtoje origjinalitetin e saj gjuhësor. Siç e dimë gjuha shqipe është gjuhë origjinale dhe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane. “ ...Gustav Meyeri e vështroi visarin leksikor të shqipes në

tërësi, edhe në fondin indoevropian edhe në huazimet që ka marrë gjatë kohëve”<sup>1</sup>.

Aspektet dhe tiparet gjuhësore, që e përcaktojnë këtë origjinalitet janë gramatika dhe leksiku baze, themelor, këto dy aspekte kur nuk i gjejmë në gjuhë atëherë ato janë gjuhë të asimiluara ose të prejardhura dhe i përkasin një familje gjuhësh, që dihet kush është. Gjuha shqipe nga kjo pikëpamje e fjalorit ka vërtet më shumë se gjysmën e saj me origjinë latine dhe neolatine, por kjo nuk e përmbys situatën e përkatësisë gjuhësore të familjes së gjuhës shqipe, sepse elementet përcaktues të përkatësisë gjuhësore janë gramatika me tre pjesët e saj ( fonetikë, morfologji dhe sintaksë ) si dhe leksiku themelor. Një situatë të ngjashme me gjuhën shqipe mund të përmendim gjuhën angleze e cila edhe pse ka mbi 65% të leksikut të saj me origjinë latine dhe neolatine ajo ngelet gjuhë origjinale dhe klasifikohet në familjen e gjuhëve anglo-gjermanike, sepse për të njëjtat arsye, që ka edhe gjuha shqipe ka gramatikën dhe leksikun bazë origjinal atë anglo-gjerman. Parimisht situata të tilla të origjinalitetit të një gjuhë siç përmendëm rastin e gjuhës shqipe dhe angleze, mund të gjenden edhe në raste të tjera gjuhësore. Leksiku i një gjuhe është një strukturë e komplikuar, nga ana formale dhe semantike. Në kuadrin e gjuhës, në pjesë të ndryshme të gramatikës si fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën mund t’i krahasojmë në mënyrë metaforike me qytete të mëdha në organizimin e një shteti, vendi, ndërsa leksikun mund ta përfytyrojmë si kryeqytetin e tij, aq i komplikuar është ai, nga ana strukturore, formale, pa harruar anën semantike të tij. Gramatika pa dyshim, që duke pasur para sysh secilën pjesë të saj, fonetika, morfologjia dhe sintaksa ka problematikat e veta dhe ndonjëra prej saj, si sintaksa p.sh. mendoj që paraqet komplikacione jo të lehta si për t’i njohur e ditur, për t’i administruar si dhe për t’i studiuar. Gjithë sesi, siç e dimë gramatika me tre pjesët e saj konsiderohet si një strukturë gjuhësore, që ka rregulla dhe pavarësisht vështirësive të mundshme të saj si nga ana teorike ashtu edhe ajo praktike ajo arrihet të administrohet dhe njihet, “Morfologjia dhe sintaksa, si dy pjesë përbërëse të gramatikës, që vështrojnë anë të ndryshme të të njëjtave fakte, janë të lidhura shumë ngushtë midis tyre.”<sup>2</sup>, ndërsa fjalori i një gjuhë paraqet një ndërlikim shumë të madh nga ana teorike dhe praktike.

Aty administrohen shtresa të ndryshme leksiko-semantike, leksiku ka hierarkinë e vet, që konceptohet nga këndvështrime të ndryshme siç janë frekuenca e përdorimit të fjalëve dhe kuptimeve të tyre, polisemia e tyre, shprehje të ndryshme gramatikore ose frazeologjike si dhe fjalët kuptimet, që lidhen me fjalorin e fushave dhe shkencave të ndryshme shoqërore dhe ekzakte etj. Fjalët në çdo gjuhë kanë një status të caktuar leksiko-semantik, të justifikuar, të merituar për të ligjëruar ”jetën“ e tij në një gjuhë. Në një moment të caktuar, çdo fjalë mund, që gjuha për arsye mospërdorimi nuk e sheh të domosdoshme mbajtjen e saj dhe prandaj e flak, nuk e mban më. Si të themi gjuha i ngjan një institucioni financiar, privat, që llogarit në çdo çast aspektet e ”leverdisë” dhe ”fitimit” të financave të veta dhe në se ka asete ose pjesë të vlerave të saj leksikore, që nuk sjellin ”fitim“ atëherë ajo i skualifikon, i heq dhe i nxjerr jashtë sistemit bankar, financiar, i shet këto asete. Edhe gjuhët në mënyrë metaforike nuk e kanë luksin të mbajnë fjalët të tepërta, në

se nuk justifikohet dobia e tyre e përdorimit leksikor. Ne, nga ana e dëshmisë të kësaj ideje mund të përmendim plot raste në gjuhë të ndryshme si dhe në gjuhën shqipe kur fjalë të caktuara kanë ekzistuar, janë përdorur për vite të tëra, dhjetëra vite ose edhe shekuj dhe sot ato fjalë nuk janë më, në gjuhën shqipe, nuk përdoren më dhe nuk janë të regjistruara në fjalorin e gjuhës shqipe. P.sh fjala me origjinë turke, penxhere, që do të thotë dritare, e cila e ka zëvendësuar, me shumë gjasa kjo preferencë për t'u zëvendësuar, do të jetë sugjeruar nga gjuhësia shqiptare mbas viteve '45, pa dashur të paragjykojmë huazimet, ka jetuar bashkë me fjalën dritare për gati gjysmë shekulli dhe kam përshtypjen se mbas viteve '90 kjo konkurrencë dhe alternancë përdorimi leksikor si sinonimi ka pushuar së ekzistuari dhe fjala penxhere me kuptimin dritare nuk po dëgjohet më, sepse gjuha me të drejtë konkurrencën semantike e lejon, por kur nuk ka arsye justifikimi semantik sado të vogël sikur edhe ndonjë nuancë, atëherë ajo duhet të vendosë kë do mbaje dhe detyrohet të flakë njërën nga këto nga përdorimi. Raste si këto në gjuhën shqipe mund të ketë plot dhe jo vetëm për arsye sinonimie, por shumica e rasteve është se fjala është semantikisht dhe leksikalisht e lidhur ngushtësisht me suksesin e objektit dhe kur objekti ose një fjalë me kuptim abstrakt nuk ka më ekzistencë leksikore në gjuhë atëherë edhe fjala si njësi fonetike dhe fonematike, në aspektin e fundit, përveç atij morfo-sintaksor dhe leksikor ajo do humbasë në kohe dhe ngelet vetëm në dokumente dhe libra të shkruar, që e dëshmojnë si përdorim të saj në të kaluarën. Këto aspekte leksikore gjuhësore mund të themi, që paraqesin natyrë etimologjike dhe mund të përbënin interes dhe stimuj për studime gjuhësore të mëtejshme mbase, krahasuese për studiues të ndryshëm.

Llogaritja e leksikut siç e dimë ka dy bilance, atë të leksikut në tërësinë e vet dhe atë të kuptimeve në kuadrin e polisemisë së fjalëve, fjalët terminologjike, fjalët dialektore, fjalët e rralla, të papërdorura, pa llogaritur këtu edhe njësi të tjera leksikore, që regjistrohen në fjalorë si shprehjet gramatikore, shprehjet frazeologjike dhe idiomatike, përdorimet ose shembujt, citimet, antonimet, sinonimet, thënie, proverbat, dhe në rastin e italishtes edhe fjalët e formuara me prapashtesa zvogëluese, përkëdhelëse, zmadhuese dhe përkeqësuese, tipike kryesisht dhe si sistem në gjuhën italiane. Kuptohet, që në çdo gjuhë nga ana numerike leksiku ka me shumë polisemi se sa fjalë. Me një përlllogaritje të përafërt të raportit midis leksikut zyrtar dhe polisemisë në një gjuhë, unë mund të supozoj që ky raport i kalon si shifer, si numër, trefishin në favor të polisemisë, që do të do thotë që çdo gjuhë normalisht do kishte tre herë më shumë kuptime, se sa fjalë ose leksik dhe kjo është normale po të arsyetojmë për nevojat dhe problemet leksiko-semantike, që ka një gjuhë për të administruar, duke favorizuar më shume poliseminë, se sa fjalët mono-semike, se kështu sistemi dhe sistemimi leksiko-semantik i fjalorit të një gjuhe ka rezultuar efektiv dhe i suksesshëm.

Gjuha shqipe, në këtë aspekt të polisemisë, do të tregojë, që ka goxha pasuri dinjitoze krahasuar me shumë gjuhë të tjera. Leksikografia e gjuhës shqipe, asaj italiane, franceze, spanjolle etj. kryesisht citojnë, si arritje leksikografike, sasinë e



fjalëve, thjesht si leksema, pa pasur merak që të llogarisë, nga ana numerike, tërësinë e polisemisë, shprehjeve etj., ndërsa leksikografia angleze, gjermane etj. referojnë si arritje në botime leksikografike, d.m.th. në fjalorë, tërësinë e fjalëve bashkë me kuptimet polisemike, shprehjet, frazeologjinë etj. Kjo mund të konsiderohet si një çështje preferencë subjektive, këndvështrimi dhe nuk mund të paragjykohet, vlera e një arritje leksikografike, ngelet e padiskutuar, është çështje thjesht subjektive dhe preferencë konceptuale për të paraqitur arritjen leksikografike.

Hartimi i një fjalori si ky, me rreth 25.000 fjalë, mund të konsiderohet i vonuar krahasuar me komunikimin ndërkulturor në mes bullgarëve dhe shqiptarëve, megjithëse një vonesë e tillë arsyetohet pas njohjes së kontekstit social dhe nivelit të arsimimit të shqiptarëve që jetonin në Bullgari para brezit të intelektualëve, anëtarëve të grupit punues të sapopërmendur. Pamundësia e bashkëpunimit në këtë nivel theksohet edhe në parathënien e fjalorit, bashkë me disa arsye që dëshmojnë komunikimet kulturore ndërbrezore.

“Prej shekujsh bullgarët dhe shqiptarët jetojnë në fqinjësi të afërt. Gjurmët e lidhjeve të tyre miqësore humben në të kaluarën e largme, aty nga fillimi i mesjetës. Bashkëpunimi midis dy popujve në lëmin e kulturës u zgjerua sidomos gjatë shekullit XIX. Lidhjet më të ngushta u vendosën pas Luftës së Dytë Botërore, që e bënë më të domosdoshëm përpilimin e fjalorëve bullgarisht-shqip, shqip-bullgarisht dhe të gramatikave”.<sup>2</sup>

Përveç përdorimit për mësimin e një gjuhe të panjohur (shqip dhe bullgarisht), fjalori gjeti përdorim edhe për përkthime letrare dhe të natyrave të tjera, meqenëse ofronte disa kuptime për një fjalë e disa fjalë dialektore, si dhe informacione për përdorimin e tyre.

Po në kohën e sotme, a e ka humbur rëndësinë ky fjalor, meqenëse u hartua vite para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972)?

Një përgjigje për këtë dilemë e gjejmë te libri studimor për jetën dhe veprën e Thoma Kacorit në Bullgari, me autoret Rusana dhe Liljana Bejleri.

Përgjigjja kategorike është se nga pikëpamja e përdoruesve shqiptarë ky fjalor nuk ka humbur asnjë prej vlerave të tij praktike, sepse mbartësit e gjuhës nuk pengohen nga ndryshimet në standard (1972) në të kuptuarit e gjuhës amtare. Artikujt e fjalorit janë të pasur me ilustrime të kuptimit të fjalëve bullgare dhe përfshijnë togfjalëshat më të shpeshtë që ndeshen në gjuhën bullgare.<sup>3</sup>

## ATRIBUTET E FJALORIT

“Fjalori i Thoma Kacorit”. Në retorikën e përditshme fjalori bullgarisht-shqip karakterizohet si Fjalori i Thoma Kacorit, ani pse ka punuar një grup i gjerë autorësh për hartimin, recensionimin dhe redaktimin e tij.

“Si çdo vepër e përmasave kolosale që përdoret vazhdimisht, edhe ky fjalor ka qenë përherë nën vëzhgimin kritik të përdoruesve të shumtë. Në këtë kuptim


<sup>2</sup> Po aty, fq. 2.

<sup>3</sup> Bejleri R. & Bejleri L., *Shkrimtari shqiptar Thoma Kacori në Bullgari, jeta dhe vepra*, Sofia University St Kliment Ohridski, Sofje, 2022, fq. 97..



përgjegjësia kryesore ra pikërisht në shpatullat e Thoma Kacorit. Ndërhyrjet e tij në hartim dhe redaktim janë të pranishme pothuajse në çdo artikull dhe mbase për këtë arsye fjalori është i njohur me emrin popullor Fjalori i Thoma Kacorit”.<sup>4</sup>

“Fjalori i parë bullgarisht-shqip”. Fjalori për të cilin e kemi fjalën tani, ndonëse është fjalori më voluminoz dhe gjithëpërfshirës, nuk është fjalori i parë bullgarisht-shqip, siç e gjejmë në disa artikuj, meqë rreth një shekull përpara (1864) ishte shkruar një fjalor i vogël bullgarisht-shqip që përmbante fjalë dhe shprehje nga bullgarishtja në shqip, por që nuk i dihet autori.



## FJALORI I PARË BULLGARISHT-SHQIP

Përmendëm se Thoma Kacori, nëpërmjet mësimdhënies në Universitetin e Sofjes, krijoi bashkëpunime me profesorë dhe studiues të gjuhëve ballkanike dhe europiane në funksion të hulumtimeve mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe, promovimin dhe zhvillimin e saj në Bullgari. Nga këto bashkëpunime, profesor Kacori arriti ta ketë në posedim fjalorin e parë bullgarisht-shqip (të njohur deri tani) nga studiuesi grek, Kostas Nehoritis, i cili ishte një nga studentët e gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes.<sup>5</sup>

Fjalori është një dorëshkrim me 500 fjalë, i kataloguar nga Dimitrije

4 Po aty, fq. 96.

5 Kacori Th., *Ndriçime*, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2000, fq. 134.

Bogdanoviq në mesin e dorëshkrimeve të gjetura në Manastirin e Hilendarit në Malin e Shenjtë, të cilat u botuan më 1978 në Beograd. Dorëshkrimi nuk përmban vetëm kuptime fjalësh, por edhe frazeologji shqipe, shënime fetare dhe shënime tregtare. Vlerësohet se rreth 500 fjalët dhe shprehjet e fjalorthit kanë një vlerë njohëse të madhe, por kanë rëndësi më tepër për leksikografinë dhe për dialektologjinë shqiptare.<sup>6</sup>

## RËNDËSIA DIALEKTOLOGJIKE E FJALORIT

Fjalori është studiuar nga Thoma Kacori në disa perspektiva lidhur me morfologjinë, sintaksën dhe dialektologjinë shqiptare. Nga të tria këndvështrimet, Kacori vlerëson se fjalori është i rëndësishëm sidomos për aspektin dialektologjik, meqë nxjerr në dritë karakteristika për të folmen e shqiptarëve të Bullgarisë. “Gjuha e fjalorit është e dialektit të Jugut, do të thotë e toskërishtes”,<sup>7</sup> gjë që e shtyn autorin të anojë nga vendbanimet shqiptare afër qytetit të Varnës ku kishin emigruar shqiptarë nga Jugu dhe të besojë se fjalori është përpiluar pikërisht për nevojat e diasporës shqiptare që jetonte në atë regjion. Për të arritur në këto përcaktime, Thoma Kacori paraqet disa analiza të fjalëve në fjalor, të përafërta me të folmen e shqiptarëve të zonës, ku në vend të shkronjës “y” përmendet shkronja “i”, apo edhe në fjalët ku ruhet shkronja “ë” fundore, si: brymë - brimë, shoshë, lopatë. Tutje prezanton analizat lidhur me zanoret e përbashkëta, diftongjet dhe ndalet te diftongu i sotshëm “ua”, që në fjalor del vetëm si “o”, si: i hoi - i huaj, gro - grua, a do - e dua, ni noi - një muaj etj.<sup>8</sup> Nga këto dhe prova të tjera të paraqitura te libri eseistik *Ndriçime*, autori hedh një hipotezë se gjuha shqipe në fjalorin e parë bullgarisht-shqip është një e folur që flitej në fshatrat bullare në mesin e shek. XIX, por me karakteristika të një dialekti të vjetër të shqipes, dikur rreth shek XV, pas shpërnguljes së shqiptarëve në trojet bullgare, pra pas pushtimit të tokave shqiptare nga Perandoria Osmane.

Nga të dhënat që disponojmë, dorëshkrimi/ fjalori i parë bullgarisht-shqip ka rreth 500 fjalë, të shkruara me alfabet cirilik, kuptimet e të cilave jepen tematikisht të organizuara në disa kategori: koha, ngjyrat, zogjtë, kafshët dhe kategori të tjera. Fjalorit nuk i dihet emri i autorit, ndërsa dorëshkrimi mban vetëm vitin 1864 dhe asnjë shenjë mbi autorësinë. Meqenëse është gjetur në Manastir dhe përmban tekste fetare të përkthyer nga gjuha bullgare në gjuhën shqipe, mendohet se autori duhet të ketë qenë një murg shqiptar që e ka njohur mirë gjuhën bullgare dhe ka përkthyer edhe disa tekste fetare për nevojat e diasporës shqiptare në Bullgari.<sup>9</sup>

Në mungesë të emrit të autorit, fjalori ruhet në dorëshkrimet e murgut me

---

6 Po aty, fq. 134.

7 Po aty, fq. 137.

8 Po aty, fq. 140.

9 Po aty, fq. 124-141.

emrin fetar Galaktion. Nga të dhënat e katalogimit del se emri i vërtetë i murgut Galaktion është Dimitrije Bogdanoviq. Ndër librat e murgut Bogdanoviq, përveç fjalorit bullgarisht-shqip, u gjetën dorëshkrime të tjera të përafërta dhe pa emra autorësh, njëri prej të cilëve është dorëshkrimi i fjalorit bullgarisht-greqisht (1880).<sup>10</sup>

### **Përfundime**

Fjalori bullgarisht-shqip (1954), i hartuar nga grupi i autorëve shqiptarë e bullgarë, jo vetëm që krijoi ura të reja komunikimi dhe forcoi lidhjet ndërmjet shqiptarëve dhe bullgarëve, por kontribuoi edhe për mësimin e gjuhës shqipe në institucionet arsimore bullgare. Studentët e programeve të gjuhëve ballkanike, në Universitetin e Sofjes “Shën Klimenti i Ohrit”, në kohën e botimit, fjalorin e autorëve Thoma Kacori, T. Tartani, L. Dusha, S. Pasko dhe L. Grabocka e përdorën si material mësimor të arsimit të lartë dhe jo vetëm. Fjalori ishte i dobishëm për të gjithë folësit bullgarë të interesuar për të mësuar gjuhën shqipe. Edhe pse dikur i rëndësishëm, ky fjalor tani nuk gjendet në librari, në mungesë ribotimesh, por mund të sigurohet nga bibliotekat publike dhe universitare.

Ky fjalor është i pari i hartuar nga një bashkëpunim ndërinstitucional mes dy vendeve, Institutit të Gjuhës Bullgare-Akademia e Shkencave e Bullgarisë dhe Institutit të Shkencave të Republikës së Shqipërisë, megjithëse një shekull më parë ekzistonte një dorëshkrim/fjalor bullgarisht-shqip i zbuluar në Malin e Shenjtë, në Manastirin Hilendar në Bullgari. Fjalorin e gjetur, është shkruar me alfabetin cirilik, përmban rreth 500 fjalë, disa shprehje dhe tekste fetare që në shekullin XIX i shërbenin komunitetit të shqiptarëve të emigruar në Bullgari, kryesisht nga pjesa jugore e Shqipërisë. Autori i këtij dorëshkrimi të vlefshëm për komunikimin mes dy popujve të Ballkanit nuk dihet. Është i njohur vetëm viti 1864 si një komponent i rëndësishëm antropologjik dhe se është regjistruar në Beograd, si material i kataloguar nga Dimitrije Bogdanoviq në mesin e dorëshkrimeve të gjetura në Manastirin e Hilendarit në Malin e Shenjtë, në Bullgari.

### **BIBLIOGRAFIA:**

BEJLERI R. & BEJLERI L., (2022): *Shkrimtari shqiptar Thoma Kacori në Bullgari, jeta dhe vepra*, Sofia University St Kliment Ohridski, Sofje.

KACORI TH., (2000): *Ndriçime*, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

KACORI TH., TARTANI T., DUSHA T., PASKO S. DHE GRABOCKA L., (1959): *Fjalor bullgarisht-shqip*, Akademia e Shkencave e Bullgarisë, Sofje.

<sup>10</sup> Po aty, fq. 138.

# TERMINOLOGJIA TURKO-ORIENTALE SI PJESË E LEKSİKUT TERMINOLOGJIK TË SHQIPES

**Prof. Asoc. Dr. Adriatik Derjaj**  
Balkan and Slavic Languages Department  
Faculty of Foreign Languages  
University of Tirana,  
E-mail: adriatikderjaj@yahoo.com

## PËRMBLEDHJE

Me zgjerimin dhe thellimin e njohurive në sektorë të ndryshëm të dijes dhe shkencës, terminologjia e fushës përkatëse është zgjeruar dhe zhvilluar më tej. Informacionet rreth të rejave të shkencës apo të teknologjisë, qofshin objekte apo koncepte, kanë nevojë për emra sa më të qartë e kuptimplotë, prandaj në shumë nga gjuhët e veçanta lind nevoja për të zgjeruar leksikun e fushës. Për ta arritur këtë, gjuhëtarët në përgjithësi përdorin të njëjtat mënyra të formimit të fjalëve. Rasti i huazimeve të shqipes nga turqishtja e periudhës osmane nuk mund të bënte përjashtim nga rregullat dhe kushtet universale të depërtimit të fjalëve dhe shprehjeve nga një gjuhë në tjetrën në çdo rrafsh lingvistik. Diapazoni më i gjerë i huazimeve shfaqet pikërisht në rrafshin leksikologjik.

**Fjalët çelës:** terminologji, turqizëm, orientalizëm, e folur, variant gjuhësor.

## TURCO-ORIENTAL TERMINOLOGY AS PART OF THE ALBANIAN LEXICON

### ABSTRACT

With the expansion and deepening of knowledge in various sectors of knowledge and science, the terminology of the relevant field has been expanded and further developed. The news of science or technology, whether objects or concepts, need names that are as clear, meaningful and unambiguous as possible, therefore in many of the special languages there is a need to expand the lexicon of the field. To accomplish this, they generally use the same ways of word formation as the common language. The case of Albanian borrowings from Turkish of the Ottoman period could not be an exception to the universal rules and conditions of the penetration of words and expressions from one language to another; the widest range of borrowings appears exactly on the lexicological plane.

**Keywords:** terminology, Turkism, Orientalism, professional speech.

## **INTRODUCTION**

The set of lexical, morphological, phraseological and syntactic tools, which are conventionally and consensually adapted by these individuals, serve to make communication between members of a certain social group clearer, faster, more accurate and more effective. This is ensured by realizing a more special, clearer communication and deprived of the ambiguity that often characterizes ordinary speech, related to arguments belonging to a certain field. Professional speech, the languages of various academic, scientific and technical disciplines, as well as all the languages of communities that share any knowledge or any special activity in their characteristics is to possess a clean and clear lexicon. Sometimes it is unknown and often difficult to understand by individuals who do not belong to that field of study. Their study deals with a special branch of applied linguistics, terminology, which is a formal discipline that systematically studies concepts and their names, used in specialized languages of a science, a technical field, a professional activity or a social group. This aims to standardize and systematize the specialized lexicon in order to allow a better understanding and clarity of the messages that individuals want to convey. According to Riediger's definition, terminology has the following functions: to make a systematic description of terms belonging to clearly defined sectors, that is, of words, locutions, expressions and symbols used in well-defined sectors, in one or more languages; transmit and disseminate technical knowledge through the creation of coherent and popular terminological resources, such as: terminological records, dictionaries and databases; to define norms for the use of terms and to standardize their use in order to promote the continuous transmission of specialized messages.

## **TERMINOLOGY IN TURKOLOGY AND ORIENTAL STUDIES**

Those who are "foreigners" in a particular sector of it, such as the case of Turkology and Orientalism, are sometimes not able to communicate or understand correctly with those who belong to that sector. The main reason is the presence to a large extent of the specialized lexicon of the field, which creates difficulties in understanding, but also in the use of various technical tools. Therefore, it is imperative that this lexicon be explained as clearly and precisely as possible. For this reason, it is necessary to draw up a terminological dictionary of the explanatory type of terms of the field, which would deal with the analysis and explanation of the terms used in a certain sector of knowledge, implying by this the analysis of the wide use of internationally accepted concepts, terms and expressions, in our case in the field of linguistics.

Briefly, we point out that linguistics, seen as the science of discourse, shares many notions and terms with other sciences that deal with communication

problems, such as neurology, mathematics, psychology, philosophy, sociology, etc. From linguistics these concepts and terms have been widely adopted and accepted in their specific uses and in their theoretical meanings. The definitions of special terms do not fulfill only an informative function, but are almost always connected to special research directions and are conceptualized in a problematic way. In our country, two terminological dictionaries have been drawn up, one by the Academy of Sciences entitled “Dictionary of Linguistic Terms” and the other by G. Belluscio & Sh. Rrokaj, “Comparative Dictionary of Linguistics Terms”, which constitute a fairly good flow, but they do not contain terminological explanations of Turkology and Orientalism, therefore the necessity of drafting an explanatory dictionary of these terms in the Albanian language, because a voice such is missing in our philology.

Therefore, our research is an attempt to explain some terms from the field of Turkology-oriental studies. We must emphasize that in the cases where these few presented terms have been interfered with, it is intended to preserve the special characteristics that often reflect the original processing or reworking that Albanian linguistic science has done and is doing to concepts according to different linguistic theories.

After many years of work as a Turkologist, the Albanian scholar Tahir Dizdari has tried to give as complete a picture as possible of the state of Turkisms in the Albanian language until the end of World War I. He has traced other words, which could be equivalent to Turkisms or which were presented as such by the lovers of the cultivated Albanian. At the same time, the author has taken care, when he had the opportunity to define it, to note the region where a word is found, as well as to add remarks about its use, that is, whether it is in living use, or has already become obsolete. With such a view, I can say that in addition to the collection and handling of borrowings, T. Dizdari has also brought another wealth within his dictionary, that is, for that part of the lexicon that he has presented, this is also a dictionary of synonyms.

The case of Albanian borrowings from Turkish of the Ottoman period could not be an exception to the universal rules and conditions of the penetration of words and expressions from one language to another; the widest range of borrowings appears exactly on the lexicological plane.

If we were to take a cursory look at the typology of borrowings on the lexicological level, we notice that the range of borrowings appears to be both extensive and diverse, affecting all spheres of human life and activity. The reason is more than simple; unlike the case of English and Latin, borrowings in the lexicological level of Albanian from Turkish during the Ottoman Empire period is the result of the high degree of density and duration not only of linguistic contact between languages, but also of vital contact between communities of speakers,

which naturally translates into a contact not simply and only between two societies, but also two cultures, docks and customs. The inclusion of this last form of contact that the community of speakers of one language has with a community of speakers of another language carries a major weight both in the topological and typological direction of borrowings. In this direction, rigorously following the method, principles and categories of linguistics of linguistic evidence, in our research, we have tried to collect a good part of the borrowings that Albanian has had from the Turkish of the Ottoman period, relying on the epic of the Kreshniks, which roughly dates back to the period of the beginnings of linguistic contact between Albanian and to the Turkish in question, as well as to the later literature, to that of the Beytegians and to other literary works of the time, without neglecting the spoken language, in which many words from the most diverse spheres of life have managed to survive and of human activity, from clothing and kinship to culinary art and toponymy.

We have provided the collected evidence organized according to the fields and spheres of life and social organization, where the alphabetical order has been followed in each item, starting first with giving the word in Albanian, which may have undergone quite a few morphological changes from the source form, and then the corresponding infinitive in the Turkish of the Ottoman period, accompanied by its infinitive in today's Albanian, in cases where it has been replaced by a translation of the foreign word. In addition to this vital taxonomy, in this dictionary we have included two grammatical categories; more specifically, verbs and adjectives, bearing in mind not only the functions they cover in the layers of language as a system, but also the importance that these two categories display in terms of the life of the language viewed as a means of communication and expression. In this regard, their presence clearly shows the instability of the ruling beliefs of 30-40 years ago, according to which the influences and borrowings that a language can have from one or more other languages, only affect the category of names and, in rarer cases, that of adjectives, but never that of verbs.

As far as the terminological level is concerned, our attention is focused on the identification of the borrowings that Albanian has had from the Turkish of the Ottoman period in the level of frozen structures: - locutions, terminological expressions and proverbs.

In principle, the identification of calques appears to be an easy undertaking, since in most cases it is a question of some terminological structures that manage to penetrate from one language to another as a result of a series of factors, mainly cultural and religious, almost always preserving the form source of the relevant language, the "giving" language, the language of origin. Such are, for example, *tout court*, *coup de théâtre*, *mise en scène*, *grosso modo*, *a priori*, *a fortiori*, *a posteriori*, *ad hoc*, *ex cathedra*, *ars poetica*, etc.

The latter, on the one hand, appear more difficult to identify, while, on the other hand, being translated, they have already been completely assimilated by the “receiver” language, thus being stripped of any “foreign” element., to become part of the way of thinking of the community of speakers of the receiving language. Precisely for this reason, we personally judge that they cannot and should not be included in the group of loans.

As we said above, some attention has also been paid to the case of proverbs and proverbs. Their identification appears difficult, of course, and methodologically requires, first of all, keeping in mind the fact that this category of expressions is the fruit of a longlife experience, often a-historical, “measurable” only with the psychic time of society. In this regard, we need to draw attention to the fact that collective psychology is one of the elements that unites, rather than separates or distinguishes people from each other, so much so that, rather than an element, personally we are led to take the side of Carl Gustav Jung, who sees it more as a “period”, not as a phenomenon. In this respect, being often associated with an archetypal experience, the proverbs and proverbs of one people show quite a bit of similarity with those of another people. In addition, the difficulty also lies in the fact that such proverbs or proverbs are often translated into the “receiver” language, thus becoming an inherent part of the expressive, life and experiential baggage. In this regard, proverbs and proverbs that we have given as inscribed to the phenomenon of influence or borrowing are mainly based on those local historical or cultural elements, which, although secondary to the archetypal value of proverbs or proverbs as such, help us to some extent to identify their source or origin. In this direction, while working with this category of expressions, proverbs or proverbs, we have almost always focused on their antiquity, for the evidence of which, for the first time in Albanian studies, works from the 13th century and 14<sup>th</sup> century.

We can say that we have two types of terminological structures from Turkish:

a) terminological expressions calculated for ordinary Albanian speakers who probably were not able to reproduce whole phrases in Turkish, of the type “By asking you can find Istanbul” (in Turkish we have “By asking you can find Baghdad” while in Oguz Turks we have “By asking you can find the Kaaba), or the pot turned over and found the lid and;

b) special units, mainly non-first words, in the framework of deliberate efforts aimed at replacing borrowings from Turkish. Clock repair, goldsmith, sales units belong to this type. It should not be forgotten that in Albanian, in addition to the above-mentioned calques, the Turkish words *sahatçi*, *kujunxhi* (less) and *shop* are still used. What draws attention in the treatment that Albanian has done to Turkicisms is that in a very large number of cases, names in Turkish have served as a basis for constructing verbal terminological expressions associated with the name.



1. Verb Noun	2. Turkish proverbs translated into Albanian
<b>Adet</b> <i>do adet</i> <b>Derman</b> <i>do dermaN</i> <b>Kneeling</b> , <i>kneeling</i> <b>Revenge</b> <i>I take revenge</i> <b>Hizmet</b> <i>I do hizmet</i> <b>Anger</b> <i>I get angry</i> <b>Kabul</b> <i>do Kabul</i> <b>Lanet</b> <i>do lanet</i> <b>Worry</b> <i>becomes worry</i> <b>Shopping</b> <i>do Shopping</i> <b>Fun</b> , <i>have fun</i> <b>Ramadan</b> <i>keep Ramadan</i> <b>Bribe</b> <i>I take bribes</i> <b>Sehir</b> <i>do sehir</i> <b>Greetings</b> , <i>I go to greetings</i> <b>Sevap</b> <i>do sevap</i> <b>Thanks</b> <i>do Thanks</i>	Ag ağça gere gün için <b>White money is for black days</b> Anasın gör, kızın al, gıyısın gör, bezin al <b>See the mother take the daughter, see the clothes take the son</b> At yerine eşek bağlama <b>Do not tie the donkey instead of the horse</b> Az söyle, uz söyle <b>Talk a little</b> Beş parmag düz değildir <b>Fingers are not the same</b> Binar başından bulanar <b>The fish stinks from the head</b> Bir taş ile iki kuş urulmaz <b>You don't kill two birds with one stone</b> Bir kişinin adı çıkacağına canı çıksın <b>Better to let the soul out than the words</b>

3. Turkish terminological structure	4. Phraseology with an oriental element
Başını kaşıyacak vakti olmamak <b>I don't have time to scratch my head</b>  Cebi delik <b>Perforated pocket</b>  Diken üstünde oturmak <b>To sit on thorns</b>  Eli uzun <b>He has a long hand; burglars</b>  Göze batmak <b>It caught my eye</b>  Kızım sana söylüyorum gelinim sen dinle <b>I told the girl, the bride heard you – knock on the verge the door will hear</b>	<b>Afion – afyon – afion</b> <i>It became very yellow</i>  <b>Beano (Aheng) – ahenk – sound, music, harmony</b> <i>Wedding without a party. Work that lacks the main thing.</i>  <b>Cot (Ahur)– ahır – closed place for cattle</b> <i>Cattle trough, dirty place</i>  <b>It has become a cradle, the place is dirty</b> <b>He has a bad heart is mean;</b>  <b>Scorpion (Akrep) – akrep – akrep</b> <b>It became a scorpion</b> it follows me and does not go away  <b>Tool (Alet-et) – alet – tool, unit</b> <b>With tools in his belt, ready for any occasion</b>

<p>Kulağına küpe olmak <b>Earring in the ear</b></p> <p>Parmağı ağızında kalmak <b>Remained with his finger in his mouth</b></p> <p>Söz bir kulağından girip öbür kulağından çıkmak <b>It goes in one ear, out from the other</b></p>	<p><b>Drudgery (Angari) – angarya – weight, burden, excess</b> <b>It caused me excess work</b> he charged me as a job that is not for me to do</p> <p><b>Love (Ashkë) – aşk – aşık, love, dear</b> <b>With the love of the heart with great desire;</b> with afsh, with fire</p> <p><b>He has affection,</b> he has a blood relationship with someone, he has something inherited from someone.</p>
---	---

### BIBLIOGRAPHY:

(1555): Meshari i Gjon Buzukut.

(2002) : Albanian Academy of Sciences, History of the Albanian People, Toena, Tiranë.

ÇABEJ E., (1975): For a chronological stratification of Turkishisms in Albanian, SF, No.4.

DERJAJ A., (2008): About the spelling of Turkisms and proper names of Turkish origin, Prishtina Consultation, ASHAK, Pristina.

DERJAJ A., (2009): Çagdas Türk Edebiyatının Arnavutçada Resepsiyon Sorunlari, (Problems of the reception of contemporary Turkish literature in Albanian In, III. Uluslararası Karsilastirmali Edebiyat Bilimi Congress, Osmangazi University, Eskisehir Turkey.

DERJAJ A., (2010): Arnavutca Turkce Dil Iskileri, Kastamonu Egitim Dergisi, Eylöl 2010 Cilt:18, No:3, Kastamonu, Turqi, fq. 991-996.

DERJAJ A., (2010): Arnavutçadaki Türkçe Alintilerin Tipolojisi Üzerine, I. Uluslararası Balkanda Dil, Kültür ve Medeniyet Arasındaki Diyalog, University of Tirana and University of Thrace, Tiranë.

DERJAJ A., (2010): Language and the reality outside it, VI International Conference on English Language and Literature Studies, Niksic, Karadag.

GJINARI J. dhe SHKURTAJ GJ., (2003): Dialektologjia, SHBLU, Tiranë.

KALESİ H., (1967): Die Turzismen im Serbo-kroatischen, UAJ 30.

MEYER G., (1891): Etymologisches Wörterbuch der albanicshes Sprache, Strassburg.

POLISI M., (2006): Islamic Lexicon, Part of the Albanian Lexicon, ASHAK, Pristina.

SHKURTAJ GJ., (2008): How to write albanian, Botimet Toena, Tiranë.

SKALYIÇ A., (1966): Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, Sarajevo.

# PASQYRIMI I TERMAVE NË FJALORË DHE PËRDORIMI I TYRE NË PRAKTIKËN LIGJËRIMORE

**Msc. Florie Nikqi – Gashi**

Fakulteti i Edukimit  
Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren  
E-mail: li\_kja@live.com

**Prof. Asoc. Dr. Muharrem Gashi**

Fakulteti i Edukimit  
Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren  
E-mail: muharrem.gashi@uni-prizren.com

## PËRMBLEDHJE

Zhvillimi i shoqërisë me shndërrime të shpejta ekonomiko-shoqërore kanë sjellë ndryshime në shumë fusha të veprimtarive. Ndërsa në kulturën gjuhësore janë shpërfaqur prirje e mënyra të sjelljeve në raport me terminologjinë dhe përdorimin e saj. Bashkërendimet e kohës së sotme paraqesin kërkesën për shqyrtime të mëtejshme jo vetëm për saktësi terminologjike, por edhe për metodologji, punë si dhe përgjegjësi, në radhë të parë, padyshim në truallin e shqip foljes. Termi është emërtim i përcaktuar i një nocioni të një fushe, si i tillë ai mund të shprehet edhe me një fjalë, me një togfjalësh, si: *mendësi, drejtshkrim, akt juridik*. Tutje ai mund të përdoret për klasa njerëzish: *krijues, ministra*, por mund të përdoret edhe për profesione të ndryshme, si: *kolegj gjyqësor, ekip mjekësor* etj. Kësisoj ai mëton formën themelore të mendimit ku përvijohen tiparet e veçanta që e konceptojnë kuptimin e realitetit objektiv.

Përimtimi i çështjes në aspektin diakronik nxjerrë mendimin se hapat e parë janë bërë, por duke mos e humbur shpresën për “dokumente të reja”, nga edhe nuk mund të flasim për një rrugë të mbarë kombëtare. Ndryshe, nëse i referohemi normëzimit të terminologjisë së kodit të traditës vendore, pra ndëshkimit të shkeljes së detyrimeve në jetë, në punë e veprimtari të tjera “Kanuni i Lekë Dukagjinit” ka thadruar një tërësi me rëndësi për të drejtën e trashëgimisë shqiptare, si: *besa, gjaku, tregu i tokës* etj. Në shqyrtim një numër fjalësh i këtyre koncepteve në fjalorë, jo vetëm që e ndihmojnë, por në mënyrë të drejtpërdrejtë e përudhin prejardhjen e termave deri te burimi i fjalëve “n’gurr t’komit”. Megjithëse ka emërtime që shquajnë koncepte të njëjta me dy a më shumë fjalë forma të huazuara, si: *draft, projekt, parlament, asamble; konkluzion-rezime* etj. Zgjerimi i terminologjisë në fushën tekniko-shkencore, huazimet nga burime të ndryshme kanë hapur kundritime në drejtim të ndërgjegjësimit në shkallë më të lartë të kulturës gjuhësore në ligjërim.

**Fjalët çelës:** shkelje, shpërfaq, drejtpërdrejt, i dyfishtë, kolegj gjyqësor etj.

## REFLECTION OF TERMS IN THE DICTIONARY AND THEIR USE IN THE DISCOURSE PRACTICE

### ABSTRACT

With rapid economic and social changes, society’s development has changed many activities. In the linguistic culture, trends and ways of behaving concerning terminology and its

use have appeared. Today's agreements present the request for further examination not only for terminological accuracy but also for methodology, work, and responsibility in the first place, obviously in the area of the Albanian verb. The term is a defined designation of a notion of a field; as such, it can also be expressed with a word or a phrase, such as mentality, spelling, or a legal act. Furthermore, it can be used for classes of people, creators, ministers, and professions, such as judicial colleges, medical teams, and other fields. In this way, he learns the primary form of thought, where the unique features that conceptualize the meaning of objective reality are outlined. Examining the issue from a diachronic point of view suggests that the first steps have been taken, but without losing hope for "new documents", we cannot even talk about a successful national path. Otherwise, if we refer to the standardization of the terminology of the code of local tradition, i.e. the punishment of the violation of obligations in life, work and other activities, the "Kanuni i Lekë Dukagjini" has established a whole of importance for the right of Albanian inheritance, such as faith, blood, land market, and the like. In examining several words of these concepts in dictionaries, they not only help but directly trace the origin of the terms to the source of the words "n'gurr t'komit". Although names denote the same concepts with two or more words, borrowed forms include draft, project, parliament, assembly, conclusion-summary, etc. Expanding terminology in the technical-scientific field through borrowings from different sources has opened contradictions toward a higher awareness of linguistic culture in discourse.

**Keywords:** breach, expose, direct, dual, judicial panel, etc.

*"Në qoftëse për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë është me rëndësi, për gjuhën shqipe ajo ka rëndësi jetësore"* (Norbert Jokli)

## HYRJE

Shoqëria njerëzore në përgjithësi dhe zhvillimi i saj i hovshëm mbi bazën e shndërrimeve të shpejta ekonomiko-shoqërore ka sjellë ndryshime të thella në shumë fusha të veprimtarive shoqërore si edhe në vetë dijen gjuhësore<sup>1</sup>. Gjuha si një organizëm i gjallë duhet të ecë përkrah këtij zhvillimi ekonomik e kulturor të një kombi, të një vendi apo kështu edhe të një zone të tërë. Mos ecja me këtë ritëm, do të nënkuptonte edhe hapa prapa në zhvillimin i kësaj fushe si dhe do të ishte e mangët përkrah të arriturave kulturore e shkencore të simotrave e mjediseve të bashkësive koherente.

Në këtë ritëm të këtyre ndryshimeve, në radhë të parë, gjithsesi, se kjo paraqitje është kërkesë e pandërmjetme, për Shqipëri, Kosovë e Maqedoni të Veriut, për treva jashtë shqip foljes, pra ku jetojnë e veprojnë ngulimet e bashkësive shqiptare, pastaj anë e kënd vendeve të ndryshme në botë kudo që ndodhet e punon mërgata jonë. Në thelb të përpjekjeve në këtë vëzhgim, kemi parasysh sfidat e zhvillimit të këtyre dy dhjetëvjetëshave të fundit ku nuk është bërë sa duhet në fushën e grumbullimit të thesarit të gjuhës sonë e as në qasjen e përcaktimit gjuhësor që

---

1 IAP, *Drejtkshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Prishtinë, 1974, fq. 15-19.

përkapin fjalë format e përfaqësimit për të arsyetuar pasqyrimin terminologjik.

### **Metodologjia**

Metodologjia që do të ndjekim në këtë përimtim shquan hulumtimin dhe analizimin e termave të ndryshëm në fjalorë, të cilët janë të strukturuar nëpër vëllime terminologjike. Në këtë kontekst kemi trajtimin e aspekteve socio komunikatave dhe kognitive të këtyre fjalë formave që janë vënë në shërbim të gjithë atyre që i përdorin si dhe atyre që i përudhin deri në përkufizimin e burimit të prejardhjes së tyre. Pastaj përditësimin dhe modifikimin e kuptimit të këtyre fjalë formave që në radhë të parë janë lëndë për pasurimin e fondit të fjalëve. Në këtë hulli duke i dhënë përparësi të pandërmjetme përdorimit të fjalëve që e “thadrojnë” identitetin autokton të kulturës terminologjike të gjuhës sonë. Përcaktim i qartë kundrejt përputhjes sa më të plotë në konceptimin e të kuptuarit të gjuhës<sup>2</sup> në secilin dimension të përdorimit të termave, pa hequr dorë nga konsiderata që i takon përdoruesit dhe qëllimit të realizimit të ligjërimit të tij. Ndërsa në anën tjetër duke e rritur pasurinë leksikore i japin ngjyrimë të larmishme e stilizuese shprehjeve dhe frazeologjisë sonë ligjërimore, pra jo vetëm asaj artistike. Gjithsesi se natyra metodologjike parapëlqen që të paraprihet në këtë kuptim në shtrimin e një “traseje” të mirëfilltë e të “shëndetshme” për rrugën tonë në planin ekspresiv, pra që merr parasysh strukturën dhe përmbajtjen. Në këtë kuadër në mënyrë të veçantë cilësinë e përzgjedhjes e të pasqyrimin të fjalë formave funksionale e më të përkryera në mënyrë që t’i përgjigjemi më denjësisht kërkesave të shtruara më lart. Këtu duke specifikuar sistemin terminologjik me qëllim të standardizimit të mëtejshëm me theks të posaçëm drejt pastërtisë, saktësisë dhe ngjyresës autoktone në ligjërim.

Shkenca shqipe tashmë ka bërë hapat në rrjedhat e shkencës së përgjithshme, pra nevoja për një qasje me një akribi më shkencore, qasja heuristike, ndryshe thënë metodologjia e marrjes me termin dhe sistemin terminologjik me qëllim të standardizimit të mëtejshëm është e pashmangshme<sup>3</sup>, madje po kështu edhe për shkencat albanologjike, të cilat nuk mund të kundrohen të ndara nga mbarë rrjedha e shkencës mbarë botërore. Sipas Wusterit, “terminologjia nis me konceptin dhe synimin për përkufizimin e qartë të secilit koncept”<sup>4</sup>. Në këtë kontekst edhe terminologjia *Reflection of terms in the dictionary and their use in the discourse practice* shqipe zë fill në epokën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, natyrisht duke mos e anashkaluar kontributin e secilit rilindës, në mënyrë të veçantë të apostujve të shqiptarizëmës, gjegjësisht të vëllezërve Frashëri, si Naimi: “*Shqip të flasim përherë, thjesht e pa përzjerë*”<sup>5</sup>.

2 De Saussure F., *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, DITURIA, Prishtinë, 2002, fq. 132-149.

3 Islamaj Sh., *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, IAP, Prishtinë, 2004, fq. 98-105.

4 Wüster E., *The Machine Tool. An interlingual dictionary of basic concepts*, Technical Pre, London, 1968.

5 Shkurtaç Gj., *Kundrimet gjuhësore*, PEGI, Tiranë, 2006, fq. 212-228.

Nisma, nuk do koment se do të shquajë interesimin e shumë përpjekjeve në vijim, kësisoj edhe të Komisionit Letrar të Shkodrës, e cila do të nisë një sektor të posaçëm terminologjik për botimin e fjalorit të termave. Duke pasur parasysh se fusha e disiplinës terminologjike është e lidhur ngushtë me semantikën, mbledhja e thesarit do ta ndihmonte edhe më çështjen, pra jo vetëm disiplinën e leksikografisë. Tutje në këtë përfaqje të kundruar në dimensionet e mbijetesës së identitetit tonë, në vend që të përkushtohemi për një përpjekje më të ngjeshur të radhëve, kemi bërë shumë pak, për të mos thënë më ndryshe. Aspekt themelor në këtë trajtim është që në këtë qasje me vëmendje ta fokusojmë gjithë hapësirë shqipfolëse. Megjithëse nuk kemi dyshime se mund të ketë dallime kundrejt qendrave nëpër njësi të organizmave shtetërorë brenda fushave e veprimtarive përkatëse. Synimi nuk është i thjeshtë, prandaj sado qofshin këmbëngulëse përpjekjet individuale nuk do të mund të nxjerrin rezultate të arrira. Ndryshe, çështja është mjaft komplekse si dhe kërkon përpjekje të organizuara mirë, madje do të shpreheshim për mënyrë ekipore që të preken rezultate që do t'i rezistonin kohës. Pavarësisht nëse janë shpërfaqur apo jo, përpjekjet kanë nisur që nga hartuesit e parë të fjalorëve të shqipes<sup>6</sup> kur edhe i kanë vënë themelet, ndonëse periudhat e mëvonshme kanë pasur mundësi, herë më pak, herë më shumë e herë-herë fare ta ndihmojnë krijimin e bazës së mirëfilltë të strukturës së disiplinës shkencore në shqyrtim. Ndërkëmbimi i përvojave, ndërgjegjësimi, tutje po në këtë rrafsh, sidomos i institucioneve profesionale, kanë hapur rrugë për nivele të punës së përbashkët. Puna me ekipe<sup>7</sup> ka dëshmuar studime më cilësore si dhe më të përthyerat në pikëpamje shkencore, përpjekje të këtilla kërkon vetë natyra e fushës që e kemi por objekt shtjellimi. Ka ardhur koha që këto përpjekje shkencore të bëhen më përfaqësuese dhe më të prera shkencërisht jo vetëm brenda hapësirës homogjene, por edhe për ngulimet ku flitet shqip, në Turqi, Greqi, Itali, Bullgari, Ukrainë, Taxhikistan etj. Në këtë rrafsh ndjehet nevojë e madhe për harmonizimin e fushës së terminologjisë, ngase edhe kemi shkallë të lartë të moskuptimit, madje deri te kuptimi fillestar i termave. Kjo çështje shumë e rëndësishme, gjithsesi se nuk duhet t'i lihet në dorë të askujt. Këtu, në mënyrë të ligjshme institucionet tona duhet të aktivizohen, si asnjëherë më parë, për të krijuar organizma që t'i themelojnë njësitë përkatëse të terminologjisë pranë institucioneve gjegjëse në shtetet e tyre. Në këtë mënyrë do të bëhej institucionalizimi i kësaj çështjeje parësore për disiplinat e albanologjisë. Përballja me mungesë të fjalorëve të fushës si dhe ndikimi i madh në këtë kohë në përgjithësi kanë krijuar vështirësi për njësimin e terminologjisë. Ngritja e funksionalizimi i komisioneve profesionale është me përparësi, nuk është fare e tepërt të sjellim në vëmendje kohën e “konsultave gjuhësore”, kur kishte edhe më shumë vështirësi. Rrugën e kemi të çelur nuk është fare me rëndësi emërtesa e

---

6 Bardhi F., *Diktionarum latino-epirotikum*, Romë, 1635.

7 IAP, *Ekspedita vjeshtore në disa vise të Serbisë Jugore*, GJASSHF, X, Prishtinë, 1980, fq. 385-395.

tyre, si për shembull, Komisioni Kombëtar për Terminologji, ose edhe Komision Ndërshtetëror për Terminologji etj. Në këtë kontekst sa për konkretizim mund t'i referohemi shumë shembujve që e pasqyrojnë këtë dukuri, këtë domosdoshmëri të kohës. Sa për ilustrim, në fushën e drejtësisë, për emërtimin e nivelit të institucionit ku fillohet një procedurë gjyqësore tek organi shtetëror bazë<sup>8</sup> për dhënien e drejtësisë kemi: *Gjykatë e Shkallës së Parë*, në Republikën e Shqipërisë, ndërsa, po për të njëjtin nivel të gjyqësorit e kemi në përdorim emërtimin institucional të po këtij organi *Gjykatë<sup>9</sup> Themelore*, në Republikën e Kosovës. Pra brenda dy njësive tona shtetërore që udhëheqin procedurë të njëjtë gjyqësore kemi dy emërtesa me formulime të ndryshme. Në gjendje të njëjtë, e kemi në administratën shtetërore të njësive përgjegjëse, në Republikën e Shqipërisë për grasësin, njeriun që vë në lëvizje një makinë, përdoret sintagma *drejtues i mjetit*, ndërsa në atë të Republikës së Kosovës, sintagma *ngasës i mjetit*. Këtu vetëm sa për konkretizim paraqitëm shembujt më të thjeshtë si dhe që veçohen mjaft për shtrirje. Ndryshe po t'i referohemi fushave të tjera mund të pasqyrohen edhe shumë terma të tjerë. Gjithsesi, po t'i kemi parasysh termat e kimisë, botanikës, mekanikës, aviacionit, bujqësisë, blegtorisë si dhe shumë fushave të tjera që janë edhe më specifike, besoj se nuk do koment çështja, ngase, me siguri do të dilnin përdorime të panumërta. Gjuha shqipe sot, përkatësisht kultura terminologjike është vërshuar me numër të pakufishëm të fjalëve të huaja, si p. sh.: *firmë, esencë, ekuilibër, iniciativë, inspirim, distancë, gjeneratë, prezent, kualitet, kuantitet, opinion, akomodim, shou, dimension, ortografi, barrierë, hit, kurioz, kuroj, preferoj, barrierë, interaktiv, civilizim, sensibilizim, inaugurim, inspirim, violencë, konfirmim, bord, brifing, suportim, diversitet, impenjim, koordinim, implementim, monitorim, agjendë, afishim, aplikim, aprovim, asistim, abuzim, aderim, ambient multimedial, multidimensional, multifunksional* etj.

Në këtë rrugë gjithsesi se kemi nocione e koncepte që për të njëjtin kuptim të përkufizimit në gjuhën shqipe përdorim përplot huazime të panevojshme nga gjuhë të ndryshme. Madje një numër folësish priren të përdorin shprehje të huaja për të pasqyruar përshtypje se kanë lexuar, gjegjësisht i kanë përvetësuar në “bibliotekën e mençurisë”<sup>10</sup>. Në këtë hulli ka shumë fjalë, ne po veçojmë një numër sosh, si për shembull: *kualitet-cilësi, kuantitet-sasi, shou-shfaqje, opinion-mendim, barrierë-pengesë, ambient-mjedis, iniciativë-nismë, violencë-dhunë, civilizim-qytetërim, interaktiv-ndërveprim, involvoj-përfshij, dimension-përmasë, relaksim-çlodhje, kreativ-krijues, prezent-i pranishëm, defekt- e metë, mortalitet-vdekshmëri, inspirim-frymëzim, esencë-thelb, injorancë-padituri, aderim-anëtarësim, abuzim-shpërdorim, aksent-theks, karrotrec (karro a treci)-mjet për bartje* (mjet për bartje

8 ASHA, *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006, fq. 365-375.

9 Stavileci E., *Fjalor shpjegues i termave administrativë*, Prishtinë, 2010, fq. 77-87.

10 Po aty, fq. 15-25.

të mjeteve, në kuptimin figurativ, merimangë), *lavazh-autolarje* etj.

Në pasqyrimin e kuptimit disa fjalë shquajnë edhe nuanca mjaft të thella dallimi, jo vetëm brendapërbrenda pasqyrimeve të kuptimeve të natyrës së gjuhës nga edhe e kanë prejardhjen, por edhe në krahasim me varietetin e njëjtë edhe në gjuhë të ndryshme: *ndihmë-asistencë-suport, kuvend-parlament-asamble, marrëveshje-dakordim-konsensus, drejtpërdrejt-live-direkt, përparësi-primare-prioritet, udhëheqës-lider-lidership, përmbledhje-konkluzion-rezume-summary, përvojë-eksperiencë-stazh, autolarje-lavazh-car wash* etj. Në korpusin e fjalësit të fjalorëve hartimi i fjalëve duhet të përditësohet, gjegjësisht të redaktohet në mënyrë që fjalët, të cilat nuk e pasqyrojnë prejardhjen burimore, sa më parë të mënjanohen, ndërsa vendin e tyre ta zënë fjalët e reja, si, p.sh.: *sipëri, çmimilirë, mendjvegël, fundmuaj, fundjavë, fundvjeshtë, fundvit, fundshekull<sup>11</sup>, shtremë, prishtë<sup>12</sup>, brithë-a, bukurezë-a, vraptar-i<sup>13</sup>*. Gjithsesi, ato që e shquajnë natyrën dhe visarin autokton, pavarësisht se në fillim mund edhe të mos i përmbushin mirëfilli përputhshmëritë, ato me kohë do të “mbëltohen” duke u bërë pjesë thelbësore e pasurisë sonë gjuhësore. Ky proces duhet të bashkëveprojë me dinamizmin e kohës për t’iu përgjigjur më denjësisht kërkesës së kombëtarizimit e të normativizimit të leksikut të gjuhës shqipe. Tutje, fjalë format që nuk përbëjnë thyerje në sistem, fjalët e huaja, ato që janë “të vjetruara”, arkaizma, historicizma, aty këtu edhe ato krahinore, pse jo edhe krijime të atilla vetjake që janë përfshirë në fjalorët e mëparshëm, nga besojmë se ka mjaft, duhet të mënjanohen: *kalenicë, llukmaxhi, patllake, rospillan, penxhere, defderdar* etj. Këtu, vetëm sa për shembull nga shkronja e parë e *Fjalorit të Gjuhës Shqipe* të vitit 2006, fjalët që nuk janë më në fondin e korpusit leksikor: *aferim, agërshak, ajërshpërndarëse, akçi, akraba, aktdelegim, allaxha, allçak, antiklerikal, araba, arka, aski, atëri, arkapi<sup>14</sup>* etj.

Ndërsa për sa i përket dallimit të kuptimit, një numër tjetër i fjalëve për shkak se pasqyrojnë një denduri të shquar në ligjërime gojor, po ashtu edhe në ligjërimin e shkruar, kanë evoluar duke krijuar nuanca më specifike në përfundimin e mirëfilltë të kuptimit të tyre. Kështu sa për shembull fjalë forma *përmbledhje*, e cila shkurtazi si dhe në mënyrë më të thuktë paraqet rezultatet konkrete të analizës së hulumtimit të përmbajtjes së strukturës kuptimore të një punimi, në krahasim më fjalë formën sinonime, *përfundim, -i, m. sh. -e(t)*, e cila modifikon të shterojë aspekte më gjithëpërfshirëse të përfundimit të një diçkaje, si: *përfundimi i kampionatit; përfundime të mira<sup>15</sup>* etj. Synimi në këtë përvijim mëton të zbutë sa më

11 Shkurtaj GJ., *Kundrime gjuhësore*, PEGI, Tiranë, 2006, fq. 228-248.

12 Gashi M., (2023): *Studime gjuhësore për të folmen e Prizrenit*, MASHT, Koha Ditore, Prishtinë, fq. 135-147.

13 Murati Q., (1998): *Fjalori i shqipes truallesore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998, fq. 202-217.

14 ASHA, *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006, fq. 9-25.

15 Po aty, fq. 728-787.



shumë mospërputhjen ndërmjet shkallës më të lartë të sintezës semantike kundrejt kërkesë themelore për qartësi funksionale si për thjeshtësi shpjegimesh, pse jo edhe për thjeshtësi formulimesh. Sendërtimi i sistemit të këtyre të korpusit leksikor për shkrimin e këtyre kuptimeve në fjalë forma të veçanta, pa i bjerrë vlerat kryesore shprehëse e kuptimore të fjalëve do ta definonte edhe më saktësinë që është jetike<sup>16</sup> për folësin. Në këtë kuptim as që duhet të komentohen fjalët e njohura, ato të përditshme, ato që në mënyrë të njëmendtë e mishërojnë pastërtinë dhe njësimin e mirëfilltë të natyrës së gjuhës dhe komunikimin e saj. Nuk është e tepërt nëse këtu e pasqyrojmë edhe *Fjalimin e Getisburgut*, fjalimin më të bukur në gjuhën angleze, që shquan 271 fjalë, nga të cilat 251 me një ose dy rrokje<sup>17</sup>. Në anën tjetër do të ishte shumë e vlefshme për përndarjen e këtyre nuancave kuptimore mbi bazën e përcaktimit të rregullave të rrepta për një njëjtësim rrënjësor në përkufizimin e disiplinës së terminologjisë. Ndryshe thënë, leksikologët, specialistët gjuhës do t'i ofronin ndihmë të pazëvendësueshme në qartësimin e kuptimit terminologjik, pra krahas leksikografëve edhe gjuhëtarët me natyrën e qasjes së tyre specifike, madje edhe në renditjen dytësore, apo qofshin vetëm edhe si këshillëdhënës. Në këtë mënyrë natyra ndërdisiplinore shkencore pandërmjetshëm e rrit edhe më shumë nevojën e standardizimit terminologjik.

Në këtë kontekst po e ritheksojmë se kryefjala e thirrjes së kohës së sotme është domosdoshmëria që specialistët e fushave përgjegjëse t'i parashtrajnë kërkesa qeverive të tyre përgjegjëse për krijimin e këtyre njësive përkatëse për standardizimin e fushës së terminologjisë gjithandëj nëpër institucione, pra jo vetëm për hapësirën shqip folëse. Kjo përballje e mungesës së harmonizimit të mirëfilltë të fushës së terminologjisë në gjuhën shqipe po i rëndon edhe ngulimet e elementit shqip ngado që ndodhen e veprojnë. Në mënyrë të veçantë edhe mërgatën tonë që vepron me punë të përkohshme në vendet e ndryshme anë e kënd rruzullit tokësor. Prandaj, në këtë aspekt, për aq sa do t'i vinim në ndihmë edhe kësaj pjese të gjakut arbëror, pavarësisht nivelit, kushteve e mundësive që ata kanë t'i përdorin. Drejtpërdrejt, ata nuk kanë nga kush tjetër ta presin ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin e kulturës e të trashëgimisë shpirtërore të elementit që i takojnë. Për ta kuptuar më shtruar këtë mjafton t'i kemi parasysh përmasat e investimeve të vendeve, duke u nisur pikërisht nga vendet që i kemi më afër deri te ato më të largëta, për të mos i zënë ngoje vendet që ndërmarrin masa ndëshkuese për përdorime jo të drejta të standardeve gjuhësore e terminologjike. Këtu, meqë e kërkon koha, prapë besoj se nuk është e tepërt, sa për shembull, të veçojmë, Francën, Republikën e Kroacisë deri te Italia e cila, së fundmi ka ndërmarrë masa të ashpra, të papara deri më sot.

Në këtë mes, po ta shohim në një aspekt më të ndjeshëm i detyrohemi gjuhës

16 Lucas S., *Arti i të folurit publik*, UET Pres, Tiranë, 2011, fq. 306-328.

17 Po aty, fq. 306-328.

dhe “gjakut” që kurrë nuk reshti të kursejë, madje me përkushtimin më të madh, sikur edhe më parë në vështirësi përherë të gatshëm, bashkë në vijën e parë, jo vetëm të punës. Pra pandërmjetshëm ndërgjegjësimi i kulturës kërkon të jemi sa më pranë qenësisë sonë, me visar autokton, jo vetëm këtu, por gjithandej kudo që gjallëron, vepron e vijon të mbijetojë në vende qoftë të lindjes a të perëndimit elementi ynë.

Kultura e veçantë si pjesë e pandarë e asaj së përgjithshmes shpërfaq të bashkërendojë vlera, bindje, qëndrime, prirje, mënyra, kode e norma të sjelljeve në raport të pa ndashëm me shoqërinë, të folmet, gjuhën dhe përdorimin e standardit. Termi është emërtim i përcaktuar i një nocioni të një fushe, qoftë të shkencës, apo edhe të artit, pse jo edhe të mbarë theksave të tjerë që përfshin jeta dhe mjedisi shoqëror. Siç është tashmë e njohur termi mund të shprehet me një fjalë, me një togfjalësh, mund të modifikohet në përdorime qoftë nga klasa njerëzish, njësoj si shprehja frazeologjike. Konceptimi i tij shpërfaq fjalë formën thelbësore të mendimit për të vërtetën<sup>18</sup>, tiparet e veçanta të përkufizimit të së përgjithshmes që e emërtojnë kuptimin e realitetit konkret. Bashkërendimi i koncepteve për sa më shumë përcaktim të definuar është në qendër të interesit terminologjik. Kjo qasje siguron qasje kognitive<sup>19</sup>, pra komunikim më efikas dhe më përmbajtjesor, i motivon sferat që dëftojnë kulturën e disiplinës dhe përfshirjen e saj në botën bashkëkohore. Nisur nga praktika e zakonshme fjalorët kryesisht hartohen nga më shumë autorë, por ka edhe fjalorë të tillë që hartohen nga vetëm një autor, siç është fjalori i M. Elezit<sup>20</sup>.

Në këtë kontekst duke mos e paragjykuar fushën e dijës, as nivelin profesional të fushës së veçantë, madje për asnjë moment, përkushtimin për punën dhe metodologjinë e realizimit, megjithatë fjalorët e derisotëm nuk e kanë qartësinë e as saktësinë që do të duhej ta kishin, pikërisht sikurse edhe ky që e cituam më lart. Padyshim se mbledhja e thesarit është domosdoshmëri shoqërore, me interes të veçantë për formësimin e identitetit të kulturës kombëtare me një terminologji të kornizuar, pra jo vetëm detyrë e instituteve dhe e institucioneve që e kanë në veprimtarinë e tyre programore. Në mënyrë të posaçme revistat dhe shtëpitë botuese mund të kujdesen më shumë duke i dhënë hapësirë më të madhe paraqitjes së këtyre trajtimeve dhe përmbajtjeve që i shquajnë, apo që i marrin në shqyrtim. Megjithëkëtë, marrë në përgjithësi, me theks të posaçëm përkushtimin e rrethit intelektual, ku përpjekjet dhe sukseset nuk duhet të mungojnë, përndryshe brezat nuk do të na vlerësojnë. Në këtë sfond të përpjekjes e vlen të e shquajmë vetëm përsëritjen e botimit të njëjtë ndër vite të fjalorëve të gjuhës së sotme shqipe me

---

18 ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, fq. 133-136..

19 Gvishanin N., *Terminology as knowledge banks: the cognitive approach (with special reference to multilingual lexicography)* në: [http://www.euralex.org/elx\\_proceedings/Euralex1992\\_1/023\\_Nataly](http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1992_1/023_Nataly)

20 Elezi M., *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, “Gjergj Fishta”, 2006, fq. 15-35.

41000 fjalë, më 1980, 1981, 1984 (Tiranë, Prishtinë). Të njëjtin fjalor me 41000 fjalë e boton përsëri shtëpia botuese “Toena”<sup>21</sup>. Po kështu, sipas një kundrimi leksikografik edhe vëllimi “Fjalor i Gjuhës Shqipe” i M. Elezit, i botuar më 2006, përmban numër të përafërt fjalësh, pra rreth 41000 fjalë.<sup>22</sup>

Në thelb të prirjes për thirrje të ndërgjegjes sonë kombëtare do të ishte e pafalshme nëse nuk do të shquanim gjithë konsideratën e vetëmohimin e secilit autor, për daljen në dritë të akëcilit vëllim. Kështu, së paku, leksikografia jonë, duke mos hyrë në analizën përimituese, ka edhe një pikë mbështetëse për referencë. Vëllimi në fjalë, na sugjeron për kujdes në përzgjedhje të duhur, ndonëse mbledhje sa më të shpejt të thesarit të gjuhës shqipe, i cili gjithsesi ka nevojë të udhëhiqet nga ente gjegjëse, si ASHA dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë etj. Pavarësisht se kemi reagime që shkojnë edhe më tej, duke e kritikuar përpjekjen e më sipërme me fjalët e gjuhës latine: “O temporal o mores”, “O kohë të çuditshme, o njerëz të çuditshëm”! Meqë flasim për rrugën që duhet të ndjekim, pajtohemi me këto vërejtje e sugjerime të S. Islamit, si: “... e para, të organizohen njerëz (studentë, punëtorë shkencorë etj.) nën udhëheqjen e Institutit të Gjuhësisë (por edhe në baza vullnetare, pse jo?) për mbledhjen sa më të shpejt të thesarit...”<sup>23</sup>, por nuk e ndajmë mendimin që të ulë përpjekjen e kujtdo qoftë, në këtë aspekt, po kështu edhe të autorit të vëllimit “Fjalori i Gjuhës Shqipe” të M. Elezit.

Megjithatë, fjalori në fjalë “e kundroi fjalën shqipe nga shumë kënde duke e sendëzuar atë me fjalë e shprehje, me frazeologjizma, me shtjellime etimologjike, me plot e përplot fjalë të urta, me gjëza, doke, urime, mallkime, besëtytni, yshtje etj.”<sup>24</sup> Aty plotësohen çerdhet e fjalëve ku shquhen emërzime me baza të ndryshme, si: *tashja, djehja, sivjetja, parvjetja*, sinonime, si: *ngjitaz, ngatangat, prekaz* etj. Në këtë hulli, në diskursin metodologjik të marrjes me termin dhe sistemin terminologjik me qëllim të standardizimit, gjithsesi se duhet njohur më thuktë sistemin në tërësi për të qenë në gjendje që të përzgjedhim variantin e qëndrueshëm. Kështu për shembull, vetëm për fjalën **leckë**, autori në fjalë shënon mbi tridhjetë fjalë forma : *pandël, zhele, cangël, cule, crrile, çukulinë, finël, floqe, haruqinë, herke, jarmë, lëfetër, mërzzllinë, pandavelë, paul, pecurinë, pejurinë, pingël, rutan, spinël, strangël, stërkanël, spathok, strukël, strukulinë, sukullinë, leshkijë, cukrrel, çuese, linç, linçe, rrekzinë* etj. Ky fond i pasur i fjalë formave të ndryshme na jep më shumë mundësi për të përzgjedhur jo vetëm një fjalë formë të mirëfilltë.

Nisur nga këtëj fusha e përdorimit të emrave që nga Buzuku, përkrah

21 ASHSH, IGJL, (2006): *Fjalor i Gjuhës së Sotme*, “Toena”, Tiranë, fq. 23-105.

22 Islami, S., *Disa fjalë për fjalorët e gjuhës së sotme shqipe dhe “Fjalorin e Gjuhës Shqipe” të M. Elezit*, “Shkëndija”, Prishtinë, 2009, fq. 26-27.

23 Po aty, fq. 26-27..

24 Zymberi A., *Shtatoi leksikografinë dhe semantikën e shqipes*, “Epoka e re”, Prishtinë, 2008, fq. 14-15.

edhe kontributit të albanologëve të huaj, si: Pedersen, Majer, Hahn, pastaj atë të gjuhëtarëve: Aganit, Ajetit e të Demirajt etj. asnjansit e shqipes i veçojnë për pasuri më të moçme të saj. Tutje po ky fjalor, qoftë edhe jo i përkryer “ka rreth njëmijë asnjans” me baza të ndryshme prejardhjesh, si: *të brryluarit, të çepuarit, të kalbunit, të djegtit, të mykëtit, të rrudhtit* etj., madje një numër i këtyre emrave ruhen edhe në ngulimet shqiptare të Ukrainës. Kontributi i M. Elezit, pavarësisht mangësive, si fjala vjen, shkrimet poetike etj., ka hapësirë për vlerësim të përpjekjeve për prurje të rëndësishme gjuhësore, por, assesi të ndajmë mendimin: “Një njeri, punoi sa një Akademi”!<sup>25</sup> Mungesa e kuadrove të fushave gjegjëse, ngritja e posaçme profesionale, s’ka dyshim se edhe përpjekjet vetëmohuese janë reale “të shpërthejnë”, siç është rasti me Fjalorin e M. Elezit. Në rrethanat e sotme të globalizmit, nëse i referohemi normëzimit të kodit të terminologjisë tradicionale, mbi bazën e këndvështrimit socio-kognitiv edhe Kanunet<sup>26</sup> kanë pasqyruar një epokë më vete. Në trojet arbërore ata e kanë përfillur perceptimin e kombinuar për koncepte për normën e jetës e të drejtës në përkufizimin për ndëshkim e detyrim: *gjobë, dëbim, hakmarrje*, me dispozita të “procedurës gjyqësore”<sup>27</sup>, pra edhe ky “univers” nuk është fenomen statik shoqëror, por një kompleks me rëndësi i së drejtës zakonore shqiptare, që pësoi një evolucion të pareshtur, ndonëse të ngadalshëm”.<sup>28</sup>

### Përfundime

Në këtë vështrim pasqyruam vështirësitë që sot përballet fusha e terminologjisë, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë parashtrojnë kërkesën për një angazhim edhe më të madh në njësimin e kësaj disipline shkencore në hapësirën shqipfolëse. Parashtresa për ngritjen e komisioneve për njëjtësimin e terminologjisë duhet t’i drejtohet organeve shtetërore të shqip foljes, pra, gjithsesi duhet të institucionalizohet. Në këtë kontekst është e domosdoshme të paraprihet me takime e konsulta të niveleve përgjegjëse, pse jo edhe të rregullta për të qenë sa më pranë zgjidhjeve të duhura në mënyrë që t’i hapim rrugë njësimin të mirëfilltë terminologjik. Mbarë korpusi fjalësor, padyshim, mbi bazën e parimeve, është i hapur për krijimin e njësive të reja, si: *brithë-a, fundvjeshtë-a, prishtë-a, sivjet-ja*, sinonime, si: *ngjitaz, ngatangatas, prekaz*; emra asnjans: *të djegtit, të mykëtit, të rrudhtit* etj. Saktësimi i kuptimit në mbarë hapësirën shqipfolëse në ligjërim: *drejtues* apo *ngasës* i mjetit etj. Identifikimin kuptimplot leksikor, në mënyrë që të zëvendësohen fjalët e huaja

25 Po aty, fq. 14-15.

26 GJEÇOVI SH., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (“\$ 496. Po vrau kush kend, gjaku lahet me “gja çdo gja”: me bagti, me tokë e me armë... \$ 498. Ma e ulta gjobë mbrin mje në një dash e më e nalta nuk mund të kalojë mbi njëqind desh.”), “Rilindja”, Prishtinë, 1972, fq. 32-84.

27 Po aty, fq. 32-84.

28 Po aty, fq. 84-108.

me fjalë shqipe, si për shembull fjalë forma *lehtë: lëfjetër, mërzzllinë, rrekzinë* etj. Përkufizimi i termave mund të sforcohet në përcaktimin e kuptimit për trajta të qëndrueshme në aspektin normativ që për bazë kanë kriterin përshkrues, informues, komunikues, si dhe atë trashëgimisë kulturore, jo *rezyme* e as *konkluzion*, por *përfundim,-e*. Në përputhje me teorinë leksikografike, bazuar në përvojën e hartimit të fjalorëve, në kuadër të aspekteve të përgjithshme të këtyre parimeve e qëllimeve të fjalorëve, në radhë të parë është përdorimi i tyre në funksion të pasqyrimin sa më të mirëfilltë të shpjegimit e të përdorimit sa më të saktë të terminologjisë.

## BIBLIOGRAFIA:

- ASHSH, (1986): *Fjalor i termave të së drejtës, shqip-frëngjisht-rusisht*, Tiranë, fq. 10-501
- ASHSH-IGJL, (2002): A. të ndryshëm, *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, fq. 81-132.
- ASHSH-IGJL, (2006): A. të ndryshëm, *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, fq. 9-25.
- BARSALOU L. W., (2003): *Situated simulation in the human conceptual sistem*, Language and Cognitive Processes 18. pp. 513-562.
- DE SAUSSURE, F.(2002): *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, DITURIA, Prishtinë, fq. 132-155.
- DURO A ., (2001): *Terminologjia si sistem*, Panteon, fq. 08-56.
- DURO A., (2009): *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, QSA, Tiranë, fq. 07-89.
- ELEZI M., (2006): *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, “Gjergj Fishta”, Tiranë, 12-402.
- FABER P., (2009): *The cognitive shift in terminology and specialized translation*, MonTI. Monografias de Traducción e Interpretación, no. 1: fq. 107-134/ 7.
- FELBER H., (1984): *Terminology Manual*, Prep. H. Felber/*General Information Programme and UNISIST/ International Information Centre for Terminology*, Paris; UNESCO and Infoterm: fq.31.
- GASHI M., (2023): *Studime gjuhësore për të folmen e Prizrenit*, MASHT, Prishtinë, fq. 135-225.
- GJEÇOVI SH., (1972): *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Rilindja, Prishtinë, fq. 32-84.
- ISLAMAJ SH., (2004): *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, IAP, Prishtinë, fq. 105-305.
- KOXHAJ A., (2002): *Administrimi i sektorit publik*, Tiranë fq. 09-31.
- LUCAS S., (2011): *Arti i të folurit publik*, UETPres, Tiranë, fq. 306-328.
- MURATI Q., (1998): *Fjalor i shqipes truallësore të Maqedonisë*, Tetovë, fq. 202-222.
- POLLOZHANI B., - SALIU L., (2004): *Procedura administrative dhe konflikti administrativ*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë fq. 32-48.
- STAVILECI E, (2010): *Fjalor shpjegues i termave administrativë*, ASHAK, Prishtinë, fq. 77-87.
- STAVILECI E., (1997): *Hyrje në shkencat administrative*, ETMM, Prishtinë fq. 11-23.
- STILLMAN II, R., (1992): *Public Admistration, Concepts and Cases*, George Mason University.

# DOMETHËNIA E RAPORTIT TË TERMINOLOGJISË HUMANE ME ATË TEKNIKE NË FJALORIN ITALISHT – SHQIP TË 1848 HARTUAR NGA ATË LUCA DA MONTE GIOVE O. F. M.

**Msc. Luljeta Dushi**

Gjimnazi jezuit “Atë Pjetër Meshkalla”  
E-mail: luljeta.dushi@meshkalla.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Në vitin 1931, “Hylli i Dritës” boton një shkrim të Atanaz Gegajt ku lexojmë për herë të parë ekzistencën e një fjalori të thujse një shekulli më herët, mbetur akoma në dorëshkrim. Bëhet fjalë për fjalorin Italisht – Shqip, hartuar nga Atë Luca da Monte Giove O. F. M., prift italian që për nëntëmbëdhjetë vjet shërbeu në Shqipërinë e Veriut, kohë gjatë së cilës grumbulloi fjalët “që i përdorin këto njerëz për të shprehur konceptet e veta” dhe më pas, me kërkesën e eprorit të tij “për të mësuar gjuhën epirote në kolegjin e Shën Pjetrit në Montorio” i bëri bashkë në një fjalor dygjuhësh të mbetur në dorëshkrim. Në 2021, botuam pjesën e tij të parë në bashkëpunim me shtëpinë botuese “Onufri”. Meqë, sikurse vetë hartuesi thotë, fjalët që përbëjnë këtë fjalor janë ato që përdorin njerëzit, në raportin e terminologjisë humanitare me atë teknike mund të kuptojmë më tepër fushat specifike për të cilat në atë kohë ekzistonte terminologji e caktuar si dhe fushat humanitare ku terminologjia ishte më e zhvilluar e kështu, të arrijmë në zberthimin e botëkuptimit shpirtëror e material të kohës pikërisht me anë të terminologjisë, aq më tepër duke marrë parasysht faktin se fjalori ka 336 faqe dhe diku dhjetë mijë lema.

**Fjalët çelës:** fjalorë, gjuha shqipe, gjuha italiane, shkenca humanitare

## THE SIGNIFICANCE OF THE HUMANE - TECHNICAL TERMINOLOGY (ITALIAN – ALBANIAN DICTIONARY OF 1848 COMPILED BY FATHER LUCA DA MONTE GIOVE O. F. M.)

### ABSTRACT

In 1931, “Hylli i Dritës” publishes an article by Atanaz Gegaj, where we read about the existence of a dictionary dating back almost a century, still in manuscript form. It is an Italian - Albanian dictionary compiled by Father Luca da Monte Giove O.F.M., an Italian priest who served in Northern Albania for nineteen years, during which he collected the words “used by these people to express their concepts.” Later, at the request of his superior, “to learn the Epirote language at the college of St. Peter in Montorio,” he put together a bilingual dictionary that remained in manuscript form. In 2021, we published its first part in collaboration with the publishing house “Onufri.”

As the author himself states, the words that make up this dictionary are the ones used by people. Regarding the relationship between humanitarian and technical terminology, we can understand more about specific fields for which there was specific terminology at that time, as well as the humanitarian fields where terminology was more developed. This allows us to delve into the spiritual and material worldview of the time through the lens of terminology. Moreover, considering that the dictionary has 336 pages and around ten thousand entries.

**Keywords:** dictionaries, Albanian language, Italian language, humanitarian science

Mes më tepër se shtatëdhjetë fjalorëve gjuhë e huaj – shqip, shqip – gjuhë e huaj që u hartuan nga viti 1635, kohë kur u botua fjalori i Bardhit e deri me ardhjen e komunizmit më '44, përmendur nga akademiku dhe leksikografi Jani Thomai<sup>1</sup>, duhet përmendur një syresh që citohet shumë rrallë, ndoshta sepse vetëm në dhjetorin e 2021 pa dritën e botimit, pjesërisht. E kam fjalën për Fjalorin Italisht – Shqip të Atë Luca da Monte Giove, përfunduar dhe dërguar pranë Propaganda Fide-s si dorëshkrim më 1848, dhe mbetur i tillë, pjesa më e madhe e tija:, fatkeqësisht akoma dhe sot.

Për jetën dhe veprimtarinë e Luca da Monte Gioves dimë shumë pak gjëra. Thuhet se ka qenë 19 vjet misionar françeskan në Shqipëri dhe më pas mësues i gjuhës shqipe në Romë. Sipas A. Gegajt Da Monte Giove ka vdekur në vitin 1862.<sup>2</sup> Sipas J. Kastratit, Gegaj i referohet Bazzocchinit.<sup>3</sup> Katër letra, që shkroi prej Pultit, brenda viteve 1839-1841, ruhen në kuvendin françeskan San Pietro in Montorio.<sup>4</sup>

Në shënimet e patër Marcello Civezza shkruhet: “L'autore dimoro come missionario lungo tempo in Albania e fu poi in Propaganda a Roma. Maestro di lingua albanese”.<sup>5</sup>

Te Mario Rok do të gjejmë edhe këtë shënim: “... misionar i vjetër në Shqipëri, prefekt apostolik dhe profesor i shqipes në Kolegjin e San Pietro in Montorio ...”<sup>6</sup>

Për t'u rikthyer te tema e kumtesës, da Monte Giove në një letër e cila gjendet bashkë me dorëshkrimin e fjalorit, i shkruan ipeshkvit të tij: “Detyra që më është ngarkuar nga Shkëlqesia Juaj për të mësuar gjuhën epirote në këtë kolegji të Shën Pjetrit në Montorio dhe dashuria që ruaj për popujt e Shqipërisë, në mes të të cilëve kam kaluar vitet më të bukura të jetës sime, më kanë nxitur të rimendoj me veten time mënyrën që ta bëj të njohur konkretisht këtë gjuhë [...] Për këtë qëllim, hartimi i një fjalori doracak, në të cilin të jenë shënuar fjalët e gjuhës epirote, do të ishte një përparësi e madhe. [...] Duke qenë se gjuha shqipe e varfër me fjalë dhe duke mos pasur ato mënyra të shprehuri, me të cilat është e pasur gjuha italiane, nuk duhet të mrekulloheni që unë siguroj Shkëlqesinë e Juaj që në këtë fjalor janë të shënuara

1 Shih. Thomai J., “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, “Studime filologjike”, Nr. 3 - 4., 2004, fq. 5 - 18.

2 Gegaj A., *Mësimi i gjuhës shqipe në Romë në shek. XVIII-XIX*, në rev. “Hylli i dritës”, nr. 4, 1931.

3 Bazzocchini F., O.F.M., *Cronaca della provincia Serafica*, Firenze, 1921, 424 - P., CUBERNATIS, Orbis S. Ap. 763.

4 Kastrati J., *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 2000, fq. 745, shën. 3.

5 Marcelin Civezza P., Biblioteca di S. Fortunato, Todì, nr. 424. P. Luca da Monte Giove, *Dizionario italo-albanese*. Manoscritto cartaceo dal 1848. Ha faciate 328. L'autore dimoro come missionario lungo tempo in Albania e fu poi in Propaganda a Roma. Maestro di lingua albanese.

6 Roques M., *Recherches sur les ansiens textes albanais*, Paris, 1932, fq. 8, shën. 6.

gati të gjitha fjalët, të cilat i përdorin këta njerëz për të shprehur konceptet e veta, por edhe jam përpjekur që të jenë të thjeshtë për t'u konsultuar nga misionarët e rinj.”

Pikërisht në pohimin se në fjalor janë *gati të gjitha fjalët të cilat i përdorin këta njerëz për të shprehur konceptet e veta* gjendet arsyeja pse është shumë i rëndësishëm raporti mes terminologjisë humanitare dhe asaj teknike në të. Duhet thënë, së pari se fjalori ka përafërsisht dhjetë mijë lema në gjuhën italiane, ndërsa në gjuhën shqipe, duke marrë parasysh se përkthimi i një fjale jepet në dy a më shumë variante në shqip, numri i këtyre të fundit është edhe më i madh. Mes lemave të fjalësit shqip, ka fjalë që sot nuk përdoren më, si për shembull *latushë* (sëpatë me teh të gjatë që përdoret për të çarë dru), “orok” (caktim që më përpara i një date kur kryhet një veprim) etj., si dhe të tjera që tregojnë vijimësinë nga Buzuku, deri te da Monte Giove, për shembull “brigë” apo “prieçë”.

Paraprakisht, vëmë në dukje se Luca da Monte Giove përdor në *Fjalorin* e vet (po ashtu si Da Leçe)<sup>7</sup> alfabetin latin, të cilin, kur është e nevojshme për të shprehur tingujt e shqipes, e përshtat duke dyfishuar shkronjat etj.. Ajo që duhet theksuar këtu është përdorimi i pesë grafemave<sup>8</sup>, që nuk janë latine. Khs. *dh* : 9, *ll* : λ, *th* : 99, *y* : 8, *z* : ε.

Në një përlllogaritje të thjeshtë matematikore, vërejmë se në përqindje, terminologjia humanitare në fjalor përbën 42% të fjalësit të tij. Ajo ndahet në terminologji humane, sociale si dhe kishtarë. Pjesa tjetër, ajo teknike ku përfshihen vegla pune, materiale ndërtimi, bujqësi dhe blegtori etj., përbën 58% të fjalësit të përgjithshëm. Duke u rikthyer te pohimi i da Monte Giove-s, vërehet se ka një numër më të vogël fjalësh që përdoren për të shprehur konceptet humanitare sesa për shprehjen e koncepteve teknike. Dhe, diçka tjetër që bie në sy gjatë analizave të fjalësit është se huazimet nga italishtja e turqishtja kryesisht dhe sllavishtja më rrallë, ndryshe nga sa pritej janë të pakta në krahasim, për shembull me huazimet e të folmes së Shkodrës. Thënë kjo, në fjalorin e da Monte Gioves gjejmë të gjithë historinë e gjuhës shqipe, qysh me fjalët e Formulës së Pagëzimit, mandej me leksikun e Buzukut, Budit, Bogdanit, lemat e fjalësit të Bardhit, Matrëngës e deri te Da Leçe, bashkë me huazimet e tyre.

Gjithashtu, vlen të përmenden edhe fjalët e rralla të përdorura në këtë fjalor, pasi një pjesë e tyre kanë humbur e nuk përdoren më. Le të rreshtojmë këtu vetëm disa prej tyre, të cilat na tërhoqën vëmendjen: *latusce-a* “latushë-a; sopatë me teh

---

7 Khs. Biblioteka françeskanë “Át Gjergj Fisha” (Kolana e shkrimtarëve françeskanë), Át Francesco Maria da Leçe O.F.M., *Dittionario Italiano - Albanese (1702)*, Botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip, përgatitur nga Gëzim Gurga, Botime Françeskane, Shkodër, 2009, fq. 82.

8 Kastrati J., në “*Historinë e albanologjisë*” (po aty, fq. 745), shkruan: “Ortografia: përgjithësisht përdor drejtshkrimin e shkrimtarëve të vjetër të Veriut me shenja të posaçme për *y*, *ll*, *z*, *dh*, *th*. Khs. edhe T. Osmani, *Udha e shkronjave*, Shkodër, 1999, veçanërisht në fq. 75 v.



të gjatë që përdoret për të çarë dru”<sup>9</sup>; *orok-u* “caktim që më përpara i një date kur do të kryhet një veprim, takim a një punë”; *stone-a* “shtonë; vijë nën dhe”; *magg8p-i* “magjyp-i”; *termal* “përtpjetë”; *l8m-i* “llumi që lë lumi kur kthehet në shtratin e vet”; *rubë-a* “shami për të mbuluar kokën”; *leçitune* “leçitun, i shpallun si i padëshirueshëm për të kryer një punë, i përzënë”; *stap* “shkop”, *stage-a* “shtagë, bastun”; *bardak* “bardhak; enë që përdoret për ujë”; *brigë-a* “brenjë, hall, mërzi”, fjalë që del edhe te Buzuku (*ke me pasunë ndonjë brigë*)<sup>10</sup>; *priçë-a* “opangë; sod përdoret mâ tepër për opangë të merzëllueme (harnue) me përqaqëza”, që e jep Gazulli me përdorim në Kelmend të Malësisë së Madhe<sup>11</sup>; *penik-u* “lloj meli me kokrra të vogla të verdheme a të kuqe”, por edhe “bukë me miellin e këtij meli”; *kroshnje-a* “zymbyl, kofne, koshare” etj..

Një qasje antropologjike e raportit të përmendur më herët do të na shpinte në idenë se për banorët e Pultit të asaj kohe, mbyllja në dhjetë mijë fjalë e gjithë botës së tyre të mendimit dhe të shprehjes, ku pjesën më të madhe e zë terminologjia teknike, tregon një varfëri psikike e shpirtërore të popullit i cili kërkon dhe një shënjeshtëri për të shënjuar konkretë më tepër sesa shënjeshtëri për të shënjuar abstrakt, pjesë përbërëse e dy dimensioneve ku kjo varfëri mund të tregohet. Por kjo mbetet hipotezë e pavërtetueshme, pasi përveç pohimit të hartuesit da Monte Giove, nuk kemi një tjetër burim tjetër për ta krahasuar nëse raporti i fjalorit i përgjigjet raportit real të komunikimit të përditshëm të kohës.

Interes të veçantë lidhur me terminologjinë ka edhe *shtojca* e fjalorit, përbërë nga tetëdhjetë e dy emra njerëzish, gjashtëmbëdhjetë emra vendesh dhe tridhjetë e tetë fjalë të urta. Aty mund të shohim dëshminë e shqiptarizimit të patronimeve romane e latine, si dhe faktin se emrin italian për vendin tonë, *Albania* e përkthen si *Albania*, a o *Skipnie* dhe *Albanese* si *Skyptar*; i. Duke parë etimologjinë e emrave, vërejmë se ata kryesisht i përgjigjen emrave të shenjtërve që në historinë e jetesës së tyre, sjelljet, martirizimi apo mënyra si kanë jetuar dhe kanë fituar shenjtërinë, janë kthyer në emra të një ngjarjeje apo dukurie, si dhe në epitete që përherë bëjnë pjesë në fushën e terminologjisë humanitare.

Emrat e njerëzve, mbështetur në artikullin e **David Lukës**, “*Rreth prejardhjes së disa emrave vetjakë kishtarë në gjuhën shqipe*”<sup>12</sup> na shpie në disa përfundime:

*Shqiptarizimi i emrave kalendarikë romakë: Lule-a (ital. Lucia), Drandeflë-a (Rosa), Diçë-a o Dieçë-a (Domenica), Mare-a (Marta), Prende-a (Veneranda), Vate-a (Vitale), Trinka (Teresa) etj..* Arsyeja e dhënies së emrave shqiptarë përkrah atyre të shenjtërore, me të cilët nuk kanë lidhje derivacioni, është shpjeguar nga Luka në

9 Gazulli N., *Fjalorth i ri*, Tiranë, 1941, fq. 232.

10 Çabej E., “*Meshari*” i *Gjon Buzukut*, pjesa e dytë, Tiranë, 1968, fq. 35 (origjinali, XIV/3).

11 N. Gazulli, *Fjalorth*, po aty, fq. 337.

12 Luka D., *Rreth prejardhjes së disa emrave vetjakë kishtarë në gjuhën shqipe*, “Studime gjuhësore” IX, Shkodër, 2006.

artikullin e sipërpërmendur. Me emra shqiptarë, që nuk dalin në kalendarin katolik romak nuk mund jo vetëm të pagëzohet fëmija i sapolindur, por as të regjistrohet në famullinë përkatëse. Prandaj për çdo emër vendës, duhet përgjegjësi në kalendarin romak. Kjo dallohet qartë te emri *Tringe-a* ku Da Monte Giove shënon dy variante *Trinke-a*, por edhe *Terese-a*, të cilët nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Pra, vajza mban emrin *Trinkë-a*, por në regjistër të kishës është regjistruar me emrin e shenjtore *Tereza*. Po kështu *Lule-a* me ital. *Lucia*.

*Emra që paraqesin interes për historinë e gjuhës shqipe, veçanërisht për fonetikën historike: Ndue-i (Antonio), Ndre-a (Andrea), Leke-a (Alessandro), Les-i "Llesh-i" (Alessio), Cile-a (Cicilia), Lene-a (Elena), Zeff-i (Giuseppe), Gi8le-a (Giulia), Nike o Kole-a (Nicola), Pa8li (Paolo), Pashk-u (Pasquale), Frank, Frano (Francesco), Aghe-a (Agata), Gustin-i (Agostino) etj.. Emrat e mësipërm përbëjnë pika mbështetëse për ata që merren me fonetikën historike, sepse paraqesin dukurinë (e marrë në analizë) në një kohë të caktuar, pra shërbejnë kryesisht për saktësimin e kronologjisë së dukurisë përkatëse. Khs. p. sh. këtu trajtën e emrit *Ndue*, që tani del me diftong *ue* dhe pa *a*-në nistore, por khs. tani trajtën e shquar me *-i (Ndoi)* e jo tjetrën me *-u Ndou*. Po kështu emri *Ndre* del me fundoren *-e* e gjatë etj.. Gjithashtu të gjithë emrat e njerëzve të gjinisë femërore në njëjës të pashquar mbarojnë me *-ë* e jo me *-a* etj.. Natyrisht çështje të tilla të vështira nuk përbëjnë objekt diskutimi për studimin tonë.*

*Emra njerëzish të besimit mysliman. Ndër tre raste emrat e kalendarit katolik romak jepen me emra muhamedanë: khs. *Brahim (Abramo), Jakup (Giacobbo)* dhe *Isai (Isai)*. Këta tre emra të vjetër, që përmenden edhe ndër ngjarjet e Biblës, pra janë emra biblikë, nuk dalin kurrkund ndër banorët e besimit katolik, qoftë në kohën kur Da Monte Giove ka shërbyer si famullitar në Pult, qoftë edhe në ditët e sotme. Mbase Da Monte Giove ka dashur të thotë se këto emra të vjetër parakristianë, vazhdojnë si të tillë në emrat e besimit mysliman.*

Kjo shfaq rëndësi të veçantë për temën tonë, pasi vërehen ndryshimet e të përbashkëtat në mënyrën sesi formohen emrat në veçanti dhe fjalët në përgjithësi në kontekstin e gjuhës shqipe.

Në fjalorin e Atë Luca da Monte Giove-s, terminologjia humanitare zë një pjesë më të vogël sesa terminologjia tekniko – shkencore. Termat e huaj për paraqitjen e saj nuk janë aq të shumtë, ndoshta për shkak se Dukagjini ku hartuesi ka shërbyer për dy dekada ishte akoma i pandikuar aq sa vendet e tjera, për shembull Shkodra. Në rastet kur ka huazime, për terminologjinë humanitare janë kryesisht nga gjuha italiane, ndërsa për atë teknike, nga gjuha turke.

Shtegtimi i mënyrës se si paraqitet terminologjia humanitare përgjatë historisë së fjalorëve shqiptarë, ndikimet dhe divergjencat që kanë sjellë, sjellin formatime të caktuara brenda të cilave ka ndodhur fjalëformimi, mendoj se do të ishin mënyra

e duhur për të krijuar një shkollë të vetme jo thjeshtë përkthimi, por shqipërimi të terminologjisë kryesisht teknike – shkencore që pasqyron zhvillimin e shpejtë e të pandërprerë të kësaj bote ku po lindin ditë për ditë të shënjuar që kërkojnë shënjes në secilën gjuhë.

### **BIBLIOGRAFIA:**

ÇABEJ E., (1968): “Meshari i Gjon Buzukut, pjesa e dytë”, Tiranë.

Da Lecce F. M., (2009): “Dittionario Italiano - Albanese (1702)”, Shkodër.

GAZULLI N., (1941); “Fjalorth i ri”, Tiranë.

GEGAJ A., (1931): “Mësimi i gjuhës shqype në Romë në shek. XVIII-XIX”, në “Hylli i dritës”, nr. 4, Shkodër.

Kastrati, J., (2000): “Historia e albanologjisë”, Tiranë.

LUKAD., (2006): “Rreth prejardhjes së disa emrave vetjakë kishtarë në gjuhën shqipe” në “Studime gjuhësore”, nr. IX, Shkodër.

ROQUES M., (1932): “Recherches sur les anciens textes albanais”, Paris.

THOMAI J., (2004): “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, në “Studime filologjike”, Nr. 3 - 4., Tirana.

# RRETH PËRVEÇIMEVE SPECIFIKE NË TEKSTE TË LITURGISË SË KRISHTERË (SHEKUJT XVI-XVII)

**Prof. As. Dr. Evalda Paci**

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

E-mail: evaldapaci@yahoo.com

## PËRMBLEDHJE

Një fushë e veçantë hulumtimi siç është ajo e terminologjisë së liturgjisë mund të gjejë hapësirë trajtimi në vëzhgime të natyrës diakronike, me një përcaktim të gjerë kohor e tematik. Prej faktit që dëshmitë më të hershme shkrimore të gjuhës e të letërsisë sonë reflektojnë në pikëpamje paracaktimi dhe përmbajtjeje një lidhje të qartë me fushën e sipërcituar, jo pak shtysa vijnë në vëmendjen tonë, aq më tepër në një perspektivë hulumtimi që merr në vlerësim veprat dhe formimin e autorëve që realizuan modele tekstesh në shekujt XVI-XVII. Kjo periudhë ka marrë vëmendje të vazhdueshme në një sërë vështrimesh, mbi të gjitha në ato që kanë objekt historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe çështjet e dokumentimit shkrimor të saj. Në veprat e letërsisë së vjetër shqipe reflektohet gjerësisht një terminologji që dhe për kohën në të cilën u realizuan këto të fundit, ishte në procese të vijueshme konsolidimi, fakt ky që lidhet dhe me zyrtaritetin e gjuhëve në të cilat tradicionalisht celebruhej liturgjia dhe ritet përkatëse. Rimarrja e këtyre çështjeve gjen shtysë dhe në kushte të disponimit të sprovave studimore të kohëve të fundit e që mbështeten në qëmtimin e një leksiku specifik nga veprat e letërsisë kishtare shqipe të shekujve të sipërpërmendur. Letërsia e vjetër shqipe përfaqësohet me një numër konciz ekzemplarësh, të pasur në elemente të brendisë, të përafërt me të tjera modele librare që përuroheshin gjatë shekujve XVI-XVII. Në disa prej tyre, përveçime konkrete në trajta me origjinë kryesisht latine, na ofrojnë dhe një panoramë arritjesh në përvijimin përmbajtësor e gjuhësor përkatës. Një panoramë e tillë mund të reflektohet në studime të natyrës diakronike, që ndjekin në pikëpamje objekti si tematikën e këtyre veprave, ashtu dhe kronologjinë përkatëse të realizimit të tyre.

**Fjalët çelës:** Letërsi e vjetër shqipe, leksik specifik, prejardhje latine, terminologji e liturgjisë

## ABOUT SPECIFIC ADDITIONS IN CHRISTIAN LITURGY TEXTS IN THE ALBANIAN LANGUAGE (XVI-XVII CENTURIES)

### ABSTRACT

A special field of research such as the terminology of the liturgy can find room for treatment in observations of a diachronic nature, with a broad time and thematic definition. From the fact that the earliest written evidence of our language and literature reflect a clear connection with the above-mentioned field in terms of predetermination and content, quite a few impulses come to our attention, even more so in a research perspective that evaluates the works and the formation of authors who produced text models in the 16th-17th centuries. This period has received constant attention in a number of aspects, above all in those that have as their object the history of Albanian written literature and the issues of its written documentation. In the works of the old Albanian literature, a terminology is widely reflected, that, for the time in which the latter were created, it was undergoing continuous processes of consolidation. This fact is also related to the officiality of

the languages in which the liturgy and the corresponding rites were traditionally celebrated. The resumption of these issues finds impetus in the conditions of the availability of recent research challenges that rely on the extraction of a specific lexicon from the works of Albanian ecclesiastical literature of the above-mentioned centuries. Old Albanian literature is represented by a concise number of specimens, rich in interior elements, similar to other book models that were inaugurated during the XVI-XVII centuries. In some of them, concrete additions in forms of mainly Latin origin, offer us a panorama of achievements in the relevant substantive and linguistic outline. Such a panorama can be reflected in studies of a diachronic nature, which follow from an objective point of view both the theme of these works and the corresponding chronology of their realization.

**Keywords:** Old Albanian literature, specific lexicon, Latin origin, terminology of the liturgy

Duke qenë se dëshmitë më të hershme shkrimore të gjuhës e të letërsisë sonë reflektojnë në pikëpamje paracaktimi dhe përmbajtjeje një lidhje të qartë me fushën e sipërcituar, jo pak shtysa vijnë në vëmendjen tonë, aq më tepër në një perspektivë hulumtimi që merr në vlerësim veprat dhe formimin e autorëve që realizuan modele tekstesh në shekujt XVI-XVII. Kjo periudhë ka marrë vëmendje të vazhdueshme në një sërë vështrimesh, mbi të gjitha në ato që kanë objekt historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe çështjet e dokumentimit shkrimor të saj.

Në veprat e letërsisë së vjetër shqipe reflektohet gjerësisht një terminologji që dhe për kohën në të cilën u realizuan këto të fundit, ishte në procese të vijueshme konsolidimi, fakt ky që lidhet dhe me zyrtaritetin e gjuhëve në të cilat tradicionalisht celebruhej liturgjia dhe ritet përkatëse.

Letërsia e vjetër shqipe përfaqësohet me një numër konciz ekzemplarësh, të pasur në elemente të brendisë, të përfaqësuara me të tjera modele librare që përuroheshin gjatë shekujve XVI-XVII. Në disa prej tyre, përveçime konkrete në trajta me origjinë kryesisht latine, na ofrojnë dhe një panoramë arritjesh në përvijimin përmbajtësor e gjuhësor përkatës.

Si një fushë specifike që grish studiuesit për hulumtime më të thelluara, terminologjia e liturgjisë së krishterë, e gjurmuar në veprat e letërsisë kishtare shqipe të shekujve XVI-XVII përbën një argument të gjerë trajtimi, qoftë dhe në kufijtë e një kumtimi si ky i ditës së sotme. Me autorë që flasin dhe përmes përpilimeve të tyre ndërkohë që mund të mos disponojmë të dhënat e dëshiruara mbi identitetin e plotë dhe veprimtarinë përkatëse, por dhe me gjurmimet që në lidhje me autorë të tjerë paraqiten në hapa saktësimi të kënaqshëm për studiuesit e periudhës, kjo letërsi paraqitet si një gurrë e çmuar të dhënash dhe elementesh për t'u gjurmuar.<sup>1</sup>

Si një gjuhë që dëshmitë më të hershme shkrimore i ka të datuara në shekuj

<sup>1</sup> Dëshmi të para të ekzistencës së një leksiku më të specializuar në lidhje me liturgjinë gjejmë që në dokumentimet më të hershme të shqipes, për të cilat studimet paraardhëse kanë vënë në dukje një sërë tiparësh ndërtime.

që lidhen dhe me premisat e zhvillimit të shtypshkrimit në Evropë e në vatra të rëndësishme kulturore të saj, shqipja nuk mungon të reflektojë me atë dokumentim të disponueshëm dhe përdorime që qartazi u përkasin sferave semantike të përcaktuara për nga destinacioni dhe përkatësia, fakt që mund të vërtetohet më së miri në gjurmime dokumentare dhe tekstore të mirëfillta. Argumenti i përzgjedhur për t'u bërë objekt trajtimi në këtë veprimtari shkencore na grish të orientohe mi dhe ndaj modeleve librare më të përhapura, që përbëjnë dhe një motiv interesant për të gjurmuar më tej mbi librat më të përdorur në shekujt XVI-XVII e sërish në fushë të praktikës së liturgjisë së krishterë. Në raport me vetë modelin libror apo me tërësinë e modeleve që ngërthehen në një vepër të vetme (si në rastin e librit të Gjon Buzukut) mund të flitet dhe për diferencime terminologjike, apo për dallime më të specifikuar, që shpjegohen pikërisht në lidhje me vetë natyrën e veprës dhe me periudhën e daljes së saj në dritë të shtypit. Në çështje të veçimit të ndërtimeve që bëjnë të flasim qartë dhe në mënyrë të shterrueshme mbi një gjuhë të liturgjisë së krishterë në botime në gjuhën shqipe, vetë letërsia kishtarë e shekujve XVI e më tej, kur mund të flitet për një kulturë shtypshkrimi të reflektuar dhe në traditën shkrimore në gjuhën tonë, është një burim të dhënash që nuk njoftojnë vetëm për gjendjen gjuhësore dhe për dallime që kanë të bëjnë me formimin individual të autorëve, por dhe për një tërësi përdorimesh që paraqiten të konsoliduara, aq sa kanë mbijetuar në të njëjtën fushë paracaktimi dhe në shekujt e mëvonë. Rindërtimi i një diakronie të përdorimit të termave të liturgjisë në gjuhën shqipe e ka pikënisjen në këtë letërsi, të cilën duke u mbështetur në një traditë emërtimi dhe kultivimi vijojmë ta quajmë në tekstet tona si letërsi e vjetër shqipe, por që në pikëpamje referimi përkon më së miri me një sërë përpilimesh të së njëjtës kohë, në të cilën viset evropiane i pohuan shtypshkrimit një epërsi të vërtetuar dhe që lehtësoi për më tepër disponimin e një pasurie librare, që ngërthente pa dyshim dhe librin e liturgjisë dhe doracakët që u shfaqën si modele të një përditshmërie përherë e më të kujdesuar në dekadat e Reformës e të Kundërreformës.

Dhe para Koncilit të Trentit e në periudhën e mbajtjes së koncileve paraardhëse kishtarë, në të cilat ka spikatur interesi për tekste të një rëndësie të veçantë dhe në pikëpamje formimi, libra të rëndësishëm që lidhen si me kulturën e njohjes së tekstit biblik, ashtu dhe të reflektimit të kësaj njohjeje në kontekste të një përditshmërie të përsëritur, mbeten objekt i një sërë gjurmimesh, në radhë të parë ndaj natyrës së tekstit, më tej dhe ndaj përveçimesh që me të drejtë në një vështrim diakronik dhe analitik, kanë gëzuar e gëzojnë një vëmendje më se të kuptueshme.

Nuk kanë munguar vështrime të natyrës gjuhësore e në funksion të historisë së fjalës, si dhe evidentimi i një trashëgimie të pasur në zëra të kësaj fushe, aq më tepër që kontributet shumëvjeçare të studiuesve të traditës studimore albanologjike janë reflektuar në vëllime të ribotuara, të përmirësuara apo të pasuruara në raste të caktuara nga vetë autorët apo përgatitësit e tyre.

Në gjurmimet e Kolë Ashtës do të mund të vjelim një sërë përveçimesh që

në kontekst të përfshirjes konkrete në veprat e letërsisë së vjetër shqipe paraqiten natyrshëm si pjesë e një terminologjie që do të gjejë konfirmim dhe në vepra të mëvona, të iniciuara nën të njëjtën qëllimshmëri, në orientim të përforcimit të një tradite të liturgjisë së krishterë në gjuhën shqipe. Kjo punë fort e vyer e tij, e paraprirë nga trajtesa që mëtojnë të reflektojnë dhe vijimësinë e përdorimit të ndërtimeve gjuhësore të këtij prelati te pasardhësit (Kristoforidhi, Justin Rrota O.F.M., Ndre Mjedja, Vincens Prennushi, Gjergj Fishta) i shërben dhe evidentimit të një pasurie leksikore të vyer në gjuhën dhe përpilimet e tij, të vëna në dukje dhe nga gjuhëtari danez G.Svane (1927-2012), të cilit i detyrojmë mirënjohjen dhe për tejskrimin e teksteve të Doktrinës dhe pajisjen me konkordanca të studimeve tematike mbi këtë të fundit.<sup>2</sup> Në kontributin e Kolë Ashtës do të duhej të ndaleshim më gjerë dhe për arsye të vërejtjeve me vend që jep duke interpretuar në mënyrë të gërshetuar çështje të ndërtimeve tipike në gjuhën e këtij autori me ato të gjinisë dhe të veçorive të shkrimtarisë, që paraqiten sërish në një dritë origjinaliteti falë njohjes së mirë nga ana e studiuesit tonë e veprës së Pjetër Budit.<sup>3</sup>

Ndër sqarimet metodologjike të Kolë Ashtës, i cili ka ndarë në disa linja punën me veprat e letërsisë së vjetër shqipe, do të mund të gjurmojmë dhe indicet e nevojshme mbi origjinën e fjalëve të caktuara, ndër të cilat do të veçonim ato të konsideruara latinizma. Dallimeve në dukje formale të tyre u duhet dhënë jo pak rëndësi, pasi rigjejmë tipare të fjalëve me origjinë latine që duhet t'i ketë në përmbajtje të teksteve të veta dhe paraardhësi i Budit, përpiluesi i *Mesharit* të vitit 1555. Veçimi i ndërtimeve me përkatësi të qartë latine, të cilat autori a shqipëruesi duhet t'i ketë marrë në tekste a libra të kohës, sigurisht të një tematike të lidhur me liturgjinë dhe praktikën fetare, e bën të mundur dhe orientimin ndaj dallimit të përdorimeve që kanë vlerë më së shumti terminologjike, siç cilëson nën këtë objektiv dhe vetë studiuesi Kolë Ashta.<sup>4</sup>

2 Me vend për t'u përfshirë në këtë trajtesë tonën dhe mjaft përdorime që përforcohen në pikëpamje të kuptimit falë pranëvënies me të tjera të ngjashme, me të cilat afrojnë në vështrimin kuptimor e kontekstual. Shih në veçanti dhe Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë, 1998, fq.135: Krahas frazeologjisë, ana leksikore e gjuhës së Budit shquhet edhe për sinoniminë e saj të gjerë, të cilën për këtë shkrimtar mund ta marrë në studim si letërsia, gjuha. Edhe këtu arsyeja, për të dalë sa më i kuptueshëm, e nxit Budin që të përdorë sinonime qofshin si fjalë me të njëjtin kuptim, qofshin me kuptime të ngjashme.

3 Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë, 1998, fq.135: Nuk mund të kalohet pa e përmendur sinoniminë me ato fjalë të njëjta o të ngjashme në kuptim, por pa dalë jashtë caqeve të vëzhgimit gjuhësor, sepse ajo kundrohet edhe nga ana letrare pors veçori stili e prozës së Budit ose kur jepet ndonjë vështrim i përgjithshëm i gjuhës së tij. E shikuar nga ana thjesht gjuhësore sinonimia e tij përbëhet me emra, mbiemra të emëruar e folje, por nuk përjashtohen rastet konkrete, kur në vend të dy sinonimeve, njëri prej tyre është frazeologji popullore.

4 Për dallimin dhe kategorizimin e latinizmave në gjuhën e tekstet e Pjetër Budit shih në veçanti Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë, 1998, fq.163: Llojet e këtyre (nënkupto: latinizmat) dallohen herë-herë jo pa një rezervë: së pari, ka te Pjetër Budi huazime prej latinishtes, të mbetura në shqipen popullore nga një kohë e vjetër e me ndryshime fonetike; së dyti shihen asosh të ardhura nga latinishtja, por që duken edhe në greqishten e vjetër ose ajo i ka marrë prej kësaj; së treti janë përmendur disa fjalë të paraqitura ashtu si në gjuhën latine pa qenë të përshkuara dikur nëpër farkën e fonetikës shqipe dhe merren si fjalë latine tekstesh, pra, nga libri e librat që ka pasur nëpër dorë Budi ose të tjerë; së katërti njihen fjalë të vona, prej italishtes. Ndryshe nga ato të dala gjuhësh së degëve të tjera, këto kategori huazimesh të rrjedhura nga latinishtja kanë problemet e veta edhe të kapërthyeshme, ndër të cilat ato të dallimit të tyre. Të këtilla huazime

U detyrohemi në këtë vështrim ndihmesave të çmuara të E.Çabejt, falë të cilit në vëllimet e përpiluara me gjurmime e interpretime mbi etimologjinë e fjalëve shqipe, gjejmë dhe trajtesa që cekin pikërisht lamijen e sipërcituar, e përfaqësuar nga një sërë përdorimesh që i përkasin fushës së liturgjisë së krishterë. Në këto gjurmime do të mund të gjejmë dhe interpretime mbi burimet në të cilat dëshmohen trajta të caktuara të së njëjtës fjalë e në rastin e përveçimeve që përfshihen dhe në trajtesën tonë, këto të fundit marrin një rëndësi themelore. Përjasjet me zëra të ngjashëm dhe në gjuhët neolatine, apo dhe dëshmimi me shembuj i një vijimësie në pikëpamje përdorimi në tekste liturgjike ndihmojnë të veçojmë për arsye të një trajtimi *ad hoc* ndërtime të veçanta të kësaj fushe, që marrin vëmendje dhe në dicionarë apo fjalorë të teologjisë së krishterë.

Në të vërtetë, në gjurmime të natyrës së sipërcituar, por dhe në korpuse të hartuara posaçërisht mbi leksikun e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, është e pashmangshme të veçohen zëra që mund të dëshmojnë përkatësinë ndaj një fushe të përcaktuar e mjaft të specializuar semantike, por dhe një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me rrugëtimin e fjalëve të veçanta e që mund të dalin në dritë falë rikthimit të disa prej tyre.

Elementet latine në gjuhën shqipe kanë qenë ndër të tjera një gurrë e pasur në burime interpretimi, pa përjashtuar fjalë që me gjithë origjinën greke, mund të kenë hyrë në gjuhën tonë nga rrugë të ndryshme. Një fakt të tillë e provojnë analiza të mëhershme që marrin në shqyrtim vetë zërat e interesuar, por dhe elemente të proceseve që kanë shoqëruar kalimin e tyre nga njëra gjuhë në tjetrën.

Sa u përket zërave që i përkasin pikërisht liturgjisë dhe katekezës, këta të fundit vijnë veçanërisht në trajta të konsoliduara në veprat a përpilimet e Pjetër Budit (1566-1622), duke pasur në disa raste dhe veçori që mund të interpretohen me çështje të formimit gjuhësor të këtij autori, që diferencohet në forma të caktuara nga paraardhësi i tij, përpiluesi i *Mesharit* (1555). Për t'iu rikthyer çështjes së latinitetit dhe ndërlidhjes me ato të leksikut të liturgjisë, duhet kujtuar pikërisht që Vulgatës latine në Koncilin e sipërpërmendur, iu kushtua një vëmendje e veçantë, dhe një fakt i tillë gjen reflektim dhe në brendinë e veprave të letërsisë sonë kishtare të shekujve XVI-XVII.

Fjalë që na shpien në një traditë të hershme të respektimit të riteve që kanë të bëjnë me kalendarin vjetor liturgjik janë dhe disa që kanë mbijetuar në dialektin verior, duke u ruajtur dhe në shprehje tipike që dëshmojnë lashtësinë e njohjes së besimit në viset tona. Në Shkodër vijon të përmendet ndërtimi “E diela e larit”, me përbërje të vet një trajtë latine që duke u bërë pjesë e leksikut të shqipes paraqitet me thjeshtimin e një prej diftongjeve më të rëndësishme për sistemin fonologjik të gjuhës latine. Sa për parentezë, duhet rikujtuar që dhe në rasë të studimit në nivele

---

i përkasin më të shumtën terminologjisë, si terma, për të cilat Budi bie ndër pengesa duke mos ditur ose duke mos pasur se si t'i zëvendësonte me fjalë shqipe.



didaktike të diftongjeve latine e që reflektojnë aspekte qenësore të pronuntia-s latine, janë pikërisht të tilla elemente (*gaudium; laurus; laus*) që ndërkohë që shfaqen si raste tipike të ruajtjes së një njësie fonologjike, janë në të njëjtën kohë dhe përveçime të ndikimit latin në gjuhën shqipe.

Ndikimi latin si i tillë është parë gjerësisht në vështrimin historik dhe të reflektimit përkatës që nuk mund të shfaqet thjesht në aspektin gjuhësor. Ky i fundit ka gëzuar një vëmendje të gjerë dhe një gjë e tillë konfirmohet qartësisht në studime mbi tekstet e vjetra shqipe, mbi përbërjen e shprehjeve më të thjeshta që përmbahen në tekste fragmentare të shqipes, në përvijimin e historikut të migrimëve të popullsisë tona në trevat italice, në qëmtime të natyrës etimologjike që evidentojnë një sërë zërash me prejardhje latine, me një reflektim të qartë të një lashtësie të hulumtuar në disa aspekte. Tekste më të përveçme siç janë psalmet e pendesës, por dhe lutjet mariane e ato të Offices përbëjnë një tjetër orientim hulumtimi që nxisin dhe ndaj dallimit të një linje të veçantë studimore mbi përveçime kryesisht me origjinë latine, por që janë ruajtur në variante të mëvona, të mbijetuara falë kujtesës popullore dhe transmetimit korrekt të tyre brez pas brezi. Edhe gjuha e liturgjisë së krishterë, me gjithë prurjet më se të kuptueshme nga greqishtja dhe ndikimet që gjejnë shpjegime të karakterit historik, dëshmon në zërat themelore të saj praninë latine dhe të riteve përkatëse.<sup>5</sup>

Një përpjekje për të pasqyruar aspekte të një gjuhe të liturgjisë në disa terma bën pikërisht Frang Bardhi (1606-1643), i cili në Dicionarin latinisht-shqip të vitit 1635 përfshin disa të tillë, natyrisht dhe duke i vënë përballë gje gjësin në gjuhën shqipe.

Ka fjalë të caktuara, të cilat nuk zgjerohen në përbërje të fjalorit në vështrim të përdorimit në sintagma që e bëjnë më të qartë vlerën funksionale dhe domethënien përkatëse kur këto të fundit konkretisht gjejnë vend: të njëjtat fjalë do të mund t'i gjejmë te autorët paraardhës: Buzuku, Budi, në kontekste të gjurmueshme sipas rubrikave të brendisë. Për fjalë që për vetë kuptimin themelor, por dhe përdorimin në tekste biblike mund të jenë pjesë e një leksikoni që përfshin lëndën biblike dhe atë teologjike, dhe në Dicionarin e Frang Bardhit mund të gjinden shembuj, gjithnjë të krahasueshëm me autorët e së njëjtës traditë. Do të gjejmë në këtë të fundit zërin *doctus (doctuer; doktuer: 21 1)*, por dhe zërin *doctor (doctuer; doktuer: 21 5)*, që na kujton sintagma tipike në tekstet e autorëve të sipërcituar.

Duke qenë vepër e shekullit XVII, Dicionari latinisht-shqip i Frang Bardhit risjell disa trajta e përdorime të gjindshme dhe në veprat paraardhëse, për të cilat mund të themi se vetë autori kishte njohuri duke qenë se figuron dhe si aprovues i ndonjë varianti kateketik të po asaj periudhe. Për vetë vëllimin dhe leksikun e

5 Siç dhe dihet, autorët e letërsisë së vjetër shqipe kanë qenë përshtatës dhe shqipëruës teksteve karakteristike, që në të njëjtën kohë paraqiteshin dhe si pjesë e një përditshmërie të përcaktuar, dhe ajo e paracaktuar në terma dhe përveçime.

përmbajtur në të, nuk mund të themi se gjithë ajo lëndë për të cilën do të kishim nevojë në pikëpamje konfirmimi nëse kemi qëllim të kryejmë përjasje mes tekstesh paraardhëse përmbahet e plotë në këtë vepër të vitit 1635.

Por në vështrim të mundësisë për të gjurmuar zëra të përveçëm, dhe në këtë dicionar mund të veçojmë disa përdorime më të veçanta e që dëshmojnë qartë përkatësinë ndaj një regjistri të posaçëm.

Trajta të caktuara që dhe në vepra të së njëjtës traditë letrare paraqiten të përdorura në një kontekst që na orienton ndaj letërsisë kishtarë dhe përveçimeve që i japin zë veçanësisë së saj në vështrim kuptimor, leksikor dhe specialistik, ndeshen pikërisht te Frang Bardhi, që në këndvështrimin e kohës në të cilën ka përpiluar dhe operuar me veprat e vepërzat e tij, paraqitet në një ndërmjetësi kronologjike që na bën të vështrojmë si ndaj autorëve që i prijnë, ashtu dhe ndaj atyre që e pasojnë. Me interes shfaqet trajta latine *oratio; oratione*, përkthyer në gjuhën tonë me *Vrata/ urata* (i përmbahemi në këtë rasë transkribimit të B.Demirajt në variantin e ribotimit të plotë mbi kritere filologjike e kritike të veprës së F.Bardhit), që na kujton lutjen e që në trajta të ngjashme do të mund të gjindet që te libri i Gjon Buzukut.<sup>6</sup>

Edhe në vështrim të gjurmimit të përdorimeve më të përveçme që shpien drejt zërash që kanë lidhje me njëri-tjetrin në pikëpamje etimologjike apo fjalëformimi, ky dicionar mbetet një referent i vyer, megjithëse vetë konciziteti në paraqitje dhe evidentim të tyre nuk lejon ilustrime apo perifrazime që mund t'i vijnë në ndihmë përdoruesit të tij.

Qasja ndaj përdorimesh më të veçanta shërben dhe për të vënë në dukje diversitetin në ngulitjen e formave të caktuara në secilën prej gjuhëve. Nëse kemi parasysh vjetërsinë e përdorimit të ndërtimit *Zotynë*, që shfaqet që në burimet më të hershme të letërsisë kishtarë shqipe, si dhe faktin që ajo gëzon një sërë trajtash që bëjnë të mendosh se ka konsoliduar një paradigme të mirëfilltë, orientimi i autorit ndaj zërit *Deus (sine nostro Deo; po aty, Dictionarium...*, 153 25), përbën një rast interesant diskutimi. Asocimi i trajtës *Deus* me trajta paradigmatiche të *Zotynë* ndeshet në disa sythe të veprës së Frang Bardhit dhe një fakt i tillë shërben si për të ngulitur domethënien që ky i fundit i vesh në kuadër të ndërtimit të leksikonit të fjalorit të tij, ashtu dhe në një vështrim më të gjerë, që sërish na orienton drejt realizimesh pak më të vona, por në të cilat do të gjindet dhe diferencimi përkatës sa

---

6 Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, fq. 255. Shih po aty dhe zërin latin *oratum*, që përkthehet në gjuhën shqipe nga Bardhi me trajtën analitike *te lutune* (po aty, *Dictionarium latino-epiroticum...*, 79 13). Me interes paraqitet dhe fakti i përdorimit të të dyja trajtave (përkatësisht *uratë* dhe *të lutuna*) në tekstet doktrinare të Pjetër Budit. Vetë fakti që në këto tekste të Budit operohet me anë të vjershërimit, bën të mundur që të gjurmohet në të njëjtin varg dhe fjalë që falë pranëvënies të jenë më afër domethënies së tyre: *Zoti im, një dritë n tee,/ n gojet sote, e më thuo,/ të mbushem plot besë e fee!* Budi P., *Dottrina Christiana/ Doktrina e krishterë (1618)*, riprodhim anastatik i botimit kritik të G. Svanes, përkujdesur, përkthyer dhe pajisur me faksimilet e tekstit burimor prej Demiraj B., Omarit A., Kapisë E., Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022, fq.613.

u përket trajtave *Deus e Dominus*. Edhe në lidhje me këtë zë e më tej, në pikëpamje të tërësisë së emërtesave që këtij të fundit i jepen në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, duhet thënë që pas Dicionarit të Frang Bardhit vepra e Pjetër Bogdanit (Patavii, 1685) vjen krejt natyrshëm, duke e pasuar në kohë e në çështje të tematikës qendrore mbi të cilën është ndërtuar dhe arsyetuar.

Vetë gjetja në përbërje të tij e zërave që përfaqësojnë dhe modele me interes për nga formimi, dëshmon që vështrimet mbi të cilat mund të gjurmohet leksiku i krishterë apo i botës së krishterë janë komplekse dhe të ndërthurura me disa qasje.<sup>7</sup>

Secili prej autorëve të letërsisë së vjetër shqipe ka dhënë një ndihmesë konkrete në pikëpamje të përvijimit të një leksiku të liturgjisë, apo të një leksikoni të përveçëm që përqendrohej në gjuhën e liturgjisë dhe të termave më të veçantë të saj. Rindërtimi i një leksikoni që mbështetet pikërisht në të tillë zëra, me një përkatësi të qartë ndaj liturgjisë dhe terminologjisë që lidhet dhe me vepra të ngjashme si breviari, psalteri apo rituali, përbën një domosdoshmëri dhe në një vështrim më të gjerë, me orientim kryesisht diakronik. Në varësi të natyrës së veprës, të teksteve që janë përfshirë në të, të ecurisë së tyre dhe të tipologjisë tekstore, jo pak shembuj na orientojnë ndaj përpjekjesh për ta bërë më solid një leksik të tillë, dhe pse në pikëpamje termash të rinj apo të rindërtuar mbi modele të ngjashme jo të gjithë dëshmojnë të njëjtën koherencë. Çka përbën një fakt për t'u vënë në dukje dhe në këtë rasë është pikërisht rimarrja në botime të mëvona, të ngjashme për nga tematika apo terminologjia përkatëse, e diktuar nga vetë veprat që u përpiluan në shekujt e mëvonë, kur dhe vetë argumentet shtjelloheshin në një përhapje më të gjerë temash dhe në disa modele librash, përfshirë trajtesa të zgjeruara që merrnin në analizë dhe përdorime të caktuara. Në traditën evropiane dhe në shekujt e mëvonë mbizotëruan botime që përpiloheshin në gjuhën latine, por dhe sprova në gjuhë të tjera, në të cilat pikërisht terminologjia latine nuk ka munguar. Në veprat dhe vepërzat në gjuhën tonë, një terminologji e tillë nuk mungon, por shfaqet krahas ndërtimesh që tërheqin vëmendjen për nga modeli i formimit të fjalëve.

### Përfundime

Ndër çështjet më të trajtueshme në lidhje me historinë e letërsisë shqipe mund të konsiderohen dhe ajo e verifikimit të të dhënave që kanë të bëjnë me autorë dhe me vepra të caktuara. Nënvizohet shpesh që nuk disponohen të dhëna në lidhje me autorët e letërsisë së vjetër shqipe. Mund të vijë në vështrim rishikimi dhe ajo e vitit të saktë të botimit të *Meshtarit*, duke qenë se referimi ndaj kolofonit mund të mos jetë mjaftueshmërisht bindës në disa pikëpamje.

Në lidhje me disponimin e të dhënave biografike të autorëve të kësaj letërsie, mbeten burime të rëndësishme faktet që jepen në faqet e korpusit madhor *Illyricum*

<sup>7</sup> Shih në veçanti zërin *Christianitas*, përkthyer me *kërshtenimi* në këtë Dicionar të Frang Bardhit (*po aty, botim I cituar*, 11 24).

*Sacrum*, por dhe shënimet në format kaligrafie të Imzot Karol Pooten.

## BIBLIOGRAFIA:

- ASHTA K., (1998): *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë.
- BUDI P., (1621): *Rituale Romanum et Speculum confessionis in Epyroticam linguam a Petro Budi Episcopo Sapatense et Sardanense translata*, Roma.
- BUDI P., (1664): *Dottrina Christiana, composta per ordine della fel.mem. di Papa Clemente VIII*, Roma.
- BUDI P., (1985): *Dottrina Christiana (1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus.
- BUDI P., (2006): *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë.
- ÇABEJ E., (1959): *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, nr.2.
- ÇABEJ E., (2006): *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë.
- CAMAJ M., (1960): *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë.
- DEMIRAJ B., (2006): *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë.
- DEMIRAJ B., (2008): *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër.
- OMARI A., (2016): *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- OMARI A., (2018): *Tradita letrare e Elbasanit si pasojë e iluminizmit gjuhësor me rrezatim nga Voskopoja*, në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- OMARI A., (2022): *Studime rreth shqipes së vjetër (shek.XV-XVIII)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- PACI E., (2014): *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4.
- PACI E., (2014): *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese (1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2.
- PACI E., (2017): *La Dottrina Cristiana del Bellarmino in una versione del gesuita Giuseppe Guagliata*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide, (a cura di A.Ndreca)*, Urbaniana University Press, Romë.
- PACI E., (2017): *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- PACI E., (2019): *Rreth disa veçorive leksikore e frazeologjike në vepra të letërsisë së vjetër shqipe (vështrim analitik dhe retrospektiv)*, në *Studime filologjike*, 1-2.
- PACI E., (2020): *Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe (përmbledhje studimesh filologjike dhe tekstologjike)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2020.
- Zamputi I., (1995): *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2.

# PASQYRIMI I FJALËSIT TË RILINDËSVE NË FJALORIN E GJUHËS SHQIPE

**Phd. C. Liridona Mehmeti**

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”

E-mail: liridona.mehmeti@uni-gjilan.net

## PËRMBLEDHJE

Gjuha shqipe tashmë ka krijuar historikun si gjuhë kombëtare e njësuar ose si gjuhë standarde me rregulla të vendosura në të gjitha sistemet e saj. Fillimet e saj historike gjuha e sotme standarde shqipe i ka që në shkrimet e para, por kristalizimi si variant i përgjithshëm nis me periudhën e Rilindjes Kombëtare, kur përpjekjet për kulturën dhe për gjuhën ishin të lidhura ngushtë me lëvizjen e gjerë politike, shoqërore e kulturore (Aleksandër Xhuvani 1905, Eqrem Çabej 1958, Dhimitër Shuteriqi 2017, Emil Lafe 1986, Jani Thomai 2006, Xhevat Lloshi 2018).

Rilindësit, si: Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Jeronim de Rada, Jani Vreto, Naim Frashëri, Sami Frashëri, të cilët ishin të vendosur për pastrimin e gjuhës nga fjalët e huaja, njëkohësisht, për shqipërimin e fjalëve të huazuara, si dhe pasurimin e fjalësisë së shqipes, duke krijuar fjalë të reja me anë të mjeteve të gjuhës amtare (me parashtesa, me prapashtesa dhe me përbërje). Kështu, nga Naum Veqilharxhi kemi fjalën *fletore*; nga Kostandin Kristoforidhi kemi fjalët: *bukëpjekës, kryeqytet, ndërgjegje, udhëheqës*; Naim Frashëri ka krijuar fjalët: *cilësi, sasi, gjithësi, vetëdije*; nga Sami Frashëri kemi disa terma të gjuhësisë: *folje, mbiemër, nyjë, presje, rrokje*; nga Jani Vreto kemi disa terma të matematikës e fjalë të tjera: *mbledhje, zbritje, mëmëdhe*. Ata, gjithashtu, bënë zëvendësimin e terminologjisë së huaj me terma shqip ose krijuan terma të rinj sipas nevojës së shkencës, të teknikës, të kulturës: *emërore, fjalor, kryefjalë, domosdoshmëri, hapësirë, zhvillim, barazim, rrënjë, trekëndësh* (Jani Thomai, 2006).

Pra, në këtë punim paraqesim ndihmesën e rilindësve për pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe, duke analizuar fjalësinë e tyre sipas ndërtimit e kuptimit, me anë të metodës së analizës e të përshkrimit.

**Fjalët çelës:** fjalësi, fjalëformimi, gjuha amtare, shqipërim fjalësh, rilindësit

## REFLECTION OF THE RENAISSANCE WRITERS LEXICON IN THE ALBANIAN LANGUAGE DICTIONARY

### ABSTRACT

The Albanian language has already created history as a unified national language or as a standard language with established rules in all its systems. Today's standard Albanian language has its historical beginnings in the first writings, but the crystallization as a general variant begins with the period of the National Renaissance, when the efforts for culture and language were closely related to the broad political, social and cultural movement (Aleksander Xhuvani 1905, Dhimitër Shuteriqi 2017, Eqrem Çabej 1958, Emil Lafe 1998, Jani Thomai 2006, Xhevat Lloshi 2005). The revivalists, such as: Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Jeronim de Rada, Jani Vreto, Naim Frashëri, Sami Frashëri, who were determined to purify the language from foreign words, at the same time, for the Albanian pronunciation of borrowed words, as well as the enrichment of Albanian vocabulary, creating new words using the tools of the mother tongue (with

prefixes, suffixes and compounds). Thus, from Naum Veqilharxhi we have the word *notebook*; from Kostandin Kristoforidhi we have the words: *baker, capital, conscience, leader*; Naim Frashëri created the words: *quality, quantity, totality, consciousness*; from Sami Frashëri we have some terms of linguistics: *verb, adjective, node, comma, syllable*; from Jani Vreto we have some math terms and other words: *addition, subtraction, mother*. They also replaced foreign terminology with Albanian terms or created new terms according to the needs of science, technology, and culture: *noun, dictionary, subject, necessity, space, development, equation, root, triangle* (Jani Thomai, 2006). So, in this paper, we present the help of the revivalists for the enrichment of the vocabulary of the Albanian language, by analyzing their vocabulary according to the construction of the meaning, by means of the method of analysis and description.

**Keywords:** vocabulary, word formation, mother tongue, word pronunciation, renaissance

## HYRJJE

### 1. VËSHTRIM TEORIK

#### 1.1. Rilindësit për gjuhën shqipe

Gjuha shqipe tashmë ka krijuar historikun si gjuhë kombëtare e njësuar ose si gjuhë standarde me rregulla të vendosura në të gjitha sistemet e saj. Fillimet e saj historike gjuha e sotme standarde shqipe i ka që në shkrimet e para, por kristalizimi si variant i përgjithshëm nis me periudhën e Rilindjes Kombëtare, kur përpjekjet për kulturën dhe për gjuhën ishin të lidhura ngushtë me lëvizjen e gjerë politike, shoqërore e kulturore (Aleksandër Xhuvani 1905, Eqrem Çabej 1958, Emil Lafa 1998, Jani Thomai 2006, Xhevat Lloshi 2005).

Siç dihet, Rilindja Kombëtare qe një lëvizje e madhe atdhetare, mendore, kulturore, arsimore, që përshkoi të gjitha fushat e jetës shqiptare; një periudhë që karakterizohet nga rilindja e kombit dhe futja e tij në rrugën e përparimit si kombet e tjera të Evropës. Ajo përfshiu të gjitha sferat e jetës shpirtërore, morale, ushtarake, materiale, arsimore, gjuhësore, që gjeti edhe një pasqyrim të fuqishëm në fushën e arsimit kombëtar dhe të mësimin të gjuhës shqipe.<sup>1</sup>

Ndër rilindësit e parë shqiptarë janë: **Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Kostandin Kristoforidhi, Jani Vretoja**, të cilët donin që me anë të përhapjes së shkrimit shqip ta arrinin t'ia arrinin një qëllimi të dyfishtë; të forconin te shqiptarët ndërgjegjen kombëtare për bashkim dhe t'i tregonin botës se shqiptarët janë një komb më vete, me gjuhën e tyre të veçantë, me kulturën vetjake të lashtë e të pasur. Si rrjedhim i kësaj, u zhvillua një letërsi artistike e publicistikë e gjerë me karakter kombëtar, që u bënë edhe fusha për lëvizimin e gjuhës.<sup>2</sup>

**Naum Veqilharxhi** nga Vithkuqi i Korçës, i cili veprimtarinë e tij e zhvilloi

---

1 [https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja\\_Komb%C3%ABtare\\_Shqiptare](https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja_Komb%C3%ABtare_Shqiptare)

2 Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, fq. 248.

në Rumani, ku filloi përpjekjet për të krijuar një alfabet të veçantë për shkrimin e gjuhës shqipe, gjë që arriti qëllimin që të krijojë alfabetin më 1844. Ai botoi një abetare të vogël të quajtur *Evëtar*, e cila është abetarja e parë në gjuhën shqipe. Një vit më vonë e botoi një abetare të re më të plotë se e para.

Ndër intelektualët arbëresh është **Jeronim De Rada** nga fshati Makie i Kalabrisë, i cili u bë një nga figurat më të shquara të letërsisë arbëreshe dhe të lëvizjes kombëtare shqiptare. Patriotët shqiptarë që jetonin dhe punonin në Stamboll, si: *Konstadin Kristoforidhi*, *Pashko Vasa*, *Hasan Tahsini*, *Ismail Qemali*, të cilët u përpoqën për njësimin e alfabetit dhe krijimin e një shoqërie kulturore-shqiptare.

**Sami Frashëri** ishte rilindës i shquar, dijetar, shkrimtar, publicist dhe ideologu kryesor i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Samiu drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe “*Drita*” dhe pastaj “*Ditura*” (Stamboll, 1884-85) ku shkroi një numër të madh artikujsh. Për nevojat e shkollës shqipe hartoi librat “*Abetare e gjuhës shqipe*” (1886), “*Shkronjtore e gjuhës shqipe*” (gramatika, 1886) dhe “*Shkronjë*” (*Gjeografia*, 1888) në gjuhën shqipe. Nga veprat më të shquara të këtij mendimtari, patrioti, demokrati dhe iluministi të kohës është “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*”, botuar pa emër autori, më 1899 në Bukuresht. Ky traktat u bë manifesti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vepra që sintetizoi programin e lëvizjes, strategjinë dhe taktikën e saj. Në të u shprehën idealet demokratike të zhvillimit politik e shoqëror të vendit, të zhvillimit të arsimit, të kulturës e të shkencës. Sami Frashëri hartoi edhe një fjalor të gjuhës shqipe, i cili mbeti i pabotuar. Gjithashtu, ai la në dorëshkrim një përmbledhje këngësh popullore shqiptare.

**Naim Frashëri** është figura qendrore e letërsisë së Rilindjes dhe një nga përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes kombëtare, njeriu që u pagëzua për së gjalli si “*apostull i shqiptarizms*” dhe “*bilbili i gjuhës shqipe*”. Ka qenë nëpunës dhe intelektual i Perandorisë Osmane, poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare, hartues tekstesh, përkthyesi i parë i pjesëve të Kur’anit në gjuhën shqipe dhe veprimtar i shquar i arsimit kombëtar shqiptar. Njihet si nismëtari i letërsisë shqiptare dhe një nga ikonat kulturore shqiptare më ndikuese të shekullit XIX. I gjendur me pozita të larta në administratën osmane deri kur vdiq, mes të tjerash ndihmoi në nxjerrjen e lejes për Mësonjëtorën e Korçës, si dhe të *Gramatikës* të Kristoforidhit.

Në vitin 1867 **Konstadin Kristoforidhi** botoi në Stamboll një abetare të re në gjuhën shqipe, e cila u përhap dhe u mirëprit në vise të ndryshme të Shqipërisë. Më 1882 boton në Stamboll me licensë prej Ministrisë së Arsimit të Perandorisë Osmane një gramatikë shqipe në dialektin toskë (*Grammatiki tis alvanikis glossis*). Vepra themelore e Kristoforidhit, fryt i një pune njëzetvjeçare, është *Fjalori i gjuhës shqipe* me 11.675 leksema, përpiluar në toskërishte me alfabet të mbështetur në shkronja greke dhe i botuar më 1904 në Athinë, botuar në Tiranë më 1961. Në të janë përjashtuar shumica e huazimeve, veçanërisht orientalizmat dhe greqizmat dhe bëhen përpjekje për të shpjeguar etimologjinë e fjalëve. Kristoforidhi,

gjithashtu, ka lënë tregimin e parë prozaik original në gjuhën shqipe, njëkohësisht, tregimin e parë për fëmijë *Gjahu i Malësorëve* (*Hieja e Tomorrit*) në të dy kryedialektet; shkruar më 1884 dhe botuar për herë të parë më 1902 nga “*Albania*” e Konicës në Londër.

**Jani Vreto** ndikuar nga kultura helene që në kohën e studimeve në Zosimea (gjë për të cilën Konica do ta quante grekoman), hartoi një vjershë më 1847 për Skënderbeun me alfabet grek dhe nisi të mbledhë fjalë të urta e këngë popullore shqiptare. Botimi i parë i Vretos ishte një gramatikë e greqishtes e përkthyer shqip, “*Grammatikê tês omilumenês hellênikês glóssês eis tèn albanikên*”, Konstandinopojë 1866 (Gramatikë e greqishtes së folur në gjuhën shqipe). Me shoqërinë “Drita” të Bukureshtit u botuan dy libra të Jani Vretos: “*Mirëvetija*” dhe “*Numeratoreja*” më 1886. Një vit më pas ai botoi një vepër 158 faqesh me titull “*Radhuashkronjë*”, Bukuresht 1889 (*Llogaritje*), për tregtarët dhe biznesmenët shqiptarë në Rumani.

## 2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E PUNIMIT

Qëllimi ynë është të paraqesim ndihmesën e rilindësve për pasurimin e Fjalorit të gjuhës shqipe, duke analizuar fjalësin e tyre sipas ndërtimit e kuptimit, si dhe krahasimin e fjalëve të tyre me fjalët gjegjëse në Fjalorin e gjuhës shqipe.

Sa i përket metodologjisë së realizimit të punimit, kemi përdorur metodën e analizës dhe të përshkrimit, duke analizuar dhe përshkruar fjalësin e rilindësve, të përfshirë në Fjalorin e gjuhës shqipe.

## 3. PASQYRIMI I FJALËSIT TË RILINDËSVE

Fusha e leksikut paraqet lëmin më të gjallë të studimeve gjuhësore, më saktësisht pjesa e leksikografisë- hartimi i fjalorëve. Hartimi i fjalorëve të ndryshëm është një nga drejtimet themelore, më të hershme e më të pasura të gjuhësisë shqipe, gjë që ka shtyrë përpara edhe studimet semasiologjike. Pasqyra më të plota të strukturës kuptimore të leksikut të shqipes janë: “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” (1980) dhe “*Fjalori i gjuhës shqipe*” (2006).<sup>3</sup>

Puna e parë që bën shkrimtarët e Rilindjes, ishte pastrimi i gjuhës nga fjalët e huaja, sidomos nga fjalët e burimit turk, që kishin hyrë me shumicë gjatë shekujve të fundit. Ata vazhdimisht punuan për pastrimin e fjalësit të shqipes nga fjalët e huaja, madje edhe kur kishin hyrë thellë në përdorim; për punën e tyre krijuese nuk huajtën as fjalët ndërkombëtare, si: *anatomi, gramatikë, gjeografi, gjeometri, universitet* etj. Rilindësit ishin shumë të vendosur në luftën kundër fjalëve të huaja. Naim Frashëri thotë se “*Gjuha jonë duhet shkruar thjesht shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. -Është e gjerë gjuha jonë dhe e bukur shumë; ka fort fjalë të mira për të vënë në vend të 1010 fjalëve të huaja.*” Po ashtu, Naim Frashëri, Jeronim

---

3 Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, fq. 305.



de Rada, Andon Zako Çajupi, gjetën në gjuhën e popullit burime të pashtershme fjalësh e shprehjesh, si dhe mundësi për krijime të tjera. Naimi shkruante: “*Gjuha shqip është mjaft e gjerë për ata që e dinë mirë, po ka edhe lehtësinë që bashkon dy fjalë, si vetë-dije, mëmë-dhe.*”<sup>4</sup>

Fjalorët na ndihmojnë për të përcaktuar edhe kronologjinë e ndryshimeve kuptimore. Kështu, nga krahasimet e dy fjalorëve të përmendur me fjalorin e Kostandin Kristoforidhit, i cili punoi disa vjet për të mbledhur thesarin e pazbuluar të gjuhës shqipe në krahina të ndryshme dhe hartoi një fjalor. Duke e njohur edhe moshën e fjalëve, del se disa kuptime të prejardhura e të figurshme të fjalëve të tilla, si: *dinamik* (zhvillim dinamik, valle dinamike), *front* (fronti antifashist), *hark* (në harkun kohor), *interes* (grupet e interesit), *katarsis* (katarsis në parti; prej këtej edhe katarsis), *klima* (klima politike), *menaxhoj* (menaxhoj konfliktin), *model* (nxënës model), *normë* (normat e sjelljes; njësi normë e gjuhës), *njësi* (njësi e mendimesh), *paradhënie* (paradhënie për kompromis), *pastroj* (pastroj paratë), *i pista* (para të pista), *plan* (në planin ekonomik; në planin ekonomik; në plan të parë), *puls* (mat pulsën për diçka), *qarkullim* (qarkullim idesh), *rezervë* (kam rezerva për një çështje), *sistem* (sistem pikëpamjesh), *trafik* (trafik droge), *trajektore* (trajektorja e zhvillimit), *theks* (me theks të veçantë), *zonë* (zonë e lirë).

Rilindësit si: Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Jeronim de Rada, Jani Vreto, Naim Frashëri, Sami Frashëri, të cilët ishin të vendosur për pastrimin e gjuhës nga fjalët e huaja, njëkohësisht, shqipërimin e fjalëve të huazuara, si dhe pasurimin e fjalësisë të shqipes, duke krijuar fjalë të reja me anë të mjeteve të gjuhës amtare (me parashtesa, me prapashtesa dhe me përbërje). Kështu, nga Naum Veqilharxhi kemi fjalën *fletore*; nga Kostandin Kristoforidhi kemi fjalët: *bukëpjekës*, *kryeqytet*, *ndërgjegje*, *udhëheqës*; Naim Frashëri ka krijuar fjalët: *cilësi*, *sasi*, *gjithësi*, *vetëdije*; nga Sami Frashëri kemi disa terma të gjuhësisë: *folje*, *mbiemër*, *nyjë*, *presje*, *rrokje*; nga Jani Vreto kemi disa terma të matematikës e fjalë të tjera: *mbledhje*, *zbritje*, *mëmëdhe*. Ata, gjithashtu, bënë zëvendësimin e terminologjisë së huaj me terma shqip ose krijuan terma të rinj sipas nevojës së shkencës, të teknikës, të kulturës: *emërore*, *fjalor*, *kryefjalë*, *domosdoshmëri*, *hapësirë*, *zhvillim*, *barazim*, *rrënjë*, *trekëndësh*.<sup>5</sup>

### 3.1. Fjalësi i rilindësve në Fjalorin e gjuhës shqipe

#### 3.1.1. Naum Veqilharxhi

Naum Veqilharxhi duhej të kishte dijeni edhe për alfabetin e Jan Velarait (1771-1823), mjeku dhe miku i Ali pashë Tepelenës, që ia dorëzoi këtë alfabet F. Pukëvilit, i cili e depozitoi në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, ku ndodhet edhe sot. Alfabeti i Naumit kishte 33 shkronja origjinale, që u përshtateshin plotësisht

4 Po aty, fq. 249, 250.

5 Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, fq. 249, 250.

veçorive fonetike të gjuhës shqipe. Këto shkronja, për dekanin e albanologjisë, gjermanin J. G. Hahn, nuk ishin primitive dhe të vrazhda, por të punuara me estetikë dhe stil elegant.<sup>6</sup> Me këtë alfabet, në vitin 1844, Naumi botoi abetaren e parë shqipe *Evëtar*. Pas kërkesave të shumta që pati, e ribotoi pas një viti, më 1845, të plotësuar dhe të shoqëruar me një parathënie. Ai përgatiti, gjithashtu, një gramatikë të gjuhës shqipe, si dhe tekste mësimore e dorëshkrime të tjera, që nuk u botuan ose u dogjën pas botimit.

Ai është nismëtari për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja dhe pasurimin e saj me fjalë të gurrës popullore ose të formuara rishtas. Duke vlerësuar gjuhën si faktor themelor të mëvetësisë kombëtare, ai vlerësonte vetëm gjuhën e popullit, pa fjalë të huaja. Në faqet e *Evëtarëve* të Naumit, kanë parë dritën e shtypit për herë të parë fjalët, si: *fatkeq, fatkeqësi, fatmir, fletore, lesim (lehtësim), nismëtor, i paçmuar, detyrë, të pambaruara, vendlermi (vendlindja)* etj. Naumi, gjithashtu, krijoi një varg termash gjuhësore, si: *zëtoze (zanore), e zëshme dhe e pazëshme*. Ai përdori i pari: *fjalë e huaj, gjuhë e huaj* dhe gjen rastin t'u këshillojë lexuesve të tij toskë që në vend të fjalëve të huaja *pishmanosem* (turqisht) ose metanoi (greqisht), të përdorin fjalën *penohem (pendohem)*, të cilën e konsideron fjalë gegërisht dhe kjo fjalë nuk është i vetmi gegizëm në veprën e tij.<sup>7</sup>

### 3.1.2. Jeronim de Rada

Sipas Alfred Uçi<sup>8</sup>, ideali i Rilindjes Kombëtare nuk ra nga qielli, por u përpunua nga personalitete të shquara të atdhetarisë arbërore: Jeronim De Rada (1814-1903), Dara Plaku dhe Gavril Dara i Riu, Zef Serembe, F. A. Santori, Zef Skiroi, Naum Veqilharxhi (1797-1846), Thimi Mitko, Jani Vreto, Dora d'Istria, Pashko Vasa, vëllezërit Abdyl, Sami e Naim Frashëri, Ismail Qemali, Zef Jubani, P. N. Luarasi, Gj. Fishta, Faik Konica, Filip Shiroka, Ndre Mjeda, Fan Noli dhe shumë të tjerë si këta, që përgatitën platformën e përbashkët të Rilindjes Kombëtare jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të arbëreshëve dhe i përgatitën të luftonin për lirinë e të drejtat e tyre, për arsimin, shkollat me gjuhën shqipe dhe kulturën e letërsinë e kultivuar kombëtare, me shqiptarizëm, pavarësisht nga dallimet fetare.

Vepra e De Radës në gjuhësi, publicistikë, krijimtari letrare, studime të karakterit albanologjik pasur nga gjithë plejada e shkrimtarëve arbëreshë të kësaj periudhe do të jepnin ndihmesën e tyre për të ardhmen e gjuhës së shkruar shqipe, për krijimin e një alfabeti të vetëm. De Rada dhe arbëreshët e Italisë dhanë kontributin e tyre historik për përpunimin e alfabetit tonë të përbashkët (kujtojmë shkronjat *ë/gj/një/*, të cilat u sollën si risi në atë që sot e njohim si Alfabeti i Manastirit). Ajo është pjesë e përpjekjeve të të gjithë patriotëve dhe mendimtarëve të kohës, të cilët

6 Hahn G. J., *Studime Shqiptare*, 1854, fq. 292,293, ribotim, Prishtinë, 2004.

7 Lafe E., *Ndihmesa e Naum Veqilharxhit për terminologjinë gjuhësore shqipe*, Studime filologjike, Nr.4, 1986.

8 Uçi A., *Jani Vreto dhe Rilindja Kombëtare*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2015, fq. 88.

i paraprinë Kongresit të Manastirit, duke dhënë kontribut të çmuar për zhvillimin e gjuhës shqipe në lidhje të pandërprerë me gjuhën e folur popullore, duke bërë të mundur që gjuha shqipe me kalimin e kohës të zhvillohej në formatet e saj më të larta.<sup>9</sup>

Në vitin 1871 në “Gramatikën shqipe“ duke folur për alfabetin De Rada shkruan: “Në zgjedhjen e alfabetit përdorur prej nesh, qëllimi ynë i vetëm ishte ai, që të përfitojmë nga mjeti më i shpejtë ekonomik për shprehjen e përsosur të të gjithë tingujve.”<sup>10</sup>

### 3.1.3. Sami Frashëri

Sami Frashëri hartoi në gjuhën shqipe gramatikën e gjuhës shqipe dhe kjo qe arritje shumë pozitive si nga ana shkencore, ashtu dhe nga pikëpamja patriotike dhe kombëtare. Ai iu përvesh punës që të shpjegonte materialin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht të krijonte e të sistematizonte një terminologji sa më shkencore dhe shqipe për gramatikën e gjuhës amtare.<sup>11</sup>

Fjalësi që krijoi Sami Frashëri i përket kryesisht fushës së gjuhësisë, më saktësisht gramatikës, si: **të përzëshme** (bashkëtingëlloret), **zëto** (zanoret), **shuhet** (apokopa), **xgjatës** (theksi), **farët e fjalëve** (pjesët e ligjëratës), **të përkthyer** (të ndryshueshme), **të papërkthyer** (të pandryshueshme), **rënjë** (rrënja), **shtonjë** (parashtesa, prapashtesa), **mbaronjëtorja** (mbaresa), **fjalëtorja** (fjalori), **fjalët e ngjitura** (fjalët e përngjitura), **gjindje** (gjinia), **formë** (trajtë), **çqimi/paçqimi** (shquarësia, pashquarësia), **rënie/rënja** (rasa), **quanjëtorja** (rasa emërore), **pyllëtorja** (rasa gjindore), **dhënëtorja** (rasa dhanore), **kallëzonjëtorja** (rasa kallëzore), **pritëtorja** (rasa vendore), **mërgonjëtorja** (rasa rrjedhore), **përkthesë** (lakim), **nyjetë** (nyja), **miemëri** (mbiemri), **miemëra nëmuri** (numërori), **përemëri vetëtor** (përemri vetor), **përemëri gjëtregonjës** (përemri pronor), **përemëri dëftonjës** (përemri dëftor), **përemëri përmëndës** (përemri lidhor), **përemëri pyetës** (përemri pyetës), **përemëri ndamës** (përemri i pacaktuar), **nyjetë** (nyjat), **përkthenja** (lakim), **shënimi ngasës** (foljet kalimtare), **shënimi mosngasës** (foljet jokalimtare), **përkthesë** (zgjedhim), **postate** (grupet e zgjedhimeve), **shënimi** (diatezë), **pësonjëto** (diateza pësore), **mesëto** (diateza mesore), **vetëvetore** (diateza vetëvetore), **punëto** (diateza veprore), **mifolje-pasfolje** (ndajfolja), **parjetë** (parafjala), **lidhjet** (lidhëzat), **thëria** (pjesëza), **thirrjetë** (pasthirrmat), **mëndyra** (mënyra), **mëndyra e preme** (mënyra dëftore), **mëndyra e varme** (mënyra lidhore), **mënyra e papandehur** (mënyra habitore), **mëndyra e uruame** (mënyra dëshirore), **mëndyra e urdhuame** (mënyra urdhërore), **mëndyra e përgjysmore** (pjesorja), **mëndyra e paçqueme** (paskajorja), **mëndyra e përcjellme** (përcjellorja),

9 Hasani M., *Sistemi foljor në veprën e De Radës*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014, fq. 26,28.

10 Po aty, fq. 27.

11 Omeri A., *Terminologjia gramatikore shqipe e Sami Frashërit në veprën Shkronjëto e gjuhës shqip, Bukuresht, 1886*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2021, fq. 24.

**moti** (koha), **mot i thjeshtë** (kohë të thjeshta), **mot i përzier** (kohë të përbëra), **mot i mëdyshmë** (kohë të mbipërbëra).

Termtat përcaktuese për kohët e foljeve në Gramatikën e Samiut nuk ndryshojnë shumë nga termtat që përdor gramatika shqipe sot. Ja disa prej termave të kohëve të foljes që ndërton Samiu, krahasuar me termtat që përdor gramatika shqipe sot.

<b>Termtat nga Sami Frashëri:</b>	<b>Termtat nga gramatika shqipe sot:</b>
<i>moti i tanishim</i>	<i>koha e tashme</i>
<i>moti i parthim</i>	<i>koha e pakryer</i>
<i>moti i shkuarë (vajta)</i>	<i>koha e kryer e thjeshtë</i>
<i>moti i pritm' i tanishim (do të vete)</i>	<i>koha e ardhme</i>

Tabela 1: Termtat e kohëve foljore sipas Sami Frashërit

<b>Termtat nga Samiu:</b>	<b>Termtat nga gramatika shqipe sot:</b>
<i>moti i parëtanishim (kam vajturë)</i>	<i>koha e kryer</i>
<i>moti i mëparthim (kisha vajturë)</i>	<i>koha më se e kryer</i>
<i>moti i parëshkuarë (paçë vajturë)</i>	<i>koha e kryer e tejshkuar</i>
<i>moti i pritm' i parëtanishim (do të kem vajturë)</i>	<i>koha e ardhme e përparme</i>

Tabela 2: Termtat e kohëve foljore sipas Sami Frashërit

Ndër termtat që pagëzon Samiu, bie në sy një përpjekje e tij e ndërgjegjshme për të krijuar një sistem terminologjik pa të meta dhe të sistematizuar; nga njëra anë gjejmë termin **moti i tanishim** për formën e thjeshtë foljore dhe përballë këtij termi gjendet termi **moti i parëtanishim** për formën e përbërë foljore. Me këtë rregull fjalëformues dhe termformues gjejmë termtat e ndërtuar nga Samiu për sistemin kohor të foljeve në mënyrën dëftore: **moti i parthim - moti i mëparthim; moti i shkuarë - moti i parëshkuarë; moti i pritm' i tanishim - moti i pritm' i parëtanishim**.<sup>12</sup>

Sami Frashëri përfshin në mënyrën dëftore dhe format foljore të asaj mënyre që në gramatikën e shqipes sot e emërtojmë “mënyra kushtore”. Ai dallon **moti i pritm' i parthim** në vend të kohës së tashme të kushtores në gramatikën shqipe sot: **do të vinja**. S. Riza (2009:406) e quan absurd termin **moti i pritm' i parthim**. Po ashtu, ai dallon **moti i pritm' i mëparthim** në vend të kohës së kryer të kushtores në gramatikën shqipe sot: **do të kisha vajturë, do të kisha thënë**. Sipas S.Rizës<sup>13</sup> po t'i

12 Po aty, fq. 38.

13 Po aty.

referohemi gramatikës shqipe sot, termi i Samiut *moti i pritm' i parthim* mbulon fjalë për fjalë konceptin dhe termin “*koha e ardhme e së shkuarës*”; termi i Samiut *moti i pritm' i mëparthim* mbulon fjalë për fjalë konceptin dhe termin “*koha e ardhme e përparme e së shkuarës*” në morfologjinë shqipe sot.

### 3.1.4. Naim Frashëri

Sipas Dh.Shuteriqit, leksiku i Naimit nuk i kapërcen 6-7 mijë fjalët dhe ky Fjalor konkretisht përmban rreth 4300 fjalë. Mund të duken pak, por këtu nuk ka rëndësi sasia, sepse ka rëndësi sistemi. Një fjalë nuk është e vetmuar, sepse kurdoherë bën pjesë në sistemin leksikor me shumë lidhje të ndërlikuara. Në rastin konkret, autori thotë se krijimtaria e Naimit përfshin vetëm 15 vjet si autor kryesor i Rilindjes Shqiptare.<sup>14</sup>

Sipas Xh.Lloshit<sup>15</sup>, 290 faqe të Fjalorit i zënë fjalët, ndër të cilat janë përfshirë edhe variantet e ndryshme. Mund të duket se variantet janë të panevojshme, por kjo ka vlerë vetëm kur kërkojmë zbatimin e normës, ndërsa nga ana historike është e domosdoshme së pari, t'i njohim variantet, dhe së dyti, pas kësaj të vëmë re se cili variant ka fituar të drejtën e normës dhe të përpigemi të japim një shpjegim nga ana e gjuhësisë. Kjo ka rëndësi edhe për të zbuluar prirjet që ka ndjekur gjuha, që ndoshta do të na ndihmonte për të kapur edhe prirjet në ditët tona.

Kundrejt fjalësit të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe dalin këto konstatime; 26 janë në Fjalorin e vitit 1980. Prej atyre që nuk dalin janë 4 neologjizmat e pafat: *dhemasje*, *dheshkronjë*, *dheshkronjës*, *dhetregonjë*; dy janë emërtime etnike: *dhanajtë* dhe *dhorinjët*. Ky i fundit është për *dorët*, të cilët në Fjalorin 1980 nuk dalin si leksemë më vete, ndërsa në ribotimin më 2006 është hequr nga shpjegimi përmendja si një nga fiset kryesore në Greqinë e vjetër, kështu shpjegimi ka mbetur “që ka të bëjë me dorët”, domethënë një fjalë shpjegohet me një fjalë tjetër të panjohur që nuk e ka fjalori. Pesë njësi janë emërtime të metaleve. Fjalën e parë Dh.Shuteriqi e ka shënuar ‘*dhal*’ si metali ‘*dalium*’, në të vërtetë Naimi e ka ‘*thal*’ dhe është *taliumi*, të cilin nuk e ka Fjalori i vitit 1980.<sup>16</sup>

Dy janë neologjizma të Naimit: *darovëshumë* dhe *i dhenjtë*. I pari është i një tipi të njohur te Naimi, si: *fjalëshumë*, *gjumëshumë*. I dyti është një mbiemër nga emri “dheu”, të cilin nuk e ka pasur shqipja e folur, por që ka dalë si i nevojshëm. Neologjizmi i Naimit nuk ka zënë vend, ndërsa nuk kanë munguar përpjekje të tjera. Jani Vretoja e kishte bërë *i tokhtë*, po neologjizmat e tij kanë qenë përgjithësisht jo të goditur. P. N. Luarasi e ka rikrijuar për kuptimin tokësor: *jetën e dhenjtë* (1911), sot me këtë kuptim Fjalori 1980 e ka në trajtën *i dheshëm*, ndërsa “Elçija” e kishte më 1905 me kuptimin konkret “tokësor” (rrjeta të dheshme dhe të ajrshme). Nevojën e mbiemrit sipas kuptimit të Naimit e ka ndier Mati Logoreci në vitet tridhjetë dhe

14 Lloshi Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2018, fq. 2.

15 Po aty, fq. 2.

16 Po aty, fq. 3.

ka krijuar *i dhertë (enë të dherta)*.<sup>17</sup>

Te Naim Frashëri gjejmë këto fjalë të përdorura: *dëgjim, dritare, gjithësi, hapësirë, papunësi, i përjetshëm, vetëdijë, vjershëtor*.

### 3.1.5. Kostandin Kristoforidhi

Vepra themelore e Kristoforidhit, fryt i një pune njëzetvjeçare është *Fjalori i gjuhës shqipe* me 11.675 leksema, i përpiluar në toskërishte me alfabet të mbështetur në shkronja greke dhe i botuar më 1904 në Athinë, botuar në Tiranë më 1961. Në të janë përjashtuar shumica e huazimeve, veçanërisht orientalizmat e greqizmat dhe bëhen përpjekje për të shpjeguar etimologjinë e fjalëve. Fjalori është vepra më madhore e Kristoforidhit, dhe një ndër më të rëndësishmet të gjuhësisë shqiptare. Punën për këtë vepër Kristoforidhi e nisi herët, që kur shëtitu Shqipërinë me J. Hanin. Fjalori është dygjuhësh: greqisht-shqip dhe bazohet në të dy dialektet e shqipes, i cili ka rreth 12000 fjalë.<sup>18</sup>

Sipas Dh. Shuteriqit<sup>19</sup>, gjuha e Kristoforidhit nuk ndryshon nga ajo e rilindësve, ndaj dhe me të drejtë ai u cilësua si “babai” i gjuhës shqipe. Ai, si të gjithë rilindësit e tjerë, mendonte se gjuha ishte një mjet bashkimi për shqiptarët e çarë dhe të përçarë në atë kohë dhe se fakti se ekzistonin dy dialekte me të folmet e tyre si degëzime të një trunq, nuk përbënte ndonjë ndarje, por bashkim të shqiptarëve. Kristoforidhi e vërtetoi këtë me përkthimet dhe me veprat e tij origjinale.

Nga Kostandin Kristoforidhi kemi fjalët: *bukëpjekës, kryeqytet, udhëheqës, fushatë, hierore “tempull”, ndërgjegje, jetëdhënës, ligjdhënës, të ngartëtë (të mjerët), ka cofune (ka ngordhur), përnjiherë (sa kaq herë), katund (fshat), trembet (friket), uturinte (ulurinte)*.<sup>20</sup>

### 3.1.6. Jani Vreto

Siç përmendëm më sipër, më 1866 Vretoja botoi një gramatikë të gjuhës greke, të cilën e kishe hartuar, duke pasur parasysh nevojat e nxënësve potencialë. Ndaj dhe e titullon *Gramatikë e greqishtes së folur në shqip*, pra, e përshtatur për shqipfolësit. Vretoja propozon: *Të hartohet Gramatikë dhe Fjalor i greqishtes së folur në gjuhën shqipe, si dhe veprimet e domosdoshme të aritmetikës, dhe kjo të bëhet duke marrë parasysh traditën. Pasi fëmijët të mësojnë leximin, t’u mësohet gjeografi dhe histori politike e përmbledhur, pasuar nga greqishtja e folur (shpjeguar) në gjuhën shqipe, si dhe zbatimi i rregullave gramatikore*.

Më 1884 e gjejmë bashkëpunëtor në themelimin e Shoqërisë Drita të shqiptarëve të Bukureshtit, e cila më 1886 vuri në funksion dhe një shtypshkronjë

---

17 Po aty, fq. 3.

18 <https://gazetadielli.com/kontributi-i-kostandin-kristoforidhit-ne-gjuhesine-shqiptare/>

19 Shuteriqi Dh., *Fjalori i Naim Frashërit*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2017, fq. 112.

20 <https://diasporashqiptare.al/2020/09/13/kontributi-i-kostandin-kristoforidhit-ne-gjuhesine-shqiptare/>

për synimet botuese të saj. Vretoja menjëherë iu përvesh punës për botimin e veprave të personaliteteve dhe intelektualëve shqiptarë të kohës. Që vitin e parë të funksionimit u botuan 10 tituj, si: *Vjersha për mësonjëtorët të para, Istori e përgjithëshme për mësonjëtorët të para, E këndimit çunavet. Këndonjëtorëja* të Naim Frashërit, mes tyre edhe veprat e veta: *Mirëvetija dhe Numëratoreja*. Punimin tjetër, *Radhuashkronjë* të vetin e botoi më 1889. Botoi e ribotoi vepra të Sami dhe Naim Frashërit, mblodhi dhe përgatiti për botim me aparat kritik dhe shpjegime *Ervehenë* e Muhamet Kycyikut, si dhe riprodhoi vazhdimisht titujt ekzistues, sidomos librat që përdorëshin për mësimin e gjuhës dhe në gjuhën shqipe. Me të drejtë Robert Elsie e ka quajtur Vreton “Gutenbergu i shqipes”.<sup>21</sup> Nga Jani Vreto kemi kryesisht terma të matematikës, por edhe fjalë të tjera, si: *mbledhje, zbritje, mëmëdhe, rrënjë, emër, përemër, folje ndihmëse*. Po ashtu, gjejmë tek ai edhe fjalë të gojës popullore përdorur me një mënyrë të re, pa mundur ta përcaktojmë me saktësi se cili ndër këta shkrimtarë është autori i parë i disa fjalëve të caktuara.<sup>22</sup>

### Përfundime

Siç trajtuam përgjatë këtij punimi, duhet theksuar se Naum Veqilharxhi është një ndër të parët që u përpoq ta pasuronte gjuhën e shkrimit e ta spastronte nga fjalët e huaja, me fjalët si: *fletore, kamës, mësim, padije, shënim, shumicë, thelloj*. Përpara tij Tahir Efendiu nga Gjakova përdori, ndër të tjera, fjalët, si: *folës, mësim, mësues, nxanës, rrëzim*.

Shkrimtarët e Rilindjes, si: Kristoforidhi, Naim e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto e të tjerë, i hynë në këtë lëmë një pune të madhe edhe me një metodë të re. Kjo metodë ishte: kërkim, përhapje e vënie në qarkullim e fjalëve që ekzistojnë në gjuhë, por që kishin mbetur mënjane; përdorimin e fjalëve të vjetra e të harruara të gjuhës; përdorimin shumë të kufizuar të fjalëve të huaja; formimin e fjalëve të reja (neologjizmave), si kompozita e rrjedhoja (derivate) pas modeleve (analogjisë). Pra, kryesisht pas shembullit të fjalëve të gjalla të ligjërimit popullor e të dialekteve të tij.

Ndër këta autorë, Kristoforidhi e pasuroi gjuhën e shkrimit me fjalë, si: *fushatë, hierore “tempull”, jetëdhënës, ligjdhënës, ndërgegje, pikë, presë, theks, zanore*. Te Naim Frashëri gjejmë fjalët: *dëgjim, dritare, gjithësi, hapësirë, papunësi, i përjetshëm, vetëdijë, vjershëtor*. Sami Frashëri dihet se përveç punës që kreu në lëmin e caqeve (termave gjeografiko-administrativë: *lindje, perëndim, jugperëndim, veriperëndim, mesditës* për meridian, *kryeministër, qeveritar*; ka vënë themelet e terminologjisë gjuhësore-gramatikore, me formime, si: *abetare*,

21 <https://www.gazetatema.net/kulture/jani-vreto-ky-grekoman-i-ndjere-i352961>

22 <https://www.kultplus.com/libri/cabej-gjuha-shqipe-eshte-e-pasur-pastertia-e-saj-eshte-tregues-i-nivelit-ter-kultures-3/>

*nyjë, njëjës, shumës, rrokje, i shquar, i pashquar.* Mirëpo, Jani Vreto përdori para tij disa prej termave gjuhësore, si: *rrënjë, emër, përemër, folje ndihmëse.*

Mund të pohojmë se Periudha e Rilindjes është e begatshme në fushën e krijimit të fjalëve të reja me mjetet e shqipes dhe sipas mënyrave të brendshme të shqipes. Fjalët e krijuara nga rilindësit përgjithësisht hyn në fjalësin aktiv e disa përdoren edhe sot e kësaj dite. Gjatë periudhës së Rilindjes janë krijuar shumë fjalë të reja për të shprehur koncepte të reja, si dhe janë zëvendësuar shumë fjalë të huaja me fjalët e krijuara nga brumi i shqipes. Kështu, fjalësi i gjuhës shqipe është zgjeruar mjaft.

### **BIBLIOGRAFIA:**

HAHN G. H., (2004): *Studime Shqiptare*, ribotim, Prishtinë.

HASANI M., (2014): *Sistemi foljor në veprën e De Radës*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.

LAFE E., (1986): *Ndihmesa e Naum Veqilharxhit për terminologjinë gjuhësore shqipe*, Studime filologjike, Tiranë, Nr.4.

LLOSHI XH., (2018): *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë.

OMERI A., (2021): *Terminologjia gramatikore shqipe e Sami Frashërit në veprën Shkronjëtores e gjuhës shqip, Bukuresht, 1886*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.

Shuteriqi Dh., (2017): *Fjalori i Naim Frashërit*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.

Thomai, J., (2006): *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë.

UÇI A., (2015): *Jani Vreto dhe Rilindja Kombëtare*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.

### **FJALORËT:**

*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe.*(1980): Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.

*Fjalori i gjuhës shqipe.* (2006): Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.

### **BURIME NGA INTERNETI:**

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja\\_Komb%C3%ABtare\\_Shqiptare](https://sq.wikipedia.org/wiki/Rilindja_Komb%C3%ABtare_Shqiptare)

<https://gazetadielli.com/kontributi-i-kostandin-kristoforidhit-ne-gjuhesine-shqiptare/>

<https://diasporashqiptare.al/2020/09/13/kontributi-i-kostandin-kristoforidhit-ne-gjuhesine-shqiptare/>

<https://www.gazetatema.net/kulture/jani-vreto-ky-grekoman-i-ndjere-i352961>

<https://www.kultplus.com/libri/cabej-gjuha-shqipe-eshte-e-pasur-pastertia-e-saj-eshte-tregues-i-nivelit-te-kultures>



# KONTRIBUTI I AKAD. PAJAZIT NUSHIT NË HARTIMIN E FJALORËVE TERMINOLOGJIKË TË PSIKOLOGJISË NË GJUHËN SHQIPE

**Dr. Vilma Proko**

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, Tiranë

E-mail: prokovilma@yahoo.com

## PËRMBLEDHJE

Leksikografia shqipe ka kapërcyer rrugë të gjatë në periferi të Evropës, por me arritje që meritojnë vëmendjen. Fjalori shpjegues i psikanalizës u hartua mbi bazën e një trashëgimie të pasur botërore fjalorësh të këtij lloji dhe këtë e ka arritur suksesshëm. Duke qenë i tillë, ai pashmangshëm përcejell zhvillimin e shumanshëm të psikanalizës botërore, por ndërkaq mund të shihet edhe si një përmasë historike e shqipes për një periudhë të caktuar kohore. Kur para 13 vjetësh u botua *Fjalori shpjegues i psikanalizës i akademik Pajazit Nushi u prit me interes të veçantë. Nuk ishin vetëm arsytet e thjeshta gjuhësore e jashtëgjuhësore por edhe sepse shprehte punën shumë serioze e me përkushtim të rrallë profesional e shkencor të hartuesit të tij. Fjalori Shpjegues i Psikanalizës i çeli rrugën edhe hartimit të Leksikonit të psikologjisë në 2 vëllime, në vitin 2014, me mjaft ndryshime, përmirësime e plotësime si përta i përket korpusit terminologjik, i cili është pasuruar dukshëm, ashtu edhe gjuhës, leksiku i së cilës ka pësuar ndryshime thelbësore.*

**Fjalë çelës:** Fjalor Shpjegues i Psikanalizës, Leksikon i Psikologjisë, korpus terminologjik, terminologji shqipe.

## ACAD. PAJAZIT NUSHI'S CONTRIBUTION IN THE DRAFTING OF PSYCHOLOGY TERMINOLOGICAL DICTIONARIES IN THE ALBANIAN LANGUAGE

### ABSTRACT

The Albanian lexicography has come a long way on the outskirts of Europe, but with remarkable achievements. The explanatory vocabulary of psychoanalysis was compiled based on a rich world heritage of dictionaries of this kind and has achieved this successfully. As such, it inevitably follows the multifaceted development of world psychoanalysis, but can also be seen as a historical dimension of Albanian for a given period of time. When the *Explanatory Dictionary of Psychoanalysis by Academic Pajazit Nushi was published 13 years ago, it was received with special interest. It was not just the linguistic and extra-linguistic reasons but it was also because it expressed the very serious and rare professional and scientific devotion of its compiler. Explanatory Dictionary of Psychoanalysis opened the doors for the compilation of the Lexicon of Psychology in two volumes, in 2014, which included lots of changes and improvements in terms of terminological corpus that has been significantly enriched, as same as the language and its lexicon that has undergone essential changes.*

**Keywords:** Explanatory Dictionary of Psychoanalysis, Lexicon of Psychology, terminological corpus, Albanian lexicography.

Akademiku Pajazit Nushi, personalitet i njohur në Kosovë, krahas kontributeve të mëdha në fushat e politikës, të kulturës dhe të arsimit, është shquar edhe për ndihmesat e vyera në fushat e mësimdhënies, të edukimit, të gjuhësisë e në mënyrë të veçantë në shkencën e psikologjisë. Kryesisht, veprimtaritë në fushën e mësimdhënies dhe të edukimit, të mishëruara me studime në këtë fushë, e kanë çuar gradualisht në hartimin e teksteve mësimore të psikologjisë për të gjitha nivelet e shkollave në Kosovë, po aq sa kryerja e studimeve të vazhdueshme të historisë së psikologjisë, të lidhura me terminologjinë e kësaj shkence, me teorinë dhe praktikën e saj, e të orientuar drejt fjalorëve terminologjikë.

Me këtë përvojë akad. Nushi i çeli udhën çështjes së rëndësishme të njësimit të terminologjisë në fushën e psikologjisë, pastrimit nga fjalët e huaja në një masë të konsiderueshme dhe zgjerimit të mëtejshëm të literaturës shkencore, në veçanti të literaturës së arsimit parauniversitar dhe atij universitar.

Fjalori i parë i prof. Nushit është *Fjalori i psikologjisë*<sup>1</sup> i v. 1987, botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës që përfshiu termat themelore të psikologjisë. Në këtë *Fjalor, në trajtimin e koncepteve, dukurive dhe ligjeve themelore psikologjike, spikasin njohja e thellë shkencore e tyre prej autorit, mendimet dhe gjykimet, materiali i pasur faktik nga jeta dhe praktika shkollore, zgjedhja dhe shfrytëzimi me kujdes i të dhënave më të reja e më përparimtare të psikologjisë së kohës. Ky Fjalor është i tipit shpjegues, me rreth 3000 zëra nga fushat e psikologjisë së përgjithshme, psikologjisë pedagogjike, fiziologjike, sociale, zhvillimore, psikometrisë, psikofizikës e psikopatologjisë. Fjalori u hartua mbi bazën e një trashëgime të termave shqip dhe të shqipëruar të marra nga teksti i psikologjisë *Fillime të pedagogjisë, Pjes' e parë. Psikologji e shtime në punë t'edukatës për shkollat normale e për mësuesit e fillorevet*, i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe, botuar më 1933<sup>2</sup>, si edhe nga vepra me sfond teorik dhe me bazë themelore, psikologjinë, *Fillime të pedagogjisë për shkollat normale e për mësuesit e fillores Pjes' e dytë. Didaktikë e edukatë për klasën e tretë të shkollës normale*, botuar më 1926,<sup>3</sup> të hartuar nga prof. Aleksandër Xhuvani.*

Vepra e dytë e prof. Nushit është *Fjalor Shpjegues i Psikanalizës*<sup>4</sup>, i botuar më 2010, i cili ka shërbyer për njohjen e terminologjisë së fushës dhe, veçanërisht, për nevoja didaktike dhe mësimore, ndërsa vepra e tretë është *Leksikon i Psikologjisë*, botuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës më 2014, një vepër terminografike me karakter enciklopedik, terminologjik e informativ, e para në llojin e saj, në të cilën, nëpërmjet shpjegimeve përgjithësuese e të sakta shkencore

1 Nushi P., *Fjalor i psikologjisë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987.

2 Xhuvani A., *Fillime të pedagogjisë, Pjes' e parë. Psikologji e shtime në punë t'edukatës për shkollat normale e për mësuesit e fillorevet*, Shtëpia Botonjese Luarasi, Tiranë, 1933.

3 Xhuvani A., *Fillime të pedagogjisë për shkollat normale e për mësuesit e fillores. Pjes' e dytë. Didaktikë e edukatë për klasën e tretë të shkollës normale. Shtypshkronja "Elbasani"*, Elbasan 1926. (ribotuar me përmirësime dhe plotësime të shumta në Tiranë, 1937. Shtypshkronja "Elbasani", Elbasan, 1926.

4 Nushi P., *Fjalor shpjegues i Psikanalizës*, Prishtinë, 2010.

jepet në mënyrë të sintetizuar zhvillimi i mendimit shkencor psikologjik, përmes koncepteve të personaliteteve të spikatur të psikologjisë botërore dhe atyre me origjinë shqiptare.

Fjalët terma që hasen në këta tri fjalorë janë kryesisht ato që përdoren në gjuhët neolatine e që mund të quhen si ndërkombëtarë, si *aperception, deduksion, eksperiment, fantazi, individualitet, induksion, intuitë, temperament* etj. Këto fjalë terma mund të ndahen në disa kategori:

**– terma të krijuara me brumin e shqipes dhe të përdorur nga prof. Xhuvani<sup>5</sup>:**

1) terma njëfjalësh: *didaktikë, intelektualizëm, marrshmëni, mbrothësi*,<sup>6</sup> *ndijë, ndijim, ndryshmëni, ngashëri, parafytyrim, prirje, rishdalje, stërmundim, ushtrimore* etj.

2) terma togfjalësh: *edukatë morale, ecuni e mësimit, fuqi kuptimore, gjendje ngashërore*<sup>7</sup>, *(mësim edukatuer, njësi metodike, pedagogji shoqërore)*<sup>8</sup>, *shoqënim i parafytyrimeve*<sup>9</sup>, *të folunit horas (të folurit të gjithë bashkë e me zë të lartë), plan përparues*<sup>10</sup> etj.

3) terma të krijuar nga fjalë të leksikut të përgjithshëm (me kuptim konkret apo abstrakt), duke iu dhënë një kuptim të caktuar: *dëshirë, gjykim, harresë, hetim, kujtesë, mbresë, nderim, ngulm, përsiatje, sedër, vullnet* etj.

4) terma me karakter të përgjithshëm: *i qensishëm, i paqensishëm, i pranishëm, përkufizoj, përkufizim, prirje, nismë, shfuqizim, shfuqizoj, pakujdesi, kotësi* etj.

**– terma të krijuar dhe të përdorur nga autori, të cilët i kemi klasifikuar sipas kategorive leksiko-gramatikore dhe termformuese**

1) terma mbiemra – *erogjen, imagjinar, pavetëdijshme (e), psikodinamik, simbolik*;

2) terma emra – *agresivitet, ambivalencë, arkaizëm, censurë, determinizëm, dëshirë, edukatë, ego, eros, ëndërr, fantazi, fantazmë, farefisni, fiksim, fobi, frikë,*

5 Në fund të librit *Fillime të pedagogjisë, Pjes' e parë. Psikologji e shtime në punë t'edukatës për shkollat normale e për mësuesit e fillorevet*, të hartuar nga prof. A. Xhuvani, gjendet një fjalorth prej 253 fjalësh në katër gjuhë, shqip-frëngjisht-italisht-gjermanisht.

6 Le Bon G., *Psikologjia e edukatës (Mbrothësia)*, 1923. Shqipëruar prej Lumo Skëndos (pseud. i Mithat Frashërit).

7 Abdiu N., *Mbi kontributin e A. Xhuvanit në fushën e psikologjisë shqiptare*, në: “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit”, fq. 219.

8 Dodbiba L., *Kontributi i Aleksandër Xhuvanit në terminologjinë shqipe*, në: “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit”, fq. 113.

9 Shih 6.

10 Shih 7.

*frojdizëm, frustrim, gjumë, histeri, instinktivizëm, intelektualizim, interpretim, karakter, katarzë, kënaqësi, kompleks, lajthitje, libido, luftë, magji, mani, marrëzi, melankoni, mohim, narcizëm, ndërgjegje, neurozë, neveri, nevojë, personalitet, perversion, përfytyrim, pikëllim, psikoterapi, seksualitet, simptomë, racionalizim, sublimim, shaka, shtypje, shtytës, tmerr, totemizëm, traumë, turp, rezistencë, , xhelozë, zili, zhvendosje, vetëdije, uni, unësi, urrejtje, vizuelizim;*

4) terma kompozita: *erogjenitet, etnopsikanalizë, falusocentrizëm, frojdomarksizëm, homoseksualizëm, kundërkateks, kundërtejbartje, metapsikologji, nënvetëdije, panseksualizëm, paravetëdije, perversion polimorf, psikologji, psikopatologji, psikoterapi, sadomazokizëm, superego, tejbartje, telepati, transvertizëm, traumë, vetëdije, vetëvrasje;*

5) terma togfjalësh me dy gjymtyrë: *amnezi histerike, analizë e drejtpërdrejtë, analizë e karakterit, ankth histerik, aparat psikik, copëzim i vetëdijes, demencë prekoks, depresion anaklitik, dinamikë e pavetëdijes, dinamikë e personalitetit, energji psikike, ëndërr ditore, fitim parësor, fitim dytësor, formacion reaktiv, formime kompromise, gjendje kufizore, interpretim i ëndrrave, kompleks i Edipit, konflikt psikik, mbetje ditore, mekanizëm mbrojtës, metodë psikanalitike, ndjenjë e fajit, neurozë narcisoide, pikëpamje dinamike, pikëpamje ekonomike, pikëpamje gjenetike, pikëpamje topike, parimi i Nirvanës, periudhë e latencës, pozicion depresiv, punë ëndërrrore, realitet psikik, rregull fundamental, seksualitet fëmijëror, simbol i ëndrrave, situatë traumatike, stad narcisoid, shtytës seksual, teknikë psikanalitike, teori psikanalitike, vëmendje futuruese;*

6) terma togfjalësh me tri a më shumë gjymtyrë: *ankth ndaj ndarjes, ankth i muajit të tetë, arkivi i Zigmund Frojdit, dyzim i vetëdijes, feja në psikanalizë, frikë nga humbja e objektit të dashur, frikë nga treshja, identifikim me agresorin, përzgjedhje anaklitike e objektit, pozicion paranoid skizoid, psikoterapi dinamike e shkurtuar, psikozë maniako-depresive, qëllim i shtytësit, stad i pasqyrës, shpjegim i ëndrrave, tolerancë ndaj frustrimit etj.*

Në Fjalorin shpjegues të psikanalizës emërtimi i koncepteve të psikanalizës, tipareve psikike, të zhvillimit dhe të dinamikës së tyre etj. jepet përmes mbiemrave, emrave, foljeve dhe ndajfoljeve, që shërbejnë për të përshkruar e për të shpjeguar mendimet, sjelljet karakteristike të njeriut dhe strukturën e personalitetit të tij,

– me prejardhje kryesisht nga lat.: *abstinencë, abduksion, afekt, ambivalencë, amnezi, animizëm, asociacion, biseksualitet, censurë, determinizëm, depersonalizim, depresion, derealizëm, ekzibicionizëm, ekstravertizëm, fiksim, hospitalizëm, identifikim, imago, incest, inkorporim, instancë, instinkt, konstrukcion, kulturë, kulturalizëm, lapsus, material, motiv, personalitet, projektion, pubertet, regresion, spiritizëm, subjekt, sublimim, sugjestion;*

– me prejardhje nga greqishtja.: *afanizëm, agorafobi, anaklitik, arketip, autoanalizë, autizëm, autoerotizëm, biofili, dekateks<sup>11</sup>, dramatizim, empati, falus, fobi, heteroseksualizëm, hipnozë, histeri, intrajeksion, intraversion, irracional, izolim, karakter, katarzë, mit, nekrofili, neurasteni, neurozë, neutralitet, okultizëm, pedofili, psikanalizë, psikozë, simbolizëm, simptomë, skizofreni, skopofili, tanatos, topikë;*

– me prejardhje nga frëngj.: *dezintegrim, dezha rakonte (tashmë e thënë), dezha vy (tashmë e parë), fetishizëm, sadizëm, vuajërizëm;*

– me prejardhje nga gjerm.: *abreagim;*

– me prejardhje nga angl.: *deprivim;*

– me prejardhje nga spanj.: *kanibal;*

– me prejardhje nga gjuha tongo e polinezëve: *tabu;*

– me prejardhje nga të folurit e Oxhibuas (fis primitiv i Amerikës së Veriut): *totem.*

E gjithë kjo lëndë ishte mjaft e nevojshme, meqë botimet leksikografike dhe enciklopedike të terminologjisë së psikologjisë, e veçanërisht ato të psikanalizës qenë pak të njohura në gjuhën shqipe, si edhe pa ndonjë traditë në zbatimin dhe përdorimin e psikanalizës dhe të mendimit psikanalitik<sup>12</sup>.

*Fjalori shpjegues i psikanalizës* me 344 faqe, si fjalor i tipit të vogël ngërthen një termës me rreth 428 zëra të renditur alfabetikisht, që u hartua mbi bazën e një lënde të pasur leksikore, të mbledhur nga përkthimi në shqip i veprave të ndryshme psikologjike dhe psikanalitike, sidomos pas viteve ‘90 të shekullit XX, ku u përkthyen kapitujt më të rëndësishëm të veprave të Frojdit etj., të botuara në formë broshurash. Përkthimi i këtyre veprave u krye brenda një kohe relativisht të shkurtër, në mungesë të një fjalori shpjegues. Edhe pse terma të psikanalizës haseshin në fjalorë shqip të psikiatrisë, psikologjisë, filozofisë, sociologjisë, pedagogjisë etj.,<sup>13</sup> duhet të theksojmë se ato përmbanin një lëndë të përzgjedhur e

11 Në psikanalizë dekateksa është tërheqje e energjisë psikike, e libidos, e shtytësit nga objekti....., *Fjalor shpjegues i psikanalizës*, fq. 53.

12 Nga vitet ‘30 të shek. XX u botuan disa fjalorë të psikanalizës, nga të cilët përmenden fjalori i Dr. R. Shterba *Handvörterbuch der Psychoanalyse (Fjalori doracak i psikanalizës)*. Ndërkaq, në frëngjisht u hartuan disa fjalorë të psikanalizës, ndër të cilët dallohen *Vocabulaire de la Psychoanalyse*, me autorë J. Laplanche e J. - B. Pontalis, i përkthyer edhe në gjermanisht, më pas u botua *Dictionnaire de la Psychoanalyse*, të autorëve Elisabeth Roudinesco et Michel Plon prej 1222 faqesh të formatit të madh, që u përkthye në disa gjuhë. U botuan edhe *Glosary of Psychoanalytic Terms and Concepts*, si edhe *Encyclopedia of Psychoanalysis*.

13 Shih për më me hollësi Proko V. & Cakaj N. & Mërtiri I., *Bibliografi e terminologjisë* në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Probleme dhe detyra”. (*Monografi të botuara; Konferenca shkencore dhe përmbledhje artikujsh; Monografi të pabotuara dhe mastera të mbrojtura; Recensione në revista shkencore; Artikuj shkencorë; Fjalorë terminologjikë*, ASHSH & ASHAK, Tiranë, 2009, fq. 243–294.

të përpunuar sipas nevojës së tyre.

Karakteristikë e përgjithshme e *Fjalorit shpjegues të psikanalizës* është se në emërtimin e koncepteve të tipareve psikike dhe psikanalitike dallojmë emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje, që shërbejnë për të përshkruar e për të shpjeguar mendimin, sjelljet karakteristike të njeriut dhe strukturën e personalitetit të tij.

Duhet nënvizuar se, ndërsa në **Kosovë pas Lufës II Botërore pati një përhapje përmes botimeve dhe literaturës të veprave të Frojdit dhe të psikanalistëve të tjerë**, të përkthyer në shumë gjuhë, në Shqipëri përkthimi në shqip i veprave të psikanalizës të Frojdit e ka zanafillën rreth vitit 1938, por u ndërpre pas kësaj lufte, e në vijim deri në vitin 1990 nga qëndrimi shpërfillës ndaj teorisë frojdiste në sistemin monist, kur qëndrimet politike dhe ideologjike u shndërruan në doktrinë antipsikanalitike. Pas viteve '90 mendimi psikanalitik u rishfaq, pësoi ndryshime dhe plotësime varësisht nga konteksti ideologjik, historik dhe kulturor.

Merita e akad. Nushit qëndron në faktin se ai u mbështetet edhe në fjalorët më të njohur të leksikografisë botërore të këtij lloji, e që sipas tij "...u themelua "Biblioteka e psikanalizës në gjuhën shqipe"<sup>14</sup>. Për këtë arsye hartimi i fjalorit shpjegues të psikanalizës ishte një domosdoshmëri, pasi përmes përkufizimit të termave dhe shtjellimit të tyre është trajtuar edhe historia e zhvillimit të mendimit psikanalitik<sup>15</sup>, duke e përpunuar zhvillimin e këtij mendimi dhe historinë e tij edhe ndër shqiptarët. Grupin më të madh e përbëjnë termat për konceptet e shkollave psikologjike për personalitetin, të tillë si: *arketip, ego, super ego, libido, introjeksion, regresion, psikomotorikë, etj., si dhe togfjalëshat: refleksi operant, të mësuarit verbal, të mësuarit problemor, stimuli – reagimi i reduktuar në formulën S.-R., stimul-organizëm-reagim (S-O-R), sipas neobihevizistëve, envajroment etj. nga psikologjia biheviziste, e cila i mënjanoi nga terminologjia e psikologjisë termat mentalistë*<sup>16</sup>.

### **Karakteristikat e Fjalorit**

*Fjalori ka karakter enciklopediko-terminologjik. Në të përfshihen:*

– 7 (shtatë) zëra institucionesh të rëndësishme të psikanalizës, si: *Federata Evropiane e Psikanalizës, Instituti Psikanalitik i Berlinit, Muzeu i Frojdit, Shkolla Frojdiane e Parisit, Shoqata Botërore Psikanalitike, Shoqata Ndërkombëtare Psikanalitike, Shoqëria Psikologjike e së Mërkurës;*

---

14 Nushi P., *Fjalori shpjegues i psikanalizës*, Hyrje, ASHAK, Prishtinë, 2010, fq. 8.

15 Brener Ç., *Themelet e psikanalizës*, UFO Pres, Tiranë, 2008; Eysenck, H. J., *Uses and Abuses of Psychology*, Penguin Books Ltd, Hamondsworth, Middlesex, 1953; Laplanche, J.– Pontalis, J., *Vocabulaire de la Psychoanalyse*, Presses Universitaires de France, 1967, Paris; Nushi, P., *Psikologjia e përgjithshme 2, Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji*, Prishtinë, 1999 etj.

16 Nushi P., *Psikologjia e personalitetit dhe terminologjia e saj*, në: "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Probleme dhe detyra". ASHSH & ASHAK, Tiranë, 2009, fq. 102.

– 13 (trembëdhjetë) zëra me titujt e veprave të Frojdit (gjithsej 24 në original), si: “E ardhmja e një iluzioni”, “Ego dhe Id” (1923), “Hyrje në psikanalizë”, “Indispozicioni në kulturë” (1930), “Metapsikologjia”, “Pesë leksione mbi psikanalizën”, “Përkthimi i veprave të Zigmund Frojdit”, “Përkthimi i veprave të Zigmund Frojdit në gjuhën shqipe” (zë i madh), “Psikologjia e turmave dhe analiza e egos”, “Psikopatologjia e jetës së përditshme”, “Skica për psikanalizën”, “Shakaja dhe lidhja e saj me të pavetëdijshmen” (1905), “Tri leksione mbi teorinë e seksualitetit”;

dhe zëri *Imago* - Revistë, në të cilin jepet informacion mbi revistën e parë psikanalitike, e cila filloi të botohet në Vjenë më 1912 me nismën e Frojdit.

Në Fjalor hasen njësi leksikore (terma) me shpjegim, të cilët na japin informacion shkencor të saktë e përgjithësues: si inteligjencë emocionale, karakteristikat metrike të teksteve, koeficienti i konsequencës së testit, llojet e asociacioneve, modeli i të mësuarit Bruner, etj.

Po ashtu, jepen emra personalitetesh: 6 (gjashtë) zëra emra dhe pseudonime pacientësh, si: *Ana O* (pacientja Berta Papenhejm), *Dor* (pacientja Ida Bauer), *Ëm Aurelia* (Öhm-Kronich Aurelia, i njohur me emrin Katerina), *Hansi i vogël* (pacienti Herbert Graf), *Mozer Fani* (pacientja Moser Sulcer), si dhe vetëm një personalitet politik - *Presidenti Uillson*;

– terma të tillë si: *klajnizëm* (term i farkuar sipas emrit Melanie Klein);

– terma togfjalësh të tipit: *njeriu-mi* (rast neuroze obsesive i një pacienti); objekt “i keq” - objekt kalues - objekt “i mirë” - objekt relacional – objekt i shtytësit.

Fjalori na ofron edhe informacione të tjera përgjithësuese e me saktësi shkencore, si: zëra të drejtimeve e doktrinave, si edhe të shkollave psikanalitike të ndryshme: *anafrojdizëm* (rrymë e psikanalitikës së fëmijëve (sipas emrit të së bijës), *frojdzëm*, *lakanizëm*, *mazokizëm*, *mesmerizëm*, *metapsikologji*, *narcizëm*, *neofrojdzëm*, *neopsikanalizë*, *pavllvizëm* etj., zëra të mitologjisë greke: si *eros*, *hermafroditizëm* (te FSHP), *Edipi*, *Elektra*. Mjaft interes për lexuesin e gjerë paraqesin zërat e mesëm e të mëdhenj: *Histori e psikanalizës*, *Histori e psikanalizës ndër shqiptarët*, *Lëvizje psikanalitike*, *Terminologji e psikanalizës* etj. Ndërkaq zërat: *Edip/kompleksi*, *Elektra/kompleksi*, *ego ideal*, *ego identitet*, *ego interesa*, *ego kompleks*, *ego libido*, *ego psikologji*, *erogjene/zona*, *fiks ideja*, *fobitë/llojet*, *frika sinjal* (një lloj mekanizmi i përdorur nga ego-ja), *Narcisoid/stadi*, *Nëna e falusit* (term si emërtim përfytyrimesh), *test i asocimit të fjalëve*, *vetanalizë*, *veterotizëm* (terma mbi teknikat e hulumtimeve) përbëjnë interes për studiuesit e fushave specifike.

Strukturimi i Fjalorit i është përgjigjur përdorimit të lehtë të tij: *Parathënia* e

shkurtër në shqip, *Hyrja, Regjistër i termave kryesorë të psikanalizës, Shkurtesat dhe emërtimi i plotë i tyre, Falënderime, Teksti themelor, Indeksi i termave dhe Literatura* krijojnë mundësi të reja për standardizimin e terminologjisë së psikanalizës, pra përdorimin pa mëdyshje të termave të pranuar si normë dhe që i gjejmë gjithandej, që nga dokumentacioni shkencor, te veprat e tekstet shkencore e deri te botimet shkencore popullore, që në ditët e sotme janë të shumta.

Fjalori pati rëndësi teorike dhe praktike, pasi termat dhe konceptet e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut paraqitën interes për specialistët (psikiatër, psikologë, sociologë etj.), por edhe për publikun e gjerë me interes në leximin dhe kuptimin e veprave të psikanalizës dhe të atyre që ndërlidhen me mendimin psikanalitik.

Meqë, psikologjia bashkëkohore dhe zhvillimet intensive të shkencave psikologjike në gjysmën e dytë të shekullit njëzet u pasqyruan edhe në zhvillimet leksikologjike dhe enciklopedike të mendimit psikologjik, lindi nevoja e hartimit të një fjalori të përmasave të mëdha, siç do të ishte *Leksikoni i psikologjisë*.

Të tilla zhvillime u dalluan veçanërisht në arritjet e psikologjisë së njohjes (konjitive), psikologjisë fiziologjike, sociale, klinike e psikopatologjisë. Këto ndryshime kanë prekur në mënyrë të veçantë raportet ndërmjet sistemit të koncepteve e termave përkatës të disiplinave të përmendura e të biopsikologjisë, somatopsikologjisë e të psikiatrisë. Shumë terma të koncepteve të psikologjisë u plotësuan me informacione të reja e me lidhje të posaçme ndërmjet tyre. Kështu, termi *diskriminim në psikologjinë sociale ka kuptimin e mospërfilljes ndaj tjetrit, që i përket gjinisë, etnisë, kombit dhe racës tjetër, kurse në psikologjinë e perceptimit kuptimi i këtij termi ka të bëjë më aftësinë e dallimit të diferencave më të vogla ndërmjet objekteve e cilësive, si edhe të raporteve ndërmjet tyre. Në rastet e kështilla diferencat i japin kuptim të plotë perceptimit të objekteve të caktuara. Shumë prej termave e ruajtën leksemën e tyre edhe në shqipe por ndryshuan kuptimin e tyre. Për këtë arsye këto terma u bënë të pavlefshëm për të emërtuar tërësisht konceptet e psikologjisë bashkëkohore. Krahas termave të vjetër që pushuan së funksionuari dhe ndryshimit të kuptimit të brendshëm të një pjese të termave, u krijuan koncepte të reja me emërtimet përkatëse gjuhësore. Fjalët popullore shqipe me kuptimin e vjetër të tyre, por të shndërruara në terma e zëra leksikologjikë, si: *besimi, mëshira, shpirti etj., gjithnjë e më pak po gjejnë përdorim në literaturën e psikologjisë së sotme. Ndërkaq, termat e rinj: inteligjenca artificiale, kujtesa implicite, mendimi konvergjent, neurotransmetuesit, psikoleksikologjia, terapia e drejtuar mbi pacientin etj., gjithnjë e më shumë po gjejnë vend në literaturën e psikologjisë moderne e të fushave që lidhen me të.**

Mendojmë se: 1. mund të ishin shmangur zëra të tillë si: *Mozer Fani f. rast specifik i kurimit psikanalitik, indispozicion, mbideterminim, nevoja*; 2. Të përdorej vetëm trajta e pashquar, dhe jo të dyja trajtat si në rastet *libido/bllokimi,*



*libido/organizimi i libidos, libidoja narcisoide-libidoja objektore-libidoja ngjitëse-libidoja plastike.*

### **Leksikon i Psikologjisë**

Qysh kur u botua pas vitit 2014 *Leksikoni i Psikologjisë*<sup>17</sup> u prit me interes të veçantë. Nuk ishin vetëm arsyet e thjeshta gjuhësore e jashtëgjuhësore pse u bë i tillë. Leksikoni u hartua mbi bazën e një trashëgimie të pasur botërore fjalorësh të këtij lloji, dhe, si i tillë, ai pashmangshëm përcjell zhvillimin e shumanshëm të psikologjisë botërore, por ndërkaq mund të shihet edhe si një përmasë historike e shqipes për një periudhë të caktuar kohore. Në leksikon trajtohen koncepte që lidhen me objektin e psikologjisë dhe raportin e saj me filozofinë, logjikën, kuptimin mbi shpirtin; në të trajtohen bazat materiale fiziologjike të disa dukurive dhe proceseve psikike; njohuri mbi gjuhën, mbi raportin ndërmjet gjuhës, të folurit dhe të menduarit etj.

Ky leksikon përmban informacione bashkëkohore shkencore për konceptet e psikologjisë dhe emrat e personaliteteve të njohur të fushës si pasojë e gjurmimeve të tyre; rrjedhojë e një pune gjysmëshekullore për mbledhjen e fjalëve nga larmia e pasur popullore e gjuhës shqipe dhe nga literatura shkencore e profesionale me karakter terminologjik për proceset shpirtërore, psikike e të sjelljeve të njeriut, si edhe për aktivitetin e kafshëve, përzgjedhjes së fjalëve-terma, përkufizimit të kuptimit të tyre, sistemit dhe paraqitjes leksikografike.

*Leksikoni i Psikologjisë është një vepër shumë më e gjerë dhe më e plotë (gjithsej me 1129 faqe) se Fjalori i Psikologjisë i v. 1987, i cili u përgatit në kushte, rrethana dhe raporte zhvillimore të veçanta të zhvillimit të psikologjisë dhe të mendimit psikologjik. Ai dallon si nga gjithëpërfshirja e termave të psikologjisë, nga përmbajtja shkencore e zërave dhe trajtimi semantik dhe gjuhësor bashkëkohor të tyre, ashtu edhe nga përfshirja e personaliteteve të huaj dhe vendës që kanë lënë gjurmë në historinë e psikologjisë. Në hartimin e Leksikonit u ndoq ky parim: gjetja dhe paraqitja shpjeguese e koncepteve dhe termave, që kanë të bëjnë me teoritë, drejtimet dhe shkollat psikologjike, si të disiplinave teorike, ashtu edhe të atyre zbatuese me sistemin konceptual të tyre. Këtij qëllimi i është nënshtruar i tërë aktiviteti gjatë hartimit të tij: përzgjedhja e zërave, shpjegimi i kuptimit të tyre dhe renditja sipas rendit alfabetik të gjuhës shqipe.*

Fjalësi i Leksikonit përmban rreth 5000 zëra (2543 në vëll. I, shkronja A-M dhe 2457 në vëll. II, shkronja N-ZH), ndër të cilët 172 zëra personalitete – krijues të historisë së psikologjisë dhe të zhvillimit të mendimit psikologjik botëror dhe atij shqiptar në veçanti. Në të hasen zëra të mëdhenj si: *Histori e psikologjisë (me nënzërat: 1. Zhvillimi i mendimit psikologjik popullor, 2. Zhvillimi i mendimit psikologjik në kuadrin e mendimit filozofik, 3. Psikologjia-shkencë e pavarur – të*

17 Nushi P., *Leksikon i psikologjisë*, 2 vëll., ASHAK, Prishtinë, 2014.

dy të fundit zëra të mëdhenj); *Historia e zhvillimit të psikologjisë ndër shqipfolësit (me nënzërin Konsolidimi konceptual i psikologjisë dhe zhvillimi institucional i saj)*, etj.

*Lënda e gjerë e vjelë nga leksiku terminologjik i fushës së psikologjisë, nga literatura psikologjike është krahasuar me fjalorë të ndryshëm terminologjikë të fushës, leksikonë dhe fjalorë enciklopedikë dhe enciklopedi të ndryshme të kësaj fushe. Karakteristikë e këtij leksikoni është se në fund të përmbajtjes së zërave të shtjelluar janë dhënë referencat e autorëve dhe të veprave të tyre, prej nga janë vjelë termat kryesorë, në gjuhën origjinale dhe në gjuhën shqipe.*

*Përmbajtja e zërave kryesorë të psikologjisë lidhet edhe me anët etimologjike të tyre, pra ka të bëjë me prejardhjen gjuhësore, përkufizimin, me kohën e shfaqjes së tij në historinë e mendimit psikologjik. Etimologjia e tyre, përpos të tjerash, lë të kuptohet se në gjuhën shqipe shumë zëra të psikologjisë e kanë burimin nga disa gjuhë të huaja (greqishtja, latinishtja, anglishtja, frëngjishtja, italishtja etj.).*

*Në Leksikon termat bazë (greq. dhe lat., e nga gjuhët romane, frëngj., it., e angl.) që i përkasin zhvillimit të psikologjisë janë marrë nga Fjalor i psikologjisë.*

*Si një fjalor i psikologjisë bashkëkohore, janë trajtuar vetëm zëra me trajtesa të rëndësishme të marra nga fushat e antropologjisë, biologjisë, fiziologjisë, filozofisë, psikiatrisë etj.*

*Duke qenë një vepër enciklopediko-terminologjike leksikoni përmban një numër zërash, titujt e të cilëve përbëhen nga disa fjalë-terma, të cilat, në njëfarë mase e rëndojnë fjalorin me informacion të tepërt, fraza të gjera deri në fjali, si p.sh., eksperimenti me grupe paralele, hullia e cipës së trurit (me nënzërat: hullia e Rolandit, hullia e Selvisë, hullia shporore), inventari multifazor i Minesotos për personalitetin, lakorja e retencionit Ebbinghaus, metodat kërkimore në psikologji, modelet e strukturës së inteligjencës, zgjedhja e rastësishme e kampionit, zgjidhja e problemit – Teoria Geshtaltiste etj.*

*Një pjesë të rëndësishme në Leksikon e zënë rreth 160 zëra për klasikë botërorë dhe studiues e shkencëtarë të fushës së psikologjisë, studiuesit e parë shqiptarë të psikologjisë, ndër të cilët 145 janë të huaj (përfshi mes tyre terma dhe emra të njohur të mitologjisë greke: si Edipi, Elektra, si dhe 15 zëra janë psikologë e studiues shqiptarë. Këto personalitete janë dhënë me një biografi jetësore dhe sidomos me një përshkrim shumë të hollësishëm të pikëpamjeve, qëndrimeve dhe kontributit të tyre në zhvillimin e psikologjisë e të mendimit psikologjik, si p.sh.: Anna Freud, Cesare Lombroso, Daniel La Gashe, Francis Galton, Hugo Münsterberg, John Lock, Karl Lashley, Kurt Lewin, Lorenz Konrad, Margaret Mead, Maria Montessori, Osvald Külpe, Peter Johannes Müller, Pierre Janet, Sigmund Schlomo Freud, Leonik Tomeu etj.*

Përmes 15 zërave persona ndeshim personalitete të ndryshëm të kulturës dhe historisë së kombit shqiptar, të cilët lidhen drejtpërdrejt me fushën në fjalë, si edhe studiues shqiptarë të mendimit psikologjik: *Gabriele Bukola, Faik Konica, Branko Merxhani, Hasan Tahsini, Jani Vreto, Aleksandër Xhuvani, Hamit Beqja, Pajazit Nushi, Bajiq Bajo, Bedri Dedja, Neki Juniku, Zekeria Rexha, Myqereme Rusi, Jashar Rexhepagiq, Nuri Abdiu*. Përmes tyre lexuesi i interesuar mund të marrë njohuri edhe mbi gjenezën e zhvillimit psikologjik të përgjithshëm dhe atij shqiptar në veçanti, e sidomos me gjurmimet e lidhjeve mes tyre.

Vlerë të veçantë kanë zërat e mëdhenj: *Historia e psikologjisë*<sup>18</sup> (ku përfshihen tri nënzëra: *Zhvillimi i mendimit psikologjik popullor, Zhvillimi i mendimit psikologjik në kuadrin e mendimit filozofik, Psikologjia–shkencë e pavarur*); *Historia e zhvillimit të psikologjisë ndër shqipfolësit*,<sup>19</sup> (ku përfshihet nënzëri *Konsolidimi konceptual i psikologjisë dhe zhvillimi institucional i saj*), *Terminologjia e psikologjisë, Terminologjia shqipe e psikologjisë* (shoqëruar me burimet përkatëse) etj.

Një tjetër veçanti e Leksikonit është edhe shoqërimi me ilustrime (grafikë, foto, skica, skema, tabela) i disa zërave të psikologjisë fiziologjike dhe statistikës, si p.sh., *iluzion me 11 nënzëra: iluzioni i Aristotelit, iluzioni i Cëlnerit, iluzioni Ebbinghaus, iluzioni Hering, iluzioni Muller Lyer, iluzioni pamor, iluzioni Pogendorf, iluzioni Ponso, iluzioni Sharpantie, iluzioni Zanforlin, iluzioni Xhekstrou*) etj.

Lënda e pasur me një larmi zërash e tematikash plotësohet më së miri me: *Treguesin alfabetik të zërave, Treguesin alfabetik të autorëve, Treguesin e termave në gjuhë të huaj të përdorur si terma burimorë, Ndryshimet zhvillimore më të rëndësishme të psikologjisë deri në fund të shekullit XX, Fillesat e mendimit psikologjik dhe ndryshimet zhvillimore të psikologjisë ndër shqiptarët deri në fund të shek. XX, Vështrim përgjithësues i shkollave të psikologjisë dhe i sistemeve konceptuale të tyre, Pasqyrë e përgjithshme e fobive të thjeshta dhe Treguesi i lëndës*.

Në kapitullin *Vështrim përgjithësues i shkollave të psikologjisë dhe i sistemeve konceptuale të tyre jepen emrat e shtatë shkollave të psikologjisë: biheviorizmi, funksionalizmi, geshtaltizmi, psikanaliza, psikologjia humaniste, psikologjia kognitive, strukturalizmi*.

Në kapitullin *Pasqyrë e përgjithshme e fobive të thjeshta jepen 95 fobi të thjeshta që shfaqen më shpesh te njerëzit. Ato janë dhënë me emërtesën në greqisht dhe përbri është dhënë shpjegimi në shqip i objektit, apo situatës ndaj së cilës njeriu shfaq frikë*.

18 Nushi P., "Leksikon i psikologjisë", 2 vëll., ASHAK, Prishtinë, 2014, vëll. I, fq. 317-321.

19 Po aty, fq. 322-325.

### ***Vlerat e Leksikonit të psikologjisë***

- **Leksikoni i psikologjisë** ka ngjyresa kombëtare. Zërat Zhvillimi i psikologjisë ndër shqipfolësit, Psikikë dhe Psikologji paraqesin në mënyrë të thukët zhvillimin historik të mendimit psikologjik ndër shqiptarët;

- *Leksikoni i psikologjisë* ka të veçantë bashkëkohësinë e termësit, që përfshin terma për të gjitha nëndegët e psikologjisë;

- Leksikoni i psikologjisë jep një model të përcaktimit të terminologjisë shqipe dhe ballafaqimit gjuhësor të saj me gjuhët që kanë sisteme të standardizuara në këtë fushë (me anglishten, me gjermanishten, me frëngjishten dhe me serbokroatishten) përmes përzgjedhjes së fjalës shqipe dhe shqipërimit të një numri sa më të madh termash, përpunimit dhe kodifikimit të terminologjisë së psikanalizës.

### **Përfundime**

Hartimi i *Fjalorit Shpjegues të Psikanalizës dhe Leksikonit të psikologjisë në 2 vëll.*, kurorëzim i një pune tepër serioze e me përkushtim të rrallë profesional e shkencor të hartuar nga studiuesi i shquar në fushën e psikologjisë dhe terminologjisë shqipe, akad. Pajazit Nushi, plotësojnë më së miri kërkesat për njohuri bashkëkohore në këtë fushë dije në nivel universitar, profesional dhe shkencor, si edhe japin rekomandime për mënyrën si të realizohen studime më të thelluara në kulturën psikologjike përmes studimit të veprave të mirëfillta psikologjike. Megjithëse gjuha shqipe dhe sistemi i saj i fjalëformimit dëshmojnë për mundësi të zëvendësimit të shumë termave të huaj të psikologjisë me ato të gjuhës shqipe, zhvillimi, pasurimi dhe plotësimi i terminologjisë shqipe të psikologjisë kërkon përkushtim të psikologëve dhe gjuhëtarëve terminologë për të përballuar vështirësitë që hasen në kushtet e globalizmit, me vërshimin e termave të huaj, sistemimin dhe standardizimin e kësaj terminologjie si pjesë përbërëse e terminologjisë shqipe.

### **BIBLIOGRAFIA:**

(2014): “Terminologjia në shkencat e ligjërimit” (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare. Përmbledhje materiale). Universiteti “Aleksandër Xhuvani”&FHF, UT&FF, UP), Elbasan.

ASHSH, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, Tiranë, 2008, fq. 1226-1227.

DIZDARI T., (2005): *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, (ISESCO), Tiranë.

DURO A., (2001): *Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërimit* në: “Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, nr. 1, Prishtinë.

DURO A., (2012): *Probleme të veprimtarisë terminologjike: standardizimi*, në: “Studime

gjuhësore”, QSA, IGJL, “Botimet Albanologjike”, Tiranë.

DURO A., PROKO V., (2011): *Probleme të standardit në terminologji* në: “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. (Aktet e konferencës shkencore). QSA, IGJL, “Botimet Albanologjike”, Tiranë.

LAFE E., (2010): *Fillimet e formimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe*, “Perla”, Nr. 2-4 (57).

LEKA F., (1984): *Zhvillimi i terminologjisë shkencore-teknike të gjuhës shqipe dhe studimi i saj pas çlirimit*, “Studime filologjike”, nr. 4, Tiranë.

MYRTEZAI E., (2000): *Fjalor i feve*, “Rilindja”, Prishtinë.

MYRTEZAI E., *Fjalor i filozofisë*, “Toena”, Tiranë, 2007.

NUSHI P., (2010): *Fjalor shpjegues i psikanalizës*, ASHAK, Prishtinë.

NUSHI P., *Leksikon i psikologjisë*, 2 vëll., ASHAK, Prishtinë, 2014.

PASHO H., (2001): *Koncepti i Naim Frashërit për leksikon terminologjik në vëllimin “Naim Frashëri dhe kultura shqiptare”*, Tiranë.

PROKO V. & ÇAKAJ N. & MËRTIRI I., (2009): *Bibliografi e terminologjisë në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Probleme dhe detyra”*. (Monografi të botuara; Konferenca shkencore dhe përmbledhje artikujsh; Monografi të pabotuara dhe mastera të mbrojtura; Recensione në revista shkencore; Artikuj shkencorë; Fjalorë terminologjikë, ASHSH & ASHAK, Tiranë, fq. 243–294.

PROKO V., (2019): *Një vëzhgim mbi botimet terminologjike në Periudhën e Pavarësisë*, në: Konferenca Shkencore Kombëtare “Zhvillime gjuhësore dhe letrare në Periudhën e Pavarësisë (përmbledhje materiale)”. Universiteti “Eqrem Çabej” & ASHSH & ASA, Gjirokastrë.

SACCA A., (2009): *Fjalor i sociologjisë*, “Almera”, Tiranë.

THOMAI J., (2009): *Fjala, termi dhe norma gjuhësore*, në: “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-probleme dhe detyra”. (Konferencë shkencore), ASHSH & ASHAK, Tiranë.

## PROBLEME TË TERMINOLOGJISË LETRARE

**Dr. Gazmend Krasniqi**

Departamenti i letërsisë  
Fakulteti i Shkencave Humane  
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës  
E-mail: gazmend\_krasniqi@yahoo.com

**Prof. As Dr. Vjollca Osja**

Departamenti i Letërsisë  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Universiteti i Tiranës  
E-mail: vjollca.osja@fhf.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Në këtë punim do të përpiqemi të evidentojmë problematikat që shfaqen në përdorimin e terminologjisë letrare në fjalorë të termave letrarë, që kanë qarkulluar dhe që qarkullojnë edhe sot, në diskursin e trajtesave teorike dhe kritike mbi letërsinë, si edhe në përkthimin e literaturës teorike bashkëkohore. Për 45 vjet (1945-1990), terminologjia letrare u ngatërrua me terminologjinë ideologjike, duke i dhënë kësaj të fundit statusin e mbikëqyrësit dhe shpesh të shtrembëruesit të koncepteve letrare. Po edhe sot, pas 30 viteve, akoma kemi probleme me konstituimin e një fjalori të referueshëm të termave letrarë dhe me stabilizimin e termave e koncepteve letrare, sidomos të periudhës së modernizmit dhe postmodernizmit. Mbase kjo është arsyeja (në gjykimin tonë) që në një pjesë të përkthimeve të literaturës teorike gjegjëse ka konfuzion e pse jo edhe ngatërresa nocionesh, duke i bërë të vështira leximet dhe përdorimet e këtyre teksteve. Në vëmendjen tonë do të jenë fjalorët letrarë (*Fjalorth termash letrarë*, përshtatur nga Gj. Zheji; *Fjalori shpjegues i termave të letërsisë*, përgatitur nga F. Leka, F. Podgorica dhe S. Hoxha; *Fjalori i termave të letërsisë*, i F. Lekës), si dhe disa libra teorikë të fushës së mendimit teorik mbi letërsinë, të përkthyer viteve të fundit.

**Fjalët çelës:** terminologji letrare, fjalorë të termave letrarë, koncepte letrare, literaturë teorike

## LITERARY TERMINOLOGY ISSUES

### ABSTRACT

In this paper, we will try to highlight the problems that appear in the use of literary terminology in dictionaries of literary terms, which have circulated and are still circulating today, in the discourse of theoretical and critical approaches to literature, as well as in the translation of contemporary theoretical literature. For 45 years (1945-1990), literary terminology was confused with ideological terminology, giving the latter the status of supervisor and often deformer of literary concepts. Even today, after 30 years, we have problems with the creation of a referable dictionary of literary terms and with the stabilization of literary terms and concepts, especially from the period of modernism and postmodernism. Perhaps this is the reason that in some of the translations of the theoretical literature there is confusion and why not even confusion of notions, making it difficult to

read and use these texts. In our attention will be literary dictionaries (Dictionary of literary terms, adapted by Gj. Zheji; Explanatory dictionary of literary terms, prepared by F. Leka, F. Podgorica and S. Hoxha; Dictionary of literary terms, by F. Leka), as well as several theoretical books in the field of theoretical thinking about literature, translated in recent years.

**Keywords:** literary terminology, dictionaries of literary terms, literary concepts, theoretical literature.

## HYRJJE

Në hyrje të këtij punimi e shohim me interes të sjellim në vëmendje shqetësimin e njërit prej pagëzuesve të teknikave dhe termave të modernizmit të fillimit të shekullit XX, T. S. Eliot-it, i cili në esenë “Eksperimenti i kritikës”, na pohon : “... Në kritikën letrare vazhdimisht po përdorim terma që nuk arrijmë t’i përkufizojmë dot, apo të përcaktojmë nëpërmjet tyre të tjera gjëra. Po përdorim shpesh terma me tensione të brendshme e të jashtme që s’përkojnë gjëkund: teorikisht ata duhen bërë që të përputhen me njëri-tjetrin, por nëse kjo s’arrihet, atëherë duhen gjetur rrugë të tjera trajtimi, pasi vetëm kështu do të dimë në çdo moment se për çfarë po flasim”<sup>1</sup>.

Ky shqetësim i Eliot-it rimerr të njëjtën intencë edhe në paratekstin me të cilin nis studimin e njohur, “Pesë fytyrat e modernitetit”, Matei Calinescu. Duke dashur të gjurmojë “grykimet e ndërlikuara të vlerave, orientimet kontradiktore dhe paradokset intelektuale” që kanë shoqëruar në kuptim dhe përdorim, në kohë dhe kultura të ndryshme, termat e *modernizmit*, *avangardës*, *dekadencës*, *kitch-it* dhe *postmodernizimit*, Calinescu ndërton pak a shumë protokollin e tij për leximin e duhur të tyre.

Ajo çfarë në thelb preokupon Eliot-in - përdorimi i duhur, marrëdhënia organike mes kuptimit që shënjojnë dhe përdorimit të drejtë apo edhe vetëdija për një stabilizim, në terma ndërkombëtarë, të terminologjisë letrare - ka shoqëruar vazhdimisht debatin akademik perëndimor, i cili ka prodhuar vazhdimisht literaturë për këtë çështje<sup>2</sup>.

## 1. PROBLEMATIKAT E SË SHKUARËS

Cila është gjendja e terminologjisë letrare në studimet tona? A ka zënë vend një shqetësim i tillë në lidhje me funksionimin real të termave letrare në procesin e grykimit të letërsisë?

---

1 Calinescu M., “Pesë fytyrat e modernitetit”, ( përkthyer nga G. Qendro), Dituria, Tiranë, 2012, fq. 7.

2 Mjafton të kujtojmë diskutimin mes teorianëve e kritikëve që hapi termi fokalizim, i pagëzuar nga G.Genette.

Duke qenë se letërsia shqipe i ka të vona preokupimet për çështje themelore teorike, sepse nuk rezonuan me kohën kur u shfaqën, çështja e terminologjisë duket se nuk ka qenë në rrezën e trajtesave, diskutimeve, shënimeve kritike që kanë marrë vend në formatet letrare<sup>3</sup> apo në librat e paktë teorikë<sup>4</sup> gjatë gjysmës së parë të shek.XX.

Sidoqoftë, në këtë periudhë (sidomos vitet 30-40) vihet re dukshëm fakti se:

- së pari, ngritja e diskutimeve mbi problematika të ndryshme të letërsisë bëhet kryesisht nga perspektiva e letrares;

- së dyti, terminologjia, ilustrimet (në pjesën më të madhe) dhe qasja mbështeten kryesisht mbi bazën e ngulitur të literaturës klasike.

Sot jemi dëshmitarë të faktit se pas viteve '40, për 45 vjet (1945-1990), atmosfera e diskutimeve mbi krijimin letrar, letërsinë dhe krijuesin do të ngarkohet me një gjuhë ideologjike diktuese. Terminologjia letrare që shoqëron studimet dhe shkrimet kritike do të ngatërrohet me terminologjinë ideologjike, deri në atë masë sa do t'i japë kësaj të fundit arbitrarisht statusin e mbikëqyrësit dhe të shtrëmbëruesit të koncepteve letrare.

Evidentimi i instrumenteve politike si masë vlerësimi për termat, shpesh edhe si kategori letrare, do të reflektohet edhe në dy fjalorët e parë të termave letrarë që do të shfaqen, njëri, në mes të viteve '60-të: "Fjalorth termash letrare"<sup>5</sup> (1965), me destinatorë të përcaktuar "...nxënësit e shkollave të mesme" (aty ku ngjizen konceptet), dhe tjetri, në fillim të viteve '70-të: "Fjalor shpjegues i termave të letërsisë" (1972), i cili sipas hartuesve rrok një gamë më të gjerë destinatorësh "në ndihmë të nxënësve, studentëve, mësuesve dhe të gjithë atyre që interesohen sadopak për letërsinë". Në këta fjalorë do të institucionalizohet absurditeti i kahjes ideologjike që do të marrin shënjesit e domethënies së termave/ terminologjisë letrare.

---

3 Shënimet e Konicës, N. Resultit, F. Fishtës, Pipës, Ashtës, Gjeçit, Kutelit, Vangjel Koçes, Çabejt, Spases, Kokonës, Dakës, Draçinit, Koliqit që do të bëjnë pjesën më të madhe të artikujve për problematika të ndryshme letrare, nga ato të funksionit estetik të artit/letërsisë, diskutimet e polemikat për çështje të thelluara teoriko-letrare e deri te çështje që kanë të bëjnë me natyrën dhe format që i duhen kritikës, te trajtesa në formë kritikash e recensionesh për vepra e autorë janë të gjitha të ngritura në sferën e letrares, V. Osja "Instalimi i diskursit ideologjik përkundër atij letrar në trajtesat mbi/ për letërsinë pas vitit '45", Studime Albanologjike, 2021/2 viti XXIV. Universiteti i Tiranës.

4 Kështu "Vargenimi n'gjuheshcype" (1906) i Gurakuqit, si traktati i parë teorik që shënjon angazhimin e kualifikuar për të ndjekur rregullat e ngulitura të krijimit poetik-letrar nuk hap diskutime. Diskutime nuk hap as libri "Prësin' l'âmë të letratyres" (1912,1920) i Xanonit, i cili përvijon rrugëtimin teorik të përfytyruar nga Gurakuqi, Po ashtu as vepra "Letratyra Shqype" (1925-1934) e Justin Rrotës, një nga përfaqësuesit më të shquar të mendimit teorik të shkollës françeskanë. Sikurse edhe ajo e Xhuvanit dhe Cipos. Arsyeja duhet kërkuar mbase te baza e ngulitur e literaturës klasike në të cilën e mbështeten terminologjinë, ilustrimet (në pjesën më të madhe) dhe qasjen autorët e mësipërm.

5 një përshtatje nga "Fjalori i shkurtuar i Termave letrare" të L.I.Timofejevit dhe I. Vengrovit.



Këtë e shohin të udhës ta pohojnë edhe hartuesit e “Fjalorit” të ’72-shit, kur deklarohen në hyrje se “Në vlerësimin e rrymave dhe të drejtimeve letrare dhe artistike janë nisur kurdoherë nga pozitat marksiste leniniste, duke pasur si orientim të sigurt veprat e klasikëve të marksizëm - leninizmit dhe materialet dhe dokumentet e PPSH në lidhje me problemet e artit dhe letërsisë”<sup>6</sup>. Po edhe pa këtë pohim, kjo ndjehet lehtësisht në të gjithë zërat e sidomos tek ato që i referohen rrymave, drejtimeve e shkollave letrare moderniste.

Në gjykimin tonë, problematika që shfaqin të dy fjalorët është e njëjtë dhe mund të grupohet në dy çështje:

1. Interpretimi i termave letrarë me frymën ideologjike;
2. Përfshirja dhe interpretimi i termave ideologjikë në funksion letrar.

Në çështjen *e parë* përfshihen të gjitha deformimet që shoqërojnë zërat që, siç thamë më lart, u referohen rrymave, drejtimeve e shkollave moderniste, si dhe të një pjese të repertorit të teknikave që ato përfaqësojnë. Mund të përmendim këtu si ilustrim, për shembull, trajtesën “*Arti për art*”, e interpretuar *si lëvizje letrare ajo drejtohej kundër..., të gjitha përpjekjeve që synojnë t’i japin artit qëllime politike, etike shoqërore, duke predikuar të ashtuquajturin “art të kulluar”... Estetika e sotme borgjeze e trumbeton me të madhe artin e kulluar dhe nën këtë parullë hipokrite përpiqet të maskojë karakterin e thellë klasor të “artit për art”<sup>7</sup>. Në të gjithë sa cituam, s’ka asgjë që ta përligjë si term letrar. Me të njëjtën frymë dhe gjuhë trajtohen edhe zërat për *parnasianët*<sup>8</sup>, *simbolizmin*<sup>9</sup>, *surrealizmi*<sup>10</sup>, avangardat e të tjera të ngjashme me to.*

Po kështu, vjen me trajtim ideologjik edhe drejtimi letrar i *realizmit*, me përqendrimin te i parapëlqyeri *realizmi kritik*. Do të mjaftonte për ilustrim vetëm një pjesë nga paragrafi nisës për të kuptuar ngjyresën politike që i është shënuar këtij termi: *Në kushtet e ashpërsimit të kontradiktave sociale midis dy klasave kryesore të shoqërisë kapitaliste... dhe në rrethanat kur mendimi progresiv u poq për t’i kuptuar fenomenet e jetës shoqërore nga pozitat e historizmit, u ngjiz drejtimi letrar i realizmit kritik*<sup>11</sup>. Siç vihet re, edhe në këtë rast as gjuha, as argumenti s’janë letrarë.

Trajtimi dhe përcaktimi pastërtish ideologjik i termit *romantizëm* me ndarjet ekstraletrare *romantizëm reaksionar* dhe *përparimtar*,

6 Leka F., Podgorica F., Hoxha S., “Fjalor shpjegues i termave të letërsisë”, Tiranë, 1972, fq. 3.

7 Leka F., Podgorica F., Hoxha S., “Fjalor shpjegues i termave të letërsisë”, Tiranë, 1972, fq. 22.

8 Po aty, fq. 163.

9 Po aty, fq. 210.

10 Po aty, fq. 223

11 Po aty fq. 185. Po aty, fq. 199.

Në këtë mënyrë pasojnë:

- interpretimi i shtrembëruar i *formalizmit...* (Identifikimi i formalizmit si teori letrare me krijimin artistik)<sup>12</sup>

- prania me trajtesë të pasaktë e *modernizmit* që gjendet te fjalori i '65 (fq. 130) dhe mospërfshirja e tij si zë më vete te ai i 72-shit,

- trajtimi i cunguar (i parë vetëm në përdorimin klasik) dhe ideologjik i konceptit të *kanonit* (fq. 101), përkundër asaj çfarë shënonte ky term në gjysmën e dytë të shek. XX në literaturën bashkëkohore etj.

Në të gjitha këto trajtesa, argumentet ideologjike bëhen shënjuet të kuptimit e ngjyresës që marrin termat letrarë.

Në çështjen e *dytë* përfshihen termat ideologjike që referojnë frymën politike si funksion letrar. Po sa letrarë mund të jenë sot termat që përfshinin parimet e famshme të realizmit socialist, si karakteri klasor i letërsisë; ideologjia, karakteri tendencioz, partishmëria në art; ideali i klasave; karakteri popullor i letërsisë etj, zëra që zënë një pjesë të mirë të fjalorit shpjegues të termave të letërsisë!

Ky raport shtrembëruet e problematik me terminologjinë do të pasqyrohet edhe në trajtesat mbi e për letërsinë në të cilat do të dominojë diskursi politik përkundër atij letrar<sup>13</sup>. Mjafton të sjellim në vëmendje vetëm paragrafin me të cilin nis trajtesën e tij Shuteriqi, për librin e F. Gjatës “Uji fle, hasmi s’fle”, ku merret me ripërcaktimin e termit *novelë* sipas terminologjisë ruse, dhe këtë na e bën me dije kur sqaron se termin e njej në kuptimin e rusishtes “povjest”. Shuteriqi zgjedh kështu t’i ikë përcaktimit klasik, të njohur perëndimor, të stabilizuar si terminologji (dhe proces shkrimi) me kohë - që nga Bokaccio, Gëte e me rralle<sup>14</sup>.

## 2. PROBLEMATIKAT E SË SOTMES

Për shkak të kësaj situatë, fillim vitet '90 gjetën një studiuës dhe lexues të indoktrinuar dhe konfuz në përdorimin e termave letrarë. Ndonëse në procesin e krijimit kemi rigjetjen e vetes brenda rrjedhave të zhvillimeve moderniste, në aspektin e reflektimit të teknikave dhe mjeteve letrare në një fjalor të ri të termave

---

12 “Fjalorth termash letrare për nxënësit e shkollave të mesme”, Drejtorja e botimeve shkollore, adaptuar dhe plotësuar për shkollat tona nga Gjergj Zheji, Tiranë, 1965, fq. 52.

13 Shih, Osja V., “Instalimi i diskursit ideologjik përkundër atij letrar në trajtesat mbi/ për letërsinë pas vitit ‘45”, Studime Albanologjike, 2 viti XXIV. Universiteti i Tranës, 2021.

14 Kështu ai i njej Gjatës, duke përjashtuar Konicën, L.Skëndon, Koliqin, Kutelin e për çudi edhe Migjenin, statusin e inauguruesit të këtij lloji letrar në letërsinë shqipe, duke legjitimuar kështu amputimin dhe daljen nga sistemi letrar të veprave të cilat jo vetëm e kishin inauguruar, por ishin shndërruar në paradigmë të këtij lloji.

letrarë, nuk ndryshoi asgjë. Për çudi, deri në vitet 2000, të vetmit fjalorë referues në gjuhën shqipe ishin dy të lartpërmendurit. Në kapërcyell të këtij viti botohet “Fjalori i kritikës moderne” (2000), përkthyer nga D. Taçi, dhe rreth një dekadë më vonë “Fjalor i termave të letërsisë” (2013), përgatitur nga F. Leka

Në këtë pjesë kemi gjykuar të evidentojmë problematikat që shoqërojnë këto dy botime, por edhe vepra teorike të përkthyer.

Duke nisur nga i dyti, **“Fjalor i termave të letërsisë” – F. Leka**

Mund të pohojmë se në thelb, ky fjalor është pasuruar në zëra, por që sërish janë të kufizuar dhe të pa trajtuar thellë, po të kemi parasysh zhvillimet e shek. XX e XXI në fushën e teorive letrare dhe të mjeteve e teknikave të krijimit. Ndonëse në aspektin e përdorimit të zërave të terminologjisë letrare klasike ky fjalor mund të lavdërohet, ai mbetet i kufizuar në disa funksione të tjera të tij.

a) Për shembull, për shkak të mos konsultimit me literaturë të kohës, zërat mbi modernizmin si lëvizje dhe teknikat që shoqërojnë procesin krijues të tij janë trajtuar përciptazi, vagullt ose mungojnë plotësisht.

b) Po ashtu, mungon plotësisht trajtimi i postmodernizmit. Parodia, ironia, grotesku shihen vetëm brenda domethënieve dhe përdorimit që u ka dhënë retorika klasike, sepse funksioni që kanë marrë në letërsinë moderniste e postmoderniste nuk përmendet. Siç shpjegon Hutcheon, “Parodia - shpesh e quajtur citim ironik, pastiche, intertekstualitet – është konsideruar mjet qendror për postmodernizmin, si nga kritikuesit ashtu edhe nga mbrojtësit e tij” Po ashtu, edhe ironia ka përdorimet e saj si mjet stilistik në modernizëm e postmodernizëm; mjafton të kujtojmë shpjegimin e U. Ekos për ironinë intertekstuale.

c) Mungesa pothuajse e plotë ndjehet edhe në ansamblin e zërave të poetikave të narrativës. Në fjalor, vetë termi narrativë shihet në linjën e retorikës antike, thjesht si tregimtari: “...tregimi me gojë ose me shkrim i disa ngjarjeve që zhvillohen në mënyrë koherente dhe zakonisht sipas një rendi kohor kronologjik”, një përkufizim që i rri shumë larg përcaktimeve të teorive të sotme të narratives.

ç) Një tjetër problematikë është se ilustrimet e termave kufizohen pothuajse tërësisht te autorët tanë të gjysmës së parë të shek. XX dhe te ata të letërsisë së huaj, duke lënë jashtë (përjashtuar vetëm disa emra) letërsinë e gjysmës së dytë të shek. XX dhe atë të krijuar pas viteve ‘90. Ndodh që ilustrimi i termave të bëhet me tekst poetik (politik) që nuk i ka qëndruar kohës dhe sistemi letrar e ka nxjerrë jashtë, si bie fjala poema “Epojeja e ballit kombëtar”, e cila përdoret si ilustruese e zërave të figurës së sinekdokës<sup>15</sup> idiomës<sup>16</sup> etj., ku mund të gjendeshin ilustrime të tjera.

15 Leka F., “Fjalor i termave të letërsisë”, Infbotues, Tiranë, 2013, fq. 361

16 Po aty, fq. 180

d) Një përcaktim shumë i vagullt i bëhet termit prozë poetike, i cili shoqërohet me një ilustrim jo të saktë nga vëllimi poetik “Gjurmët e stinëve” të Koliqit<sup>17</sup>, kur shembujt mund të kërkoreshin te *Pasqyrat e Narçizit*.

### ***Fjalori i kritikës moderne- përkthyer nga D. Taçi***

Duke qenë përkthim i njërit prej fjalorëve referentë të terminologjisë së kritikës në gjuhës angleze (“A Dictionary of Modern Critical Terms”, edited by Roger Fowler), ky fjalor është relativisht i pasur brenda specifikës dhe qëllimësisë së tij<sup>18</sup> (parashtruar në parathënie) koherent në zëra e ilustrime dhe me trajtesa skrupuloze e të gjera. Por edhe ky fjalor, konsideruar nga ne si kontribut paraqet probleme për sa i përket sjelljes së materialit apo zërave në gjuhën shqipe.

Problematika e parë ka të bëjë me qartësinë në shpjegimin e termave. Duke qenë se formulimet nuk janë të natyrës kategoriale, po më së shumti trajtime të shtrira mbi natyrën e termit dhe perceptimin e tij, është e rëndësishme sjellja e qartë e koncepteve. Na rezulton se në një pjesë informacionet brenda trajtesave vijnë jo të qarta. Në respekt të kohës, do të përmendim vetëm disa prej tyre.

Kështu, në zërin për *lexuesin*<sup>19</sup>, kur vjen te koncepti i Barthes-it për tekstin, gjejmë një përcaktim të tillë: Barthes preferon modele të paqarta të *tekstivele të ndërthurura*<sup>20</sup>. Në fakt, bëhet fjalë për konceptin e njohur të Barthes-it për ndërthurjen në tekst të *citimeve nga qendra të panumërta të kulturës*, ose teksturën e ndërthurur me citime që shoqëron tekstin letrar, por formulimi që vjen në fjalor vështirë të na çojë te ky argument.

Vjen i paqartë:

- konceptimi për *modernizmin*. “Modernizëm do të thotë acarimi i sipërfaqes realiste të letërsisë prej forcave të padukshme. Shqetësimi mund të bëhet edhe vetëm prej logjikës estetike ose mund të jetë sociale në një shkallë të lartë”<sup>21</sup>. Në origjinal, në fakt, modernizmi referohet si “shprishje e sipërfaqes realiste të letërsisë nga forcat themelore – shprishja mund të bëhet edhe vetëm prej kërkesës (logjikës) estetike ose tepër sociale”<sup>22</sup>.

- koncepti për *rrëfimtarin e besueshëm e të pabesueshëm*, i cili, sipas pagëzuesit të këtij termi, W. C Booth-it, lidhet me faktin nëse e folura apo veprimi i rrëfimtarit përputhen ose jo me normat e veprës, me normat që ka vendosur autori

---

17 Po aty, fq.315

18 Libri që po ju paraqitet nuk ka si qëllim zëvendësimin ....., por të nxisë një perspektivë të re të terminologjisë letrare

19 Fjalori i Kritikës moderne, Toena, Tiranë 2000, fq. 190.

20 Po aty, fq. 102.

21 Po aty, fq. 208.

22 “A Dictionary of Modern Critical Terms”, edited by Roger Fowler, Routledge 1987, pg. 118.

i nënkuptuar në vepër<sup>23</sup>.

- dallimi mes fiksionit dhe novelës. Në origjinal pohohet se *romani ka një përmbajtje më të ngushtë historike dhe ideologjike se sa fiksioni* (Novel has narrower historical and ideological content than fiction (fq. 94), ndërsa në fjalor na vjen *Romani ka një histori narrative dhe një përmbajtje ideologjike në krahasim me fiksionin*<sup>24</sup>.

- koncepti i njohur i Frost-it për përkthimin e poezisë, si ajo që humbet (mbetet jashtë) gjatë përkthimit; e vjen në fjalor si ajo që *lihet mënjanë* në përkthim<sup>25</sup>.

Emërtimi i të njëjtës vepër vjen në disa variante: siç është rasti i *Morfologjisë së përrallës* së Propp-it, që vjen herë si *Morfologjia e rrëfimit folklorik* (fq 299), e herë si *Morfologjia e tregimit folklorik* (fq. 243). Çka natyrisht sjell konfuzion.

Termi i teknikës postmoderniste të *pastishit*, që ka hyrë në shqipe në këtë formë, vjen me pastiche (me gjasë me një ndikim nga konsultimi i ndonjë varianti të përkthyer në italisht të fjalorit).

Po ashtu, Ezra Pound, poeti dhe kritiku i madh i poezisë, vjen i referuar si poet.

### **Vepra teorike të përkthyer**

Një shembull për ilustrim mund të na shërbejë problematika që shoqëron përkthimin e librit “Poetika e intertekstualitetit”<sup>26</sup> të Natalie Piegay Gros. (libër që në fakt, që kur hyri është bërë referent në punimet e studiuesve dhe doktorantëve që kanë pasur objekt studimi këtë fushë)

Problemi i parë që ndikon te përcëptimi i tekstit, ka të bëjë me sjelljen në shqip të strukturave mbi të cilat vijnë të përkthyer fraza e fjali, të cilat, shpeshherë, janë aq të ngatërruara, sa është stërmundim nxjerrja e një kuptimi prej tyre. (Ilustrimi me një shembull të përkufizimit të transtekstualitetit: *Përfundimisht, është me këtë term transtekstualitet, kjo që Genette, në fillim të Palimpsestit, emërton këtë trandhendecë tekstuale, kategori abstrakte e cila dërgon tek gjithçka që tejkalon një tekst të dhënë dhe e hap atë mbi tërësinë e letërsisë*<sup>27</sup>.

Gjithashtu, ndikon:

23 “Unë e kam quajtur rrëfimtarin të besueshëm kur ai flet ose vepron në përputhje me normat e veprës (që do të thotë normat e autorit të nënkuptuar), jo të besueshëm kur nuk e bën këtë” (158-59).

24 Fjalori i Kritikës moderne, Toena, Tiranë, 2000, fq. 86.

25 Po aty, fq. 238.

26 Osja V., “Mbi poetikën e intertekstualitetit”, të N.P. Gros-it, Rev. Letra, v.I, nr.I, 2012.

27 Po aty, fq. 23.

- përpekja për të përkthyer terma të cilët kanë qenë të stabilizuar në shqip, si p.sh termi *kolazh* që sillet me formën *ngjitje*.

- për të kontribuar me emërtime të reja në sferat e teknikave të rrëfimit. Kështu termi *rrëfimesi*, i sajuar nga përkthyesi për termin zhenetian *narrate* shoqërohet me një sqarim që më tepër e ndërlikon, se sa e sqaron natyrën e termit. Po ky term në një përkthim të veprës “Diskursi i ri i rrëfimit” të Zherar Zhenetit ka ardhur si rrëfimmarrësi<sup>28</sup>, term sërisht i sajuar, pa shpjegim dhe i diskutueshëm.

Te kjo vepër termi, i pagëzuar nga Genette si *fokalizim* dhe i pranuar përgjithësisht nga komuniteti i teoricienëve dhe kritikëve të narrativës, ka ardhur në variantin *fokusim*. Por koncepti i *fokalizimit* (si zevëndësim dhe zgjerim i termit *pikëvështrim*) i Zhenetit na duket se nuk është afër me domethënien që sugjeron *fokusimi* (përqendrimi). Te *fokalizimi*, Zheneti “*tregohet shumë i kujdesshëm për të bërë dallimin ndërmjet dy kategorive “kush po percepton” nga njëra anë dhe “kush po flet” nga ana tjetër. Genette-i e quan perceptimin e ngjarjeve të rrëfyera me termin “fokalizim”.*

Që termi *fokusim* nuk i përgjigjet idesë së mësipërme, na e tregon ilustrimi i përdorimit të tij në këtë shtjellim: *Novela X është përqendruar në sende, njerëz dhe vende të zakonshme: një botë që lexuesi mund ta njohë si të veten. Ajo është përqendruar në një botë materiale të përditshmërisë, duke ngulmuar në idenë se e pasqyron atë.*

## **Përfundime**

Siç shihet, edhe sot pas 30 viteve lirie politike dhe ideologjike, akoma kemi probleme me konstituimin e një terminologjie letrare dhe me stabilizimin e termave e koncepteve letrare, sidomos të periudhës së modernizmit dhe postmodernizmit.

Mbase kjo është arsyeja (në gjykimin tonë) që në një pjesë të përkthimeve të literaturës teorike gjegjëse, dhe po ashtu edhe një pjesë e punimeve të doktorantëve (flasim nga përvoja e rasteve që kemi shqyrtuar) ka konfuzion e pse jo edhe ngatërresa nocionesh, duke i bërë të vështira leximet dhe përdorimet e këtyre teksteve.

Ndaj mendojmë që është koha të vëmë dorë, e siç thotë Eliot-i të gjejmë rrugët e trajtimit, në mënyrë që të dimë në çdo moment për çfarë flasim.

---

28 Genette G., “Diskursi i ri i rrëfimit”, *Dy lindje, dy perëndime*, 2014, fq.107.

## **BIBLIOGRAFIA:**

- CALINESCU M. (2012): “Pesë fytyrat e modernitetit”, (përkthyer nga G. Qendro), Dituria, Tiranë.
- ELIOT S.T., (1929): “Experiment in criticism”, Bookman 70.
- FOWLER R., (ed. by) (1987): A Dictionary of Modern Critical Terms”, Routledge.
- GENETTE G., (2014): “Diskursi i ri i rrëfimit”, *Dy lindje, dy përëndime*.
- LEKA F., PODGORICA F., HOXHA S., (1972): “Fjalor shpjegues i termave të letërsisë”, Tiranë.
- LEKA F., (2013): “Fjalor i termave të letërsisë”, Infbotues, Tiranë.
- OSJA V., “Instalimi i diskursit ideologjik përkundër atij letrar në trajtesat mbi/ për letërsinë pas vitit ‘45”, Studime Albanologjike, 2021/2 viti XXIV. Universiteti i Tiranës.
- TAÇI D., (2000): “Fjalori i Kritikës moderne”, *Toena*, Tiranë.
- ZHEJI GJ., (përshtati), (1965): “Fjalorth termash letrarë”, *Drejtorja e botimeve shkollore*, Tiranë.

# TERMINOLOGJIA NË TEKSTET PUBLICITARE DHE PËRKTHIMI

**Dr. Viola Adhami**

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: viola.adhami@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Mes gjuhëve të specialitetit, gjuha e përdorur në tekstet publicitare është një nga gjuhët që ndryshon dhe zgjerohet pandalur. Leksiku i saj përfshin fusha të ndryshme të komunikimit dhe është e pasur me fjalë, terma dhe shprehje, burimi i të cilave është i shumëllojshëm dhe i gjithanshëm. Ajo kap prirjet e reja të gjuhës bashkëkohore, e instrumentalizon dhe e bën të vetën këtë gjuhë. Termat vijnë nga fusha të ndryshme, mjekësia, moda, gastronomia, sporti, politika, shkencë etj. Në këtë studim synojmë të analizojmë terminologjinë e përdorur në fushën e publicitetit duke u ndalur në disa fusha dhe aspekte të ndryshme të saj si dhe në përkthimin e termave të përdorura.

**Fjalët çelës:** tekst publicitar, leksik, përkthim, komunikim

## TRANSLATION AND TERMINOLOGY IN ADVERTISING TEXTS

### ABSTRACT

Among the specialist languages, the language used in advertising texts is one that is constantly changing and expanding. Its lexicon includes various fields of communication and is rich in words, terms and expressions, the source of which is diverse and versatile. It captures the new trends of contemporary language, instrumentalizes and makes this language its own. The terms come from different fields like medicine, fashion, gastronomy, sports, politics, science, etc. In this paper, we intend to analyze the terminology used in the field of publicity, focusing on several different areas and aspects of it, as well as the translation of the terms used.

**Keywords:** advertising text, lexicon, translation, communication

Publiciteti sipas Erich Fromm-it “vepron tek ana emocionale dhe jo racionale”, nuk ofron asnjëherë thjesht informacion për një produkt, synon të krijojë një interes, të zgjojë një reagim tek publiku. Që të jetë sa më bindës dhe tërheqës në paraqitjen e produktit, publiciteti përdor imazhe ose fjalë me përqendrim të lartë shprehës. Një nga rregullat bazë në realizimin e një reklame është “të qenit specifik në komunikim”<sup>1</sup>. Për këtë, terminologjia që përdoret në publicitetet përmban një larmi gjuhësore që vjen nga sektorë të ndryshëm të jetës dhe realitetit shoqëror. Është një gjuhë që i referohet disa veçorive më specifike: në këtë rast bëhet fjalë për nënkodë, ose mikrogjuhë të komuniteteve të ndryshme si ato shkencore dhe profesionale, ku përdoret gjuha juridike, shkencore etj. Nga pikëpamja leksikore

1 Hopkins C., *La Mia Vita nell'Advertising*, IbeX Edizioni, Milano, 2022, fq.175



gjuha e publicitetit nuk është e qëndrueshme, por është rezultat i një mbivendosje dhe i një sinkretizmi të shumë kodeve gjuhësore. Një nga zgjedhjet leksikore është pikërisht futja e gjuhës teknike; terma dhe shprehje tekniko-shkencore përdoren shpesh në reklama edhe në fusha që nuk kanë lidhje me teknologjinë. Termat vijnë nga fusha të ndryshme, mjekësia, moda, gastronomia, sporti, politika etj. Natyrisht për t'i dhënë vlera produktit, për ta bërë konsumatorin kureshtar, për këto produkte të reja, të realizuara nga zbulimet më të fundit në fushat përkatëse. Në një mesazh publicitar, në disa lloje reklamash, përdorimi i gjuhëve të specializuara ose të veçanta, i jep një ton autenticiteti mesazhit. Përdorimi i kësaj terminologjie specifike kombinohet me gjuhën standarde. Mesazhi publicitar, përpiket të kushtëzojë kështu zgjedhjet e konsumatorit nëpërmjet një gjuhe retorike bindëse.

### Terminologjia shkencore në tekstet publicitare

Vitet e fundit reklammat janë pasuruar shumë me informacion shkencor pikërisht që mesazhi promocial të bëhet më bindës. Pra përdorimi i gjerë i termave teknikë si “status simbol”<sup>2</sup> si në shqip dhe në gjuhë të huaj, që lexuesi zakonisht nuk i njeh, kanë për qëllim të japin “një garanci të vlefshmërisë së produktit për shkak të natyrës shkencore apo (pseudo) shkencore të gjuhës së përdorur”.<sup>3</sup> Kjo bëhet për t'i dhënë siguri konsumatorit si dhe për ta bërë atë ta ndiejë veten të përfshirë dhe njohës të karakteristikave të produktit. “Kjo ndodh sepse padyshim mendojmë se “nëse e thotë shkenca, duhet të jetë e vërtetë”.

Çfarë është, për shembull, *lactobacillus bifidus essensis* që përdoret për të përshkruar kosin? Po *bifidus actiregularis*? Për shumë njerëz këto janë terma të panjohura, kuptimi i të cilave kërkon njohuri të një niveli të lartë specializimi, por nuk është një parakusht për lexuesit dhe apo shikuesit e reklamave. Termi teknik përdoret për të mahnitur marrësin e mesazhit. Ndodh që mesazhi që përcillet nga termat teknikë nuk është i vërtetë, por termat teknikë i japin marrësit të mesazhit siguri për cilësinë e produktit dhe për këtë arsye kanë një vlerë “pseudo-informative”<sup>4</sup> pasi për konsumatorin ky është një mesazh informues edhe pse termat nuk arrin t'i kuptojë. Kjo terminologji përdoret nga shkencëtarët, dermatologët apo njerëzit e sektorëve të veçantë në përgjithësi. Këto terma nuk janë të kuptueshme nga një audiencë më e gjerë, por edhe nëse lexuesi/dëgjuesi nuk i kupton, përsëri do t'i pranojë si të vërteta dhe të vlefshme. Për shkak të respektit dhe vlerësimit të shkencës, lexuesi do ta pranojë përmbajtjen e mesazhit me besim. Pra, fushatat publicitare janë vërtet shkencë: ato na përplasnin në fytyrë një imazh objektiv të subjektivitetit tonë, që përndryshe nuk do të ishim ndërgjegjësuar. “Reklammat më japin njohuri objektive të dëshirave dhe idealeve të mia – prandaj i shërbejnë atij

2 Sergio G., La salute in vendita. Un sondaggio lessicale sulla lingua medito pubblicitaria, tek Lingua italiana d'Oggi, n.4, Roma, Bulzoni, 2008, fq. 280.

3 Serra G., L'uso dell'inglese nella pubblicità italiana, Aracne Editrice, Roma, 2006, fq. 41.

4 Baldini M., Parlar chiaro, parlare oscuro, Laterza, Roma-Bari 1989, fq. 275.

që shet”<sup>5</sup>. Për ta bërë sa më të besueshëm këtë mesazh në reklamë jepet imazhi i një mjeku, ose edhe i vetë zbuluesit të këtij elementi mrekullibërës, për t’i dhënë vlerë tekstit si p.sh. dentisti në reklamën e pastës së dhëmbëve AZ, apo pediatri tek Pampersi, specialisti ORL tek Amplifon etj.

Terminologjia teknike përdoret kryesisht në tekstet më përshkruese dhe më të detajuara të reklamës, për të t’i dhënë një informacion më të plotë konsumatorit.

Sager<sup>6</sup> bën një klasifikim të përdorimit të termave teknikë ose teknikizmave:

- terma të veçantë të një disipline të caktuar që përdoren nga specialistët (fjalëformime të reja apo të marra nga gjuhë semantikisht të riformuluara në gjuhën e specialitetit),
- fjalë të gjuhës që përdoren në gjuhë të specialitetit pa ndryshim kuptimi, në mënyrë transversale, në të gjitha disiplinat ose vetëm në fushën e specialitetit,
- fjalë të gjuhës së përditshme që përdoren me një kuptim të ngushtë në një fushë specialiteti.

Sipas De Mooij<sup>7</sup>, “bindje do të thotë t’i mbushësh mendjen dikujt për të bërë diçka”. Për autorin në fushën e publicitetit - copywriter, teknikizmi është një mënyrë për të vënë në pah të mirat e produktit, pa e bërë konsumatorin të dyshojë, që ai mos ta shohë reklamën si një mjet për ta bindur që të blerë produktin.

Teknicizmi në publicitet shërben pikërisht që të arrijë të krijojë te konsumatori impulsin e blerjes, për më tepër në disa kategori të caktuara konsumatorësh, kjo vërtetësi shkencore apo pseudo-shkencore ka fuqinë të funksionojë pozitivisht.

Po të shohim shembullin e enzimës Bifidus ActiRegularis të kosit Activia danone që e përmendëm dhe më lart, kjo enzimë nuk ekziston, por flitet për Bifidobacterium animalis DN-173 010, zhvilluar nga Danone Research për të favorizuar tretjen në zorrë. Pra kemi të bëjmë me një term të ri. Nëse bëjmë një zbërthim të fjalës do të shohim që “Acti”vjen nga emri i produktit dhe “Regularis” - kthim në normalitet - zotëron një *status-symbol* që “kalon” nga produkti te konsumatori. “Status” që duhet të ruhet edhe kur mesazhi përcillet në gjuhë të tjera dhe rolin e *copy-t* e merr përkthyesi. Këtu më poshtë po sjellim një nga reklamat e kosit Activia në shqip dhe italisht, ku siç e shohim termi i ri ruhet edhe në përkthim me të vetmin ndryshim se është i transkriptuar.

---

5 Benvenuto S., La scienza del consumatore. riflessioni sulla pubblicità oggi e sul gusto di massa <https://www.leparoleeleccose.it>, 2022.

6 Sager J-C., Essays on definition, John Benjamins Publishing Company, 2000, fq. 44.

7 De Mooij M., Global Marketing and Advertising; understanding cultural paradoxes, Sage, 2018, fq. 4.



Fig.1 Activia DANONE

Jeto në harmoni me Activia – Lo yogurt Danone Activia, con il suo Bifidus Actiregularis  
Me përbërësit e përzgjedhur me kujdes  
Lloje të ndryshme të jogurtave me akti regularis  
Actimel - Për te rritur dhe femije

**ElkosGroup Danone**

## Terminologjia dhe publiciteti i produkteve kozmetike

Në sektorin e reklamave të produkteve kozmetike, shpesh gjejmë terma teknike që lidhen me sektorin e kozmetikës ose dermatologjisë, d.m.th. “fjalë dhe shprehje që nuk janë pjesë e fjalorit që përdoret zakonisht” si në reklamat në Shqipëri ashtu dhe tek ato në Itali.” Po japim disa shembuj për të ilustruar idenë si në shqip edhe në italisht: me proretinol; me formulën PRO-V; në 48 nuanca; me acid hialuronik; lufton kruajtjen, zbokthin; pa amoniak; silikon; pa paraben; principe aktive; hidratuese etj. – con il proretinolo; con la formula PRO-V» «in 48 nuance, con acido ialuronico»; «combatte prurito, forfora»; «senza ammoniaca» «siliconi»; senza parabeni «principi attivi idratanti» etj.

Siç e përmendëm dhe më lart terminologjia e përdorur në fushën e publicitetit përfshin shumë fusha të specialiteteve të ndryshme. Për të parë sesi përdoret kjo terminologji do të ndalemi kryesisht në reklama të produkteve kozmetike të kompanisë “Bottega Verde” e cila operon edhe në tregun shqiptar për të parë sesi vijnë edhe në shqip këto terma, duke parë termat e marrë nga disa fusha.

Në këtë tekst publicitar të serumit *Uva preziosa* gjejmë shumë terma shkencore, kryesisht të fushës së kimisë dhe të fushës së botanikës ku për ta bërë sa më të besueshëm produktin jepet një shpjegim shkencor.



**Fig. 2** Serum Uva preziosa

**Serum** fytyre **antioksidant** Uva Preziosa. Falë ekstraktit të **rrushit të kuq** të marrë nëpërmjet **procesit** inovativ të **hiperfermentimit** dhe **acidit hialuronik** luan një rol **hidratues** të rëndësishëm në zbutjen e shenjave të para të plakjes.

Un **siero** concentrato dall'azione **antiossidante** e **idratante**. L'**estratto di Uva rossa** ottenuto attraverso l'innovativo **processo di iperfermentazione** e l'**acido Ialuronico** che svolge un'importante attività **idratante** e levigante dei primi segni del tempo.

Acidi glikolik është një acid që përdoret në kozmetikë për realizimin e kremrave, vetë përdorimi i termit shkencor e bën konsumatorin kureshtar për produktin. Pasi, siç e shikojmë, jepet një shpjegim i hollësishëm i procesit biologjik tek njeriu dhe zgjidhja që ofrojnë produktet nëse konsumatori i bën të vetat. Më poshtë po japim një nga shpjegimet që e gjejmë në të dyja gjuhët në lidhje me acidin glikolik, për ta bërë sa më të pranueshëm produktin dhe për të krijuar besueshmërinë e nevojshme. “Kur promovohet një produkt duhet që informacionet e dhëna të jenë të ndershme, të vërteta dhe të sakta, duke shmangur ekzagjerimet, sidomos për sa i përket karakteristikave dhe efekteve të produktit dhe/ose shërbimit”<sup>8</sup> Në përgjithësi siç e përmendëm, këto shpjegime jepen në pjesën e përshkruese të produktit dhe jo në reklamën kryesore.

### **Acidi glikolik**

Rinovoni dhe rigjallëroni lëkurën me linjën e fytyrës me **Acid Glikolik**. Vetitë e tij eksfoluese dhe zbutëse kontribuojnë në rinovimin qelizor të lëkurës duke nxitur shkëlqimin, elasticitetin dhe hidratimi.

Ndoshta jo të gjithë e dinë se **qelizat e lëkurës** sonë kanë një cikël jetësor të përcaktuar mirë. Ato lindin nga shtresa më e thellë bazale dhe gradualisht ngrihen

---

8 Masini S., Neo marketing ed emozioni sostenibili. Miti e mode, illusioni e inganni del consumatore digitale, Franco Angeli, 2023, fq. 35.

në sipërfaqe: këto janë “qelizat e vdekura” të famshme që eliminohen natyrshëm nga lëkura jonë. Me rritjen e moshës, për shkak të faktorëve të shumtë, të brendshëm dhe të jashtëm, ky cikël ngadalësohet duke shkaktuar një akumulim të **qelizave të vdekura** në fytyrën tonë, e cila gradualisht humbet ndriçimin dhe shkëlqimin e saj. Për të promovuar rinovimin e **qelizave**, Bottega Verde ka zhvilluar një linjë të tërë trajtimesh të fytyrës me acid glikolik, i cili, ditë pas dite, rinovon **lëkurën** duke e ndihmuar atë të rifitojë përsosmërinë e saj natyrale.

### Acido Glicolico

Rinnova e rivitalizza la pelle con la linea viso Acido Glicolico. La sue proprietà esfolianti e leviganti, contribuiscono al rinnovamento cellulare della pelle promuovendone luminosità, elasticità e idratazione.

Forse non tutti sanno che le cellule della nostra pelle hanno un ciclo vitale ben definito. Nascono dallo strato basale più profondo e salgono progressivamente in superficie: queste sono le famose “cellule morte” che vengono naturalmente eliminate dalla nostra pelle. Con l’aumentare dell’età, a causa di molteplici fattori interni ed esterni, questo ciclo viene rallentato causando un accumulo di **cellule morte** sul nostro viso, che perde progressivamente di luminosità e splendore. Per favorire il rinnovamento **cellulare**, Bottega Verde ha messo a punto un’intera linea di trattamenti viso all’acido Glicolico che, giorno dopo giorno, rinnovano la **pelle** aiutandola a ritrovare la sua naturale perfezione.



Fig.3 Retinolo

#### *Azione anti-tetà e levigante*

Il **Pro Retinolo**, unito all’**Acido Ialuronico**, combatte i segni del tempo e mantiene a lungo l’idratazione. La formula è arricchita con gli **estratti iperfermentati di Ginseng rosso** dall’azione **energizzante** e di **Carota**, fonte di **sali minerali**, **provitamina A** e **vitamine E, B e C**.

## IL MIO PRIMO RETINOLO

### Retinol edhe për lëkurën më të re!

Trajtim i plotë që kundër rrudhave te para me një veprim energjik hidratimi afatgjatë. Formula e përmirësuar me **acid hialuronik** dhe ekstrakte **karrotë e hiperfermentuar** dhe **xhensen i kuq**, burim **kripërash minerale**, **provitaminë A** dhe **vitamina E,B dhe C**. Zbuloni rutinën e plotë të kujdesit të lëkurës 🍷

Po ashtu gjejmë terma edhe nga fusha e fizikës si UVA, UVB, rragji- rreze; pasqyruar në shembullin e mëposhtëm



Fig.4 Krem Sol Karitè

SOL CREMA SOLARE VISO - ANTIETÀ ANTIMACCHIE SPF50 **protezione** alta (50 ML) studiato per prevenire i danni provocati dai **raggi UVA e UVB** grazie a formule professionali e ingredienti di origine naturale.

Krem **mbrojtës** ndaj diellit, për lëkurën e fytyrës, me një formulë dermatologjikisht të testuar, që ndihmon në **mbrojtjen** e lëkurës nga djegia dhe parandalon shenjat e plakjes që shkaktohen nga efektet dëmtuese të **rrezeve UVB dhe UVA**. Kremi ka faktor të **mbrojtjes** nga dielli prej 50 SPF për mbrojtje efektive të lëkurës dhe përmban gjalpë shea me efekt ushqyes për lëkurën.

Një fushë tjetër nga e cila merren termat shkencorë është edhe ajo e anatomisë ku gjejmë terma të ndryshme si cellule-qeliza, pelle- lëkurë, viso-fytyrë, corpo-trup etj. Terma këta që i gjejmë edhe në reklamat që kemi marrë për shembull.

Në reklamën e mëposhtme gjejmë shumë terma të matematikës të cilat shërbejnë për të saktësuar informacionin siç është përdorimi i numrave dhe përqindjeve dhe për ta bërë më të besueshëm dhe më të hollësishëm. Nuk mungojnë as termat e

marra nga gjeometria si “linjat”<sup>9</sup>. . Si p.sh.: Linja Bakuchiol për rrudhat, Linjat Sol, Linja e fytyrës, një linjë të tërë trajtimesh si: La Linea Sol, Linea Bakuchiol rughe, linea viso, un'intera linea di trattamenti.



Fig. 5 SOL

Në grupin e reklamave që kemi marrë për shembull, nuk mungon as terminologjia ushtarake gjë që shpjegohet me qëllimin për ta bërë sa më të pranishme “luftën” për të ruajtur shëndetin e trupit; përmendim këtu fjalë të përdorimit të figurshëm si lufton-combatte, mbrojtje- protezione, etj.

Siç mund ta vëmë re edhe nga shembujt e marrë më sipër, terminologjia që i përket fushave të kimisë dhe botanikës është ajo që përdoret më shumë dhe nëse analizojmë teknicizmat sidomos të fushës së kimisë, shohim një farë teprie në përdorimin e tyre. Teknicizmat që i përkasin fizikës janë ato me përdorim më të pakët dhe i përkasin më shumë reklamave të kremrave të diellit. Ndërsa termat e fushës së biologjisë e pasurojnë leksikun dhe i japin një vlerë të shtuar informacionit. Të njëjtën gjë vërejmë edhe në përkthimin në shqip, ku janë përdorur termat e duhura nga fushat e ndryshme.

### Përfundime

Në një botë ku publiciteti ka pushtuar çdo gjë, bëhet e vështirë për krijuesin e një fushate publicitare që të arrijë të realizojë me anë të strategjive gjuhësore apo vizuale, një reklamë ku produkti të tërheqë vëmendje, pa rrezikuar të ngjallë te targeti dyshimin se është duke u përpjekur ta bindë atë. Ndërsa këto strategji aktivizojnë më lehtë barrierat vetëmbrojtëse të konsumatorit, termat teknike kanë më shumë efekt bindës pikërisht sepse nuk janë shumë (ose më pak) të dukshme. Kjo terminologji, cilido qoftë sektori i origjinës, i jep një miratim teknologjiko-shkencor produktit të cilit i bëhet reklamë. Gjë që e shohim më së miri në shembujt e mësipërm. Përkthimi dhe përdorimi i

<sup>9</sup> “linja” e pranishme në grup fjalët linjë trajtimi, linjë bukurie, linjë produktesh». Buratta, P., cit., Baldini M., Le fantaparoie. Il linguaggio della pubblicità, Armando, Roma, 1996, fq.150

terminologjisë ndërthuren me njeri-tjetrin sepse terminologjia konceptohet si “një grup kompetencash gjuhësore dhe komunikuese që janë të artikuluar në një shumësi gjuhësh”.<sup>10</sup>

Prandaj, reklama duhet të jetë inovative për të tërhequr target grupin. Është në interesin e kompanive ta bëjnë për vete konsumatorin dhe qëllimi është që në fund konsumatori ta blerë produktin. Publiciteti është një nga kanalet më të zakonshme dhe më të rëndësishme të komunikimit. Mund të themi se dy nga veçoritë bazë që mesazhi të jetë ai i duhuri janë të kuptuarit dhe rëndësia. Pra që kompanitë të sfidojnë konkurrencën dhe të jenë të suksesshme duhet të përcjellin të njëjtat vlera që mbart target-grupi dhe të flasin me njerëzit dhe për njerëzit. Ndonjëherë pra konsumatori priret të jetë dyshues ndaj reklamës, pasi mendon se nuk do të ketë autonomi në zgjedhje. Në shumicën e rasteve futja e terminologjisë shkencore i jep siguri. Duke e kthyer kështu në bashkëudhëtar dhe aleat natyror të kompanisë, duke i shtuar besimin dhe rritur besnikërinë, për një të ardhme të sigurtë dhe të suksesshme.

## BIBLIOGRAFIA:

ARCANGELI M., (2008), Il linguaggio pubblicitario, Carocci.

BALDINI M., (1989). Parlar chiaro, parlare oscuro, Laterza, Roma-Bari.

BALDINI M., (1996). Le fantaparole. Il linguaggio della pubblicità, Armando, Roma.

BENVENUTO S., (2022) La scienza del consumatore. riflessioni sulla pubblicità oggi e sul gusto di massa <https://www.leparoleelecose.it>

BROCHAND B., LENDREVIE J. GOZZINI G (1986) Le regole del gioco, Lupetti.

CALANDRA P., (2017), La scienza negli spot pubblicitari- progresso o propaganda? <https://www.ismn.cnr.it>.

DE MOOIJ M., (2018) Global Marketing and Advertising; understanding cultural paradoxes, Sage.

DODMAN M., (2004): “La competenza plurilingue”, I diritti della scuola, n.1, anno I korrik, Bolzano, fq. 27-28.

FALABRINO G. L., (2007): Storia della pubblicità in Italia dal 1945 a oggi, Roma, Carocci.

FROMM E., (2021): Fuga dalla libertà, Mondadori.

GIACOMELLI R., BONOMI I., MASINI A. & MORGANA S., (2003): La lingua della pubblicità, te La lingua italiana e i mass media, , Roma, Carocci, fq. 223-248.

HOPKINS C., (2002): Scientific Advertising, Positive Club.

HOPKINS C., (2022): La Mia Vita nell'Advertising, Ibox Edizioni, Milano.

LOMBARDI M., (2021): Creatività in pubblicità. Dalla logica alle emozioni, Franco Angeli.

10 Dodman M., “La competenza plurilingue”, I diritti della scuola, n.1, anno I. Korrik, Bolzano, 2004, fq. 27.



MASINI S., (2023): Neo marketing ed emozioni sostenibili. Miti e mode, illusioni e inganni del consumatore digitale, Franco Angeli.

OGILVY D., Confessioni di un pubblicitario, Lupetti editore.

PYM A., (2004) *The Moving Text: Localization, translation and distribution*, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins 1992 ribot. f. 101-102

SAGER J-C., (2000) *Essays on definition*, John Benjamins Publishing Company

SCARPA F. (2008): *La traduzione specializzata. Un approccio didattico professionale*, BOTIMI II, HOEPLI, Milano.

SERGIO G., (2008), *La salute in vendita. Un sondaggio lessicale sulla lingua medico pubblicitaria*, tek *Lingua italiana d'Oggi*, n.4, Roma, Bulzoni

SERRA G., (2006) *L'uso dell'inglese nella pubblicità italiana*, Aracne Editrice, Roma.

SOLIMAN T.L., (2016) *Lingue speciali. Dinamiche di ricerca*, CLEUP

Using scientific or clinical claims (representations) in therapeutic goods advertising 22 shkurt 2023 <https://www.tga.gov.au/>

[www.bottega.verde.it](http://www.bottega.verde.it)

[www.bottegaverde.al](http://www.bottegaverde.al)

# HULUMTIME MBI TERMINOLOGJINË E KRITIKËS TEKSTUALE MESJETARE DHE TË TERMAVE EKLEZIASTE NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES

**Dr. Arta Sula**

Departamenti i Letërsisë  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Univertsiteti i Tiranës  
E-mail: artasula@yahoo.it

## PËRMBLEDHJE

Objekt i këtij punimi do të jenë hulumtime mbi njohjen e terminologjisë së kritikës tekstuale mesjetare dhe, në mosnjohjen e kuptimit të saktë të termave ekleziaste (në rrafsh historik), që prej *paraletërsisë* e deri te letërsia filobiblike gjatë procesit të mësimdhënies. Sikurse dihet, studimi i ‘letërsisë’ deri në shek. XVI është kryesisht paleografi dhe, trashëgimia afro 15-shekullore e dorëshkrimeve të ruajtura në Shqipëri, duke qenë shprehje e *ars scribendi*, është njëherësh dhe shprehje e evolucionit kulturo-historik, i cili i ka fillesat e veta ndër tekste liturgjike e ‘Shkrime të Shenjta’ latinisht e greqisht të shkruara a murgjive dhe ndikoi në formimin e gjuhës kombëtare. Një prej aspekteve të prodhimit libror mesjetar nuk është vetëm ruajtja me besnikëri e teksteve të dorëshkrimeve apo libri si simbol a univers i simboleve, por edhe libri si mjet leximi e studimi, si mjet gjuhësor që na ofron trashëgimia jonë historike për të mbërritur, në kontekstin humanist evropian, drejt shkrimit doktrinar fetar, filozofik e letrar në gjuhën shqipe. Në këtë këndvështrim, rëndësia e ligjëritit dhe e studimit të letërsisë në universitet bazohet në njohjen e disiplinave historike e humaniste dhe veçanërisht, në lëvrimin e filologjisë. Mosnjohja e kuptimit të saktë të terminologjisë kritiko-tekstuale shpie në moskuptim apo variacione të moskuptimit të mësimi të letërsisë. Le të sjellim ndërmend rëndësinë e kuptimit të konceptit autor ose më saktë të funksionit autor, që lidhet me sistemin institucional të Kishës, e nis që prej termit *auctoritas*, *auctor* e deri te *Autore* te Buzuku dhe *Auctor* te Bogdani.

**Fjalët çelës:** dorëshkrimet, kodikët e Shqipërisë, shkrimi doktrinar, letërsi filobiblike, mësimdhënie e letërsisë

## RESEARCH ON THE TERMINOLOGY OF MEDIEVAL TEXTUAL CRITICISM AND ECCLESIASTICAL TERMS IN THE TEACHING PROCESS

### ABSTRACT

The object of this paper will be research on the recognition of the terminology of medieval textual criticism and, in the not knowing of the exact meaning of ecclesiastical terms (on a historical level), from pre-literature to philo-biblical literature during the teaching process. As is known, the study of “literature” until the century XVI is mainly paleography and the nearly 15-century heritage of manuscripts preserved in Albania, being an expression of the *ars scribendi*, is at the same time an expression of the cultural-historical evolution, which has its beginnings among the liturgical texts of the Latin and Greek ‘Holy Scriptures’ of scribes or monks and influenced the formation of the national language. One of the aspects of medieval book production is not only the faithful preservation of manuscript texts or the book as a symbol or universe of symbols, but also the book

as a reading and a studying that our historical heritage offers us to arrive, in the European humanist context, towards religious, philosophical and literary doctrinal writing in the Albanian language. In this perspective, the importance of the lecture and the study of literature at the university is based on the knowledge of historical and humanistic disciplines and especially, in the study of philology. Not knowing the exact meaning of critical-textual terminology leads to misunderstanding or variations of misunderstanding of the teaching of literature. Let's remember the importance of the understanding of the author concept or more precisely the author function, which is related to the institutional system of the Church, starting from the term *auctoritas*, *actor* to *Autore* in Buzuku and *Auctor* in Bogdani.

**Keywords:** manuscripts, codices of Albania, doctrinal writing, philo-biblical literature, teaching of literature.

Studimi i letërsisë është kryesisht paleografi deri në fund të shek. XV, pohonte dikur Carlo Dionisotti. Ndoshta, është deri në mes të shek. XVI; por, të paktën pjesërisht, është e vërtetë edhe e anasjellta, që d.m.th. se përsa i përket epërsisë librore, nuk mund të jetë paleografi nëse nuk është edhe studim edhe njohje e proceseve letrare.

Trashëgimia afro 15-shekullore e dorëshkrimeve të ruajtura në Shqipëri, duke qenë shprehje e *ars scribendi* (arti i të shkruarit), është njëherësh dhe shprehje e evolucionit kulturor dhe historik, i cili i ka fillesat e veta ndër tekste liturgjike e 'Shkrime të Shenjta' greqisht a latinisht të shkruesve, murgjve a logothetëve<sup>1</sup> dhe, ndikoi në formimin e gjuhës kombëtare e të letërsisë së vjetër shqipe apo asaj filobiblike<sup>2</sup>, sikurse quhet ndryshe.

Në këtë pikëvështrim, njohja e terminologjisë së kritikës tekstuale mesjetare dhe në veçanti njohja e termave ekleziaste luajnë një rol me rëndësi gjatë procesit të mësimdhënies. Padyshim, mosnjohja e kuptimit të saktë të kësaj terminologjie krijon moskuptim apo variacione të moskuptimit të mësimin të letërsisë, por edhe të *paraletërsisë*.

Qysh nga antikiteti, gjatë mesjetës e më vonë, teksti është shkruar me 'dorë' dhe lind e përhapet në formën e dorëshkrimit, kodikut, *codex*. Që këtu nis vështirësia fillestare se çfarë kuptohet me termin kodik, që përfshin në vetvete të gjithë procesin e kodifikimit, me zëvendësimin progresiv të rrotullës së papirusit me kodikun. Madje, ai ishte revolucioni më i madh në historinë e librit para shtypshkronjës: kalimi nga *volumen*, rrotulla e traditës helenistike, te *codex*, kodiku i traditës veçanërisht romake, që mund të konsiderohet si

1 Janë të shumta shënimet që gjejmë në kodikë, të cilat dëshmojnë se në mesjetën e vonë, shkruesi është (γραμματεὺς, ἑως - sekretar; γραμματικός - erudit, kancelar) dhe shkruan me porosi të familjeve patronimike.

2 Sipas përkufizimit të Sabri Hamitit, veprat e letërsisë së vjetër zotërohen nga karakteri doktrinar i krishterë, të plotësuara me elemente historike të popullit shqiptar dhe duke qenë të zotëruara nga temat e kultura biblike, në porosi e në ligjërime, vetvetiu marrin cilësimin e karakterizimin e letërsisë filobiblike.

paraardhësi i librit modern.

Njohja e një procesi të tillë shpjegon dhe mungesën, në traditën e mbetur, të grupe librash - dhe jo të librave të veçantë - ka të bëjë me kalimin nga rrotulla (= një libër) në kodik: zhduket një kodik, zhduket një grup librash, një bllok librash që kanë lidhje mes tyre.

Një vend me rëndësi, në studimin dhe njohjen e proceseve letrare, zë ai i shkimit dhe i kopjimit të manuskriptit apo dorëshkimit, i cili nënkupton njohjen me terminologjinë e kritikës së tekstit mesjetar, duke filluar nga fjalët *tekst*, *manuskript*, *transmetim* i *tekstit* dhe *traditë* për të mbërritur drejt “kritikës së tekstit”.

Njohja e kuptimit të saktë të termave si: *ars scribendi*, *scriba*, *arketip*, *autograf*, *kopje*, *editio princeps*, *errata corrige*, *in-foglio*, *recto* e *verso*, praktika e *incipit* dhe e *explicit*, *recensio*, *usus scribendi*, *scriptorium*, *vulgata* dhe deri te variante të autorit, ndihmojnë procesin e mësimdhënies së letërsisë për një komunikim letrar mes ligjëruesit dhe dëgjuesve.

Shkrimi i librit, kaligrafia, arti i të shkruarit realizohej në mesjetë nga tipa të ndryshëm shkruesish (skribë a kopjues e më rrallë shkrues profesionistë) përveç murgjve (dhe, më pak, murgeshave) të cilët i kopjonin kodikët e tyre për të fituar mbretërinë e qiellit. Termi që haset për shkruesit është pikërisht *scriptor*, siç e dëshmojnë dhe nënshkrimet e këtij tipi: “*Dentur pro penna scriptori caelica regna*”. Duhet të sjellim ndërmend, ashtu sikurse vihet re edhe nga ky citim, që në mesjetë folja *scribere* (*shkruaj*), me derivatet e saj romanze (*scrivere*, *escrire*, *escriure*, *escribir* ecc.), do të thotë “kopjoj, transkripto”; kështu “të shkruash një libër” ishte sinonim i “të kopjosh”, ndërsa për të treguar punën krijuese të autorit përdorej folja *facere* (dhe derivatet romanze: *fare*, *faire*, *far*, *fazer* etj.): “të bësh një libër” etj.<sup>3</sup>

*Ars scribendi* i jepte mundësinë shkruesit për liri grafike, që është njëkohësisht shprehje e identitetit të tij, por edhe shprehje e një shkalle autorësie dhe është një proces i tërë letrar për të mbërritur nga termi ‘skrib, shkrues, *scriptor*’ te termi ‘autor, *auctor*’.

Sipas shënimeve të Dh. Shuteriqit<sup>4</sup>, në veprën e A. Ducellier, “La façade maritime d’Albanie au moyen âge” përmendet termi ‘*scribanus*’, viti 1388, ku thuhet se: “Një Andrea nga Durrësi është *scribanus* i anijes së një raguzini dhe merr qytetarinë e kësaj republike”. Nga termi *scriba* (*scribanus*), do të mund të mbërrijmë në emrin *shkruos* në gjuhën shqipe.

---

3 Cavallo G., *Dalla parte del libro*, Quattroventi, Urbino, 2002, fq. 224 - 225.

4 Shuteriqi Dh., “Moti i madh”, *Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479*, Dituria, Tiranë, 2006, fq. 19.

Në të vërtetë, M. Shuflaj ka vërtetuar se gjatë Mesjetës, në Shqipëri qytetet dhe parësia e vendit në aktet e në korrespondencën e tyre kanë përdorur ku greqishten, ku latinishten e ku serbishten; por edhe gjuha e vendit ka të ngjarë të ketë qenë shkruar në popull si gjuhë private e për një përhapje popullore të shkrimit, duket se flet edhe vetë fjala *shkruaj* bashkë me emrin *shkruos* “scriba” që gjejmë te Gjon Buzuku, fjalë të cilat, sipas E. Çabej, i atribuohen fondit autokton të gjuhës, dhe të cilat dëshmojnë për një traditë të hershme të shkrimit në vend.<sup>5</sup>

Para se të ndalemi tek termi *auctor*, autor, duhet të nisemi nga termi *auctoritas*, autoritet.

Çfarë është një *auctoritas*? Në fjalorin mesjetar, *auctoritas* tregon në radhë të parë cilësinë që i jep autoritet një njeriu: magjistrat, shkrimtar, dëshmitar, murg; pastaj, në vazhdim për metonimi, ky term do të kalojë për të treguar personin që e ka këtë cilësi dhe në fund tekstin të cilit i referohet: kështu, që prej mesjetës së hershme, do të qarkullonin përmbledhje të *auctoritates*. Duhet rikujtuar që *auctoritas* nuk shpreh tjetër veçse *fides ecclesiastica* (besimi kishtar): nëse në fakt *fides ecclesiastica* i kundërvihet *auctoritas*, *auctoritas* do të humbte çdo vlerë.

Pra, nuk mund të flitet për *fides* të *auctoritas* veçse në raport me *auctoritas* vetë. Apo më mirë nuk konsiderohet *auctoritas* veçse si *fides*, përderisa është shprehje e *fides ecclesiastica*.

Tashmë, mund të kalojmë tek *auctor*, autori, krijuesi i një teksti. Libri mori sanksionimin e tij më të lartë përmes Krishtëritimit. Krishtërimi ishte religjioni i Librit të Shenjtë, në të cilin shprehet qartë se është Zoti ai që shkruan apo urdhëron profetin të shkruajë. Vetëm Zoti, Krijuesi, ka autoritetin, *auctoritas*, profetët do të shkruajnë vetëm nën frymën e Zotit.

Në Mesjetë Etërit e Kishës ‘shkruajnë’ si transmetues të fjalës së Zotit. Në fillim, i vetmi krijues, autor ishte Zoti, pastaj kemi përfaqësuesit e Zotit, të cilët transmetojnë dijet në emër të Tij.

Te “Meshari”, Buzuku i referohet Zotit si *Bāsi i parë*, më pas si *Autore* e më shpesh si *Bāsi i gjithë shekullit*, kështu në f. IX/2 kemi:

- *Rekordou, o Bāsi i parë, η salutet, pors i korpit sinë një tjetërë herë formë more me vertyt tande, tue lēm njëj Virgjëne.*<sup>6</sup> (Memento, rerum Conditor, nostri

5 Çabej E., “Buzuku dhe gjuha e tij”, Gjon Buzuku dhe gjuha e tij, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2005, fq. 27.

6 Çabej E., “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), Botim kritik, Pjesa e dytë, Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë 1968, fq. IX/2.

quod olim corporis, sacrata ab alvo Virginis, nascendo formam sumpseris).<sup>7</sup>

Në f. X. Buzuku i drejtohet Krijuesit me fjalën Autore.<sup>8</sup>

*O Autore, kujtoq ñ së shelbuomit sinë, qi ñ motit së shkuom formë more  
ndë korp uman, me vertyt tande me lëm ñ Virgjënet.*<sup>9</sup>

Për Buzukun, ‘Autori’, *auctor*-i është krijuesi, ndërsa për Bogdanin krijuesi është Hyj-i për *Deus*, të cilën te Buzuku nuk e hasim, gjejmë vetëm Zot’ynë = *Dominus noster*, sikurse e ka vërejtur At J. Rrota.

Bogdani shprehet qartë në ‘*Të primitë përpara letërarit*’, teksa përmend vështirësitë në gjuhën shqipe duke qenë - *vepëra fort e naltë, [...] lëftova me ecunë një udhe së ndërmjetshime, tue më rām ndë mend kanka e Poetësë, - duke shprehur konceptin Autor - Poeta.*

Vetë Bogdani në parathënie shpreh edhe përcaktimin e punës së tij si *auctor* që mbështetet mbi *auctores, auctoritates*, ai thotë se *ndjek të dijtëshimitë*, ashtu sikurse ata kanë ndjekur njëri-tjetrin.

Ai përdor fjalën *të dijtëshimitë* “*auctores*” duke iu referuar kështu një liste (një cikli) të shkrimtarëve që gëzonin një autoritet kanonik.

Sipas mendimit të I. Rugovës, termat më të përshtatshëm për profilizimin e Bogdanit janë *auctor* dhe shkrimtar, që u afrohen edhe mendimit të sotëm.

Padyshim, njohja e kuptimit të saktë të këtyre termave, shkrues – *scriptor* dhe autor - *auctor* qartëson njohjen e niveleve të autorësisë krijuese të shkrimtarëve të letërsisë së vjetër shqipe, nga niveli i përkthimit (Buzuku 1555 e Matranga 1560-1619) deri në nivelin e hartimit origjinal (Bardhi 1606-1643, Budi 1566-1622 e Bogdani 1630-1689).

Sipas S. Hamitit, shkrimtaria e tyre kalon nëpër nivelet e shkrimit doktrinar fetar, në nivelin dokumentar historik e më në fund edhe filozofik e letrar dhe krijojnë një periudhë të shkrimit të gjuhës e të letërsisë shqipe. Karakteri i shkrimit të tyre identitar më së forti lidhet me nivelin e shqipes së tyre, si gjuhë e formuar kishare në konceptet themelore, e mbështetur në fjalor me frymën e jetës materiale

---

7 Paraqet interes përkthimi në gjuhën shqipe të fjalës ‘Krijuesi’ (lat. *conditōr, conditōris* – themelues; krijues, autor; *mundi conditor* - krijues i botës, *rerum Conditor* – Krijues i gjërave, *conditor carminum* - autor i këngëve), po me një fjalë të gjuhës latine, me *Basi*-n (*bāsis, basis* – themeli, baza; βάσις, εως, greq. baza, themeli), e konsideruar prej Buzukut si më e përshtatshme për të dhënë kuptimin në gjuhën shqipe.

8 Paci E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, fq. 44. Studiuësja ndalet te koncepti i Zotit si autor, si krijues te “Meshari”.

9 Çabej E., “*Meshari*” i *Gjon Buzukut (1555)*, Botim kritik, Pjesa e dytë, Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë 1968, fq. X.

të shqiptarëve.<sup>10</sup>

Jemi të mendimit se, gjatë procesit të mësimdhënies, mosnjohja e kuptimit të saktë të termave ekleziaste (në kontekstin e terminologjisë latine të kohës), paraqet vështirësi në mësimin e letërsisë filobiblrike. Njohja e gjuhës kishtare të jep çelësat për të hapur thesaret e fshehura të kësaj letërsie, në një mënyrë të tillë që, studenti do të mrekullohej përballë zbulimit të mrekullive që përmbajnë këto vepra, për të rrokur me të vërtetë mendimin e shkrimtarëve të vjetër.

Një çështje më vete përbën mosnjohja e kuptimit të saktë të termave ekleziaste (në rrafsh historik), sikurse rasti i *Formulës së Pagëzimit* në dokumentin me titull “Konstitucionet”<sup>11</sup> e Pal Êjllit – të Kuvendit të Matit në vjetin 1462”, ku përveç formulës së pagëzimit *in vulgari albanico* - Unte’ paghesont premenit Atit et birit et spertit senit, - përcaktohen edhe rregullat për pagëzimet jashtë kishe, dhe ka një keqkuptim mes termit në latinishten mesjetare “parrochianos - me kuptimin në shqipe *famullitar*” me vlerën që ka sot kjo fjalë në italishte, që do të thotë “besimtarë të një famullie”.

Kuptohet qartë se Pal Êjlli në këtë dokument nuk u referohet *besimtarëve* por *famullitarëve* për të drejtën e pagëzimit, e cila mbetej ekskluzivitet i klerit: “Në se ndonjeni asht pagëzuem në ket mënyrë, nuk duhet pagzue për s’dytit herë por ai duhet të përmbushë katekizmën. Nga ky vendim përjashtohen veç rasat kur dyshohet njimend, apo kur këto fjalë janë shqiptue nga një laik apo grue që, në rrethana shtrënguese, ka pagzue ksisoj, kështu pra, sacerdoti, duke pagëzue, të hedhë ujë mbi kryet e fmisë duke thanë: Si tu es baptizatus, ego non të rebaptizo, sed si non es baptizatus, ego te baptizo un nomine Patris et filij et spiritus sancti (n’shqip: N’kjoftë se je pagëzuem, un nuk të ripagëzoj, por n’mos kjoftë ti i pagëzuem, un po t’pagëzoj n’emën t’Atit, t’birit e t’shpirtit shëjtë)”.

Në këtë paragraf nuk del askund që prindërit, a ndokush tjetër jashtë funksioneve fetare, të mundte të kishte autoritetin për të kryer këtë sakramend.<sup>12</sup> Mosnjohja e kuptimit të saktë të termave ekleziaste (në rrafsh historik) shpie në gabime konceptuale.

Një prej aspekteve të prodhimtarisë librare mesjetare nuk është vetëm ruajtja

10 Hamiti S., “Letërsia filobiblrike”, në *Testamenti*, Prishtinë, 2018, fq. 341.

11 Shamku-Shkreli L., “Konstitucionet” e Pal Êjllit – të Kuvendit të Matit në vjetin 1462”, në *Tej prologut, Shqipja dhe çështje të metodës*, Çabej, Tiranë, 2017, f. 287. Emërtesa: *Constitutiones, Ordinationes et Statuta (Konstitucionet)*; Vendodhja e dok.: *Kodi Ashburnham, II, 1167*; Titulli i dok.: “Konstitucionet” e Kuvendit, (fl. 2a-9a); Përgatitë në: *Ecclesia Sancte Trinitatis de Emathia* (Kisha e Shindërtatit në Mat). Lëshue nga: *Paulus Angelus, Archiepiscopus Durrachiensis et Illiricae Regionis*; Kaligrafia: *shkrim dore me cilësi dhe lexueshmëri të naltë*. Vendodhja e formulës: *fajja 4-a (verso e dok.)*; Datimi: *8 Nandor 1462 (Indictione Decima Die vero Lune octava mensis Novembris MCCCCLXII)*. (Shuteriqi Dh., *Antologjia 7*; po ky “Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850”, 1976.

12 Shamku-Shkreli L., “Konstitucionet” e Pal Êjllit – të Kuvendit të Matit në vjetin 1462”, në *Tej prologut, Shqipja dhe çështje të metodës*, Çabej, Tiranë, 2017, fq. 286 - 295.

me besnikëri e teksteve të dorëshkrimeve apo libri si simbol a univers i simboleve, por edhe libri si mjet leximi e studimi, si mjet gjuhësor që na ofron trashëgimia jonë historike për të mbërritur, në kontekstin humanist evropian drejt shkrimit të letërsisë shqiptare në latinisht.

Një çështje me rëndësi paraqet shpjegimi i termit historiografik të humanizmit dhe në tërësi të qytetërimit të rilindjes si kusht i domosdoshëm për të kuptuar, gjatë procesit të mësimdhënies, rëndësinë e Marin Barletit si i pari autor i letërsisë shqiptare në latinisht me veprat e tij *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës, Rrethimi i Shkodrës dhe Historia e Skënderbeut*.

Njohja e terminologjisë së kësaj epoke, shërben për të kuptuar jo vetëm meritën e padiskutueshme të Barletit në themelimin e historiografisë shqiptare, por edhe kontributin e tij të veçantë në lëvizjen e humanizmit evropian.

Humanizmi është një periudhë në të cilën rimerren motivet klasike. Nëse do të donim të jepnim një përkufizim të përgjithshëm; humanizmi është një term historiografik ku mësohet qytetërimi që zhvillohet duke nisur prej shek. XIV, fundi i '300-ës, një qytetërim letrar që bazohet në afirmimin e vlerave mondane që bëri rimarrjen e klasikëve.

Po çfarë është një 'klasik'? Klasik është një term që rrjedh prej mbiemrit latin *classicus* – që do të thotë saktësisht – ajo që i përket klasës (klasit) të parë duke iu referuar pesë klasave mbi bazën e censimit romak. Pra, ai që i përket klasit të parë. I pari që e ka përdorur termin në kuptim të rafinuar ishte Aulus Gellius, që është një shkrimtar latin, në librin *Noctes Atticae*. Vetë Ciceroni e kishte përdorur termin *classis* për të përkufizuar një klasë filozofësh, shkrimtarësh duke sjellë në përdorim termin një klasë – një kanon. Pra, termi 'kanon' është një listë autorësh dhe kujtojmë se kanonet e para u hartuan në Greqi, qysh prej periudhave të hershme antike.<sup>13</sup>

Kështu për humanistët, gjatë rilindjes, klasikët ishin vetëm autorët grekë dhe romakë.

Për t'iu kthyer sërish termit humanizëm që është një term historiografik, i cili nuk ekzistonte para '800-ës. Rrjedh prej fjalës 'humanist', një termi që është i lidhur me qytetërimin, kulturën e periudhës së humanizmit. Në latinishten e '400-ës ekzistonte fjala *humanist* dhe kush ishte humanisti?

Ishte mësuesi i *humanae litterae* (litterae – mësim që i referohet njeriut, ato disiplina që në epokën klasike ishin përkufizuar si *studio humanitatis* – studime liberale, d.m.th. studime të njeriut të lirë prej veprimtarive manuale) e pra,

---

13 Në Athinë, për dramaturginë u vendos vetëm për tre dramaturgët e mëdhenj: Eskili, Sofokliu, Euripidi; - ky është një kanon. Në Greqinë e lashtë, sikurse dihet, ka pasur edhe dramaturgë të tjerë, por ka ndikuar mjaft fakti që veprat e tyre nuk u përfshinë në kanon e kësajsoj nuk u ruajtën dhe nuk u transmetuan deri më sot përmes një tradite të drejtpërdrejtë, direkte apo tradite indirekte.



gramatika, retorika, poezia, historia dhe filozofia.

Sot fjala *humanist* tregon në një kuptim të gjerë figurën intelektuale tipike të humanistit, kultivuesin e studimeve klasike, filologun klasik. I përdorur si mbiemër, termi *humanist* tregon atë çka i përket qytetërimit të humanizmit, p.sh fakultetet, shkencat humanitare.

Në fillim të shek. XIX, Friedrich Niethammer, në Gjermani, nisi të përhapë termin *humanizëm* për të treguar ato disiplina letrare dhe historiko-filozofike, që në atë kohë përfaqësonin edukimin filozofik, për të mbrojtur një edukim skolastik ai shpiku termin humanizëm.

Humanizmi është kultura e qytetërimit të Rilindjes, në realitet ekziston një përafërsi mes këtij termi dhe atij të Rilindjes, por humanizmi nënvizon në mënyrë të veçantë momentin ideologjik kulturor – d.m.th. vetëdijshmërinë që humanistët kishin për rolin e tyre.

Këtu nis të qartësohet edhe figura e personaliteti i Marin Barletit në mjedisin humanist të Venedikut, ku përmes shkrimeve të tij, nën veshjen priftërore, jo vetëm vepronte humanisti, por ishte ende i gjallë luftëtari që lartësonte luftërat për mbrojtjen e atdheut dhe në këtë pikëvështrim, studimi i veprës së tij në kontekstin humanist evropian shpaloset me të gjitha vlerat që mbart në vetvete.<sup>14</sup>

Tiparet e patriotizmit të tij u brendashkruhen atyre të një patriotizmi popullor, të ushqyer me ndjenjë fetare. Koncepti *pro patria mori*, si produkt i mendimit politik të Mesjetës, ishte funksional edhe gjatë Rilindjes europiane, kur atdheu vazhdonte të mbahej si një “*corpus mysticum*”: atdheu ishte dhuratë nga Zoti, së cilës askush nuk mund t’i shmangej duke e dëmtuar ose duke e fyer. Ishte pjesë përbërëse kjo e aparatit konceptual të humanizmit të krishterë.<sup>15</sup>

E. Çabej, në *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, në hyrjen e thukët të këtij teksti, shkruante: “*literatura shqipe është pjesë integrante e literaturave të Ballkanit, dhe qëndron në gjithë atë kohë në kufti të Perëndimit me Lindjen [...] Ajo është shprehja më e vërtetë e shpirtit shqiptar, shprehje estetike dhe shprehje etnike*”. Ky formulim dykrahësh, sipas L. Shamku-Shkrelit, që e konsideron produktin letrar të bashkësisë shqipfolëse si element që e bashkon dhe njëherazi e mëvetëson kulturën tonë ndaj simotrave të saj është tipar i qenësishëm i çdo edukimi kulturor progresist.<sup>16</sup>

Njohja e terminologjisë së kritikës së tekstit dhe e shtjellimeve filologjike, panorama e qartë mbi figurën e shkruarit, të shkrimtarit, të autorit që prej

14 Nadin L., Plasari A., “Barleti i Hershëm”, Onufri, 2022, fq. 21.

15 Po aty, fq. 26.

16 Shamku-Shkrelit L., “Edukimi letrar dhe vetëdija kombëtare”, në *Tej prologut, Shqipja dhe çështje të metodës*, Çabej, Tiranë, 2017, fq. 342.

antikitetit të hershëm, në mesjetë e deri në periudhën e humanizmit e të rilindjes janë në funksion të studimit dhe të njohjes së proceseve letrare, në funksion të mësimimit të letërsisë.

Sipas S. Hamitit, rëndësia e ligjërimit dhe e mësimimit të letërsisë në universitet nuk ka humbur kurrë dhe nuk do të humbasë, qoftë e provokuar rëndë me ndryshimin e mënyrës së komunikimit në modernitet. Kjo rëndësi provohet me vlerë kulturore të letërsisë si thesar dituror e estetik dhe me shpalosjen e kësaj vlere nga një brez te tjetri. Pra, kemi parasysh mësimin e letërsisë për të provuar e për të prodhuar një *dije* e jo për të zhvilluar një *doktrinë*. Rëndësia e studimit të letërsisë si art i fjalës e si njohje e botës është e madhe kudo, mirëpo studimet letrare në kulturën shqipe marrin peshë të veçantë, sepse në këtë kulturë, deri më sot letërsia ka qenë edhe bazë e njohjeve në disipinat historike e humanitare.<sup>17</sup>

Procesi i mësimdhënies dhe i mësimnxënies së letërsisë ka të bëjë edhe me rrethana që lidhen me dijen e shijen e dëgjuesit, me kulturën letrare e me njohuritë e tij mbi mendimin e ‘shpirtin’ mesjetar, në fund të fundit dhe me perceptimin e ndjeshmërinë e kohës e të brezave. Këtu mund të prodhohet moskuptimi apo variacione të moskuptimit, por është një përpjekje e vazhdueshme ku njohja letrare e mësimi i letërsisë kërkojnë t’i bashkohen kënaqësisë së ligjërimit.

## BIBLIOGRAFIA:

- ÇABEJ E., (1968): “*Meshari*” i *Gjon Buzukut* (1555), Botim kritik, Pjesa e dytë, Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, fq. IX/2.
- ÇABEJ E., (1968): “*Meshari*” i *Gjon Buzukut* (1555), Botim kritik, Pjesa e dytë, Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, fq. X.
- ÇABEJ E., (2005): “Buzuku dhe gjuha e tij”, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, Akademia e Shkencave, Tiranë 2005, fq. 27.
- CAVALLO G., (2002): *Dalla parte del libro*, Quattroventi, Urbino, fq. 224 - 225.
- HAMITI S., (2018): “Letërsia filobiblike”, në *Testamenti*, Prishtinë, fq. 341.
- HAMITI S., (2018): “Mësimi i letërsisë”, në *Testamenti*, Prishtinë, fq. 331.
- PACI E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, fq. 44.
- SHAMKU-SHKRELI L., (2017): “Konstitucjonet” e Pal Êjllit – të Kuvendit të Matit në vjetin 1462”, në *Tej prologut, Shqipja dhe çështje të metodës*, Çabej, Tiranë, fq. 287.
- SHUTERIQI DH., (1976): *Antologjia 7*; po ky “*Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*”.
- SHUTERIQI DH., (2006): “Moti i madh”, *Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479*, Dituria, Tiranë, fq. 19.

---

17 Hamiti S., “Mësimi i letërsisë”, në *Testamenti*, Prishtinë, 2018, fq. 331.

---

# RRETH VEPRËS SË ÁT JUSTIN RROTËS DHE TERMINOLOGJISË SË PËRDORUR

**Prof. Asoc. Dr. Elda Molla Resmja**

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: elda.resnja@unitir.edu

## PËRMBLEDHJE

Vepra me titull është shkruar gjatë mesit të shekullit XX dhe sot e kësaj dite mbetet një punim mjaft serioz mbi shqipen dhe sistemin e saj. Vepra e përbërë nga 6 pjesë ka sjellë pasqyrim të rrafshëve të ndryshme të gjuhës, që nga fonetika e deri të leksikologjia. Nuk mungojnë shënime të autorit për etimologjinë dhe albanologjinë. Fatkeqësisht autori nuk pati kohë t'i jepte një dorë të fundit veprës së tij, kështu që gjatë gjithë punimit vërehen luhatje të shumta, veçanërisht në terminologjinë të formave dhe kategorive gramatikore të përdorur nga autori, por që në këtë pikë redaksia nuk ka ndërhyrë duke i lënë ashtu si janë. Na mbetet neve të bëjmë disa vëzhgime në këtë fushë për të parë nga afër termat e përdorura nga autori dhe për të zbuluar arsyet pse ka ndodhur kjo dukuri. Ky libër mbetet një burim i rëndësishëm për historinë e studimeve gjuhësore duke zënë vend të veçantë në fushë të gramatologjisë shqiptare.

**Fjalët çelës:** etimologji, gjuhë e shkruar, fonetikë, morfologji, sintaksë

## ABOUT THE WORK OF FATHER JUSTIN ROTA AND THE LINGUISTIC TERMINOLOGY USED IN IT

### ABSTRACT

The book “*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*” is written during XX century and nowadays it remains a very special and valuable book about Albanian language and its system. This book is divided in 6 parts and brings reflection of different levels of language, phonetics, morphology, syntax and lexicology. The author gives his own original thoughts about etymology. Unfortunately he could not have the possibility to prepare the book for publishing. As a result in most cases many oscillations are observed, especially in terminology of grammatical forms and categories. The authors who have prepared the book for edition have not interfered leaving as they were. Our aim is to underline these cases, the reasons why the author has used them etc. This book remains a very important source in the history of linguistic studies, considered as very special one in Albanian grammarology.

**Keywords:** etymology, morphology, phonetics, syntax, written language

At Justin Rrota lindi në Shkodër, më 17 shkurt 1889. Në Austri kreu studimet e larta të, cilat e formuan si filolog me një pasion dhe vullnet për të njohur më shumë historinë e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Ky pasion do ta ndiqte dhe pasi u shugurua meshtar. Ai ka lënë trashëgimi studimesh në gjuhësi dhe letërsi. Është ndër botuesit e parë të teksteve për shkollat e mesme. Përmendim studimet: *Rreth gramatologjis shqype*, *Rreth problemit të lavrimit të gjuhës*, *Vrejtje mbas vrejtyesh*, *Analyzimi i rasavet t' emnit e zhvillimi historik i tynve* etj. Ndiheza e J. Rrotës vërehet dhe në fushë të studimit filologjik dhe gjuhësor të teksteve të vjetra të çdo lloji duke hedhur themelet e filologjisë shkencore shqiptare.

Eqrem Çabej do ta vlerësonte Rrotën për kontributin e tij që ka dhënë për afirmimin e librit te parë të shqipes Mesharit të Buzukut. Sipas autorit, Rrota “ka ndihmuar shumë ndër ne në përhapjen dhe në njohjen e këtij monumenti gjuhësor”.

Në shkrimin “Hulumtime dhe shënjime mbi Gjon Buzukun” (BSHSH e Tiranë, 1956, nr. 3) dhe ngre përsëri probleme të diskutueshme, dhe thekson idenë e shprehur 20 vjet më parë se hartuesi i Mesharit “ka qenë prift katolik shqiptar, një gegë autentik”. Për Justin Rrotën Gjon Buzuku qe një malësor i Krajës, lokalitet i perëndimit të liqenit të Shkodrës, duke hedhur kështu poshtë versionet e tjera për veprën dhe autorin e saj.

Në veprën *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore* si një nga librat më të plotë e të realizuar autori ka bërë një analizë të shumanshme filologjike, gjuhësore dhe historike duke kombinuar vështrimin historiko-filologjik me vështrimin e mirëfilltë gjuhësor.

Qëllimi i punimit tonë do të jetë vëzhgimi i veprës, e cila ruhej si dorëshkrim në institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Studiuesit mendojnë se kjo veprë e rëndësishme është shkruar gjatë viteve 50 të shekullit të kaluar. Përbëhet nga 6 pjesë:

- I. Burimi I Shqipes (Leksikologjia)
- II. Tingujt e Shqipes (Fonetika)
- III. Trajtat e Shqipes (Morfologjia)
- IV. Fjalia e Shqipes (Sintaksa)
- V. Të përbámt e Shqipes (Etimologjia)
- VI. Lavruesit e Shqipes (Albanologjia)

Fatkeqësisht, studiuesi nuk arriti të redaktonte këtë punim të vetin dhe personat që janë kujdesur që vepra të shohë dritën e botimit janë përpjekur siç janë shprehur “të paraqesin sa më besnikërisht mendimin e shprehjen gjuhësore të autorit”. Ata kanë ndërhyrë në ato raste kur nuk janë zbatuar parimet dhe rregullat që vetë ati ka

formular në një moment në vepër. Por redaktorët nuk kanë ndërhyrë për të njëzuar këtë luhatje në përcaktimet terminologjike të formave ose kategorive gramatikore. Do të jetë detyra jonë për t'i vënë në dukje këto luhatje e për të shpjeguar arsyet pse ka ndodhur. Gjithashtu redaksia nuk ka ndërhyrë në pikëpamjet e autorit për çështje e teza tashmë të hedhura poshtë nga studiuesit e shqipes. Megjithatë vepra merr rëndësi të veçantë në historinë e studimeve gjuhësore për kohën kur është shkruar.

Në *Parathanje* autori kërkon të përlligjë botimin e kësaj vepre si një ndihmesë për lëvrimin e shqipes e për të treguar siç shprehet ai vetë” Jemi orvat të tregojmë shpirtin, ngjyrën dhe natyrën e shqipes”.

Në pjesën e parë Të hymt, autori arrin të na japë një pasqyrim të teorive mbi klasifikimin e gjuhëve, teorive që kanë qarkulluar si dhe origjinën e indoevropianishtes. Kjo e fundit sipas Rrotës, është ajo familje e madhe gjuhësh, të cilat rrjedhin prej një trungut të vetëm dhe se Evropa qendrore e lindore mbahet si vend i banimit ase djepi i parë.

Studiuesi vijon të përmendë 13 degët më të rëndësishme: indishtja, iranishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, italikishtja, keltishtja, gjermanishtja, sllavishtja, baltishtja, trako-frigishtja, hetitistja e tokaristja.

Një syth të veçantë autori i kushton rrafshit leksikologjik ku në një fjalorth ai përmbledh një numër fjalësh që mbahen si trashëgimi indoevropiane. Po këtu sipas alfabetit rendit rreth 38 fjalë që përfaqësojnë elementin trako-ilirian.

Si njohës i mirë i gjuhëve klasike Rrota flet për ndikimin e greqishtes së vjetër dhe thekson se shqipja nuk ka marrë shumë fjalë. Autori përmend dhe disa toponime nga greqishtja

Ajasma – ujë i bekuem

Gjirokastra – këshjell i argjentë

Kalivçi – vend i mirë

Karavnja- mal i rrëfes

Kosturi – keshtjell

Saranda – Katërdhetë shenjtët

Më tej flet për ndikimin e latinishtes ku rreshton rreth 110 fjalë me burim nga latinishtja. Në toponimi përmendim:

Kurbini – corvinus vend korbash

Abripa – përtej bregut

Frashëri – fraxinus

Karburnara – carbunaria vendi ku digjet qymyri

Kashnjet – castanetum – vend i gështenjave

Valbona – vallis bona – luginë e mirë

Këlsyra – clausura – gryke e ngushtë malesh

Vend të rëndësishëm zë dhe elementi rumun dhe përmend faktin se ndikimi vërehet jo vetëm në leksik por dhe në fonetikë, morfologji e sintaksë. Me fjalë të renditura saktë e në mënyre shteruese sipas alfabetit janë dhënë dhe elementet nga sllavishtja, turqishtja, italishtja.

Me interes përmendim toponimet si Petrella – sham i vogël, Perlat – Imzot, Prel Autori nuk harron të përmendë dhe huazimet e vona dhe neologjizma dhe përbën pjesë të rëndësishme të këtij kapitulli. Sipas autorit të cilin po e citoj “ Për shqipen mjerisht shpallja e pavarësisë shenjon një fazë të re edhe ma të vullëshme huazimesh ndërkombëtare dhe sipas autorit duhen përdorur fjalët e shqipes dhe jo të huajat.

Neologjizmave apo formimi i fjalëve të reja është një dukuri që ka filluar që me shkrimtarë e parë. Përmend këtu krijesa të Buzukut fjalët *gjykatë, shërbesë, ndjekëtar etj.*

Një hapësirë të rëndësishme autori i ka kushtuar dhe dallimeve mes dy dialekteve kryesore të shqipes ku autori shprehet se *ndryshimet mjedis këtyne dy kryedialektevet nuk janë githaq ndë morfologji, sintaksë a fjaluer, sa ndë fonetikë.* Në fakt autori nëpërmjet shembujve na njeh me dallimet në rrafshin fonetik, atë morfosintaksor dhe me atë leksikor ku na jep përsëri një fjalorth të fjalëve ku autori rreshton “këtu disa fjalë që janë të njinjishme ndë vështrim, por të përdoruna me pakë ndryshime për kahë trajta”.

agjëroj- njinoj

arrij - mrrij

tutje- përtej

yll- hyll

Në pjesën e dytë të titulluar Tingujt e shqipes autori merr në shqyrtim

- Fragmentat lingvistikë ase dromcat e shqipes së shkrueme
- Auktorët e Vjetër
- Shkrimin e Arbëreshvet t' Italis
- Alfabetat e Shoqënivet Letrare: Stambolli, Bashkimi, dhe Agimi
- Albanologët
- Alfabetin e Monastirit

Studiuesi thekson faktin se shkrimtarët gegë ishin më të lëkundur në shkrimin e shqipes, ndërsa “ata të toskërishtes i ndejnë ortografisë së Kongresit të Stambollit , të prekunë diçka ma vonë nga S. Frashëri dhe këtë përdor në gjithnjë djeri në vendimin definitiv t Alfabetit të shqipes, në Kongresin e Monastirit (1908)”

Sipas Rrotës dokumenti i parë i shkrimit shqip ishte “Perikopeja e Ungjillit të Pashkës” dhe jo Meshari i Buzukut. Si njohës i mirë i shqipes dhe gjuhëve të tjera ati ka mbajtur gjithmonë qëndrime të veta e origjinale për shumë çështje. Tezë e hedhur poshtë nga studimet e mëvonshme. Vijon me fjalorthin e von Harfit (1497) dhe perikopenë e Ungjillit të Pashkës (shek. XV-XVI) dhe më gjatë flet për të gjithë autorët e vjetër, duke sjellë dhe pjesë nga tekstet origjinale

Pjesa e tretë Trajtat e shqipes ose morfologjia mbetet një pjesë e rëndësishme e këtij botimi ku autori dallon 10 pjesë ligjërata. Krahas emërtimeve që kanë pranuar e përdorin gramatikat e mëvonshme autori në kllapa shënon dhe termin latinisht. Përmendim substantivin, genus, dezinenca por nuk mungojnë dhe raste kur përdor mbaresë, pronomina për përemra, verb për foljen .

Në këtë pjesë autori na sjell listë sipas alfabetit apo fjalorth emrash personash dhe përbri jep dhe kuptimin dhe origjinën e emrit dhe i ndan në elementin mysliman dhe atij të krishterë apo kristian, siç e quan ai.

Te përemrat autori dallon dhe përemrin reciprok apo pronomen reiprocum *njëni-tjetri, njëra-tjetërs, shoqi- shoqit*. Te folja autori flet gjatë për trajtat emnore të verbit, sipas të cilit me anë të trajtës së pjesore s së shkuar, shqipja e sotme ndërton mënyrën e pakufijores sjellë në standarde me forma të pashtjelluara. Ai quan pakufijore paskajoren, dhe tregon lëkundje në përdorimin e termit, pasi po me këtë term nënkupton dhe format e pashtjelluara.

Autori quan *qetashja* për të *tashmen*, *aorist* për të *kryerën e thjeshtë*, *e tejkaluemja* për më se të *kryerën*, *e përtejkluesmja* për të *kryerën e tejshkuar*. Për

mënyrën e kushtores përdor *qyshkore*.

Pjesa IV, Sintaksa e gjuhës shqipe është pjesa më e rëndësishme e librit. Autori dallon degën e parë të sintaksë e cila studion fjalinë e thjeshtë. Më tej flet për kryegjymtyrët, gjymtyrët kryesore dhe ato të dytat si cilësori (atributi), ndajshtimi (apozicion) , kundrina (objekti) ndajfoljori (adverbjari). Ky term i fundit përkon me rrethanorët dhe llojet e tyre.

Dega e dytë e sintaksës, *Përmbi fjaline përbame*, Fjalitë e para (të pavarëshme) e fjalitë e dyta (të mvarëshme). Këtu autori flet për fjalitë e përbëra dhe llojet e ndryshme të fjalive të nënrenditura. Një hapësirë autori i kushton dhe bisedës së drejtë (oratio recta) dhe bisedës së zhdrejtë (oratio oblique). Flet për ndryshimet që pëson fjalia nga ligjëratë e drejtë në të zhdrejtë si dhe shenjat e pikësimit që duhen përdorur.

Pjesa V, *Të përbamt e fjalëvet (etimologjia)* visari i fjalevet të shqipes. Si i përban gjuha fjalët. Autori flet për dukuri t ëndryshme gjuhësore që çojnë në pasurim të gjuhës. Në mënyrë shteruese jep pasqyrë të parashtesave a prapashtesave. Kompetenca e tij gjuhësore e lejon të flasë dhe për origjinën e tyre nga gjuhët e tjera.

Pjesa VI *Albanlogjia Lavruesit e shqipes*. Një pjesë e rëndësishme e librit mbetet dhe kapitulli i fundit ku autori flet për studiuesit e gjuhës shqipe të kësaj gjuhe të çuditshme dhe kryekëput dalluese nga të folmet e popujve të Evropës. Autori flet me shumë kompetencë mbi studimet e albanologëve pasi njihte mirë gjuhët moderne dhe ato klasike. Duket qartë se ai i ka lexuar at punime dhe siç thotë dhe vetë “e gjykuem të arsyeshme t’u kushtojshim një kapitull albanologëve pasi gramatika jonë përmban një pjesë të rëndësishme - mbi brumin e shqipes- që asht fryt i mundit të tyne”

Mbasthanja *Nga historia e një vepre që nuk u botue kurr*, mbetet një burim i rëndësishëm për të hedhur dritë mbi jetën e thjeshtë të Atit dhe mundimeve për botimin e kësaj vepre me vlera. Kolec Cefa, bashkëpunëtor i atit, rrëfen se Rrota kishte besim se Instituti i Gjuhësisë i atyre viteve dhe prof. A. Kostallari do t’ia botonin, por për fat të keq vepra nuk njohu dritën e botimit.

Më vonë Pader Justini i shkroi. “Unë mendimin e gati 50 vjetëve e reklamoj dhe nuk due kurrsi që ky të bahet gjaja e askuj, res nullius që të jetë i lirë secili studiues t’i bëjë të vetat tue i botue mutatis mutandis ....dhe t’i botojë në emën t’vet”.

Pjesa e fundit përmban bibliografinë e shkrimeve të At Justin Rrotës, përgatitur nga Emil Lafe dhe Enver Hysa. Janë libra dhe artikuj të ndryshëm shkencorë të shkruar me aq vërtetësi shkencore nga Rrota, që nga viti 1913 e deri 1968.



At Justin Rrota ka lënë një trashëgimi të pasur studimesh e librash mbi gjuhën, duke mbetur kështu një nga personalitetet më të shquara të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare.

### **BIBLIOGRAFIA:**

(1965): *Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*, Tiranë.

(1988): *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.

(1995): *Gramatika e gjuhës shqipe I Morfologjia*, Tiranë.

(1997): *Gramatika e gjuhës shqipe II Sintaksa*, Tiranë.

BUZUKU GJ., (1968): *Meshari i I. II* Tiranë.

ÇABEJ E., (1976), (1977): *Studime gjuhësore III, IV, VI*, Prishtinë.

DEMIRAJ SH., (1986): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.

MYDERRIZI O., (1944): *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë.

RIZA S., (1966): *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Tiranë.

# LESIKU BIBLIK NË VEPRËN E DOSTOJEVSKIT “KRIM DHE NDËSHKIM”, VËSHTRUAR NË RRAFSHIN PËRQASËS RUSISHT-SHQIP

**Msc. (Phds) Elvira Xhamani**

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: elvira.xhamani@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Leksiku biblik në mendjen e lexuesit lidhet jo vetëm me Biblën, por edhe me të gjitha monumentet kulturore të krijuara në bazë të shkrimeve të shenjta. Biblizmat, të pranishëm në romanin e F.M. Dostojevskit “Krim dhe Ndëshkim”, u përkasin mjeteve shprehëse artistike të përdorura nga shkrimtari në funksione të ndryshme. Bibla ndikoi në formimin e pikëpamjeve fetare, filozofike dhe estetike të shkrimtarit. Shkrimi i shenjtë shërben si pikënisje në krijimtarinë e tij artistike. Nuk ka një përkufizim të veçantë të biblizmit, ndaj në këtë vepër do të kuptohen si citime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga Bibla, emra të vendeve biblike dhe emra të përveçëm, njësi frazeologjike biblike në formë të plotë ose të cunguar. Në një vepër artistike biblizmat kryejnë funksione stilistike, kompozicionale dhe pragmatike. Objekti i kumtesës është krahasimi i leksikut biblik në rusisht dhe shqip, dhe specifikat e përkthimit të tyre. Të njëjtat fjalë biblike në rusisht dhe shqip mund të kenë ngjyrimë të ndryshme stilistike. Biblizmi jo vetëm që duhet të lidhet specifikisht në tekstin e përkthimit, por edhe të mbajë një lidhje me tekstin e shkrimit të shenjtë gjatë përkthimit. Pra, leksiku biblik si element ndërtekstual duhet të ruhet në tekstin e përkthimit. Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm gjatë përkthimit të njësisve biblike si elemente ndërtekstuale është ruajtja e funksionit të këtyre njësisve në tekstin e përkthimit.

**Fjalët çelës:** leksiku biblik, F. M. Dostojevski “Krim e Ndëshkim”, përkthimi, funksioni i biblizmave

## THE BIBLICAL LEXICON IN DOSTOYEVSKY’S “CRIME AND PUNISHMENT” FROM THE RUSSIAN – ALBANIAN COMPARATIVE PERSPECTIVE

### ABSTRACT

The biblical lexicon in the mind of the reader is related not only to the Bible, but also to all the cultural monuments created on the basis of the scriptures. Bibliisms, present in the novel by F.M. Dostoevsky’s “Crime and Punishment” belong to the artistic means of expression used by the writer in various functions. The Bible influenced the formation of the religious, philosophical and aesthetic views of the writer. The holy scripture serves as a starting point in his artistic creativity. There is no special definition of biblicism, so in this work it will be understood as direct and indirect quotations from the Bible, names of biblical places and proper names, biblical phraseological units in full or truncated form. In a literary work, bibliisms perform stylistic, compositional and pragmatic functions. The object of the communication is the comparison of the biblical lexicon in Russian and Albanian, and the specifics of their translation. The same biblical words in Russian and

Albanian can have different stylistic shades. Biblicism must not only relate specifically to the text of the translation, but also maintain a connection with the text of scripture throughout the translation. So, the biblical lexicon as an intertextual element must be preserved in the translation text. Also, an important factor when translating biblical units as intertextual elements is to preserve the function of these units in the translated text.

**Keywords:** biblical lexicon, F. M. Dostojevski “Crime and Punishment”, translation, function of biblicisms

Bibla është në thelb të kulturës së shumë kombeve. Për shumë shekuj, ajo ka ndikuar në të gjitha format e artit: në pikturë, muzikë, skulpturë dhe, natyrisht, në letërsi. Shumë studiues në veprat e tyre përshkruajnë më hollësisht ndikimin e tekstit të shkrimeve të shenjta në gjuhën dhe kulturën e popujve të ndryshëm. Shkrimtari M. Zeqo e cilëson Biblën si një antologji e çuditshme e shumë librave të shkruara në kohë të ndryshme dhe se ndikimi i saj është tejet i madh për letërsinë e kombeve. Deri më sot nuk ka asnjë përkufizim të vetëm të një gjëje të tillë si biblizmi, përkundër faktit se në praktikë shumë studiues si (Kunin, Kornjejeva, Ivanova dhe shumë të tjerë) mendonin se këto janë komplete, citate dhe shprehje popullore me origjinë biblike. Duke folur për romanin “Krim dhe Ndëshkim”, kjo specifikë qëndron në rëndësinë e motiveve biblike brenda veprës.

Nuk ka dyshim se Bibla ndikoi në formimin e pikëpamjeve fetare-filozofike dhe estetike të F. M. Dostojevskit. Shkrimi i shenjtë bëhet pikënisja në punën e tij artistike. Ai i drejtohet shkrimit të shentë jo vetëm për shpëtimin e shpirtit, por edhe për qëllime të veçanta krijuese. Sipas studiuesit, V.S. Ljakhin, “ky komunikim me tekstin e shenjtë të lashtë presupozonte jo vetëm asimilimin e mësimave të tij morale, por edhe njohjen me atë fenomen të tregimit biblik, i cili karakterizohej nga një pamje e veçantë e botës dhe e njeriut”. V. Ljakhin shprehet se, “një studiues duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm, të mos modernizojë tekstin biblik”.

Por çfarë nënkuptohet me biblizëm në gjuhësinë moderne? Si rregull, njësitë biblike kuptohen si njësi frazeologjike, aforizma ose fraza kapëse nga Bibla. Sipas J.A. Gvozdarjev, “biblizmi është një shprehje e fiksuar në gjuhën ruse, e përbërë nga disa fjalë, të riprodhuara rregullisht, të përcaktuara semantikisht dhe leksikisht nga teksti biblik”.<sup>1</sup> Një përkufizim më i thjeshtë është dhënë nga O.S. Akhmanova: “Një fjalë ose shprehje biblike që ka hyrë në gjuhën e zakonshme”. Në këtë kuptim, përkufizimi i studiuesit E.M. Vjereshagin duket të jetë më specifik: “fjalë individuale, fraza të caktuara, shprehje të tëra dhe madje edhe fraza, që datojnë në origjinën e tyre në Bibël, të cilat ose janë huazuar ose i janë nënshtruar ndikimit semantik të teksteve biblike”.<sup>2</sup> Vjereshagin, si Akhmanova, është një përkrahës i

1 Гвоздарёв Ю.А., Библиизмы в русской фразеологии (к истории освоения) / Ю.А. Гвоздарёв // Эволюция лексико-фразеологического и грамматического строя русского языка: межвуз. сб. науч. работ. -Магнитогорск, 1994. С. 26.

2 Верещагин Е.М., Библийская стихия русского языка: сборник научных статей / 1993. №1. – С.97.

qëndrimin se konceptet e biblizmit dhe sllavizmit të kishës janë identike. Ndërsa studiuesi V. V. Kolesov është i mendimit se jo të gjithë biblizmat depërtuan në gjuhën ruse përmes sllavishtes kishtare, por “përmes literaturës mësimore të Rusisë së lashtë, përmes patristikës, veçanërisht përmes mësimëve kishtare dhe fjalëve”.<sup>3</sup>

Njësitë frazeologjike që lexuesi i lidh me tekstin biblik, sipas V. Gak, ndryshojnë në atë që, pavarësisht nga burimi, ato u zgjedhën dhe u futën në kulturën e popullit sipas rendit të tyre unik: “Në strukturën e përmbajtjes së frazeologjizmave biblike shihen qartë përbërësit moralë, didaktikë dhe etikë, të cilat, para së gjithash, lidhen me bazën fetare të vetë Biblës, besimet e saj, duke u nisur nga kundërshtimi i koncepteve të së mirës dhe së keqes.”<sup>4</sup>

Shpesh hasim vështirësi në gjetjen e leksikut biblik, duke qenë se në shumicën e rasteve biblizmat përdoren jo vetëm pa iu referuar burimit, por ndonjëherë në një formë të modifikuar qëllimisht (për të arritur disa nga qëllimet e autorit - për të krijuar një efekt të caktuar stilistik, - që përkthyesi duhet ta zbërthejë) - shpesh thuajse përtej njohjes. Zbulimi i etimologjisë së njërive frazeologjike nuk është gjithmonë një detyrë e lehtë, por është jashtëzakonisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për përkthimin. Ndaj përkthyesi duhet të marrë parasysh se si kultura marrëse mund ta perceptojë përkthimin.

Gjatë përkthimit të leksikut biblik si elemente ndërtekstuale nuk mund të fiksohen në mënyrë abstrakte ose të “përkruhen”, por përcaktohen në secilin rast specifik në varësi të situatës së përkthimit, që përbëhet nga qëllimi pragmatik i përkthimit, lloji i tekstit burimor dhe natyra e objektivi i synuar i përkthimit. Përkthimi biblik, si dhe çdo element ndërtekstual, është “pa dyshim një detyrë e vështirë, pasi kërkon që përkthyesi të studiojë shtresa të ndryshme tekstesh “bërthamore” të kulturave marrëse dhe të kulturave transmetuese, tekste të përbashkëta për disa kultura; dhe tekste specifike kombëtare”.<sup>5</sup>

Bibilizmat mund të konsiderohen si intertekste brenda semiosferës globale. Duke qenë se leksiku biblik është element universal ndërtekstual, ai mund të kryejë të njëjtin funksion në tekstin e origjinalit dhe të përkthimit, d.m.th., ai mund të përkthehet nga një element ndërtekstual. Të njëjtat shprehje biblike në rusisht dhe shqip mund të kenë ngjyrosje të ndryshme stilistike. Në letërsinë artistike, leksiku biblik përdoret për të pëmbushur funksion stilistik, kompozicional dhe pragmatik.

Bibilizmi nuk duhet të lidhet vetëm me një lloj të caktuar në tekstin e përkthimit,

---

3 Колесов В.В., Библизмы в «Слове» // Энциклопедия «Слова о полку Игореве»: в 5 т. – СПб., 1995. – Т. 1. – С. 110–111.

4 Гак В.Г., Особенности библейских фразеологизмов в русском языке (в сопоставлении с французскими библейскими фразеологизмами) /В.Г.Гак// Вопросы языкознания: сборник научных статей. - 1997. - №5. – С.55-65.

5 Кузьмина Н. А., Феномен художественного перевода в свете теории интертекста // Текст. Интертекст. М.: Азбуковник, 2001, С. 97-111.

por edhe të ruajë lidhjen e tij me tekstin e shkrimit të shenjtë në përkthim. Pra, në tekstin e përkthimit duhet ruajtur biblizmi si element ndërtekstual. Përveç kësaj, një faktor i rëndësishëm në përkthimin e fjalëve biblike si elemente ndërtekstuale është ruajtja e funksionit të këtyre njësive në tekstin e përkthimit.

Në veprën e Dostojevskit “Krim dhe ndëshkim”, biblizmat do të kuptohen si citime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga Bibla, toponime dhe emra të përveçëm biblikë, njësi frazeologjike biblike në formë të plotë ose të cinguar, çdo reminiscencë biblike. Pa përfshirë tekstin e Ungjillit, është e pamundur të kuptohet dhe vlerësohet vepra e shkrimtarit në të gjithë plotësinë, kompleksitetin dhe origjinalitetin e saj.

Në vetvete, Dostojevski ishte një njeri fetar dhe kjo shfaqet hapur në romanin të tij. Njësitë frazeologjike me origjinë biblike i gjejmë të përfshira në fjalimin e personazheve. Për shembull, personazhi kryesor Radion Raskolnikov, shpesh përdor fraza frazeologjike me origjinë biblike në fjalimin e tij, gjë që tregon erudicionin e tij, por ai zakonisht i shqipton ato në fjali me ngjyrimë ironike të tipit: *Этому тоже надо Лазаря неть, — думал он, бледнея и с постукивающим сердцем*<sup>6</sup>. *(Ky është ai që duhet të këndoje Llazarin) ose — А по-моему, так вы, со всеми вашими достоинствами, не стоите мизинца этой несчастной девушки, в которую вы камень бросаете.*<sup>7</sup>. *(për mendimin tim, ti, me gjithë virtytet e tua, nuk ia vlen as sa gishti i vogël i kësaj vajze fatkeqe, së cilës i hedh një gur).* Frazeologjizma “*hedh një gur*” iu tha Luzhinit, i cili akuzoi Sonja Marmeladovën për sjellje të pahijshme. Fillimisht, kjo njësi frazeologjike përdoret në Ungjill, një shprehje e tillë u shqiptua nga Jezusi kur iu soll para një mëkatare.

Në skenën kur Sonja i ofron Raskolnikovit kryqin e saj, Dostojevski luan me kuptimin e drejtpërdrejtë dhe figurativ, të fjalës “*крест*” (*kryq*), që lidhet me shprehjen biblike (*për të mbajtur kryqin*. “*Merre... merre!*” i lutet ajo), “*Ne do të shkojmë të vuajmë së bashku dhe së bashku do ta mbajmë kryqin!*...”. Kryqi është një simbol i besimit të krishterë, si dhe i vuajtjes që një person duron në jetën e tij. Frazeologjia për të mbajtur/pranuar kryqin e dikujt - të durosh me durim vuajtjet, fatkeqësitë, të durosh fatin e trishtuar, bazohet në legjendën biblike për Jezusin, i cili mbante kryqin, mbi të cilin më pas u kryqëzua: “Dhe ai, duke mbartur kryqin e tij, u nis drejt vendit që quhej “*Kafka*”, që në hebraisht quhet “*Golgota*”<sup>8</sup>

Ka një marrëdhënie të veçantë midis botës së Biblës dhe botës artistike të shkrimtarit, e cila shfaqet në nivelin e reflektimeve dhe lidhjeve. Romani përmban shumë referenca biblike. Kjo manifestohet dhe në nivelin e emrave të personazheve

6 Dostojevski. F. M., “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle, 2017, kap. 1, fq. 219, \*R-RASKOL.PDF

7 Dostojevski. F. M., “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle, 2017, kap. 1, fq. 146, \*R-RASKOL.PDF

8 Ungjilli i Gjonit, kap. 19, v. 16-17. <https://www.bible.com/sq/bible/7/JHN.19.16.ALBB>

të tij. Autori mendoi me kujdes emrat dhe mbiemrat e personazheve të romanit.

Mbiemri i personazhit kryesor *Raskolnikov*: Mendohet se vjen nga *roskol*, në shqip (*skizma*), skízm/ë,-a -a(t) përcarje brenda një kisha a një organizate politike për shkak të mosmarrëveshjeve të thella e parimore. “Besimtarët e Vjetër”, ishte një rrymë që u krijua në mesin e shekullit XVII në kishën ruse si një protestë kundër risive të Patriarkut Nikon (1605-1681), që përkonte në korigjimin e librave të kishës dhe disa zakoneve të saj. Në periudhën e shkrimit të romanit, tema e “Besimtarëve të Vjetër” dhe përcarja e kishës ruse zinin një vend të spikatur në shtypin rus. Ndaj mund të themi se nuk është rastësi që krimin e Raskolnikovit në roman e merr përsipër një nga “raskolnikovët”, nga “skizmatikët”.

Emri *Rodion*, mendohet se mund të rrjedhë nga rusishtja (*родина*), në shqip (atdhe), duke përfaqësuar tokën që e lindi. “*Raskolnikov*” (ndarje), “*Rodion*” (atdhe), pra “ndan atdheun e tij”, dhe nëse marrim parasysh atësinë “*Romanoviç*”, dhe kuptimin ideologjik të vetë imazhit, atëherë do të ishte i mundur një interpretim i drejtpërdrejtë: *Rodion Romanoviç Raskolnikov*, (Ndarja e atdheut të Romanovëve).

Një vend i veçantë në romanet e Dostojevskit u takon grave “të buta” të quajtura Sofia.

**Sonja Marmeladova** – Sonja është një shkurtim tipik rus, i emrit Sofia. Të gjitha Sofiat në romanet e tij mbajnë me përlulësi kryqin që u ka sjellë fati, por besojnë në fitoren përfundimtare të së mirës. Autori pohon se “shturja e vërtetë nuk ka depërtuar ende asnjë pikë në zemrën e saj” “*Ее сердце доброе и простодушное*”, (Zemra e saj është e mirë dhe e butë). Mund të themi që nuk është rastësi që emri i zgjedhur nga shkrimtari, *Sofia* është urtësia e Zotit, ideja e shenjtërisë femërore. Shpesh Nëna e Zotit identifikohet me Hagia Sofia. E reja Sonja Marmeladova, quhet “*мать*”, (nënë) nga të dënuarit. Raskolnikovi, i goditur nga vetëflijimi i Sonjës dhe vuajtjet që ajo duroi, iu përkul dhe i tha: “*Я не тебе поклонился, я всему страданию человеческому поклонился*”, (Unë nuk u përkula para teje, u përkula para të gjitha vuajtjeve njerëzore). Sonja, sipas M. M. Bakhtin, është një njeri i ideve. Imazhi i saj kombinohet me atë të një ideje të plotë<sup>9</sup>.

Gjithashtu, interesant është fakti se prostituta në roman mban emrin e martires së shenjtë **Duklida** (ajo ishte e angazhuar në varrimin e të krishterëve të vvarë, për të cilën ajo u vra me gurë në shekullin IV). Emri i saj ka një kuptim të thellë simbolik: çdo mëkatar mund të bëhet shenjtor, si Maria Magdalena, si Sonja Marmelladova.

**Lizaveta**, motra e Sonjës. Në listën alfabetike të shenjtorëve të kalendarit të Kishës Ortodokse, *Elizabeta*, ka kuptimin adhurim ndaj Zotit. Ajo është aq e qetë, e butë dhe pajtohet me gjithçka. Duke theksuar pastërtinë shpirtërore të Lizavetës, Sonja citon Ungjillin e Mateut “Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta

9 Бахтин М. М., Проблемы поэтики Достоевского – М.: Художественная литература, 1972. – 464с.

shohin Zotin”<sup>10</sup>.

Madje dhe shërbëtorja e zotërisë **Nastasja** e mban këtë emër jo rastësisht: Anastasia do të thotë “ringjallje” nga greqishtja. Nastasja, si Pulheria Aleksandrovna, është një simbol i tokës mëmë. Megjithëse Raskolnikovi zemëron tokën mëmë që e lindi, ajo, në personin e Nastjas, ende kujdeset për të, beson “në të dielën” e tij. Në këtë kujdes dhe në këtë besim është garancia e ringjalljes së Raskolnikovit.

Fakti që Dostojevski e dinte dhe e lexonte mirë Ungjillin, dëshmohej edhe nga përdorimi i citimeve të shumta. Për më tepër, ai përdor jo vetëm shprehje të njohura, por edhe ato pak të njohura. Në romanin “Krim dhe Ndëshkim” mund të gjejmë sllavizma kishtare si *старец* (plaku), *священник* (prift), *Житие, Жития святых* (jeta, biografia e shenjtorëve), *инок* (murgu), *дьявол* (djalli) e shumë të tjera. Një grup i veçantë përbëhet nga leksiku i teksteve biblike: *рай* (parajsa), *ад* (ferri), *алтарь* (altari), *ангел* (engjëlli), *содом*, kuptimi i së cilës ekziston dhe në leksikun e shqipes *sodom*-kalk, kuptimi i parë në shqip është: I rrafshoj shtëpinë, i shkul nga rrënjët pemët përreth dhe i shkatërroj çdo gjë tjetër një vrasësi, i cili arratiset nga fshati për të shpëtuar prej ndëshkimit (sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit), dhe i dyti kuptimi figurativ: Shkatërroj me kulm e themel; nuk lë gur mbi gur, e shfaros).

Një përdorim të gjerë do të gjejmë në roman dhe përdorimi i citateve nga Bibla: “*Все тайное становится явным*”<sup>11</sup>, “*Gjithçka e fshehtë bëhet e qartë*” - një shprehje që gjendet në Ungjillin e Markut: “Sepse nuk ka asgjë të fshehtë që të mos zbulohet, as kurrëgjë sekrete që të mos dalë në dritë”.<sup>12</sup>

Shprehja “*неть Лазаря*” (të këndosh Lllazarin), lindi nga Ungjilli, nga shëmbëlltyra e Lllazarit të varfër, i cili shtrihej te porta e të pasurit dhe do të ishte i lumtur të ngopej edhe nga thërrimet që binin nga tryeza e tij. Në kohët e vjetra, lypsat e gjymtuar, duke lypur lëmoshë, shpesh këndonin “vargun për Lllazarin e varfër”, të krijuar në komplotin e shëmbëlltyrës së ungjillit. Përdoret në kuptimin e ankimit për fatin, të qarit, të shtirjes si të pakënaqur, të varfër.

“*Се человек!*”<sup>13</sup> (Ja njeriu!) - fjalët e Pont Pilatit për Jezu Krishtin: Jezusi, pra, doli, duke mbajtur kurorën prej gjembash dhe mantelin e purpurt. dhe Pilati u tha atyre: “Ja njeriu!”<sup>14</sup>

“*Ищите у обряцете*”<sup>15</sup>, d.m.th. “*kërkoni dhe do të gjeni*” – një citim nga

10 Ungjilli i Mateut, kap. 5, v. 8, <https://www.bible.com/sq/bible/7/MAT.5.8.ALBB>

11 Dostojevski F. M., “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle, 2017, kap. 1, fq.17, \*R-RASKOL.PDF.

12 Ungjilli i Markut, kap. 4, v. 22, <https://www.bible.com/sq/bible/7/MRK.4.22.ALBB>

13 Dostojevski. F. M., “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle, 2017, kap. 1, fq.361, \*R-RASKOL.PDF.

14 Ungjill i Gjonit, kap. 19, v. 5, <https://www.bible.com/sq/bible/7/JHN.19.5.ALBB>

15 Dostojevski. F. M., “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle, 2017, kap. 1, fq.541, \*R-RASKOL.PDF.

Predikimi në Malin e Jezu Krishtit.

*“дети — образ Христов: «Сих есть царствие божие»”, (fëmijët janë shëmbëlltyra e Krishtit: “Për ta është Mbretëria e Zotit”).*

Disa nga mënyrat e transmetimit në gjuhën shqipe të leksikut biblik të gjendur në romanin e përkthyer nga Dhimitër Cico dhe Jorgji Dhoksani janë:

- Përkthimi biblik me korrespondencë tradicionale ose ekuivalente. Këtë mënyrë përkthimi e shohim kur transmetojmë fjalë biblike, të cilat vetëm në mënyrë indirekte lidhen me Biblën dhe kanë një shkallë jashtëzakonisht të ulët intertekstualiteti: *“Есть на тебе крест? - вдруг неожиданно спросила она, точно вдруг вспомнила”* (A ke kryq mbi vete? - pyeti papritur ajo, sikur papritur iu kujtua) - fjala “крест” (kryq) në mendjen e lexuesit ka hyrë në përdorim dhe nuk njihet si element biblik. Raste të tilla janë shumë të zakonshme, ndonjëherë edhe në rastin e fjalëve të tilla të dukshme biblike si fjala “Бог” (Zot), e cila shfaqet në tekstin e romanit rreth 200 herë, por nuk paraqet interes nga pikëpamja e përkthimit, sepse ka hyrë në shtresën e fjalorit të zakonshëm dhe përkthehet lehtësisht duke përdorur një fjalor konvencional. Në të njëjtën mënyrë janë përkthyer dhe shprehje të tilla biblike si *“Ноев ковчег”* (Varka e Noes), *“возйти на Голгофу”* (me u ngjit në Golgota). Ky lloj përkthimi përdoret edhe për fraza frazeologjike me origjinë biblike që janë fiksuar në fjalorin e zakonshëm. Kështu, përkthyesi Jorgji Dhoksani<sup>16</sup> zgjodhi ekuivalentin e plotë të frazave biblike *“бросать камень”* (vërvit gurin), *“Вода камень точит”* (Uji e laton gurin), duke ruajtur stilin dhe përbërësin ndërtekstual. Në versionin rus, ky motiv ndodh vazhdimisht dhe në Dhiatën e Vjetër tingëllon “Uji fshin gurët; derdhja e tij fshin pluhurin e tokës; kështu ti shkatërron shpresën e njeriut”.<sup>17</sup>

- Me mungesë të biblizmave në përkthim. Në ato raste kur një ose një tjetër biblizëm është asimiluar brenda një kulture, por është refuzuar nga një tjetër, përkthyesi mundet, në mungesë të një opsioni tjetër, të lërë jashtë përbërësin ndërtekstual, por më pas duhet ruajtur funksioni estetik. Për shembull: *“Параиша опять выступила на сцену, да и не она одна, — одним словом, начался содом”*. Është sjell në shqip nga Theodhor Cico<sup>18</sup> si: *Doli përsëri në skenë Parasha, dhe jo vetëm ajo, me një fjalë filloi një rrëmujë e vërtetë.*, dhe nga Jorgji Dhoksani: *Doli përsëri në skenë Parasha, u bë një katrahurë e vërtetë. Это камень преткновения для всех вам подобных, а пуще всего — поднимают на зубок, прежде чем узнают, в чем дело!, Është pikërisht një pengesë për të gjithë ata si ju, dhe për më tepër fillojnë të tallen përpara se ta mësojnë për çfarë bëhet fjalë.*

16 Doksani J., Krim dhe ndëshkim : roman ;Fjodor Dostojevski; Botimi 2 ;Uegen, Tiranë, 2000.

17 Ungjilli i Jobit, kap. 14, v. 19, <https://www.bible.com/af/bible/7/JOB.14.19.ALBB>

18 Cico Th., Krim dhe ndëshkim : roman ;Fjodor Dostojevski; Fan Noli, Tiranë, 2010.



## Përfundime

Kërkesat për një transmetim ideal të biblizmit janë të shumta, por në praktikë të dy përkthyesit duhej të linin mënjatë disa funksione për shkak të pamundësisë për të krijuar një ekuivalent të plotë. Bibla është një tekst precedent dhe për këtë arsye duhet të ngjallë asociacione të ngjashme midis përfaqësuesve të kulturave të ndryshme, ndaj përkthyesi duhet t'i ruajë ato dhe në veprën e tij.

## BIBLIOGRAFIA:

CICO TH., (2010): Krim dhe Ndëshkim: roman; Fjodor Dostojevski; Fan Noli, Tiranë.

DOKSANI J., (2000): Krim dhe Ndëshkim: roman; Fjodor Dostojevski; Uegen, Tiranë.

DOSTOJEVSKI F. M., (2017): “Krim dhe Ndëshkim”, ISBN 9984-9395-5-3 Ditari VECORDIA © Valdis Egle.

UNGJILLI, <https://www.bible.com/sq/bible/7/JHN.19.16.ALBB>

БАХТИН М. М., (1972): Проблемы поэтики Достоевского – М.: Художественная литература.

ВЕРЕЩАГИН Е.М., (1993): Библейская стихия русского языка: сборник научных статей.

ГАК В.Г., (1997): Особенности библейских фразеологизмов в русском языке (в сопоставлении с французскими библейскими фразеологизмами) /В.Г.Гак// Вопросы языкознания: сборник научных статей. - №5.

ГВОЗДАРЁВ Ю.А., (1994): Библизмы в русской фразеологии (к истории освоения) / Ю.А. Гвоздарёв // Эволюция лексико-фразеологического и грамматического строя русского языка: межвуз. сб. науч. работ. -Магнитогорск.

КУЗЬМИНА Н. А., (2001); Феномен художественного перевода в свете теории интертекста // Текст. Интертекст. М.: Азбуковник.

# HUAZIMET NË GJUHËN SHQIPE DHE ROLI I TYRE NË KOMUNIKIM

**Dr. Ela Vasi**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E –mal: ela.vasi@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Dukuria e huazimeve në shqip ka qenë dhe mbetet objekt i rëndësishëm studimi për shumë studiues të gjuhësisë, por çfarë janë huazimet dhe kur hynë ato në gjuhën tonë kombëtare? Huazimet janë fjalë të huaja që kanë hyrë jo vetëm në komunikimin e përditshëm por edhe në terminologjinë juridike, administrative, teknologjike etj. Nuk duhet të mohojmë faktin se huazimet kanë anë e tyre pozitive pasi shumë fjalë të huaja tashmë i gjejmë në fjalorët tanë. Këto fjalë na ndihmojnë në pasurimin e gjuhës sonë kombëtare. Gjithashtu anglicizma dhe italianizma të shumtë hasim për të përcaktuar terminologji në fusha të ndryshme të jetës si në mjekësi, informatikë, mekanikë por edhe në përdorimin e një leksiku teknik i cili lidhet me produktet, shërbimet apo edhe vetë web-in. Për fat të keq në gjuhën shqipe huazimet nuk kanë hyrë të kontrolluara por hyrja e tyre e vrullshme dhe e pakontrolluar arriti të krijojë deri një lloj institucionalizimi, nëse do të mund ta quajmë të tillë, të ndikimeve të huaja i kryer nëpërmjet miratimit të emërtesave të veprimtarive publike a shtetërore, tregtare dhe ekonomiko-financiare. Bëhet fjalën për ato lloj veprimtarish të cilat mund të emërtohen nga fjalët e gjuhës shqipe. Nuk janë të pakta rastet kur përdorimi i huazimeve bëhet shkak për probleme në komunikimin e përditshëm, pasi mesazhi që përcjell folësi nuk shkon plotësisht i qartë tek të gjithë dëgjuesit dhe gjithashtu, nuk mungojnë as rastet kur huazimet luajnë rol kyç në zgjerimin dhe pasurimin e gjuhës sonë kombëtare. Shqyrtimi i këtyre rasteve do të na qartësojnë më shumë përdorimin e saktë dhe pozicionin e tyre në komunikim, në mënyrë që të ruajmë dhe pasurojmë gjuhën tonë.

**Fjalët çelës:** Huazime, komunikim, terminologji, gjuhë, mesazh

## LOANS IN THE ALBANIAN LANGUAGE AND THEIR ROLE IN COMMUNICATION

### ABSTRACT

The phenomenon of loan words in Albanian has been and remains an important object of study for many linguistic researchers, but what are loan words and when did they enter our national language? Loan words are foreign words that have entered not only in everyday communication but also in different linguistic fields as legal, administrative, technological terminology, etc. We should not deny the fact that borrowings have their positive sides as we already find many foreign words in our dictionaries. These words help us enrich our national language. We also encounter many Anglicisms and Italianisms to define terminology in different areas of life such as medicine, informatics, mechanics, but also in the use of a technical lexicon related to products, services or even the web itself. Unfortunately, borrowings have not entered the Albanian language in a controlled manner, but their rapid and uncontrolled entry managed to create a kind of institutionalization, if we can call it such, of foreign influences carried out through the adoption of the names of public or

state, commercial and economic-financial activities. We are talking about those types of activities that can be named by the words of the Albanian language. There are a few cases when the use of loan words causes problems in daily communication, since the message conveyed by the speaker is not completely clear to all listeners, and there are also cases when loan words play a key role in expanding and enriching our national language. Examining these cases will clarify their correct use and position in communication, in order to preserve and enrich our language.

**Keywords: Loan words, communication, terminology, language, message.**

Dukuria e huazimeve në gjuhën shqipe ka qenë dhe mbetet objekt i rëndësishëm studimi për shumë studiues të gjuhësisë. Huazimet janë fjalët me burim të huaj të cilat janë përvetësuar nga gjuha shqipe dhe janë bërë pjesë e këtij leksiku. Në kushtet e ndryshimeve të përgjithshme gjuha shqipe u kap befasisht nga trysnia e madhe e ndikimeve nga gjuhë të tjera. Ndryshimet e gjithanshme në shoqërinë shqiptare kanë sjellë futjen në ligjërimin shqip të fjalëve dhe strukturave gramatikore të gjuhëve të huaja. Këto fjalë dhe struktura kanë qenë të dobishme në rastet kur kanë pasuruar më tej ligjërimin e gjuhës shqipe, por gjithashtu nuk mungojnë as rastet kur ato kanë shkaktuar pështjellim e janë futur në ligjërim në kundërshtim me kriteret dhe standardet gjuhësore. Një situatë të tillë na ndihmon të kuptojmë se si hyrja e pakontrolluar e fjalëve dhe përdorimi i strukturave të gjuhëve të tjera në shqip ka shkaktuar një gjendje pasigurie në lidhje me qëndrimin që duhet mbajtur ndaj tyre.

Huazimet më të hershme të cilat janë të certifikuar në gjuhën shqipe vijnë nga Dorishtja<sup>1</sup>, por ishte pikërisht latinishtja që solli një ndikim shumë të fortë në gjuhën shqipe.

Profesor Eqerem Çabej ndër shumë studime mbi gjuhën shqipe na sjell edhe një tjetër studim mbi elementët arkaikë të gjuhës latine në shqip duke përcaktuar 4 rregulla të cilat tregojnë lidhjet e disa fjalëve të gjuhës shqipe me prejardhjen e tyre latine.<sup>2</sup>

1. Latinisht diftongu / au / bëhet në gjuhën shqipe /a/ në huazimet më të hershme: *aurum* → *ar*; *gaudium* → *gaz*; *lauri* → *lar*. Latinisht / au / është ruajtur në huazimet e mëvonshme.

2. Latinisht / ō / bëhet në gjuhën shqipe /e/ në huazimet më të vjetra latine: *pōmum* → *pemë*; *hōra* → *herë*.

1 Huld Martin E., "Shtrirja e theksuar e fjalëve të huaja greke në gjuhën shqipe", 1986.

2 Çabej E., "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe: fonetika historike e shqipes, vol.2., Shtypur nga dega e botimeve të Universitetit, 1962.

3. Shprehjet e brendshme dhe fillestare të pazgjidhura latine humbasin në shqip: *cubitus* → *kub*; *medicus* → *mjek*; *paludem* > V. latine *padule* → *pyll*. Një ndryshim analog ka ndodhur nga proto-indo-evropiane në shqip dhe në të kundërt, në huazimet e mëvonshme latine, ku ruhet rrokje e brendshme: *paganus* → *pagan*; *plaga* → *plagë* etj.

4. Grupi i bashtingëlloreve në gjuhën latine / tj /, / dj /, / kj / kthehet qellzore për bashtingëlloret shqip / s /, / z /, / c /: *vitius* → *ves*; *ratio* → *arsye*; *radius* → *rreze*; *facies* → *faje*; *socius* → *shoq* etj. Nga ana tjetër, bashtingëllorja e latinishtes /s/ u ndryshua në /ʃ/ në shqip.

Një tjetër periudhë e cila karakterizohet nga prurjet e huazimeve daton në shekullin VII-IX, ku shohim edhe hyrjet e para nga gjuhët sllave. Duke nisur nga shekulli i IX-të me dyndjet e sllavëve jugorë, por edhe falë kontaktit të zgjatur me pro-rumunët apo vllehtë. Gjatë kësaj periudhe studiuesit kanë vënë re një qasje të shkëmbimeve të njëanshme leksikore nga shqipja në rumanisht. Një shkëmbim i tillë tregon qartazi edhe lëvizjet migratore të rumunëve nga një zonë me shumicë sllave në një zonë me shumicë shqiptare, më saktë drejt Dardanisë ku vllehtë u regjistruan për herë të parë në shekullin e X-të.<sup>3</sup> Ky fenomen lidhet edhe me zgjerimin e Perandorisë Bullgare gjatë asaj periudhe drejt Shqipërisë.

Një tjetër periudhë mjaft e pasur me huazime nis nga vitet 90-të e më tej, ku një mori fjalësh u futën në gjuhën shqipe nga gjuhët e vendeve perëndimore. Gjithashtu nuk janë të rralla rastet kur në bisedat mes miqsh e të njohurish kemi dëgjuar fjalë përsëritëse si: *ciao*, *hello*, *hi*, *Ola* etj të cilat i dëgjojmë ende sot të përdoren në mënyrë të rëndomtë, por përdorimi i tyre na kthen në mendje vjershën e thurur nga Filip Shiroka “Si po prishet gjuha shqype?”<sup>4</sup> e cila me mjeshtëri na paraqet modën e shëmtuar të zëvendësimit të fjalëve të gjuhës tonë me fjalë të gjuhëve të tjera. Vjersha tregon, se si një i ri kthehet në atdhe nga Italia ku ka përfunduar studimet dhe duket se për 5-6 vjet ka harruar gjuhën e tij.

Që në fillim autori nis me Asteizmin:

Gjyshërit tanë, eh, paçin dritë

njerëz kokëtrashë, kurrë s’kanë dijtë...

Ata të mjerët s’kanë dijtë atëhera

---

3 Curtis, Matthew Cowan. “Slavic-Albanian Language Contact, Convergence, and Coexistence”. (“Kontakti i gjuhës sllavo-shqipe, konvergenca dhe bashkëjetesa”). ProQuest LLC.

4 Shiroka F., “Si po prishet gjuha shqype?”. Revista Letrare 30.03.2020.

as “buongiorno” as “kalispera”

Më tej autori me ironi thekson fuqishëm paradoksin shumëgjuhësor. Ku njohuria e disa gjuhëve edhe pse konsiderohet si një pasuri e çmuar do të na jepte tjetër rezultat nëse gjuhët do të kryqëzohen në mënyrë abuzive dhe të pakontrolluar. Kështu autori vazhdon me vargjet:

“Kur flet shqip, asht çud me e ndi, gjysë për gjysë tue e përzi me fjalë të gjuhëve të hueja”,

Filip Shiroka e përfundon këtë vjershë me një mesazh të fortë dhe tepër aktual:

“E kshtu gjuha po shëmtohet, Dhe kshtu kombi po mjerohet.”

Pra mesazhi që përcillet nëpërmjet këtyre fjalëve është i fortë pasi tregon qartazi se rrënjët e një kombi janë të gërshetuara fuqimisht me gjuhën, historinë dhe kulturën e tij. Gjithashtu e quaj me vend të sjell përsëri fjalët e Profesor Eqerem Çabej-it kur thekson se:

“Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij”<sup>5</sup>

Përdorimi i huazimeve pa kriter dhe zëvendësimi i fjalëve të gjuhës amtare me terminologji të huaja i bën ato të dëmshme e madje edhe parazite, por gjuha duhet të zhvillohet e të pasurohet sepse pasurimi i gjuhës është tregues i zhvillimit të gjithanshëm të një vendi. Në fushën e komunikimit atë ekonomike, politike, letrare, kulturore etj, gjithmonë ka lindur e do të vazhdojë të lindë nevoja për përdorimin e krijimin e terminologjive të reja. Në mjaft raste përdorimi i terminologjive specifike na ka detyruar të përdorim fjalë të huaja, një dukuri kjo kryesisht pozitive pasi e pasuron gjuhën amtare, por përkrahë këtij ndikimi nuk mungojnë rastet e shkatërrimit dhe varfërimit të gjuhës, ku përdorimi i pakontrolluar i huazimeve ka zëvendësuar apo ka zhdukur tërësisht shumë fjalë të gjuhës shqipe. Gjuhëtari i njohur Italian Tullio De Mauro shprehet se: Shkatërrimi i gjuhës është premisë për çdo shkatërrim tjetër<sup>6</sup>.

Prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe të rezervuar kur bëhet fjalë për huazimet dhe mënyrën se si ato përdoren, pasi në vendin tonë hyrja e vrullshme e tyre arriti të krijojë deri një lloj institucionalizimi, nëse do të mund ta quajmë të tillë, të ndikimeve të huaja i kryer nëpërmjet miratimit të emërtesave të

5 <https://www.facebook.com/GjuhaShqipePaGabimeFaqjaZyrtare/posts/th%C3%ABnie-p%C3%ABr-gjuh%C3%ABn-shqipe-dhe-gjuh%C3%ABn-n%C3%AB-p%C3%ABrgjith%C3%ABsi-gjuha-%C3%ABsht%C3%AB-tep%C3%ABr-e-r%C3%ABnd%C3%ABsish/136819493682477/>

6 <https://www.teksteshqip.com/letersi/thenie-per-gjuhen-shqipe.php>

veprimtarive publike a shtetërore, tregtare dhe ekonomiko-financiare. Bëhet fjalën për ato lloj veprimtarish të cilat mund të emërtohen nga fjalët e gjuhës shqipe. Kështu aktivitete si Lift Steak & Rooftop bar, Albanian Screen , Top Select, `Ora News, `EnBiXhi Benk`Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, King House Restourant, Mon Cafe, Proper Pizza, Tony's American Restourant & Coffee etj mund të zëvendësohen me emërtime në gjuhën shqipe. Përfytyroni sa e vështirë do të ishte për një qytetar të thjeshtë të kuptojë thelbin e këtyre emërtimeve. Ai padyshim do kërkonte një përkthyes të zotin për t'i shpjeguar kuptimin e tyre por nuk duhet të anashkalohet edhe vështirësitë që ai do të haste në shqiptimin e tyre.

Pra shohim qartë se në ligjërim vërehen shkelje të pafalshme të normës gjuhësore jo vetëm në rrafshin leksikor, por dukshëm dhe në atë fonologjik e morfosintaksor, të shumta janë edhe rastet kur nuk mungojnë shkelje të tilla si: përsëritja e pareshtur e përemrit vetor në të njëjtën fjali, e emrit të vetë folësit gjatë bisedës, shformime të mbaresës të mjaft formave të kohëve të shkuara të shumë foljeve duke i përzier ato me format kryesisht dialektore, pasaktësi në përdorimin e kohëve të foljes, teprim në përdorimin e fjalëve të ndërkallura sipas modelit të gjuhëve të tjera, pasaktësi në përdorimin e parafjalëve, parregullsi e plotë në periudhat me bashkërenditje e nënrenditje e kështu me radhë.

Nuk mungojnë as rastet kur të bie në sy fjalori i rëndomtë gjerësisht i përdorur me më shumë ngarkesa duke pasqyruar prishjen e normave etike të të shprehurit dhe të komunikimit. Gjithashtu në disa raste përdorimi i huazimeve është aq i shpeshtë sa fjalët e gjuhës shqipe duket se janë anashkaluar tërësisht. Të tilla janë fjalët si: akomodoj- rehatoj; adapt-i përshtatshëm; afirmoj-pohoj; abuzoj- keqpërdor; aksent- theks; asistencë- ndihmë; aplikant- kandidat; brutal-i egër, i vazhde; bazik-thelbësor, kryesor; dedikoj- kushtoj; disponoj- kam, zotëroj; diferencë-dallim, ndryshim; demolin- shkatërrim; egzagjeroj- teproj; ekzakt- i përpiktë; interferoj- ndërhyj; insistoj- këmbëngul; konfrontim- përballje, ballafaqim; lidërshp-udhëheqës; licencë-leje; prezent- i pranishëm; permanent- i përhershëm; kurioz-kureshhtar etj

Pra shohim qartë se nuk janë të pakta rastet kur përdorimi i huazimeve bëhet shkak për probleme në komunikimin e përditshëm, pasi mesazhi që përcjell folësi nuk shkon plotësisht i qartë tek të gjithë dëgjuesit shqipfolës por gjithashtu, nuk mungojnë as rastet kur huazimet luajnë rol kyç në zgjerimin dhe pasurimin e gjuhës sonë kombëtare. Shqyrtimi i këtyre rasteve do të na qartësojnë më shumë përdorimin e saktë dhe pozicionin e tyre në komunikim, në mënyrë që të ruajmë dhe pasurojmë gjuhën tonë. Terminologji të shumta janë futur në gjuhën shqipe nga fushat e mjekësisë, juridikut, informatikës, mekanikes etj. Kështu për shembull,

vetëm në fushën e mekanikës hasim fjalë të cilat kanë prejardhjen nga italishtja, ato janë futur në gjuhën standarde për të emërtuar pjesët e makinës. Fjalë të tilla si: *testato, valvola, kutia e diferencialit, kuzhinata, sinkronizatorët, ingranazhet, cilindri, radiator, elektroventilatori, guarnicioni, kambio, piston, sotokarteri, spinoti, disku etj* janë raste të huazimeve që e pasurojnë gjuhën, por fatkeqësisht duhet theksuar se jo të gjitha prurjet e fjalëve të huaja që kanë hyrë në gjuhën shqipe janë të tilla .

Në situatën që është krijuar sot në gjuhën shqipe lipset të mbahet një qëndrim i ekuilibruar në lidhje me huazimet gjuhësore si në rastin e atyre fjalëve dhe strukturave të cilat kanë zhvendosur padrejtësisht format e shqipes ashtu edhe ndaj rasteve, të cilat mund të pranohen si pasurim për gjuhën shqipe.

Veç huazimeve gjuha shqipe do të mund të krijonte një leksik të pasur edhe falë përmirësimit dhe përpunimit të mëtejshëm të saj. Rugët e pasurimit të një gjuhe janë të shumta dhe në këtë punim do të shohim disa prej tyre .

Gjuha jonë është e pasur me fjalë të cilat janë formuar me burimin e vetë gjuhës dhe sipas modeleve prodhimtare të sistemit fjalëformues të shqipes. Sot numri i fjalëve të formuara nga kjo mënyrë është i shumtë. Të tilla kemi: *qëndrueshmëri, mbingarkoj, nënvlerësim, nëndetëse, përparësi, përmirësim, përuroj, etj*. Pra rruga kryesore e pasurimit të gjuhës shqipe është nëpërmjet përdorimit të parashtesave e parashtesave a bashkimit të dy temave si fjalët e përbëra, të tilla janë : *marrëdhënie, përgëzoi, bashkëveprim, përuroj, etj*.

Një tjetër mënyrë e formimit të fjalëve të reja dhe pasurimit të mëtejshëm të gjuhës është edhe përdorimi më i gjerë i fjalëve e i frazeologjisë të marrë nga populli. Në mjaft raste përdorimi i këtyre fjalëve na ka ndihmuar të zëvendësojmë fjalë të huaja të panevojshme që kanë hyrë në përdorimin e shqipes.

Kështu përdorimi i fjalës *flas* në vend të *bisedoj*, *dhurues* në vend të *donator*, *fshat* në vend të *rural*, *mjedis* në vend të *ambient*, *zhduk* në vend të *eliminohet*, *përvojë* në vend të *eksperiencë apo ndryshim* në vend të *diferencë etj*.

Gjithashtu, rimarrja dhe përdorimi i fjalëve të vjetra me burim amtar të gjuhës shqipe për të mënjanuar fjalët e padobishme të ardhura nga italishtja, anglishtja e nga gjuhët e vendeve fqinje si Greqia, e vendet sllave na shpie drejt pasurimit të mëtejshëm të gjuhës shqipe.

Psh: *fjali* zëvendëson fjalën e huaj *frazë e miratoj* po përdoret gjerësisht në vend të fjalës së huaj *aprovuj, mbulesë* në vend të *kapak*.

Por, sikundër përmendëm edhe më parë një burim tjetër janë edhe huazimet.

Huazimet e vjetra gjithashtu bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës sonë të tilla janë fjalë si : *autor, personazh, dialog, aksiomë, aritmetikë, histori, gramatikë, poemë, komedi ,epitet, teori etj.*

Gjithashtu, edhe përdorimi i fjalëve ndërkombëtare është një element i rëndësishëm pasi realizon mundësinë e përdorimit të huazimeve dhe pasurimit të mëtejshëm gjuhësor por jo gjithmonë është kështu në gjuhët neolatine si italishtja apo frengjishtja shohim zëvendësimin e tyre me fjalët përkatëse të këtyre gjuhëve. Në frengjisht fjala *Compiuter* zëvendësohet me fjalën *ordinateur* po kështu në gjuhën italiane fjala *Hotel* zëvendësohet me *albergo* e njëjta dukuri ndodh edhe për fjalë të gjuhës shqipe të tilla si: *solucion* që është zëvendësuar më *tretësirë, nuclear* me *bërthamor, neutral* me *asnjanës etj.* Ndërkombëtarizmat janë të pranishme në fusha të ndryshme të jetës sonë. Shpesh hasim zëvendësimin e tyre me fjalë të cilat burojnë nga gjuha shqipe por në disa raste ky zëvendësim është i pamundur madje ai mund të na shpjerë në ndryshimin e kuptimit të fjalës. Disa ndërkombëtarizma janë të nevojshme dhe ato nuk mund të zëvendësohen lehtësisht nga fjalë me burim nga gjuha amtare. Të tilla janë terma si: *dialekt, materializëm, karrierë, vullkan, astronomi, orakull, zoologji etj.* Por shpesh hasim edhe zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera si : *drejtshkrim, gjuhësi, gjuhëtar* në vend të fjalëve *ortografi, linguistikë, linguist.* *Asnjanësi* në vend të *neutral, asnjanësim* në vend të *neutralizim etj.*

Nuk janë të paktë edhe termat që dikur dukeshin si ndërkombëtarizma të paprekura por që sot janë zëvendësuar me terma të shqipëruar të tilla kemi fjalët si : *sensibël – i ndjeshëm, terror-frikë, komplikacion – ndërlikim etj.*

Së fundmi mund të mbyllim këtë punim me fjalët e Prof. Gjovalin Shkurtaj “ Mbrotjtja e gjuhës është detyrë dhe peng nderi për çdo shqiptar”<sup>7</sup>

## Përfundime

1.Në kushtet e ndryshimeve të përgjithshme gjuha shqipe u kap befasisht nga trysnia e madhe e ndikimeve nga gjuhë të tjera. Ndryshimet e gjithanshme në shoqërinë shqiptare kanë sjellë futjen në ligjërimin shqip të fjalëve dhe strukturave gramatikore të gjuhëve të huaja.

---

7 <https://www.facebook.com/GjuhaShqipePaGabimeFaqjaZyrtare/posts/th%C3%ABnie-p%C3%ABr-gjuh%C3%ABn-shqipe-dhegjuh%C3%ABn-n%C3%ABp%C3%ABrgjith%C3%ABsi-gjuha%C3%ABsht%C3%AB-tep%C3%ABr-e-r%C3%ABnd%C3%ABsish/136819493682477>



2. Përdorimi i huazimeve pa kriter dhe zëvendësimi i fjalëve të gjuhës amtare me terminologji të huaja i bën ato të dëmshme e madje edhe parazite, por gjuha duhet të zhvillohet e të pasurohet sepse pasurimi i gjuhës është tregues i zhvillimit të gjithanshëm të një vendi.

3. Në fushën e komunikimit atë ekonomike, politike, letrare, kulturore etj, gjithmonë ka lindur e do të vazhdojë të lindë nevoja për përdorimin e krijimin e terminologjive të reja. Në mjaft raste përdorimi i terminologjive specifike na ka detyruar të përdorim fjalë të huaja, një dukuri kjo kryesisht pozitive pasi e pasuron gjuhën amtare.

4. Në ligjërim vërehen shkelje të pafalshme të normës gjuhësore jo vetëm në rrafshin leksikor, por dukshëm dhe në atë fonologjik e morfo-sintaksor.

5. Përdorimi i huazimeve shpesh bëhet shkak për probleme në komunikimin e përditshëm, pasi mesazhi që përcjell folësi nuk shkon plotësisht i qartë tek të gjithë dëgjuesit shqipfolës por gjithashtu, nuk mungojnë as rastet kur huazimet luajnë rol kyç në zgjerimin dhe pasurimin e gjuhës sonë kombëtare.

6. Në situatën që është krijuar sot në gjuhën shqipe lipset të mbahet një qëndrim i ekuilibruar në lidhje me huazimet gjuhësore si në rastin e atyre fjalëve dhe strukturave të cilat kanë zhvendosur padrejtësisht format e shqipes ashtu edhe ndaj rasteve të cilat mund të pranohen si pasurim për gjuhën shqipe.

7. Shqyrtimi i këtyre rasteve do të na qartësojnë më shumë përdorimin e saktë dhe pozicionin e tyre në komunikim, në mënyrë që të ruajmë dhe pasurojmë gjuhën tonë.

## **BIBLIOGRAFIA:**

ÇABEJ E., (1962): Hyrje në historinë e gjuhës shqipe: fonetika historike e shqipes, vol.2., Shtypur nga dega e botimeve të Universitetit.

HULD, MARTIN E., (1986): “Shtirirja e theksuar e fjalëve të huaja greke në gjuhën shqipe”.

SHIROKA F., (2020): “Si po prishet gjuha shqype?”. Revista Letrare 30.03.2020.

SHKURTAJ GJ., (2003): Kohë dhe dukuri të kulturës së gjuhës, Shtëpia Botuese “Kristalina- KH”, Tiranë.

SHKURTAJ GJ., (2012): Si të shkruajmë shqip, Tiranë.

**BURIME NGA INTERNETI:**

<https://www.facebook.com/GjuhaShqipePaGabimeFaqjaZyrtare/posts/th%C3%ABnie-p%C3%ABr-gjuh%C3%ABn-shqipe-dhe-gjuh%C3%ABn-n%C3%ABp%C3%ABrgjith%C3%ABsi-gjuha-%C3%ABsht%C3%AB-tep%C3%ABr-e-r%C3%ABnd%C3%ABsish/136819493682477>

<https://www.teksteshqip.com/letersi/thenie-per-gjuhen-shqipe.php> .

# NDIKIME SOCIO-KULTURORE DHE TERMINOLOGJIKE SHQIPTARE DHE GREKE NË ZAKONE DHE TRADITA TË KRISHTLINDJEVE E VITIT TË RI

**Msc. (PhDs) Aida Zoto**

Departamenti i Gjuhës Greke  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti i Tiranës  
E-mail: aida.zoto@unitir.edu.al

**Dr. Isida Metaj (Foçi)**

Departamenti i Gjuhës Greke  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti i Tiranës  
E-mail: isida.metaj@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Ditët e festave janë ditë që i kushtohen traditës, zakoneve dhe dokeve. Për dy popuj fqinj si Shqipëria dhe Greqia, të cilët gjatë bashkëjetesës së tyre pranë njeri-tjetrit kanë marrë e kanë dhënë aq shumë, është e natyrshme që festat e fund vitit në zona të ndryshme të vendit të festohen duke u bazuar në zakone e tradita dhe terminologji të përbashkëta, duke sjellë në këtë mënyrë dhe shembullin e një fqinjësie të mirë përmes ndikimit të ndërsjellët të elementeve kulturorë. Nga kontaktet e pandërprera, përmes traditave, miteve dhe gojëdhënave, të cilat transferohen nga brezi në brez, këto shoqëri tradicionale pasqyrojnë dhe transmetojnë perceptimet, besimet dhe praktikatat që lidhen me jetën e këtyre komuniteteve.

**Fjalët çelës:** zakone e tradita, terminologji, Shqipëria dhe Greqia

## ALBANIAN AND GREEK SOCIO-CULTURAL TERMINOLOGY INFLUENCES ON THE CUSTOMS AND TRADITIONS FOR NEW YEAR AND CHRISTMAS

### ABSTRACT

Holidays are days dedicated to tradition, customs and docks. For two neighboring peoples like Albania and Greece, who have given and received so much during their coexistence with each other, it is natural that the end of the year holidays in different areas of the country are celebrated based on customs and traditions and common terminology, bringing in this way the example of good neighborliness through the mutual influence of cultural elements. From continuous contacts, through traditions, myths and oral traditions, which are transferred from generation to generation, these traditional societies reflect and transmit the perceptions, beliefs and practices related to the life of these communities.

**Keywords:** customs and traditions, terminology, Albania and Greece

Pozita gjeografike, kushtet klimaterike, zhvillimet shoqërore, lëvizja e lirë dhe emigracioni, kanë bërë që shumë shoqëri në botë të karakterizohen nga shkëmbimet e modeleve dhe ritualeve kulturore.

Identifikimi i ndikimeve të ndërsjella socio kulturore dhe modelet e shoqërizimit midis popullit shqiptar dhe grek, karakterizohen nga një larmi faktorësh antropologjikë, etnologjikë, sociologjikë dhe psikologjikë. Kjo bën të mundur kuptimin e praktikave kulturore të tilla si: stili i jetës, gjuha, vlerat, simbolet, arsimimi, muzika, festat fetare etj., të cilat burojnë nga tiparet e trashëguara të çdo grupi shoqëror dhe qartësojnë mundësitë dhe hapësirat e përshtatshmërisë dhe ndërveprimit shoqëror ndërmjet këtyre popujve.

Larmia kulturore dhe zakonet e traditat e përbashkëta paraqesin një thesar vlerash, që në përmbajtjen e tyre ruajnë të mbijetuara shumë besime. Një ndër rastet e veçanta të mbushura me praktika janë festimet e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, që përbëjnë pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe greke. Si dukuri kulturore, festimet përmbajnë veprime e praktika shoqërore nga më të ndryshme, ku secila ka domethënien e qëllimin e vet të veprimit dhe të arritjes së efektit në të mirë të njeriut. Parapërgatitjet për festimin sa më shpirtëror të këtyre festave, shërbesat e ndryshme në të gjitha kishat, ceremonitë, aktivitetet e ndryshme artistike etj., zhvillohen gjatë gjithë periudhës para festimeve.

## TRADITAT DHE ZAKONET POPULLORE NË SHQIPËRI E GREQI

Kolendrat/ Kërshëndellat (*gr. τα καλαντα*)<sup>1</sup> – kolendrat janë këngë popullore, me motive biblike, të cilat këndohen më 24 dhjetor, në vigjilje të Krishtlindjeve apo të Vitit të Ri. Grupe të rinjsh dhe fëmijësh nën shoqërinë e veglave muzikore përshkojnë rrugët dhe shkojnë shtëpi më shtëpi duke uruar shëndet e mbarësi përmes këngës së tyre dhe duke përcjellë lajmin e gëzueshëm. Kolendrat janë një traditë e vjetër kudo në Shqipëri e Greqi.

Kolendrat këndohen kryesisht nga fëmijët e moshave 13-15 vjeç, por në disa raste edhe nga të rriturit. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë formë festimi kalojnë nëpër shtëpi, dyqane, vende publike etj., me shoqërimin e trekëndëshit tradicional prej hekuri ose instrumenteve të tjera muzikore si harmonikë, fizarmonikë, daulle, flaut etj., me qëllim kryesor shpërblimin. Në Greqi fëmijët mbajnë degëza ulliri ose dafine, të stolisura me fruta, mbi të cilat varin fije të kuqe apo të bardha. Në qendër të saj, festa e kolendrave në disa zona të Shqipërisë, ka gatimin e kuleçve, të cilët

---

1 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i shqipes së sotme. KOLENDËR f. etnogr.* Festë fetare një natë para darkës së Krishtlindjeve ose një ditë para Vitit të Ri; kënga që këndonin fëmijët në këto festa. Kulaç i vogël, i gatuar me miell të mirë gruri dhe i pjekur në furrë, që u jepej fëmijëve një natë përpara darkës së krishtlindjeve, 2002..

quhen *kolendra* ose *kullana*, prej së cilës merr emrin dhe kjo festë. Kolendarët gostiten nga të zotët e shtëpisë me kuleç, fiq të thatë, arra, portokall etj. Megjithëse, kolendrat janë një traditë që shpreh besim, gëzim, dashuri dhe paqe, ato festohen në mënyra të ndryshme – sipas krahinave të ndryshme dhe njihen me emërtime të ndryshme. Në zonën e Korçës, Kolonjës, Përmetit dhe Myzeqesë quhen *kolendra*, në Pogradec dhe Berat quhen *kullakë*, ndërsa në Shkodër *kullana*<sup>2</sup>. Kolendrat festohen në mënyra të ndryshme; në zonën e Korçës një fëmijë mban një fener me xhama, ku digjet një qiri, një tjetër mban një ikonë dhe një i tretë një bllok, ku shënohen lekët e mbledhura. Përgjithësisht, mblidhen djemtë e tri lagjeve dhe u bien dyerve me çekanë të drunjtë dhe shkopinj. Kolendrat i këndojnë në dhomën e fëmijëve të vegjël dhe në përfundim të këngës, të gjithë puthin ikonën. Gjyshja e shtëpisë ua vendos lekët mbi ikonë, por, fëmijëve që këndojnë kolendrat, u jepen gjithashtu misra të zier me sheqer dhe gështenja. Sapo largohen fëmijët, të zotët e shtëpisë hedhin në oborr misra pa sheqer që t'i hanë pulat – për të bërë sa më shumë vezë dhe zogj. Ditën e Krishtlindjeve në mëngjes, fëmijë të vegjël vijnë me qese pëlhure të lidhura në qafë, me çekanë të vegjël druri të zbukuruar me ngjyra dhe po në të njëjtën ditë vjehrrat u dërgojnë nuseve të tyre dhurata të vogla me fëmijët që këndojnë kolendrat<sup>3</sup>; në zonën e Përmetit një ditë përpara Krishtlindjeve përgatiteshin kolendrat, të cilat qenë kuleç me forma të ndryshme. Zakonisht bëheshin aq kolendra sa për nevojat e familjes dhe të fëmijëve të fqinjëve, të cilët mendohej se do të vinin për vizitë. Në Greqi, në qytetin Veria, amvisat përgatishnin një lloj kulaçi të vogël/ kullure të quajtur koliki (*gr. το κολλίκι*), ndërsa në Siatista, Kozani këtë lloj kulaçi e gjejmë me emërtimin kuliadina (*gr. τα κουλιαντίνα*). Fëmijët këndojnë kolendrat duke shkuar shtëpi më shtëpi ku i qerasnin me kuleç, petulla të saçit, me arra etj. Në qytetin e Shkodrës, fëmijët kur e shihnin se e zonja e shtëpisë nuk i gostiste, këngës së kolendrës i shtonin vargje të tjera plot humor, të cilat vinin në lojë koprracinë e saj<sup>4</sup>; këtë formë humori apo ngacmimi e gjejmë edhe në zona të ndryshme të Greqisë ku nëse shpërblimi nuk ishte i kënaqshëm, fëmijët këndonin: “Zoti im në pelerinën tënde, një mijë morra ardhshin, u shtofshin, u shumofshin e lëshofshin vezë”<sup>5</sup>.

Druri i Krishtit (*gr. το Χριστόζυλο*) – natën e Krishtlindjeve, në zona të ndryshme të Shqipërisë, i zoti i shtëpisë vendos në zjarr një kërcu të madh, të ashtuquajtur *druri i Krishtlindjeve*, të cilin sipas krahinave e gjejmë me emra të ndryshëm. Në përgjithësi, në veri të Shqipërisë e gjejmë me emrin *buzmi* ose *buzëm*, ndërsa në jug të Shqipërisë e gjejmë me emrat *Trungu i Kërshëndellave*

2 Llukani A., *Himnologjia*, Botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2005.

3 Stralla K., *Në vigjilje të Krishtlindjeve – Kolendrat*, Kujtime vegjël, 2013.

<http://www.radiandradi.com/tradita-te-lashta-shqiptare-qe-jehojne-nder-ditet-tona/>

4 Llukani A., *Himnologjia*, Botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2005.

5 Σιαμάκης Κ., *Τα κάλαντα – άρθρο*, Η Τερπνή, 2001.

ose *Kërcuri i Vitit të Ri* ose *Kërcuri i Kondrave* apo edhe *Kopaçja e Vitit të Ri*. Sjellja e buzmit në shtëpi dhe vendosja e tij në vatër me të gjitha përkushtimet dhe flijimet, me ushqime dhe pije, përbën një zakon të vjetër të Krishtlindjeve i cili në thelb simbolizon ngrohtësinë e foshnjës hyjnore dhe dëbimin e shpirtrave të këqij. Në disa zona të gjithë anëtarët e shtëpisë ulen rreth tryezës që përmban asortimente të ndryshme e sidomos *Bukën e Krishtit*, ndërkohë që dy meshkuj të shtëpisë sjellin dy buzme, të cilët i mbartin horizontalisht dhe në prag të derës i drejtohen të zotit të shtëpisë. Pastaj buzmet i vënë mbi vatër dhe në skajet e tyre vendosnin nga njëra anë bukë dhe djathë, ndërsa nga ana tjetër një gotë raki. Pastaj vështronin se në ç' anë lëshonte lëng druri që nxehej nga zjarri i vatrës; nëse rridhte nga ana e gotës së rakisë, atëherë vreshti do të jepte shumë prodhim, nëse rridhte nga ana e kundërt atëherë tregonte bagëti të mbarë e shumë bulmet<sup>6</sup>. Këtë traditë të vjetër e gjejmë edhe në Greqinë Veriore me emërtimet druri i Krishtit (*gr. το Χριστόζυλο*), dymbëdhjetëditëshi (*gr. ο δωδεκαμερίτης*)<sup>7</sup> apo dhe skarkatzalos (*gr. ο σκαρκάνζαλος*), ku sipas zakonit, i zoti i shtëpisë zgjedh drurin më të bukur, të fortë dhe të trashë prej pishë ose ulliri të cilin e djegin pranë vatrës së zjarrit. Në disa zona të tjera të Greqisë, përpara se ta hedhin në zjarr drurin e spërkasin atë me bajame dhe arra. Në përfundim të festës hiri i drurit të Krishtit hidhej nëpër ara pasi mendohej se ishte i mirë për të korrat dhe bimët. Ndërkohë, në Thesali dhe në Greqinë Qendrore, ky zakon gjendet në formën e *martesës së zjarrit* (*gr. το πάντρεμα της φωτιάς*), ku në vend të një druri, ata zgjidhnin dy; një dru që simbolizonte të zotin e shtëpisë (një pemë me një emër mashkullor) dhe një dru që simbolizonte të zonjën e shtëpisë (një pemë me një emër femëror), duke i bashkuar në zjarr për shëndet dhe jetëgjatësi të çiftit<sup>8</sup>.

*Rrushkulla* (*gr. τοκοφτανέτσι*) – një nga zakonet më të bukura në zonën e Labovës dhe të Dropullit (Gjirokastrë) është ai i Rrushkullës, një lloj shkurreje me kokrra me ngjyrë të kuqe dhe me gjemba. Pjesëtarët e familjes ulen përballë vatrës dhe hedhin në zjarr kokrrat e kuqe të lules së shkures. Çdo herë, kreu i familjes, hedh nga një kokërr për secilin pjesëtar të familjes, duke shpresuar të zbulojnë të ardhmen e tij. Nëse kokrra e kuqe e lules bën zhurmë të madhe kur digjet, do të thotë që pjesëtari i familjes për të cilin u hodh, do të ketë jetë të gjatë dhe shëndet, por nëse kokrra digjet brenda zjarrit pa bërë zhurmë, simbolizon të kundërtën. Po në të njëjtën zonë, në Pershtan (Gjirokastrë), në vend të kokrrave të rrushkullës banorët hidhnin në zjarr kokrra dëllinje (të kuqe ose të zeza)<sup>9</sup>. Në rrethin e Beratit ky zakon realizohet me disa ndryshime të vogla, në vend të kokrrave të rrushkullës,

6 Tirta M., *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSH, Mësonjëtorja, 2004.

7 Periudha dymbëdhjetë ditëshe në traditën e krishterë quhet periudha e dymbëdhjetë ditëve nga Krishtlindja (25 dhjetor) deri në prag të Teofanisë (5 janar).

8 *Τα Λαογραφικά της Αιτωλοακαρνανίας* <http://www.laografika.gr/el/>

9 Meksi F., *Labovë e Madhe dhe Labovitët: Gjurmime në vite*, Migjeni, Tiranë, 2010.

përdoren kokrra gruri e misri duke thënë “*Mirë se erdhe Viti i Ri, qofsh me shëndet, me kësmet, me beqeret, me para në qeset!*”<sup>10</sup>, ndërsa në Sarandë dhe në ishullin Thasos (Greqi), këtë zakon të veçantë e gjemë me emërtimin gjethet e ullirit (*gr. το σπόρδισμα των φύλλων*). Pjesëtarët e familjes ulen përballë vatrës, tërheqin thëngjijtë jashtë dhe fillojnë të hedhin në zjarr gjethet e ullirit. Çdo herë hedhin nga një gjethe për secilin pjesëtar të familjes, duke shpresuar të zbulojnë të ardhmen e tij në Shqipëri, ndërsa në Greqi ky zakon lidhet me plotësimin e dëshirave. Nëse gjethja e ullirit përdridhet, do të thotë që pjesëtari i familjes për të cilin u hodh, do të ketë jetë të gjatë, shëndet dhe do t’i plotësohen të gjitha dëshirat. Nëse gjethja vyshket brenda zjarrit, simbolizon të kundërtën. Për këtë traditë është zgjedhur pema e ullirit si një simbol i prosperitetit dhe pasurisë<sup>11</sup>.

*Uji që s’flet* (*gr. το αμίλητο νερό*) – një nga zakonet më të veçanta është ai i “ujit që s’flet” të cilin e gjejmë në zonën e Përmetit, Gjirokastrës dhe në zonën e Kardhicës. Disa orë para agimit të Krishtlindjes, sipas zakonit, zbrazen të gjitha enët që mbajnë ujë dhe një nga gratë e shtëpisë (zakonisht më e rejat), shkojnë të sjellin ujë (ujin e ri) në shtëpi nga çezma më e afërt, me një shtambë. Gjatë rrugës së kthimit vajzat rrinë në heshtje. Kjo është dhe arsyeja që ky ujë quhet “uji që s’flet”<sup>12</sup>. Këtë traditë të veçantë, në Greqi e gjemë edhe me emrin ushqyerja e çezmës (*gr. τούτσισμα της βρύσης*). Në këtë rast gratë mbajnë me vete dhe ushqime si mjaltë, gjalpë, grurë, djathë, gjethe ulliri etj. Me këto “ushqejnë” çezmën para se të mbushin shtambën me ujë. Gjatë kohës që mbushet shtamba, ato luten, gjithnjë pa folur, që Viti i Ri të sjellë mbarësi. Pasi shtamba është mbushur, hedhin brenda saj një gjethe dafine dhe tre guralecë. Kur kthehen në shtëpi dhe pasi pinë ujin që s’flet, të gjithë pjesëtarët e familjes spërkatën me të, së bashku me gjithë ambientet e shtëpisë dhe kafshët e tyre që çdo gjë të shkojë mbarë. Në zona të caktuara besohet se vajza që shkon e para në çezmë është fatlumja e gjithë vitit.

*Buka e Krishtit* (*gr. το Χριστόψωμο*) – Buka e Krishtit, quhet buka që amviset greke e përgatitin posaçërisht për festën e Krishtlindjeve. Në shumicën e zonave mbi sipërfaqen e kësaj buke shënohet forma e kryqit me rripa brumi, ndërsa në skajet e saj vendosen bajame dhe arra, të cilat janë simbole të prodhimit të pasur. Dekorimi i saj shpesh parapërcaktohet nga profesioni i kryefamiljarit; pra, nëse ai p.sh. është një bujk, mbi bukë vizatohet një parmendë dhe qe; nëse merret me blegtori, mbi bukë vizatohen dele apo dhi etj. Në disa vende të tjera brenda bukës vendoset një monedhë. Gjatë ndarjes së bukës, anëtari i familjes që gjen monedhën quhet më fatlumi i vitit. Në varësi të zonës, Buka e Krishtit gatuhet në mënyra të

10 Tirta M., *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSH, Mësonjëtorja, 2004.

11 *Ηθη και Έθιμα της Θάσσο* <https://www.thassos-island.gr/el/>

12 Tirta M., *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSH, Mësonjëtorja, 2004.

ndryshme dhe me përbërës të ndryshëm. Në Kretë përdorin miell të situr hollë, ujë trëndafili, mjaltë, susam, kanellë dhe karafil, ndërsa qendër vendosin një arrë të pathyer. Në sipërfaqen e mbetur me një thikë ose pirun vizatojnë forma të ndryshme si lule, gjethe, fruta, zogj<sup>13</sup>. Në Greqinë Qendrore, në mëngjeset e Krishtlindjeve, pas Meshës Hyjnore, prifti shkon nëpër shtëpitë e besimtarëve për të bekuar Bukën e Krishtit. Ky zakon është quajtur “Lartësimi i Bukës”. Prifti ngre lart Bukën e Krishtit me të dyja duart, psal një bekim, ndërkohë që anëtarët e familjes prekin Bukën e Krishtit me dorën e djathtë. Më pas e vendos mbi kokën e tij duke ushtruar presion më të dy skajet. Buka e Krishtit ndahet më dysh dhe kontrollohen dy pjesët që mban në dorë prifti. Nëse pjesa në dorën e djathtë është më e madhe se sa ajo në të majtë atëherë viti do të jetë i mirë, në të kundërt viti do të jetë i vështirë<sup>14</sup>. Në hapësirën e Shtatë Ishujve, rituali kërkon që të gjithë anëtarët e familjes të prekin Bukën e Krishtit dhe t’i drejtohen tryezës, pranë oxhakut. Atëherë, i zoti i shtëpisë hedh vaj ose verë në zjarrin që djeg. Nëse zjarri ndizet më shumë, kjo është një shenjë e mirë për vitin që pason, por nëse ulet ose shuhet zjarri është një shenjë e keqe<sup>15</sup>. Në pothuajse të gjitha zonat e Greqisë, brenda Bukës së Krishtit vendosej një monedhë dhe anëtari i familjes që e gjen atë, siç besohej, do të kishte fat gjatë gjithë vitit. Një nga variantet më interesante të Bukës së Krishtit e gjejmë në Spartë, ku në vend të formës klasike të rumbullakët, amviset e brumosin Bukën në formën e një kryqi dhe e dekorojnë atë me bajame dhe arra. Një tjetër ndryshim në përgatitjen e kësaj buke e gjejmë nga Sarakatsanët (nëngrup i popullsisë etnike greke), të cilët ditët e Krishtlindjeve përgatisnin dy bukë; një për familjen e tyre dhe një tjetër për kafshët e tyre<sup>16</sup>. Në Shqipëri gjejmë disa forma të këtij gatimi; kështu, në Baltëz të Fierit, në Mallakastër, në Berat etj., në ditën e Shën Vasilit (Vitet të Ri) gatuhet bukë misri (*gr. το καλαμποκόψωμο*), e cila gatuhet tre ditë para se të vinte kjo festë, ndërsa amvisat gatuanin çeçereveçe<sup>17</sup> për çdo pjesëtarë të familjes. Brenda në një nga kuleçtë vendosej një monedhë dhe pjesëtari i familjes që gjente monedhën do të kishte fat gjatë gjithë vitit. Në Kosovë të Përmetit, ky gatim gjendet në formën e byreksheqerëve – një ëmbëlsirë e gatuar me miell misri. Amvisat shkojnë në çdo ambient të shtëpisë duke kënduar “*Olekbolek plot me buk’e bereqet, me hambarë e me qilarë, Me nuse e djem gëzuar!*”<sup>18</sup>, ndërsa në disa zona të tjera e gjejmë me emërtimin byreku ose kulaçi ose keku i Shën Vasilit (*gr. Βασιλόπιτα*)<sup>19</sup>.

13 Χριστουγεννιάτικα Έθιμα στην Κρήτη [www.kalanta.gr/ithi-kai-ethima](http://www.kalanta.gr/ithi-kai-ethima)

14 Ήθη και Έθιμα της Θάσους <https://www.thassos-island.gr/el/>

15 Χριστουγεννιάτικα έθιμα Επτανήσων [http://www.pass2greece.gr/culture\\_det.asp?culture\\_id=32](http://www.pass2greece.gr/culture_det.asp?culture_id=32)

16 Μάθημα Πολιτισμού: Ελληνικές γιορτές, 2010.

<https://is.muni.cz/el/1421/podzim2010/REBcB25/um/Politismos.pdf>

17 Kuleç të vegjël misri.

18 Habazaj A. R., Një vështrim mitologjik mbi festat kalendarike e tradicionale të vitit dhe lirikën ritual, Info Arkiva On-line, 2014.

19 Radion Ngjallja. <https://www.radiongjallja.org/besetytnite-per-vitin-e-ri/>



Ylli prej dërrase (gr. *το ζύλινο αστέρι*) – në zonën e Beratit përgatitjet e Krishtlindjeve fillojnë një javë përpara. Fëmijët ndërtonin një yll prej dërrase që simbolizonte Yllin e Betlehemit, e mbështillnin me letër të kuqe dhe në mes vendosnin një qiri. Në mbrëmje shkonin shtëpi më shtëpi e këndonin me qiriun e ndezur. Në mëngjes çdo fëmijë bënte gati çomangën ose çomiklen<sup>20</sup>, e cila në dy skajet kishte nga një gozhdë<sup>21</sup>. Në Greqi, simbolin e Yllit të Krishtlindjeve (gr. *τοΧριστουγεννιάτικο αστέρι*), i cili përsëri simbolizon Yllin e Bethlehemit, e gjejmë vetëm në lidhje me dekorin. Kështu, ylli i ndritshëm në krye të pemës simbolizon yllin që ka ndriçuar në Bethlehem dhe ka udhëhequr tre magjistarët natën që Krishti ka lindur<sup>22</sup>.

*Karnavalet e Vitit të Ri/ Rrogeçët* (gr. *Πρωτοχρονιάτικο καρναβάλι/ τα Ραγκουτσάρια*)<sup>23</sup> – zakoni i maskimeve të Vitit të Ri është tepër i përhapur në Maqedoninë Perëndimore. Këtë zakon e hasim me disa emërtime: Ragoutsaria e Kosturit (gr. *τα Ραγκουτσάρια της Καστοριάς*); Rougkatsia Grevena (gr. *τα Ρουγκάτσια των Γρεβενών*); Bambara (gr. *τα Μπαμπάρια*) në fshatrat Popollzhan dhe Ermen (Follorinë); Boumpousaria (gr. *Μπουμπουσάρια*) në Siatisa, Kozhani; Lougkatsaria (gr. *Λουγκατσάρια*) në fshatin Agia Paraskevi të komunës Livadeia etj. Konkretisht, ditën e Vitit të Ri të rinjtë e fshatit të veshur me kostume popullore apo lëkurë kafshësh dhe maska në fytyrë, rrotullohen nëpër fshat, të lidhur me këmborë, duke kënduar kolendrat në mënyra të ndryshme satirike e duke ngacmuar njëri-tjetrin. Pas tyre vjen “dhëndri me nusen” e në fund “prifti” i cili dëbon shpirtrat e këqij<sup>24</sup>. Zhvillimin e këtij zakoni gazmor e gjejmë me ndryshime të vogla në varësi të zonave ku zhvillohet. Në Shqipëri zakonin e maskimeve e gjejmë në fshatin Polenë, Korçë nën emërtimin Karnavalet e Polenës ose Të lënë e mishit – një rit arkaik dhe më lashtë se Karnavalet qytetare. Banorët i zhvillonin festimet në ditën e Vitit të Ri ose në një datë të afërt, ndërsa elementi kryesor janë lugetërit (krijesa të egra dhe të frikshme të cilat duan të pengojnë ardhjen e ditës së re). Veshjet e të maskuarve janë shumë autentike – lëkurë deleje, dhie ose kafshe tjetër – të dekoruara me ngjyra, brirë, dhëmbë ose kocka kafshësh. Ata mbajnë në duar zile e këmborë për të lajmëruar ardhjen e tyre dhe për të paralajmëruar banorët të rrinë larg tyre<sup>25</sup>.

20 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i shqipes së sotme, ÇOMANGE* f. sh. Shkop i trashë e i qëruar me një xhungë të rumbullakët në njëren anë; xhore, 2002.

21 Llukani A., *Himnologjia*, Botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2005.

22 Κυριακίδου Ν. Α., Οι δώδεκα μήνες - Τα λαογραφικά. Μαλλιάρης Παιδεία – MalliarisPaedia, 2015.

23 Emërtimi Ragoutsaria e ka prejardhjen nga fjala latine rogator, rogatoris [m.]; lypës; përderës; ai që kërkon lëmoshë. Emërtimi i zakonit lidhet me faktin që të maskuarit kërkojnë derë më derë dhurata në mënyrë që, sipas tyre, të largojnë shpirtrat e këqij.

24 Πούχνερ Β., Συγκριτική Λαογραφία Β', Δημόδη βιβλία και λαϊκάθέματα στηχερσόνησοτουΑίμου, εκδ. Αρμός, Αθήνα, 2009.

25 Karnavali e Polenës [https://sq.wikipedia.org/wiki/Karnavali\\_e\\_Polen%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Karnavali_e_Polen%C3%ABs)

*Vizitori i parë* (gr. το ποδαρικό) – herët për Krishtlindje apo Vitin e Ri, për urime, pritej i pari një person i caktuar. Ky përshëndetës konsiderohej si me “këmbë të mbarë” për fat e prodhimtari gjatë vitit në vazhdim. Përshëndetësi zakonisht duhej të ishte me nënë e me babë e me fatbardhësi në jetën e tij familjare dhe jo jetim e fatkeq. Zakonisht ky ishte fëmijë, në shumicën e rasteve duhej të ishte djalë, po mund të ishte edhe vajzë. Kishte raste që në rolin e përshëndetësit ishte një kafshë e caktuar, që futej në shtëpi këtë ditë a natë dhe ndonjëherë na paraqitej dhe si flije e festës. Shumë familje këtë njeri me fat e caktonin një natë përpara dhe e ftonin që t’u shkonte i pari të nesërmen në mëngjes herët për urime. Në mëngjes kur shkonte, ai merrte pak bar të njomë dhe kur vinte këmbën e djathtë në prag të derës, e hidhte barin në një skaj të vatrës e thoshte: “*Siç mbin bari, ashtu u shtoftë njerëzia e bagëtia në këtë derë!*”<sup>26</sup>. Në Greqi zakoni i vizitori të parë është një zakon që ka një domethënie simbolike, ndërsa vizitori, ashtu si edhe në Shqipëri, duhet të jetë një fëmijë ose një njeri me fat. Në pothuajse të gjitha zonat e Greqisë, përshëndetësi mban me vete edhe një shegë – simboli i mbarësisë dhe duke hyrë në shtëpi, gjithmonë me këmbën e djathtë, “çan” një shegë në derën kryesore të shtëpisë duke uruar “*Aq korrka sa ka shega, aq lira të keni në xhepin tuaj! Aq e kuqe sa është shega, aq e kuqe të jetë zemra juaj!*”. Nga kjo përplasje kokrrat shpërndahen në gjithë shtëpinë duke simbolizuar “mbushjen” e shtëpisë me lumturi, bollëk, fatmbarësi, fatmirësi, pjellori etj. dhe duke simbolizuar fillimin e një viti të ri të mbarë<sup>27</sup>.

Ditët e festave janë ditë që i kushtohen traditës, zakoneve dhe dokeve. Populli shqiptar dhe ai grek, gjatë bashkëjetesës së tyre pranë njëri-tjetrit, përmes traditave, miteve dhe gojëdhënave, të cilat transferohen nga brezi në brez, pasqyrojnë dhe transmetojnë perceptimet, besimet dhe praktikat që lidhen me jetën e këtyre komuniteteve. Elementet e ndërsjellët kulturorë shfaqen në mënyrën dhe organizimin e jetës shoqërore, në mentalitet e ngjashme, në ritualet e organizimit të ceremonive të lindjes, martesës apo vdekjes, por edhe në zakonet e doket për festimin të festave të ndryshme.

Mesazhi i gëzueshëm i lindjes së Krishtit dhe ndërrimit të viteve festohet në mënyrë të veçantë në çdo cep të botës, duke mbajtur gjallë zakonet e doket që kanë mbijetuar deri më sot. Gjatë gjithë vitit, çdo vend në Greqi apo Shqipëri, qytet apo fshat, ka mundësinë që të ruajë traditën e tij popullore dhe të ringjallë zakonet e vjetra të cilat marrin një karakter të veçantë, të përshtatur me traditat dhe zakonet vendase, duke marrë parasysh se, ndër vite, zakonet festive kanë pranuar ndikime evropiane apo/dhe amerikane. Shumica e traditave të secilit shtet janë në një farë

26 Tirta M., *Mitologjia ndër shqiptarë*. ASHSH, Mësonjëtorja, 2004.

27 *Μάθημα Πολιτισμού: Ελληνικές γιορτές*, 2010. <https://is.muni.cz/el/1421/podzim2010/REBcB25/um/Politismos.pdf>

mënyre ringjallje e zakoneve antike, të rrënjosura në mite që u kthyen në përralla popullore, me një ngarkesë të rëndësishme fetare dhe një përbashkim me natyrën. Në këtë punim janë sjellë vetëm disa nga zakonet e traditat e përbashkëta kulturore të dy vendeve, duke marrë parasysh se ne të gjithë i përkasim një komuniteti me histori të pasura dhe kultura të ndërthurura.

## BIBLIOGRAFIA:

(2010): *Μάθημα Πολιτισμού: Ελληνικές γιορτές*.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002: *Fjalor i shqipes së sotme*.

HABAZAJ A.R., (2014): *Një vështrim mitologjik mbi festat kalendarike e tradicionale të vitit dhe lirikën rituale*, Info Arkiva On-line.

[http://www.pass2greece.gr/culture\\_det.asp?culture\\_id=32](http://www.pass2greece.gr/culture_det.asp?culture_id=32)

<http://www.radiandradi.com/tradita-te-lashta-shqiptare-qe-jehojne-nder-ditet-tona/>

<https://is.muni.cz/el/1421/podzim2010/REBcB25/um/Politismos.pdf>

<https://is.muni.cz/el/1421/podzim2010/REBcB25/um/Politismos.pdf>

Karnavali e Polenës [https://sq.wikipedia.org/wiki/Karnavali\\_e\\_Polen%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Karnavali_e_Polen%C3%ABs)

LLUKANI A., (2005): *Himnologjia*, Botimet Trifon Xhagjika, Tiranë.

MEKSI F., (2010): *Labovë e Madhe dhe Labovitët: Gjurmime në vite*, Tiranë: Migjeni.

Radion Ngjallja. <https://www.radiongjallja.org/besetytnite-per-vitin-e-ri/>

STRALLA K., (2013): *Në vigjilje të Krishtlindjeve – Kolendrat*, Kujtime vegjëlle.

TIRTA M., (2004): *Mitologjia ndër shqiptarë*. ASHSH. Mësonjëtorja.

*Θηη και Έθιμα της Θάσου* <https://www.thassos-island.gr/el/>

KYPIAKIDOU N. A., (2015): *Οι δώδεκα μήνες - Τα λαογραφικά*. Μαλλιάρης Παιδεία – Malliaris Paedia.

ΠΟΥΧΝΕΡ Β., (2009): *Συγκριτική Λαογραφία Β*, Δημόδη βιβλία και λαϊκάθέματα στηχερσόνησσοτου Αίμου, εκδ. Αρμός, Αθήνα.

ΣΙΑΜΑΚΗΣ Κ., (2001): *Τα κάλαντα* – άρθρο, Η Τερπνή.

*Τα Λαογραφικά της Αιτωλοακαρνανίας* <http://www.laografika.gr/el/>

*Χριστουγεννιάτικα Έθιμα στην Κρήτη* [www.kalanta.gr/ithi-kai-ethima](http://www.kalanta.gr/ithi-kai-ethima)

*Χριστουγεννιάτικα έθιμα Επτανήσων*.

# NJËSIMI I TERMINOLOGJISË ADMINISTRATIVE NË MBARË SHQIPEN

**Prof. Dr. Ajten Hajdari – Qamili**  
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
Fakulteti i Filologjisë,  
Universiteti “Shën Kirili e Metodi” – Shkup  
E-mail: teni79@yahoo.com  
E-mail: ajtenqamili79@gmail.com

## PËRMBLEDHJE

Nevoja e njësimimit të terminologjisë administrative në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Kosovë, gjegjësisht, në mbarë shqipen është konstatuar shumë moti, por një theks të veçantë ka pasur gjatë përdorimit të shqipes në administratën e Maqedonisë së Veriut. Shpesh përkthyesit, por ndonjëherë edhe hartuesit e teksteve administrative në Maqedoninë e Veriut janë ballafaquar me sfida të mëdha gjatë përzgjedhjes së termave përkatës, sepse janë ndeshur me variante të ndryshme në këto tri shtete. Në Shqipëri në terminologjinë administrative më shumë ka ndikuar italishtja dhe kohëve të fundit edhe anglishtja, kurse në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut më shumë kanë ndikuar gjermanishtja dhe gjuhët sllave. Kjo është arsyeja që terminologjia nuk është e njësuar. Çështje shumë serioze ka qenë se cila formë apo model duhet marrë për bazë: ajo që përdoret në Shqipëri, ajo në Kosovë apo përkthimi i përpiktë nga maqedonishtja? Për t’u dhënë fund këtyre sfidave zgjidhja e vetme është që të njësohet terminologjia administrative e mbarë shqipes e më pas edhe e fushave të tjera. Për ta argumentuar nevojën e njësimimit të terminologjisë, në këtë kumtesë do të trajtoj vetëm disa nga termat që janë më problematike, shumica e të cilëve janë sinonime të plota, por edhe të pjesshme. Disa çifte sinonimike nuk kanë asnjë dallim semantik, por vetëm ndryshon gjuha nga cila ka hyrë në shqipe. Termat i kam analizuar duke i përshkruar si janë në fjalorët shpjegues (në fjalorët e shqipes së sotme dhe të maqedonishtes së sotme), pastaj si përkthehen në fjalorët shqip - maqedonisht, pastaj si përkthehen në fjalorët maqedonisht - shqip dhe si krahasim kam vënë edhe fjalorët shqip - serbokroatisht dhe anasjelltas, meqë bëhet fjalë për terma internacionalë ose për terma që janë njëllorë në gjuhët sllave.

Si përfundim i kësaj analize del se tash detyrë kryesore e albanologëve duhet të jetë njësimi i terminologjisë administrative, të përcaktohen qartë e mirë, duke argumentuar se cili term duhet përzgjedhur, por në qoftë se nuk mund të njësohet për arsye jashtëgjuhësore, atëherë të sqarohet pse. Më pas, me të gjitha shpjegimet të futen në fjalorët elektronikë dhe në softuerin që do të përpilojë AZGJ-ja, që pastaj të përhapen në të gjitha trojet ku përdoret shqipja.

**Fjalët çelës:** njësim, terminologji administrative, fjalorë elektronikë, mbarëkombëtar.

## UNIFICATION OF THE ADMINISTRATIVE TERMINOLOGY THROUGHOUT THE ALBANIAN LANGUAGE

### ABSTRACT

The need to unify the administrative terminology in RNM, Albania and Kosovo respectively, throughout the Albanian language has been ascertained for a long time, but there has been a special stress for the use of the Albanian language in the administration of RNM. The translators very often,

but sometimes even the compilers of administrative texts face great challenges during the selection of relevant terms, because have been confronted with different varieties in these three states. A very serious issue has been which form or model should be takes as basis: what is being used in Albania, in Kosovo or the meticulous translation from Macedonian? In order to end these challenges, the only solution is for the administrative terminology in the Albanian language to be unified and later on also of other fields. To give arguments regarding the need for the unification of the terminology, in the following I will address some of terms that are the most problematic, most of which are full synonyms, but also some partial ones. Some synonymous pairs have no semantic difference, but only differs the language from which they have entered into the Albanian language. I have analyzed the terms by describing how they are in explanatory dictionaries (in the dictionaries of modern Albanian language and modern Macedonian language), afterwards how they are translated in Albanian-Macedonian dictionaries, later on how they are translated in Macedonian-Albanian dictionaries and for comparison I have put also the Albanian-Serbo-Croatian dictionaries and vice versa, since its regarding international terms or terms that are the same in the Slavic languages.

As a result of this analysis, it appears that now the main task of Albanianologists should be the unification of administrative terminology, to be defined clearly and well, while arguing which term to be selected, but if it cannot be unified because of non-linguistic reasons, then to be explained why. Subsequently, all the explanations to be put in the electronic dictionaries and in the software, which would be developed by LIA, so then to be spread in all lands where the Albanian language is used.

**Keywords:** unification, administrative terminology, electronic dictionary, nationwide.

Përdorimi zyrtar i shqipes nëpër institucionet e Maqedonisë së Veriut pas vitit 2019 me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, nxori në pah disa probleme lidhur me terminologjinë administrative të panjësuar të shqipes që përdoret në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Shpesh ndodh që përkthyesit nëpër institucione të vihen në situata të palakmueshme për shkak se gjithmonë ata janë viktimat e kritikave për nivelin gjuhësor që përdorin apo për përzgjedhjen e termave përkatës, edhe kur ata nuk kanë faj. Një nga situatat e këtilla është rasti me emërtimin e pjesëve përbërëse të institucioneve, si p.sh.: sektor, degë, njësi, njësit, repart etj., të cilët së pari nuk janë të unifikuara mes institucioneve simotra brenda Maqedonisë së Veriut e aq më pak edhe me pjesët përbërëse të institucioneve homologe të Shqipërisë dhe të Kosovës. Nëse për të njëjtën nënndarje të institucionit në një institucion emërtohet *одделение*, diku tjetër përdoret *отдел*, diku *секција* e diku tjetër ndryshe, ndërkaq gjatë përkthimit të tyre në shqip diku përkthehen si *njësi*, diku tjetër si *seksion*, diku *degë*, diku tjetër *njësit* etj. Arsyeja pse ndodhin këto, është se në fjalorët shpjegues të shqipes së sotme që të gjitha këto fjalë janë sinonime të plota ose të pjesshme dhe në fjalorët maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht për secilin nga këta terma jepen të gjitha këto fjalë si alternativa. Përzgjedhja e cilit term do të përdoret i mbetet në përgjegjësi përkthyesit ose udhëheqësit të institucionit. Duhet theksuar këtu se shumë shpesh përkthyesit e institucioneve të ndryshme nuk shkëmbejnë mendje me njëri-tjetrin, por edhe nëse e bëjnë këtë, përsëri nuk mund të harmonizohen mes tyre. Madje, jo vetëm përkthyesit që nuk

mund të harmonizohen, por edhe albanologët kur merren për konsultim, secili jep përgjigje ndryshe, varësisht nga shija, stili, botëkuptimi apo diçka tjetër.

Këtyre problemeve duhet t'u gjehet zgjidhje sa më parë dhe pikërisht për këtë shkak iu rreka punës që të nxjerr në pah shkaqet e kësaj dukurie e për të kërkuar rrugëdalje. Duke dashur të jap ndihmesën time në këtë çështje, kam bërë një analizë ku pasqyrohen shpjegimet e termave të mësipërm, se si definohen apo përkruhen ata në fjalorët shpjegues, së pari i radhis fjalët nga fjalorët e shqipes së sotme, më pas nga fjalorët e maqedonishtes së sotme. Pastaj i vë në përqasje po këto fjalë se si përkthehen në fjalorët shqip - maqedonisht dhe si përkthehen në fjalorët maqedonisht – shqip. Përveç kësaj, si krahasim kam vënë edhe fjalorët shqip - serbokroatisht dhe anasjelltas, meqë bëhet fjalë për terma internacionalë ose për terma që janë njëloj në gjuhët sllave.

Në vijim po japim fjalët nga fjalorët shpjegues të shqipes së sotme:

**Sektor** – nëndarje e veprimtarisë së një institucioni kërkimor-shkencor ose e një administrate sipas fushave të veçanta. <sup>1</sup>

**Njësi** – formacion ushtarak që përbëhet nga disa reparte (brigada, batalione etj.) të një arme që kryen detyra të caktuara luftarake. 2. nëndarje administrative. <sup>2</sup>

**Njësit** – formacion i vogël ushtarak, *Njësit vrojtues. Njësitet e luftimit. Njësitet vullnetare pulllore. Njësitit i shërbimit.* <sup>3</sup>

**Seksion** – degë ose ndarje e veçantë e një institucioni shtetëror, organizatë shoqërore etj. 2. ndarje e veçantë që përfshin disa fusha të afërta studimi në një akademi shkencash. 3. një nga ndarjet e punimeve të një kongresi, konference etj. <sup>4</sup>

**Repart** – ndarje në një ndërmarrje prodhimi, shërbimi, tregtie etj. sipas llojit të punës, pajisjeve ose të prodhimit. Ndarje në një spital. 2. njësi ushtarake sipas detyrës ose llojit të armës që ka. 3. grup njerëzish për të vepruar me një qëllim të përbashkët. <sup>5</sup>

**Degë** – nëndarje administrative në një dikaster, në një ndërmarrje a në një institucion; pjesë e një organizate kulturore a e një institucioni që vepron në një rreth

---

1 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 1078.

2 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 812.

3 Po aty, f. 812.

4 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 1077.

5 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 1018.

a qytet tjetër: *Dega ushtarake. Dega e bankës. Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve.*<sup>6</sup> Fushë e ditorisë, e artit, e shkencës etj. dhe drejtim i veçantë i studimit përkatës në një shkollë profesionale a të lartë; nënndarje e një veprimtarie shoqërore: *Degët e ekonomisë. Dega e gjuhës. Dega e ndërtimit.*<sup>7</sup>

**Departament** – degë a seksion në një ministri.(në administratën shqiptare para Çlirimit); ministri (në SHBA, Zvicër etj.). *Departamenti i shtetit* ministria e punëve të jashtme në SHBA. 2. njësi e madhe administrative e tokësore në Francë, prefekturë. *Kryeqendra e departamentit.*<sup>8</sup>

**Katedër** – grup pedagogësh në shkollat e larta që drejtojnë e kryejnë punën mësimore e shkencore për një lëndë të caktuar a për disa lëndë të lidhura ndërmjet tyre; dhoma e këtyre pedagogëve: *Katedra e gjuhës shqipe.*<sup>9</sup>

**Pavijon** - dhomë ose repart në një spital, sipas llojit të sëmundjeve dhe të mjekimeve. 2. Ndërtesë a sallë për të paraqitur mallrat në një panair.<sup>10</sup>

Në vazhdim do të paraqesim se si këta terma janë përkthyer në fjalorët shqip-maqedonisht dhe shqip-serbokroatisht. p.sh.:

**Sektor** – Сектор (посебен оддел од организација, стопанство, општество и сл.).<sup>11</sup> 1. сектор *сектор на цивилната одбрана (sektori i mbrojtjes civile)*, 2. одсек, 3. гранка *гранка на служба (sektori i shërbimit)*<sup>12</sup> 1. iseçak, sektor, 2. одсек, odeljak. 3. grana, sektor, polje, područje delovanje. 4. odeljenje<sup>13</sup>

**Njësi** – Единица<sup>14</sup> (*njësi monetare, tregtare, ushtarake, kohore, matjeje, leksikore, mësimore – парична, трговска, воена, временска, лексичка, наставна единица, единица за мера*; 2. еДИНСТВО<sup>15</sup> 1. jedinica ekonomska jedinica; 2. jedinstvo jedinstvo mišljenja, jedinstvo osećanja.<sup>16</sup>

6 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 184. kuptimi 4.

7 Po aty, kuptimi 5.

8 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 189.

9 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984) : *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, fq. 500, kuptimi 2.

10 Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984, fq. 871.

11 Ymeri H.- B., *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, 2012, fq. 773.

12 Agai A. & Agai K., *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996, fq. 638.

13 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S., (1981) : *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, fq. 846.

14 Labroska V., Sulejmani B., Ymeri H. – B., Atanasov P., (2016) : *Fjalor maqedonisht – shqip dhe shqip – maqedonisht*, Shkup, 2016, fq. 115.

15 Agai A. & Agai K., *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996, fq. 487.

16 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S., *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, fq. 646.

**Njësit** – 1. одред, 2. мала воена формација;<sup>17</sup> 3. единица.<sup>18</sup> 1. odred<sup>19</sup>

**Seksion** – 1. секција (како дел на институција, организација, школски активности исл.), 2. секција (како дел на поважен состанок, конгрес и сл.); 3. отсек (во администрација и сл.); 4. пресек (во геометрија).<sup>20</sup> 1. odeljenje, odsek, sekcija. 2. presek.<sup>21</sup>

**Pavijon** – 1. павиљон, 2. просторија, 3. зграда.<sup>22</sup> 1. paviljon.<sup>23</sup>

**Repart** – 1. отсек, одделение. 2. погон. 3 воена единица; вод.<sup>24</sup> 4. болнички отсек.<sup>25</sup> 1. odsek, odeljenje (ustanove, radne organizacije); 2. pogon (fabrike, preduzeća); 3. voj. jedinica.<sup>26</sup>

**Degë** – 1. бот. гранка, ветка, вејка 2. геогр. притока; 3. оддел, раздел; 4. отсек *отсек за историја, за хемија*; 3. струка<sup>27</sup>, специјалист, бранша, област, подрачје *подрачје за снабдвање*, отсек *отсек по историја*, одделение, секција. филијала *филијала на банка*, подружница *синдикална подружница*.<sup>28</sup> 1. bot. grana; 2. grana, struka, branša, branža, oblast, područje. 3. odsek, odeljenje, sekcija, ogranak, filijala, podružnica. 4. pritoka.<sup>29</sup>

**Departament** – 1. департман (*административно-територијална единица во некои западни земји*); *административно подрачје*;<sup>30</sup> област, околија, 2. гранка, отсек<sup>31</sup>

Ndërkaq, të njëjtat fjalë në fjalorët shpjegues të maqedonishtes së sotme<sup>32</sup> dhe në fjalorët maqedonisht-shqip janë përkthyer ose shpjeguar kështu:

17 Ymeri H., – B., (2012) : *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, fq. 583.

18 A. & K. Agai, (1996) : *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, fq. 487.

19 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, fq. 646.

20 Ymeri H., – B., (2012) : *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, fq. 773 dhe Agai A. & Agai K., (1996): *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, fq. 638.

21 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S., *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, fq. 846.

22 Agai A. & Agai K., *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996, fq. 522.

23 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S., *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, 1981, fq. 691.

24 Agai A. & Agai K., *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996, fq. 600.

25 H. Ymeri – B., (2012) : *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, f. 737.

26 A. Zajmi, M. Bardhi, S. Drini, L. Mulaku, G. Luboteni, S. Imami, (1981) : *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, f. 797.

27 Ymeri H.- Bina, (2012) : *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, f. 124.

28 Agai A. & Agai K., (1996) : *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, f. 131.

29 Zajmi A., Bardhi M., Drini S., Mulaku L., Luboteni G., Imami S., (1981) : *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë, f. 172.

30 Agai A. & Agai K., (1996) : *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, f. 136.

31 Ymeri H.- Bina, (2012) : *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup, f. 127.

32 Në këtë fjalor përveç se shpjegohet fjala maqedonisht, jepet edhe fjala gjegjëse anglisht dhe shqip.



**Единица** – 1. shifra e fundit e një numri shumëshifror. 2. njësh, notë e dobët. 3. njësi matjeje. 4. njësit ushtarak. 5. vajzë e vetme.<sup>33</sup>

**1. Бројка со која се бележи природниот број еден.**

*Англиски:* one *Албански:* njësh

Вид: број (м.)

**2. Последната цифра во повеќецифрените броеви, класа на единици.**

*Албански:* njëshe

Употреба: Математика

**3. Најниска, слаба оценка во образованието.**

*Албански:* njësh, e dobët

Употреба: Образование

Слично со: кец (м.)

**4. Тој или таа што е означено со бројката еден  
(играч во спортот натпреварувач, превозно средство, просторија).**

*Албански:* njëshi, i pari

**5. Големина, мерка според која се мерат други големини  
(за тежина, должина итн.)**

*Англиски:* unit *Албански:* njësi

Употреба: Физика

**6. Дел од некаква целина, изделен поради посебноста на делокругот  
на дејноста, неговите специфични задачи, цели и сл.**

*Англиски:* unit *Албански:* njësi

Употреба: Административен термин

<sup>33</sup> Ymeri H., Osmani Z., (2000) : *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, f. 87 dhe Ymeri H., Osmani Z., (2008) : *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, f. 175.

Примери:

*воена единица*

*пешадиски единици*

*противпожарна единица*

*производствена единица*

## **7. Определен составен дел, елемент од некој систем, множество, збир.**

*Англиски: unit Албански: njësi*

Примери:

*јазична единица* <sup>34</sup>

**Оддел** – 1. pjesë e një lokali. 2. kupe treni. 3. pjesë teksti a libri; paragraf. 4. njësi administrative, seksion, departament, degë, <sup>35</sup> repart.

*мн. оддели*

Вид збор: *Именка, машки род*

Ранг: 3408

## **1. Составен дел од организација, институција, установа.**

*Англиски: department Албански: seksion*

Примери:

*Хируршки оддел.*

*Одделот за образование при Општината.*

Слично со: отсек (м.)

## **2. Дел, заглавие на книга, весник и сл.**

---

<sup>34</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0>

<sup>35</sup> Ymeri H., Osmani Z., *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, f. 282 dhe Ymeri H., Osmani Z., (2008) : *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, 2000, fq. 493.

Англиски: section Албански: pjesë, seksion

Примери:

*Последниот оддел од трудот претставува сумирање на резултатите од истражувањето.*

### **3. Гранка, дисциплина од поширока област што се одликува со посебни карактеристики.**

Англиски: field Албански: fushë, disiplinë

Примери:

*Оддел за генетика во рамките на биотехнологијата.*<sup>36</sup>

**Одделение** – 1. klasë (në shkollë fillore). 2. pjesë a degë e një institucioni.<sup>37</sup>

*мн. одделенија*

Вид збор: *Именка, среден род*

Ранг: 1299

### **1. Составен дел од организација, институција, установа.**

Англиски: department Албански: njësi

Употреба: Административен термин

Примери:

*одделение за интензивна нега*

*трауматолошко одделение*

Слично со: оддел (м.)

### **2. Клас во основно училиште.**

<sup>36</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D0%BE%D0%B4%D0%B4%D0%B5%D0%BB>

<sup>37</sup> Ymeri H., Osmani Z., *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, f. 282 dhe Ymeri H., Osmani Z., (2008) : *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, 2000, fq. 493.

Англиски: class Албански: klasë

Употреба: Образование

Примери:

*Поради отсуство на наставничката двете одделенија ги споија.*

*прво одделение*

Слично со: паралелка (ж.)

## Изведенки

### 1. одделенски прид.

одделенскиот

Што се однесува на одделение.

Пример: одделенски раководител

### 2. одделенец м.

мн. одделенци <sup>38</sup>

Одред – repart, aradhe (ushtarake),<sup>39</sup> detachment.

### 1. Воена единица или вооружена организирана група со борбена задача.

Англиски: detachment Албански: njësit, detachment

Употреба: Воен термин

Примери:

*Партизански одреди.*

*Командант на одредот.*

*Одред од педесетина луѓе.*

### 2. Организирана група со организација слична на воената.

Англиски: department Албански: repart

---

<sup>38</sup> <http://www.makedonski.info/>

[search/%D0%BE%D0%B4%D0%B4%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5](http://www.makedonski.info/search/%D0%BE%D0%B4%D0%B4%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5)

<sup>39</sup> Ymeri H., Osmani Z., *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, 2000, f. 284 dhe Haki Ymeri; Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, 2008, fq. 497.

Примери:

*Извиднички одред.*<sup>40</sup>

**Отсек** – 1. ndarje, pjesë, 2. seksion, degë, 3. segment.<sup>41</sup> repart.

*мн. отсеци*

Вид збор: *Именка, машки род*

Ранг: 15706

### **1. Дел од некоја целина.**

*Англиски: part Албански: pjesë*

Примери:

*Композицијата е поделена на педесет и шест тактови, поделени на четири отсеци.*

Слично со: дел (м.)

### **2. Внатрешна организациска единица во едно одделение на некоја установа, управен орган или сл.**

*Англиски: department Албански: repart*

Употреба: Административен термин

Примери:

*Јас сум референт во станбен отсек.*

*Правен отсек.*

Слично со: одделение (ср.)

### **3. временски период**

<sup>40</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D0%BE%D0%B4%D1%80%D0%B5%D0%B4>

<sup>41</sup> Ymeri H., Osmani Z., *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, 2000, f. 300 dhe Ymeri H., Osmani H., *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, 2008, fq. 523.

Англиски: period Албански: periudhë

Примери:

*Час е отсек на време што трае 60 минути.*

*временски отсек*

Слично со: период (м.)

#### **4. Отсечен дел, отсечка, отсечок.**

Англиски: segment Албански: segment

Употреба: Математика

Слично со: отсечок (м.)

#### **5. Место каде што е брегот обронат и стрмен.**

Англиски: abyss Албански: humnerë

Употреба: Геологија

Слично со: амбис (м.) <sup>42</sup>

**Департман:**

*мн. департмани*

Вид збор: *Именка, машки род*

Ранг: 33117

#### **1. Административно-територијална единица во некои земји (на пр. во Франција).**

Англиски: department Албански: repart

Примери:

*Направен е пустош во четиринаесет департмани.*

---

42 <http://www.makedonski.info/search/%D0%BE%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%BA>

Слично со: област (ж.) , околија (ж.)

## **2. Министерство за надворешни работи во некои земји (Швајцарија, САД).**

*Англиски:* department *Албански:* ministrija e punëve të jashtme

## **3. Управно одделение на повисока установа во некои земји.**

*Англиски:* department *Албански:* repart <sup>43</sup>

1. назив за регионална заедница (околија, округ) во некои земји, посебно во Франција; 2. во САД : Министерство за надворешни работи. <sup>44</sup>

## **Сектор:**

### **1. Дел од круг ограничен од лак и два радиуса.**

*Англиски:* sector *Албански:* sektor

Употреба: Математика

Примери:

*рамен сектор*

### **2. Дел од некое пространство, подрачје.**

*Англиски:* sector *Албански:* zonë

Примери:

*секторот на одбраната*

*источниот сектор на фронтот*

Слично со: подрачје (ср.)

<sup>43</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D0%B4%D0%B5%D0%BF%D0%B0%D1%80%D1%82%D0%BC%D0%B0%D0%BD>

<sup>44</sup> Микуновик Љ., *Современ лексикон на странски зборови и изрази*, Иро наша книга, Скопје, 1995, fq. 154.

### **3. Оддел на установа или организација со определена специјализација.**

*Англиски: sector Албански: sektor*

Употреба: Административен термин

Примери:

*Продажниот сектор на претпријатието.*

Слично со: одделение (ср.)

### **4. Дел од стопанството со определени економски и социјални признаци.**

*Англиски: sector Албански: sektor*

Употреба: Економија

Примери:

*приватниот сектор*

*државниот сектор*<sup>45</sup>

1. исечок, дел од круг; 2. изрезок, дел од кугла. 3. дел од воен фронт;
4. подрачје, делокруг на работа; 5 дел од пат.<sup>46</sup>

### **Секција:**

**Оддел или пододдел на установа, организација со определена специјалност; подраздел на конгрес, конференција и сл.**

*Англиски: section Албански: seksion*

Примери:

*младинска секција*

*работата на секциите на друштвото*

---

<sup>45</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D1%81%D0%B5%D0%BA%D1%82%D0%BE%D1%80>

<sup>46</sup> Микуновик Љ., *Современ лексикон на странски зборови и изрази*, Иро наша книга, Скопје, 1995, fq. 538.



*Конгресот работи по секции.*

Слично со: оддел (м.)

## **2. Дел на некој градежен систем, на некоја машина или уред, блок.**

*Англиски: section Албански: seksion*

Употреба: Технологија

Примери:

*секцијата на каналите*

Слично со: блок (м.)

## **3. Дел од пат или пруга, сектор.**

*Англиски: section Албански: sektor*

Слично со: сектор (м.)

## **4. Расечување на труп.**

*Англиски: dissect Албански: copëtoj*

Употреба: Медицина

Слично со: расечување (ср.)

## **5. Географска карта на помало подрачје <sup>47</sup>**

1. отсек, оддел, дел од установа или организација, подраздел на конгрес, конференција и сл. 2. дел од еден пат, од една сообраќајница; 3. географска карта на помало подрачје.<sup>48</sup>

Нë vijim po japim disa përdorime konkrete nga rajoni vetëm me fjalën **sektor**, p.sh.:

Сектори për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit

<sup>47</sup> <http://www.makedonski.info/search/%D1%81%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0>

<sup>48</sup> Микуновиќ Љ., *Современ лексикон на странски зборови и изрази*, Иро наша книга, Скопје, 1995, fq. 539.

Sektori për Procedurë Administrative të Shkallës së Dytë, Konteste Administrative dhe Arkëtim të Kërkesave

Sektori për Revision të Brendshëm

Sektori për integritime europjane

Sektori për sigurim shëndetësor dhe ndjekje të punës se FSSHM

Sektori i teknologjisë së informatikës dhe komunikimit

Sektor për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndihmë teknike në kabinet

Sektori për menaxhim me kriza në sektorin e shëndetëse dhe donacionet

Sektori për çështje normative ligjore dhe administrative

Sektori për punë të përgjithshme

Sektori për mbrojtje preventive shëndetësore

Sektori për mbrojtje primare shëndetësore

### **Сектори во министерството за економија**

Сектор за координација на активностите на министерот

Сектор за управување со човечки ресурси

Сектор за финансиски прашања

Сектор за правни работи

Сектор за европска интеграција

Сектор за внатрешен пазар

Сектор за меѓународно - трговска соработка

Сектор за енергетика

Сектор за минерални суровини

Сектор за индустриска и инвестициска политика и општествена одговорност

Сектор за претприемништво и конкурентност на малите и средни претпријатија (мсп)

Сектор за туризам и угостителство

Сектор за информатичка и комуникациска технологија

Zyra e Burimeve Njerëzore (Tiranë)

Sektori i Burimeve Njerëzore (Kosovë)

Sektori i Burimeve Njerezore (Mallakstër)

Sektori i ndërtimit (Tiranë)

Sektori i ndërtimtarisë (Maqedonia e Veriut)

Sektori për inspeksion financiar në sektorin publik (Maqedonia e Veriut)

Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (Kosovë)

Në disa institucione për të njëjtat nëndarje përdoren termat *njësi*, *degë*, *zyrë* etj.

Ka edhe raste kur për disa terma apo togfjalësha (sintagma) zhvillohet debat shumë i flaktë mes gjuhëtarëve dhe vështirë se mund të argumentohet plotësisht se cili nga variantet që jepet si mundësi është më i saktë për shkak se ndikojnë shumë faktorë. Përveç përzgjedhjes së termit, mosharmonizimi mes këtyre emërtimeve vërehet edhe te përdorimi i shkronjës së madhe. Në disa institucione të gjitha shkronjat nistore të emrit të sektorit shkruhen me shkronjë të madhe, ndërsa në disa institucione vetëm fjala *sektor* shkruhet me shkronjë të madhe e pastaj emërtimi vazhdon me shkronja të vogla.

## PËRFUNDIME

Nga e gjithë kjo që u shtjellua më sipër po vërehet se për të njëjtën fjalë ka shumë sinonime herë të plota e herë të pjesshme, por që vazhdimisht qarkullojnë dhe ngatërrohen njëra me tjetrën, duke shkaktuar hamulli dhe paqartësi të plotë. Kjo nuk ndodh vetëm gjatë përkthimit, por edhe gjatë të hartuarit e teksteve qoftë shqip e qoftë maqedonisht. Faktorët që kanë shkaktuar këtë larmi të termave në përdorimin e administratës në Maqedoninë e Veriut, në Shqipëri dhe në Kosovë janë të shumtë, duke filluar nga: faktorët e traditës së institucioneve; të ndikimit të gjuhëve dhe të kulturave të huaja; rregullimi juridik dhe administrativ i ndryshëm në këto tri shtete; çështjet e stilit dhe parapëlqimit individual të hartuesve dhe përkthyesve; burimi i gjuhës së tekstit të hartuar (në Maqedoninë e Veriut gati se gjithmonë shqipja është gjuhë e përkthyer) e shumë faktorë të tjerë.

Meqë të gjithë shqiptarët kudo në botë kemi një alfabet, një shqipe standarde të përbashkët për të gjithë, duhet që edhe terminologjia e të gjitha fushave të jetë e njësuar. Tash detyrë kryesore dhe tepër e vështirë e albanologëve do të jetë, së pari njësimi i terminologjisë administrative e më tutje edhe i fushave të tjera. Si fillim, duhet të përcaktohen qartë e mirë dhe të argumentohet se cili term duhet përzgjedhur për përdorim. Në qoftë se nuk mund të njësohet ndonjë term për arsye jashtëgjuhësore, por mbase edhe për arsye gjuhësore, atëherë të sqarohet hollësisht arsyeja. Kjo do të ndihmojë dhe do të lehtësojë punën e përkthyesve që të mos ketë hamendje, sepse deri tash secili përkthyes ka bërë përzgjedhjen e vet lidhur me cilën fjalë si do ta përkthejë.

Nga përvoja e shteteve të tjera lidhur me këtë çështje (p.sh. Tiroli i Jugut) është konstatuar se kjo punë zgjat me dekada, prandaj lypset vullnet, përkushtim, punë serioze dhe durim. Këtu do ta veçoja edhe tolerancën, sepse për disa terma apo shprehje që nuk ka argumente shkencore, por janë thjesht çështje stili dhe traditë përdorimi, do të duhet që ndonjëra nga Akademitë e Shkencave (e Maqedonisë së Veriut, e Shqipërisë ose e Kosovës) dhe qeveritë e tyre të lëshojë pe, duke hequr dorë nga tradita e deritashme dhe të fillojë të përdorë termin apo shprehjen e përzgjedhur nga grupi i specialistëve të fushave përkatëse dhe gjuhëtarëve më eminentë.

### **Rekomandime për hapat e zgjidhjes së problemeve**

- Të organizohen takime pune me një grup gjuhëtarësh dhe juristësh nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova dhe diaspora, të cilët do të përcaktojnë saktësisht se çka duhet të ngërthejë në vete termi sektor, çka është më e madhe dhe më e vogël se ajo si nëndarje.

- Nëndegët e saj duhet të jenë: njësi apo seksione apo çka?
- Për të gjitha nënndarjet që janë trajtuar në këtë kumtesë, të definohen saktësisht kuptimet e parme, të radhiten në mënyrë hierarkike dhe të mos jenë sinonime, por me përpikëri të kuptohet dallimi i tyre.
- Të gjithë termat të krahasohen me përdorimin praktik në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Kosovë.
- Të intervenohet te fjalorët ekzistues (duke u futur të gjitha shpjegimet), sidomos në fjalorët elektronikë, në softuerin që do të përpilojë AZGJ-ja dhe në programe elektronike që do të jenë të qasshme për secilin njeri, në ribotime të fjalorëve të shtypur të plotësohen sqarimet dhe të ndryshohet përkufizimi i tyre.
- Të bisedohet me qeveritë e të tria shteteve që të bëhet marrëveshje për ta ndryshuar përdorimin e deritanishëm.

## BIBLIOGRAFIA:

- ZAJMI A., BARDHI M., DRINI S., MULAKU L., LUBOTENI G., IMAMI S., (1981): *Fjalor shqip - serbokroatisht*, Prishtinë.
- AGAI A. & AGAI K., (1996) : *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup.
- Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1954) : *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1980): *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*.
- Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1984): *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë.
- Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (1954): *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- JASHARI A., (2007): *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Grup autorësh, (2000): *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*, Mitrovicë.
- YMERI H. - BINA, (2012): *Fjalor shqip – maqedonisht*, Logos-A, Shkup.
- YMERI H., OSMANI Z., (2000): *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup.
- YMERI H., OSMANI Z., (2008): *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup.
- ТНОМАЈ Ј., (1999): *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- ВЕЛЈАНОВСКА К., (2006): *Фразеолошките изрази во македонскиот јазик (со осврт на соматската фразеологија)*, Македонска ризница, Куманово.
- МИРТО Љ., (2008) : *Фразеолошки споредби меѓу албанскиот и македонскиот јазик*, Скопје.
- МИЌУНОВИЌ Љ., (1995): *Современ лексикон на странски зборови и изрази*, Иро наша

книга, Скопје.

TASE P., (2006) : Fjalorth i ri, Tiranë.

ДИМИТРОВСКИ Т., КОРУБИН Б., СТАМАТОСКИ Т., (1961): Речник на македонскиот јазик (со српскохрватски толкувања), А-Н, Скопје.

ДИМИТРОВСКИ Т., КОРУБИН Б., СТАМАТОСКИ Т., (1965): Речник на македонскиот јазик (со српскохрватски толкувања), О-П, Скопје.

ДИМИТРОВСКИ Т., КОРУБИН Б., СТАМАТОСКИ Т., (1996): Речник на македонскиот јазик (со српскохрватски толкувања), Р-Ш, Скопје.

NUHIU V., (2002): Fjalor shprehjesh frazeologjike (Anglisht-Shqip), Prishtinë.

LABROSKA V., SULEJMANI B., YMERI H. – BINA, ATANASOV P., (2016): Fjalor maqedonisht – shqip dhe shqip – maqedonisht, Shkup.

ДИГИТАЛЕН РЕЧНИК НА МАКЕДОНСКИОТ ЈАЗИК: <http://www.makedonski.info/>

# PËR HARTIMIN E NJË FJALORI TERMINOLOGJIK SISTEMOR PËRKUFIZUES TË SË DREJTËS

**Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu**

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E- mail: eda.shehu@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Deri në ditët e sotme në botë dhe në vendin tonë fjalorët e çdo tipi e paraqesin lëndën leksikografike në rend alfabetik. Megjithatë, përveç kësaj ekziston edhe forma e paraqitjes së informacionit terminologjik në formë sistimore, duke i dhënë termat të lidhur konceptualisht njëri me tjetrin, çka e përforcon dhënien e kondensuar të informacionit shkencor përkufizimin e çdo termi. Kjo metodë e zbatuar për herë të parë nga austriaku i njohur E. Vyster (Wüster), është praktikuar në vendin tonë në hartimin e “*Fjalorit të termave themelore të bujqësisë*” (2006) (sistemor me përkufizime). Bazuar në modelin e Fjalorit të mësipërm kemi menduar të paraqesim në këtë studim një *Para-projekt* për hartimin e një fjalori terminologjik sistemor përkufizues të së Drejtës. Në bazë të modelit të Fjalorit terminologjik të bujqësisë në këtë studim jepen në mënyrë sintetike e skematike fazat kryesore të punës që duhen ndjekur për hartimin e Fjalorit që mund të ndërmarrim në të ardhmen: skematizimi i fushës, paraqitja e lëndës në sistem dhe e përkufizuar, hedhja e lëndës në skeda të informatizueshme, nxjerrja e Fjalorit dhe treguesit në gjuhë të huaj.

**Fjalët çelës:** model fjalori, fjalori terminologjik sistemor përkufizues të së Drejtës

## ON THE DESIGN OF A SYSTEMATIC AND DEFINING LAW TERMINOLOGY DICTIONARY

### ABSTRACT

Until today, in the world and in our country, dictionaries of every type present the lexicographic subject in alphabetical order. However, in addition, there is also the form of presentation of terminological information in a systematic form, giving the terms conceptually related to each other, which reinforces the condensed presentation of scientific information and the definition of each term. This method, implemented for the first time by the well-known Austrian E. Vyster (Wüster), has been practiced in our country in the drafting of the “*Dictionary of basic terms of agriculture*” (2006) (system with definitions). Based on the model of the Dictionary above, we thought to present in this study a *Pre-Project* for the drafting of a systematic terminological dictionary defining Law. Based on the model of the Terminological Dictionary of Agriculture, this study presents in a synthetic and schematic way the main stages of the work that must be followed for the drafting of the Dictionary that we can undertake in the future: schematization of the field, presentation of the subject in the system and defined, placing the subject in computerized files, extracting the Dictionary and indicators in foreign languages.

**Keywords:** vocabulary model, systematic terminological dictionary defining Law

Deri në gjysmën e parë të shekullit të XX terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes në gjuhën shqipe, sikurse edhe në gjuhët e tjera të botës, janë katalogizuar në fjalorë terminologjikë në formë të renditjes alfabetike në dy tipa fjalorësh: në fjalorë përkthimore, gjuhë amtare / gjuhë e huaj (gjuhë të huaja) dhe gjuhë e huaj –gjuhë amtare, si edhe në fjalorë me përkufizime, me shpjegime (përkufizues ose shpjegues). Krahas këtyre dy tipash fjalorësh, që vijnë të hartohen e botohen kryesisht deri në ditët e sotme, për herë të parë studiuesi Eugjen Vyster<sup>1</sup>, i cili u bë babai i terminologjisë së shkollës së Vjenës, që me veprat e tij vuri bazat teoriko-metodike të terminologjisë, njëqind vite më parë, hodhi idenë e hartimit të një fjalori të veçantë përkufizues të tipit sistemor. Te kjo ide e çoi Vysterin zbulimi prej tij të karakterit sistemor të terminologjisë së çdo fushe dije, të organizuar në sistem termash, që i përgjigjen sistemit konceptor të fushës përkatëse. Kjo sistemësi e termave, sipas tij mbështetet nga marrëdhënie konceptore, që vendosen ndërmjet temave, siç janë marrëdhëniet ontologjike, e tëra / pjesa dhe marrëdhëniet funksionale. Mbi bazën e këtyre marrëdhënieve, sipas tij duhej bërë çdo vështrim e studim i terminologjisë, si edhe ndërtimi i fjalorëve terminologjikë, siç veproi dhe vetë, duke hartuar një fjalor të tillë.

Sipas vlerësimeve të mëtejshme të kësaj ideje (Piht<sup>2</sup> Sager<sup>3</sup> etj.), të zbatuar në fjalorët terminologjikë, dalin në pah përparësitë e paraqitjes në ta në sistem të informacionit terminologjik, që në fjalorët terminologjik e japin atë në mënyrë të copëzuar të shpërndarë, ku, siç nënvizon Pihti<sup>4</sup> “u pranëvihen sipas rendit alfabetik terma që shënojnë koncepte që janë larg njëri-tjetrit”. Ky këndvështrim i ri çoi më vonë në përpunimin e terminologjisë me metoda kompjuterike me bazë të gjera të dhënash në krijimin e bankave terminologjike, në vështrimin e çdo informacioni të paraqitur në Fjalor në formë të lidhur e të kondensuar, në risjelljen e tij sipas nevojës për përdoruesin nëpërmjet kompjuterit .

Duke përdorur Fjalorin<sup>5</sup> e Vysterit si model të përpunimit të terminologjisë dhe të paraqitjes në fjalorë sipas fushave të ngushta të dijes, hartohen sot në shkallë të gjerë standardet e terminologjive teknike, që vijon të krijohen edhe nga Drejtoria e Standardeve <sup>6</sup> në vendin tonë, në bashkëpunim me Institutin Teknik të Vjenës dhe me Departamentin e Informacionit që funksionon pranë tij.

Përveç punës që bëhet në Drejtorinë e Standardeve për hartimin e fjalësave

---

1 Wüster E., *Mezhdunarodnaja standartizacija v tehnike*, Standartgiz, Leningrad, Moskva, 1935.

2 H.Piht H., *Terminology: An Introduction*, Kopenhagen, 1985.

3 J.Sager J., *A practical course in terminology processing*, Amsterdam Philadelphia, 1990.

4 Piht H., shih 2.

5 Wüster E., *Machine Tool* (“Veglat prerëse), London Technical Press, 1968, vol.1.

6 Lafë E., *Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar* në “Gjendja dhe zhvillimi I terminologjisë shqipe” problem e detyra”, Tiranë, 2009.



(termesave) të fushave të ngushta teknike, hartimi i fjalorëve të këtij tipi, sidomos përfushat humanitare, nuk ka pasur mundësi të realizohej, për shkak të punës së madhe që kërkon hartimi i tyre, kërkesës për fonde financiare, forcave njerëzore: organizimin e punës, bashkërenditjen e proceseve në rang kombëtar, mbarëkombëtarë dhe ndërkombëtar.

Për herë të parë një Fjalor i një tipi të tillë, “sistemor përkufizues”, është hartuar disa vite më parë nga Departamenti i Leksikologjisë dhe i Terminologjisë (IGJL) në bashkëpunimin e një grupi të gjerë specialistësh dhe gjuhëtarësh terminologë: “Fjalor i termave themelorë të bujqësisë<sup>7</sup>, sistemor përkufizues, me barazvlerës në disa gjuhë të huaja (anglisht, frengjisht, italisht, rusisht), të numërtuar alfabetikisht.

Duke pasur këtë Fjalor si *model* mendojmë të paraqesim si *paraprojekt* hartimin në të ardhmen të një Fjalori të tipit të tillë (sistemor përkufizues) për fushën e së drejtës, me barazvlerës në disa gjuhë të huaja. Meqë hartimi i një fjalori të tillë kërkon një bashkërendim forcash njerëzore të kualifikuara dhe, sidomos bashkëpunim shumë të ngushtë, ku specialisti mban peshën kryesore të punës, mendoj se formimi im i dyfishtë dijon si specialiste në fushën e së drejtës (e diplomuar në këtë fushë) dhe si filologe (pedagoge e gjuhës ruse), më mundëson në të ardhmen për të qenë bashkautore në hartimin e një fjalori të tipit të tillë, çka lidhet me qëllimin që i kanë vënë vetes këta.

Për të realizuar qëllimin tonë do të paraqesim shkurt skematikisht disa ekstrakte nga Fjalori në fjalë, i hartuar nga IGSL “*Fjalor i termave bazë të bujqësisë* (sistemor dhe me përkufizime)”<sup>8</sup>. Këto të dhëna do të shtjellohen në mënyrë sintetike në *Paraprojektin* tonë, që lidhen me hartimin e një fjalori të tillë:

#### **A. Fazat e punës në fjalorin ekzistues (FJALORI I BUJQËSISË, SISTEMOR - PËRKUFIZUES)**


• Paraqitja skematike e terminologjisë në fjalë (e bujqësisë në fusha e nënfusha, deri në mikrofusha, nga ku ka filluar regjistrimi i lëndës në skeda dhe hedhja në kompjuter në mënyrë sistimore).

##### **a. Veçimi dhe identifikimi i mikrofushës (“Bletaria”) në fushën e dhënë – bujqësi, sipas Klasifikimi Dhjetor (Decimal) Universal (KDU)<sup>9</sup>**

7 “*Fjalor i termave themelorë të bujqësisë*” (Sistemor përkufizues) shqip – anglisht – frengjisht – italisht – rusisht), Tiranë, 2006.

8 Shih parathënien e “*Fjalorit të termave themelorë të bujqësisë*” “*Fjalor i termave themelorëtë bujqësisë*” (F.sistemor përkufizues) shqip – anglisht – frengjisht – italisht – rusisht), Tiranë, 2006”.

9 Me këtë *Sistem klasifikimi Ndërkombëtar* (KDU) janë pajisur pothuajse të gjitha bibliotekat (të mëdha e të mesme në vendin tonë)



b. **Krijimi i termësit (fjalësit) për çdo nënfushë**, i cili kryhet: a) me vjelje dhe b) drejtpërdrejtë nga specialisti (shih. 638.1 - Bletaria).

c. **Krijimi dhe plotësimi i skedës terminologjike**, duke paraqitur të dhënat rreth termit e konceptit dhe të dhëna të tjera.

**SKEDA TERMINOLOGJIKE (Ndërkombëtarisht e pranueshme) :**  
**Termi: bletari**

(Të dhënat)

1. Numër serial 4366	2. KDU 638.1.1	3. Termi standard <i>bletari</i>	4. Sinonime <i>bletërritje</i> <i>apikulturë</i>
5. Marrëdhënie Lloji + gjini <i>bletari / blegori</i>	6. Marrëdhënie pjesa e tëra (-----)	7. Shpjegime (-----)	
8. Konteksti (-----)	9. Përkufizime (a---b---c-----)	10. Përkufizimi standard (-----)	
11. Gjuhët e huaja (Ang., Fr., It.)	12. Figura (skema) (Nëse ka)	13. Burimet (Literatura e koduar)	
14. Data e hartimit (-----)	15. Autori (-----)	16. Redaktori (-----)	

**b) Treguesit e koduar të bazës së të dhënave**

- 1. NS - Numri serial
- 2. KDU - Kodi Decimal Universal (ose një sistem tjetër klasifikues)
- 3. Ts - Termi standard
- 4. Si - Sinonime
- 5. Sp - Sinonim i pranuar
- 6. Spp - Sinonim i papranuar
- 7. M.ll.gj. - Marrëdhënie lloj / gjini
- 8. M.p.t. - Marrëdhënie pjesa / e tëra
- 9. Sh - Shpjegime
- 10. Ko - Konteksti
- 11. Pr - Përkufizime

- 12. Prs - Përkufizim standard
- 13. A - Anglisht
- 14. Fi. - Figura (Nëse ka)
- 15. Bu. - Burimet (Literatura)
- 16. D.h. - Data e hartimit
- 17. Ha - Hartuesi
- 18. Red - Redaktori

**c) Krijimi i bazës së të dhënave**

**(Krijimi i bankës terminologjike)**

Hedhja e të dhënave të skedës në kompjuter në bazë të programit ISIS (në formën e bazës së të dhënave) (ose në bazë të një programi tjetër)

Formati i të dhënave për termin *bletari*

1. NS	4366	10.	Sh. Bletari
2. Ko.	-----	11. Pr	-----
3. KDU	638.1	12. Prs	-----
4. Ts	<i>bletari</i>	13. A.	bee –keeping,
5. Si	<i>apikulturë,</i> <i>bletërritje</i>	14. F.	apiculture.
6. Spp	<i>apikulturë</i>	15. Bu:	QN Bleta
7. Sp	<i>bletërritje</i>	16. D.h.	05.05.1994
8. M. Il. gj.	<i>bletar / blegtori</i>	17. Ha.	Selami Toro
9. M. p. t.	<i>bletari / insektet</i>	18. Red.	Agron Duro

**d) PRODUKTET e përftuara (Fjalori)**

a) Nxjerrja automatike e të dhënave sipas programit ISIS (ose programi tjetër): termi, përkufizimi, paraqitja sistimore, sinonimet, gjuhët e huaja

b) Nxjerrja automatike e treguesve të gjuhëve të huaja

(Ky fjalor është produkt i bazës terminologjike). (Lidhur përftimin e këtij fjalori duhet nënvizuar se vetëm një pjesë është modeluar si bankë (**bletaria**)).

#### e. Baza e fjalorit (me rend sistematik)

Paraqitja në formë të kufizuar nga Fjalori të përzgjedhur e termave **bletari** dhe **bletë** me të dhënat përkatëse:

366 **bletari**: degë e blegtorisë që përfshin tërësinë e njohurive mbi jetën dhe veçoritë biologjike të bletëve, praktikën e punës, jetës etj..  
a. bee – keeping; f. apiculture

4369. **bletë**: insekt i dobishëm me krahë, me trup të vogël, të mbuluar me push të verdhë .... etj.

s. bletari, bletërritje, apikulture

## II

#### f. *Treguesi anglisht* (në rend alfabetik)

bee – 4369

bee – keeping – 4366

## III


#### g. *Termësi shqip në rendin alfabetik me refernca dhe numra:*

bletë – 4369

bletari – 4366

## 2.FAZAT E PUNËS, TË PARASHIKUARA NË PARAPROJEKTIN PËR HARTIMIN E FJALORIT SISTEMOR PËRKUFIZUES TË FUSHËS TË SË DREJTËS

- Paraqitja skematike e terminologjisë në fusha, nënfusha e mikrofusha<sup>10</sup>.



2. Paraqitja e një termësi (fjalësi) nga mikrofusha, (nga nënfusha) *e drejta familjare*<sup>11</sup>: **birësim** (02.6 - 2536) në të cilin termat janë renditur në sistem në bazë të lidhjeve, të krijuara sipas marrëdhënieve konceptore të vendosura ndërmjet tyre. Këtu duhet nënvizuar renditja e termave në bazë të lidhjeve konceptore do të bëhet nga specialisti, duke i nxjerrë në bazë të kësaj lidhjeve nga termësi tërësor i mbledhur dhe i regjistruar në databazat e veçanta, kurse gjuhëtari do të jetë konsulent dhe bashkëpunues me të.

10 Për paraqitjen e fushës të së drejtës është shfrytëzuar *Udhëzuesi për studentët e së Drejtës*, “Danida”, Tiranë 2002-2003 (tek *Programet Akadematike sipas Departamenteve*).

11 Mandro – Balili A., *E drejta familjare*, Tiranë, 2009.

0.2.6. <i>birësim.</i>	2543 <i>prind biologjik</i>
↓	↓
2536 <i>birësues - i</i>	2544 <i>prind jobiologjik</i>
↓	↓
2537 <i>i birësuar - i</i>	2545 <i>familje e origjinës</i>
↓	↓
2538 <i>birësues - i</i>	2546 <i>birësim i vullnetshëm</i>
↓	↓
2539 <i>atësia</i>	2547 <i>birësim i pavullnetshëm</i>
↓	↓
2540 <i>amësia</i>	2548 <i>birësim vendës</i>
↓	↓
2541 <i>fëmijë i birësuar</i>	2549 <i>birësim ndërvendës</i>
↓	↓
2542 <i>bashkëshort birësues</i>	2550 <i>etj</i>

### 3. SKEDA TERMINOLOGJIKE: (Termi: BIRËSIM)

(Të dhënat)

1. Numri serial 2KDU 3. Përkufizimi 4. Termi standard 5. Sinonime 6. Sinonim i papranuar

2430

*birësim-i = adoptim-i adoptim*

7. Marrëdhënie funksionale 8. Gjuhët e huaja 9. Burimet 10. Data e hartimit 11. Autori 12. Redaktori

-----) (*birësim / birësues*) (-----) (Literatura e koduar) (-----) (-----) (-----)

#### 3.1. Treguesit e koduar të bazës së të dhënave:

1. NS	- Numri serial	7. M.f.	- Marrëdhënie funksionale
2. KDU	- Kodi Decimal Universal	8. A	- Anglisht
3. Ts	- Termi standard	9. Bu.	- Burimet
4. P.	- Përkufizimi	10. D.h.	- Data e hartimit
5. Si	- Sinonime	11. Ha	- Hartuesi
6. Sp	- Sinonim i pranuar	12. Red	- Redaktori
4.2 Spp	- Sinonim i papranuar		

#### 4. Krijimi i bazës së të dhënave

##### (Krijimi i bankës terminologjike)

Hedhja e të dhënave të skedës në kompjuter në bazë të program ISIS (ose programi tjetër) (në formën e bazës së të dhënave) Formati i të dhënave për termin *birësim*.

1. NS	2436	7. Mf	birësim / i birësuar
2. KDU	0.2.6 - 2436	8. A.	adoption
3. Ts	birësim	9. Bu	Arta Mandro, Ef. Tiranë, 2020
4. Si	birësim, adoptim	10. D.h	05.05.2025
4.1. P.	procedurë e marrjes së fëmijës në ngarkesë përtëritje, arsimim, ushqim...	11. Ha	Arta Mandro
5. Spp	adoptim	12. Red.	Eda Shehu
6. Sp	birësim		

#### 4. PRODUKTET e përfuara (Fjalori)

a) Nxjerrja automatike e të dhënave sipas programit të caktuar: Termi, përkufizimi, paraqitja sistimore, sinonimet, gjuhët e huaja

b) Nxjerrja automatike e treguesve të gjuhëve të huaja

Ky fjalor është produkt i bazës terminologjike. Lidhur me përfitim të këtij fjalori duhet nënvizuar, se vetëm një pjesë është modeluar. (Këtu si shembuj: *birësim, birësues, i birësuar*)



## 6. Baza e fjalorit (me rend sistematik)

- I -

2536- <b>birësim-i</b> : procedurë e marrjes së një fëmije në ngarkim për rritje, edukim, arsimim, ushqim, etj.	2537- <b>i birësuar - i</b> : fëmijë i marrë në ngarkim për rritje, ushqim, edukim sipas një procedure ligjore të caktuar.	2538 - <b>birësuesi - i</b> : person që merr në ngarkim nga fëmijë për rritje, ushqim sipas një procedure ligjore.
<i>a. adoption;</i>	<i>a. adoptee;</i>	<i>a. adopter</i>
<i>f. adoption</i>	<i>f. adopté</i>	<i>f. adoptor</i>
<i>s. birësim, adoptim</i>	<i>s. i birësuar; i adoptuar</i>	<i>s. birësues, adoptues</i>

- II -

## 7. Treguesit në gjuhë të huaja

A (anglisht)	F (frengjisht)
<i>adoptee</i> 2537	<i>adopté</i> 2537
<i>adopter</i> 2538	<i>adopter</i> 2538
<i>adoption</i> 2536	<i>adoption</i> 2536

-III-

## 8. Fjalësi shqip në rendin alfabetik me referenca me numra

*birësimi* - 2536

*i birësuar* - 2537

*birësues* - 2538

etj.

## VLERAT E FJALORIT

1. Përmes dhënies së sistemuar të termave bëhet **paraqitja e kondensuar e dijes**, e sistemit të koncepteve: *birësim, birësues, i birësuar, fëmijë i huaj, fëmijë vendas* etj.

2. Ka vlera të mirëfillta njohëse, formuese, me të dhëna të hollësishme, **si përkufizimi, sinonimet, barasvlerësit e huaj** etj.

3. Ka vlerë për specialistët, sepse termi jepet me gjithë lidhjet në sistem, kurse paraqitja alfabetike i jep mundësi përdoruesit për të kërkuar e gjetur termin në çdo rast.

## Përfundime

Mbi bazën e kësaj përvoje duhet punuar në të ardhmen për krijimin e një baze të dhënash nga e gjithë lënda që qarkullon për të gjitha nënfushat e dhëna. E gjithë lënda më tej duhet ndarë sipas mikrofishave me paraqitje hierarkike. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e bankave terminologjike për çdo fushë, hartimin e fjalorëve terminologjikë sistemorë dhe me përkufizime. Mbi këtë bazë mundësohet hartimi i fjalorëve terminologjikë sipas nënfushave. Në këtë mënyrë realizohet detyra e përpunimit në sistem të terminologjive, duke i përqsur sistemet terminologjike shqipe me ato të huaja (të standardizuara)<sup>12</sup>, në bazë të parimeve të teorisë së përgjithshme të terminologjisë dhe të metodave të punës së saj.

Kjo do të ishte rruga e përfshirjes në sistem të terminologjive të shqipes në rrjetin ndërkombëtar të terminologjisë, duke u bazuar në terminologjitë që merren si gjedhe standardizimi në rrafshin ndërkombëtar, si, anglishtja, frëngjishtja, italishtja, rusishtja, gjermanishtja dhe spanjishtja.

## BIBLIOGRAFIA:

WYSTER E., (1935): *Mezhdunarodnaja standartizacija v tehnikе*, Standartgiz, Leningrad, Moskva.

PIHT H., (1985): *Terminology: An Introduction*, Kopenhagen.

SAGER J., (1990): *A practical course in terminology processing*, Amsterdam Philadelphia.

WYSTER E., (1968): *Machine Tool* (“Veglat prerëse”), London Technical Press, vol.1.

LAFE E., (2009): *Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar në “Gjendja dhe zhvillimi I terminologjisë shqipe”* problem e detyra”, Tiranë.

(2006): *“Fjalor i termave themelor të bujqësisë”* (Sistemor përkufizues) shqip – anglisht – frëngjisht – italisht – rusisht, Tiranë.

(2002-2003): *Udhëzuesi për studentët e së Dretjës, “Danida”*, Tiranë (tek Programet Akademike sipas Departamenteve).

---

12 Duro A., *Albanian Terminologies: Problems involved in elaboration and standartization*, Term Net News, Vienne, 1998.

MANDRO – BALILI A., (2009): *E drejta familjare*, Tiranë.

DURO A., (1998): *Albanian Terminologies: Problems involved in elaboration and standartization*, Term Net News, Vienne.

**THESARI SI FUSHË PËRDORIMI E TERMINOLOGJISË  
EKONOMIKE DHE FINANCIARE  
(PËRVOJË PËRKTHIMORE NGA GJUHA RUSE NË SHQIPE)**

**Prof. Asoc. Dr. Alma Pinari**

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike  
Dega e Gjuhës Ruse  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti i Tiranës  
E-mail: alma.pinari@unitir.edu.al

**PËRMBLEDHJE**

Problemi i përdorimit dhe unifikimit të terminologjisë ekonomike dhe financiare në fushën e Thesarit del në pah gjatë kalimit nga një gjuhë në tjetrën. Nisur nga përdorimi i kësaj terminologjie dhe kalimi nga gjuha shqipe në gjuhën ruse dhe anasjelltas, kuptojmë që formimi në rrugë të ndryshme i kësaj terminologjie sjell jo pak herë vështirësi dhe pështjellim gjatë procesit të përkthimit.

Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë problemin e funksionimit të termave financiarë dhe ekonomikë në fushën e thesarit mbi materiale nga gjuha shqipe në krahasim me rusishten, referuar anglishtes, si gjuhë nga e cila është huazuar shumë në këtë fushë të terminologjisë; Termat origjinale kombëtare dhe të huazuara analizohen për sa i përket ekuivalencës/mosekuivalencës së tyre; Bëhet një analizë krahasuese e materialit të gjuhës shqipe, me materialin e gjuhës ruse dhe angleze, e cila na lejon të identifikojmë midis tyre terma financiarë dhe ekonomikë të huazuar me funksione dominuese në fushën e thesarit si në gjuhën shqipe ashtu edhe ruse, por edhe terma me kuptime të ndryshme nga gjuha burimore. Ndaj mbledhja dhe unifikimi e tyre, ndoshta në një fjalorth për këtë fushë terminologjike, do ndihmonte sadopak për kalimin automatik nga njëra gjuhë në tjetrën, kërkesë kjo e kohës.

**Fjalët çelës:** thesari, buxheti, terminologji financiare, ekonomike, huazimi, unifikimi, shqip, rusisht, anglisht etj.

**TREASURY AS A SPHERE OF USE FINANCIAL AND ECONOMIC  
TERMS  
(BASED ON TRANSLATION EXPERIENCE FROM RUSSIAN TO  
ALBANIAN)**

**ABSTRACT**

The problem of the use and unification of economic and financial terminology in the Treasury field comes to the fore during the transition from one language to another. Based on the use of this terminology and the transition from the Albanian language to the Russian language and vice versa, we understand that the formation of this terminology in different ways often brings difficulties and confusion during the translation process.

In this paper, we will examine the problem of the functioning of financial and economic

terms in the field of treasury on materials from the Albanian language compared to Russian, referring to English, as a language from which much has been borrowed in this field of terminology; Original national and borrowed terms are analysed in terms of their equivalence/non-equivalence; A comparative analysis of the material of the Albanian language, with the material of the Russian and English languages, is made, which allows us to identify among them borrowed financial and economic terms with dominant functions in the field of treasury in both the Albanian and Russian languages, but also terms with different meanings from the source language. Therefore, their collection and unification, perhaps in a dictionary for this terminological field, would help a little for the automatic transition from one language to another, which is the need of the hour.

**Keywords:** treasury, budget, financial terminology, economic, borrowing, unification, Albanian, Russian, English, etc.

Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe është e zhvilluar në masë të konsiderueshme, mirëpo, hulumtimet shkencore dhe akademike gjatë kohës janë shumë të kufizuara, duke lënë kështu një zbrazëti në përdorimin e saj më të gjerë dhe njësuar në segmente përkatëse. Edhe pse gjuha shqipe ka qenë dhe është nën ndikimin e shprehjeve të gjuhëve tjera, ajo megjithatë ka arritur ta ruajë mëvetësinë në disiplinat shkencore, duke përfshirë ekonominë. Ndikimi më i madh në këtë terminologji si në shumicën e gjuhëve të botës padyshim ka ardhur nga gjuha angleze që përkton me zhvillimin e ekonomisë globale, ekonomisë si shkencë e veçantë shoqërore, zbulimet e reja shkencore etj. Së fundi, globalizimi ekonomik sjell fjalë të reja, përkthimi i dobët i të cilave shpesh nuk ndryshon nga fjalët burimore. Pavarësisht pranisë së termave dhe fjalëve të mëhershme me origjinë nga gjuhët tjera, duket se mbajtja e tyre në përdorim është më e leverdishme se kalimi nga huazimet e një gjuhe me ndikim në tjetrën sipas „nevojës” ose „trendit” nga rrymat joprofesioniste që nuk ka sjellë ndonjë përmirësim, por më tepër e ka vështirësuar kuptimin e gjerë të terminologjisë nga shumica e atyre që gjuhë amtare e kanë shqipen.

Aktualisht, ekziston një proces i zhvillimit të shpejtë të terminologjisë speciale në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore të individit dhe shoqërisë. Një nga këto fusha financiare dhe ekonomike është Thesari, i cili ka një historik të gjatë zhvillimi si në vendet e Lindjes ashtu edhe në Evropë, dhe konkretisht në Shqipëri. Studimi i formimit të termit dhe i përdorimit të termit në fushën e thesarit karakterizohet nga ndërkombëtarizimi, d.m.th. funksionimi i një numri të madh termash ndërkombëtarë në një kohë kur ekziston edhe një numër i caktuar termash kombëtare. Përputhshmëria, komplementariteti i tyre përbën terminologjinë në fushën e thesarit.

Studimi i kushteve të thesarit, si element përbërës i një shtrese të gjerë të termave financiarë dhe ekonomikë dhe gjuhës profesionale, është relevant si në aspektin e gjuhësisë së përgjithshme ashtu edhe në atë të gjuhësisë krahasuese. Pse terminologjia në fushën e Thesarit?

Problemi i përdorimit dhe unifikimit të terminologjisë ekonomike dhe financiare në fushën e Thesarit del në pah gjatë kalimit nga një gjuhë në tjetrën. Nisur nga përdorimi i kësaj terminologjie dhe kalimi nga gjuha shqipe në gjuhën ruse dhe anasjelltas, kuptojmë që formimi në rrugë të ndryshme i kësaj terminologjie sjell jo pak herë vështirësi dhe pështjellim gjatë procesit të përkthimit.

Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë problemin e funksionimit të termave financiarë dhe ekonomikë në fushën e thesarit mbi materiale nga gjuha shqipe në krahasim me rusishten, duke iu referuar anglishtes, si gjuhë nga e cila është huazuar shumë në këtë fushë të terminologjisë; Termat origjinale kombëtare dhe të huazuara analizohen për sa i përket ekuivalencës/mosekuivalencës së tyre; Bëhet një analizë krahasuese e materialit të gjuhës shqipe, me materialin e gjuhës ruse dhe angleze, e cila na lejon të identifikojmë midis tyre terma financiarë dhe ekonomikë të huazuar me funksione dominuese në fushën e thesarit si në gjuhën shqipe ashtu edhe ruse, por edhe terma me kuptime të ndryshme nga gjuha burimore.

“Problemi i studimit të gjuhëve profesionale dhe terminologjive të industrisë ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e gjuhëtarëve, por kohët e fundit është bërë veçanërisht e rëndësishme në lidhje me studimin aktiv të specifikave të imazhit profesional të botës.

Në qendër të veprimtarisë profesionale të specialistëve të bankës dhe ekonomisë është puna me dokumente zyrtare, kështu që merr rëndësi të veçantë përkthimi i dokumentacionit financiar dhe ekonomik. Nga përkthimi i saktë dokumentet financiare mund të ndikojnë në fatin e një transaksioni ose marrëveshjeje të madhe. Dokumentacioni ekonomik ndahet në pasqyra financiare, dokumentacion bankar, auditim, konkluzione, plane biznesi.

Përkthimi është një proces kompleks, rezultati i të cilit në secilin rast përcaktohet nga shumë njerëz faktorë që kërkojnë njohje të gjuhëve të huaja dhe amtare, si dhe njohje të kulturës, karakteristikat sociale të dy vendeve. Në procesin e përkthimit, ekziston një krahasim i ndërgjegjshëm i dy gjuhëve, si rezultat, përkthimi e çon bashkëbiseduesin në një kuptim adekuat të tekstit të huaj.

Përkthimi përdoret si mjet ndihmës për të kuptuar një tekst të huaj, si veprimtari njohëse që shërben si bazë për mësimin e ndërgjegjshëm të gjuhës. Prandaj, është e rëndësishme zotërimi i metodologjisë së përkthimit dhe përdorimi kompetent i saj gjatë punës me një tekst të veçantë.

Përkthimi financiar dhe ekonomik kërkon përdorim të saktë të termave. Një qëndrim sa më i kujdesshëm ndaj detajeve, dallohet nga qartësia dhe konciziteti i paraqitjes, pra, nga përkthyesi kërkohet të ketë jo vetëm njohuri të shkëlqyera të gjuhës, por edhe njohuri të veçanta në këtë fushë ekonomi, kontabilitet, marketing, specifika të punës së bankave dhe pjesëmarrësve të tjerë në veprimtaritë financiare

dhe ekonomike.

Leksiku mendor i të rinjve karakterizohet nga një numër anglicizmesh, të nxënë nga përditshmëria, qasja e jashtëzakonshme në informacione në nivel botëror, të cilët mund të shërbejnë si bazë për të krijuar fjalë të reja ose kuptime të reja më shprehëse. Ato mund të pësojnë ndryshime sado pak kuptimore, ndonjë ngjyrim ose nuancë shtesë, që e bën të pazëvendësueshme plotësisht fjalën shqipe me atë angleze: performancë-paraqitje apo performoi – u paraqit ose film – shirit, finalja – përfundimtarja – që do të thotë se ka raste kur nuk ekzistojnë mundësitë e përshtatjes së plotë. E ky punim ka për qëllim që të zbërthejë shkallën e njohurisë për koncepte të shenjuara me fjalë të huaja (kryesisht angleze të përzgjedhura nga fjalorë fjalësh të huaja), por të përdorshme në përditshmëri, në mënyrë që të vërtetohet nëse janë të informuar për kuptimin e disa prej tyre dhe sa i shfrytëzojnë me mjeshtëri mundësitë për pasurim semantiko-pragmatik të fjalëve të caktuara, më shumë të përhapura.

Shumë gjuhëtarë shqiptarë si Eqrem Çabej, Gjovalin Shkurtaç, Androkli Kostallari, Vesel Nuhiu e kanë konsideruar si të dëmshme shprehinë për ta vërsuar gjuhën me fjalë të huaja, e duke lënë anash thesarin kombëtar e autentik shqip, meqë huazimet e prishin gjuhën shqipe, siç është vërtetuar në periudha të hershme historike kur ajo ka qenë e rrezikuar nga asimilimi. Ato me lehtësi mund të shmangen nga përdorimi, kur e kanë korresponduesen shqipe, me ekuivalencë të plotë semantike, mirëpo vazhdojnë të përdoren dendurisht të të rinjtë për shkak të asocimit me nivel më të lartë intelektual dhe njohje të kulturave të huaja apo nevojë

për ta shfrytëzuar mundësinë për krijimin e fjalëve sociolektale.

## **Materiali dhe metodat**

Për ta dhënë një këndvështrim të shkallës së njohjes, prirjes dhe të përhapjes së këtij leksiku në shqipe, u është bërë anketë 100 të intervistuarve të moshës 18-35-vjeçare, me pyetje të hapura dhe të mbyllura, shoqëruar me një listë fjalësh, për të cilat i kanë dhënë përkufizimet e tyre, mbështetur në praktikat në përditshmërinë e tyre. Fjalët që janë zgjedhur për anketim/intervistë janë të pasqyruara në veprën “Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja” (1986) nga Mikel Ndreca. Ata janë testuar se sa i njohin ato semantikisht. Gjithashtu, janë pyetur se cilat fjalë të huaja parapëlqejnë t’i përdorin, në mënyrë që të nxirret një pasqyrë e saktë rreth prirjeve të tashme ndaj kësaj shtrese leksikore.

## **1. Gjuha terminologjike**

Dija gjuhësore nuk është e mjaftueshme për ta prodhuar tekstin e folur apo të shkruar pranueshëm në një fushë të specializuar, sidomos kur është fjala për diskurs serioz para një audience që është njohëse e fushës së caktuar. Për ta kryer një studim a hulumtim, paraprakisht duhen njohur kategoritë e konceptet e veçanta të një fushe, për t’i vënë përshtatshëm në përdorim termat teknikë ose për t’i ilustruar kategoritë shkencore, e që përbëjnë shtresë të rëndësishme leksikore.

Gjuha terminologjike ka cilësi të veçanta, meqë ka ngarkesë më të lartë e më komplekse semantike sesa ajo e zakonshme, e cila përfshin fjalë të përdorura shpesh në përditshmëri, për ç’arsye edhe tingëllojnë si të pahijshme për mirëqenien e një gjuhe. Megjithatë, qëndrimet duhet të jenë të peshuara sa i përket thirrjes për t’i refuzuar njësitë e huaja. Konceptet terminologjike bartin efekt më të fortë intelektual dhe ndonjëherë nuk i kanë gjegjëset e veta semantike. “Terminologjia gjithashtu shërben si mjet vlerësues, në atë se sa bën përparim një gjuhë...”<sup>1</sup>. Pra, në rastet kur i integron termat më të rinj e me përhapje botërore, i bie se ajo nuk i përjashton prirjet leksikore të reja. Dhe kështu, terminologjia mbetet ‘treva’ ku çdo gjuhë duhet t’i hapë dyert për njësi leksikore e tendencat e kohës. Kjo, sepse terminologjia e pranishme te diskursi i folësve buron nga nevoja për ta lehtësuar marrëveshjen mes studiuesve të një lëmi ose gjatë eksplorimit me gjedhet fjalëformuese, pa e cenuar materialin leksikor vetjak. Motivet kryesore të lindjes së fjalëve terminologjike janë: nevoja për ta shprehur dijen për koncepte të reja dhe për

---

<sup>1</sup> Maurais J., IX. Terminology and Language Planning. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam, 1993, fq. 115.

t'i emërtuar ato, në mënyrë që të përdoren aktivisht<sup>2</sup>. Duhet vënë në dukje se fjalët angleze në gjuhën shqipe nuk janë me shumicë nga terminologjia profesionale, por, të shumtën, janë nga lëmenjtë e sportit, të argëtimit, muzikës, politikës, po edhe nga fusha ekonomisë etj<sup>3</sup>. Kështu, elementet e huaja prekin, shpërndahen dhe vilen në krejt kontekstet përdorimore. Globalizmi, në radhë të parë, duhet të shihet dhe vlerësohet si dukuri sociologjike, që manifestohet pothuajse në të gjitha sferat e jetës së njeriut<sup>4</sup>.

Për të arritur në njohje të gjuhës terminologjike, studiuesit duhet ta njohin edhe disiplinën përkatëse, për shkak se “terminologjia përbën set termash që përdoren në një fushë specifike të dijes”<sup>5</sup>. Pra, duhet dije e specializuar për të depërtuar në leksikun e një dege, në veçanti njohjen e të gjithë termave që përfshihen në atë lëmë shkencor.

## 1.2 Huazimet gjuhësore terminologjike

E përfshirja e terminologjisë së një fushe ka dallim me depërtimin e fjalëve të papritura apo që i kanë korrespondueset e veta. “Terminologjia është aktivitet sistematik në të cilin ekspertët e fushave të ndryshme mbulojnë një fushë semantike, derisa në modernizmin leksikor sajohen fjalë pjesë-pjesë, pa përpjekje sistematike për ta mbuluar një fushë të tërë semantike”<sup>6</sup>. Kjo do të thotë se janë në një shkallë të pranueshëm termat identikë ndërkombëtarë edhe kur huazimi është plotësisht i integruar në sistemin e gjuhës marrëse. Ai në këtë stad nuk dallohet me tiparet fonologjike as fonetike nga fjalët e gjuhës marrëse<sup>7</sup>.

Sipas ekspertëve, huazimi realizohet në tri shkallë: shkalla e parë është transferimi - kur fjala është e paasimiluar dhe e papërshtatur, shkalla e dytë interferenca, kur ndërrohet forma që të arrihet deri diku përputhje mes gjuhësh. Faza e fundit është ajo e integritit - kur nuk hetohet se është huazim gjuhësor. Njësoj ngjan edhe me terminologjinë. Sipas Cabre<sup>8</sup>, terminologjia buron nga

---

2 Thomas P., Choosing headwords from language-for-special-purposes (LSP) collocations for entry into a terminology data bank (term bank). *Terminology. Applications in Interdisciplinary Communication*. John Benjamins, Amsterdam, 1993.

3 Nuhiu V., Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 24.

4 Munishi Sh., Shqipja në epokën e globalizmit. ZeroPrint, Prishtinë, 2015, fq. 18.

5 Hirs W., XV. The use of Terminological Principles and Methods in Medicine. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam, 1993, fq. 238.

6 Maurais J., IX. Terminology and Language Planning. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam, 1993, fq. 112.

7 Nuhiu V., (2013): Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 26.

8 Cabré M. T., (1999). *Terminology: Theory, methods, and applications* (Vol. 1). John Benjamins Publishing, Amsterdam, 1999, fq. 37.

nevoja e teknikëve e shkencëtarëve për t'i unifikuar konceptet dhe termat e fushave të tyre, për ta lehtësuar komunikimin profesional dhe transferuar dijen. Fjala e huazuar, në krahasim me fjalën e huaj, është e integruar më shumë sesa fjala e huaj në sistemin e gjuhës marrëse<sup>9</sup>.

Bloomfieldi e ka dalluar huazimin e drejtpërdrejtë, kur dy gjuhë fliten në një bashkësi unike, dhe të tërthortë me natyrë kulturore, atëherë kur ndodh mes dy kombesh që tipologjikisht nuk përbëjnë një njësi. Sa i përket bashkëpunimit me gjuhën angleze, e vetmja gjë që shqipja dhe anglishtja e kanë të përbashkët është fakti se që të dyja i përkasin familjes indoevropiane<sup>10</sup>. Pra kontakti i tyre është krejt kulturor, e nuk ekziston ndonjë predispozitë tjetër bashkëpunuese, pos faktit se ilustron një gjuhë universale që ka imponuar në një masë vërshimin leksikor. Faktorë si motivimi i shkencëtarit për të zbuluar diçka, vlerësimi i lartë i shoqërisë moderne për inovacion, trendi drejt interdisiplinaritetit dhe teknologjia kontribuojnë për kalimin më të shpejtë të dijes në fusha të ndryshme dhe në numër më të madh<sup>11</sup>.

## REZULTATET

### 2. Fjalët për të cilat janë pyetur

Në pyetjen: *A i njihni kuptimisht këto fjalë? Nëse po, tregojeni kuptimin e tyre*, të intervistuarve u është paraqitur një listë leksemash terminologjike, që janë të pasqyruara në fjalorin e dedikuar pikërisht për këto fjalë. Ato janë përzgjedhur nga vepra “Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja” nga Mikel Ndreca.

#### *Fjalët për të cilat janë pyetur dhe përqindja e njohësve të kuptimit*

Antagonist **65%** Autonome **21 %** Aneks **35%** Beneficion **96%** Apeloj **70%**  
Bluf **40%** Bedel **4%** Betonim **70%** Besëtytni **89%** Bojkotoj **80%** Dominim **100%**  
Demokraci **79%**

Degjeneroj **75%** Definim **69%** Dekan **91%** Denazalizëm **20%** Depozitohet **40%**  
Determinoj **49%** Dezertoj **85%** Dezinfektoj **100%** Dialekt **78%** Diategjë **34%**  
Diktafon **24%** Dilemë **89%**

9 Nuhiu V., Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 26.

10 Nuhiu V., Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 22.

11 Pavel S., Neology and phraseology as terminology-in-the-making. Terminology: Applications in interdisciplinary communication, 21, 34.:John Benjamins, Amsterdam, 1993, fq. 22.

Diletant <b>51%</b> Disident <b>10%</b> Ekspozitë <b>87%</b> Ekstradim <b>40%</b> Ekzekutoj <b>91%</b> Ekzaltoj <b>49%</b> Emancipim <b>77%</b> Emetoj <b>44%</b> Empirik <b>60%</b> Epilog <b>69%</b> Epope <b>72%</b> Esencë <b>100%</b>
Evident <b>100%</b> Falimentim <b>98%</b> Fatalitet <b>95%</b> Faunë <b>80%</b> , Filigran <b>39%</b> Kordele <b>100%</b> Kronologji <b>88%</b> Kualifikoj <b>90%</b> Kurban <b>100%</b> Labirint <b>71%</b> Laik <b>100%</b> Legalizoj <b>98%</b>
Likuide <b>73%</b> Linear <b>38%</b> Magnet <b>100%</b> Polarizim <b>90%</b> Poliklinikë <b>88%</b> Predikim <b>77%</b> Maksimë <b>44%</b> Marksizmi <b>59%</b> , Narciz <b>77%</b> Neurologjik <b>90%</b> , Nomenklaturë <b>0%</b>
Observacion <b>59%</b> , Obsesion <b>97%</b> Oratori <b>99%</b> Oriental <b>100%</b>

**Tab.1 Fjalët për të cilat janë pyetur dhe përqindja e të intervistuarve që e kanë ditur plotësisht ose përafërsisht kuptimin leksikor të fjalëve**

Vërehet se fjalët më të përhapura që riprodhohen si pjesë e gjuhës së përditshme, kanë përqindje të lartë njohjeje, derisa ato që janë të kufizuara vetëm në një rënë fushë profesionale ose fare pak të integruara, kanë përndarje më të ulët e rrjedhimisht, njihen dobët ose fare.

Ka pasur raste kur e kanë deshifruar kuptimin në bazë të pjesëve përbërëse të fjalës p.sh. *ortografi, ortoepi, pacifik* janë shpjeguar saktë, si rrjedhojë e njohjes së fjalëve latine, e në këto raste shfrytëzohet njohja e elementeve leksikore ekzistuese në mënyrë që të dekodohen saktësisht. Pra, “përveçqë siguron fjalët për t’i përshkruar konceptet në domene specifike, terminologjia është mënyrë për ta shfaqur dijen lidhur me një term të veçantë, për shembull të dhënat gjuhësore dhe konceptuale të tij...”<sup>12</sup>.

Disa prej tyre i konsiderojnë fjalë shqipe, pavarësisht se s’përkojnë fare me rregullsitë fonetike të saj. Dihet se aftësia qëndrestare e shqipes është arritur pikërisht me anë të rezistimit ndaj barbarizmave. Ato mund të shihen si vlerë pasuruese, atëherë kur mbushin boshllëqet leksikore dhe arrijnë të sjellin koncepte që më parë kanë qenë të panjohura për masën. Por, përdorimi i tepruar e i pakontrolluar e rrezikon mbijetesën e gjuhës, për shkak se pakujdesia dhe mospërfillja e standardeve për ruajtjen e gjuhës mund të ketë pasoja mbarëkombëtare. Një këmbëngulje e fortë, e vetëdijshme për mospranimin e tyre do të kontribuonte në ruajtjen e leksemave me rrenjë shqipe.


12 Thomas P., Choosing headwords from language-for-special-purposes (LSP) collocations for entry into a terminology data bank (term bank). Terminology. Applications in Interdisciplinary Communication. John Benjamins, Amsterdam, 1993, fq. 44.

## 2.1 Rezultatet e anketimit

Pasur parasysh se rrezja e fjalëve terminologjike shtrihet edhe në përditshmëri, krahas nevojave profesionale, u është dhënë një pyetësor 100 të intervistuarve 18-35-vjeçarë, në mënyrë që të kihet një pasqyrë lidhur me qëndrimet rreth diskursit të folur të ditëve të sotme që herë-herë është i ‘përmbytur’ me fjalë të huaja. Ata e kanë plotësuar pyetësorin dhe janë përgjigjur gojarisht më gjerësisht lidhur me shkaqet ose arsyetimet më të detajuara rreth opinionit të shprehur në njërin nga opsionet e zgjedhura.


Më poshtë janë dhënë pyetjet, statistikak dhe pjesë interpretimesh nga ta.

### 1. A besoni se terminologjia e huaj po e pushton fjalorin e të rinjve në përgjithësi?




Shumica e të intervistuarve vlerësojnë se fjalët terminologjike nga të gjitha fushat po e dominojnë gjuhën e tyre të përditshme. Ata theksojnë se ndonjëherë mund të depërtojnë pa vetëdije, e herë-herë qëllimisht futen për t’u dukur më kompetentë e ‘ndërkombëtarë’, por është e pamundshme që të shmangen plotësisht. Kjo, pasi teknologjia është bërë tashmë pjesë e pandashme dhe integrale e çdo ndërmarrjeje. Një e intervistuar thotë se prania e fjalëve të panevojshme në libra shkencorë po ashtu e ka efektin e vet në praninë apo përhapjen më intensive. Për këtë arsye, duhet planifikim dhe politikë gjuhësore e kujdesshme, me terminologji të përditësuar, e jo të vjetruar, me fjalë që s’janë fare aktive në leksik, e që vetëm e prishin bërthamën e vlerave të gjuhës. Të intervistuarit theksojnë se është detyrim që këto të jenë në anglishte, për shkak se lidhen me bartjen e drejtpërdrejtë nga ajo gjuhë dhe pasur parasysh intensitetin e qarkullimit në nivel botëror, nuk parapëlqejnë që ta imponojnë fjalën shqipe.

## 2. Sa mendoni se i përfshini fjalët e huaja në përditshmëri?



Pothuajse gjysma e të intervistuarve shprehin mendimin se është tepruar me anglicizma të pranishëm edhe në vetë leksikun e tyre. Ata thonë se jo gjithmonë i ndërpusin në mënyrë të qëllimshme apo të paramenduar, porse duke i dëgjuar jashtëzakonisht shpesh, janë kthyer si pjesë e leksikut aktiv të përditshmërisë së tyre. Thonë se ndonjëherë ua ndryshojnë domethënien atyre, duke i kthyer në sociolekte, p.sh. i drejtohen shoqes së ngushtë: *pie, wife, honey* etj., megjithëse i njohin korrespondueset shqipe. 7 të intervistuar thonë se nuk janë plotësisht të vetëdijshëm se ato e ndotin gjuhën dhe i përdorin duke e parë veten më të integruar në shoqërinë moderne, si dhe shtojnë se në secilën gjuhë përfshirja e anglishtes është e lidhur drejtpërdrejt me emrat origjinalë, e që janë vështirë të zëvendësueshëm në shqipe.


## 3. A mendoni se është duke u tepruar me përdorim të tyre?





Përpos kur ka raste plotësimesh të boshllëqeve semantike e mungesë të fjalës shqipe, ose kur ndihmojnë në krijimin e një gjuhe më shprehëse, fjalët e huaja nuk janë të shëndetshme për mirëmbajtjen e autenticitetit të gjuhës. E qëndrimi mbizotërues i të intervistuarve se po teprohet me leksik të huaj tregon se edhe ata janë të ndërgjegjshëm për stërpërdorimin e tyre në diskurs. Mirëpo, përmendin nuancat shtuese semantike në leksema të caktuara. Për shembull fjalët *xhentëlmen*, *donator*, nëse përdoren në vend të fjalëve shqipe, *fisnik*, *dhurues*, s'arrijnë të përmbushen plotësisht semantikisht nga këto fjalë. Pra, ka konotacione plotësuese, sepse nuk i kanë të gjitha semat ekuivalente kuptimore leksemat shqipe.

#### 4. A kanë ndikim negativ apo pozitiv këto fjalë për zhvillimin e përgjithshëm të gjuhës?



Në këtë pyetje shumica janë deklaruar se huazimet nuk shërbejnë në të mirë të gjuhës, për shkak se përdorimi i tepruar tregon mësymjen për t'u orientuar në kahe tjetër nga ajo autentike. E kjo dobësi nuk i leverdis aspak gjuhës. Siç e thamë, disa mendojnë se vishen me prestigj nëse ndërfitin fjalë të huaja. 35 të intervistuar e ndajnë bindjen se këto njësi leksikore e ngritin nivelin e gjuhës si dhe shërbejnë si urë lidhëse mes Kosovës e Amerikës. Megjithatë, që të mos kalojë në një dukuri shqetësuese, duhet ngritja e vetëdijes së përgjithshme për t'i mënjeluar ato në shtresat ku nuk ka nevojë të përdoren. Ajo që vërehet është se megjithëse te pyetjet e tjera deklarojnë se ato janë të dëmshme për gjuhën në qenësi, është interesante se një numër relativisht i madh i informantëve thonë se kjo është pjesë zhvillimi pozitiv, për shkak se hyjnë konceptet më 'moderne' e shtohet prirja drejt eksperimentimit me begati leksemash qoftë të huaja, e qoftë shqipe.

### 3. Fjalët e huaja që të intervistuarit i përdorin në përditshmëri

Një pyetje e hapur që u është shtruar ka të bëjë me fjalët të cilat kanë arritur të depërtojnë në leksikun e tyre mendor dhe u është kërkuar që t'i thonë ato konkretisht, në mënyrë që shihen konceptet përkatëse që kanë depërtuar ndjeshëm në fjalët që i zgjedhin.

Gjatë intervistës, janë ndeshur fjalë mjaft interesante, të cilat kanë thënë se i përdorin shumë shpesh:

*Disavantazh, case of study, playback, website, access, miting, suportim, deadline, start, penalti, juice, imazh, failure, calling, first class, konkludim, klip, make up, trend, flirt, fajll, tender, bord, koktej, sponsor, puding, fansa, fair, play, nokout, rekord, plejmejker, footballer, shopping, trajner, marketing, xhentëlmen, donator, follower, indikacion, online, gangster, klikim, busy, download, make up, selfie, formatim, presing, kamp, boss, gollmen, koktej, softuer, thriller, lider, spiker, singer, airbag, gloss, disk, chat, performancë, agjendë, devil, haphazard, apple, pie, ekspazion, konsekuencë, judge, tranzicion, challenge, check in, check out, ekzagjerim, evoluim, autostradë, xhip, single, date, online, check-up, kalibër, ekuilibrim, xhudge, singelleshë, drifta, kingeshë, nice, koshiencë, airbag, show, party, friend, browser, cookies suportim, aprovim, salutoj, skanoj, trendy, hacker, chat, direktivë, abonent, first lady etj.*

Siç shihet, shumë prej tyre si: *aprovim, ekspansion, implementim, fansa, friend, singer* i kanë fjalët shqipe me barasvlerë sinonimike. E përdorimi i tyre nga këta të intervistuar e folësit e tjerë në përgjithësi u jep rol zotërues leksemave të huaja. Kështu që kjo dukuri negative duhet shoqëruar me pasurim autentik me burim nga gurra gjuhësore, të fjalët që shprehin dukuri, marrëdhënie e koncepte të gjithëpërhapura, por edhe për realizimin kuptimplotë të komunikimit profesional. Shkalla kritike e depërtimit të tyre do të rrezikonte mbijetesën e gjuhës dhe folësit duhet të jenë syçelë për të mos hequr dorë nga lënda e brumi vetjak.

### 4. Nevoja për përfshirje/zëvendësim të fjalëve

Konceptet semantike që hyjnë në gjuhë duhen përfshirë brenda gjuhës marrëse përmes një lekseme, qoftë me anë të huazimit të drejtpërdrejtë, apo zëvendësimit të fjalës me një neologjizëm të prodhuar nga gjedhet fjalëformuese të gjuhës. “Gjuha duhet të jetë fleksibile dhe t’i përfshijë teknologjitë, idetë, ideologjitë e konceptet e reja”<sup>13</sup>. Për ta bërë këtë, hartuesi/ja e këtij fjalori duhet ta vërtetojë se a bëjnë pjesë në leksikun aktiv. Sidomos duhen përvetësuar e integruar brenda gjuhës termat që

---

13 REED, D. (1993): Some terminological Problems of Translating Common Laë Concepts from English to French. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam, fq. 84.

janë obligueshëm të rekomanduar për t'u mësuar e të përhapur, pra gjithëpërfshirës e të gjithpërdorshëm, mungesa e të cilëve do ta cenonte aftësinë shprehëse. Kur bëhet fjalë për dukuri të pranishme të gjithsecili, përmbushja e boshllëkut mund të arrihet me formime të brendshme të shqipes. Kjo ndodh sidomos kur mund të arrihet ekuivalencë e plotë semantike e konceptuale, që nuk do t'ia lëndonte në asnjë formë kuptimin e synuar.

Më poshtë është dhënë një listë fjalësh që janë përhapur pa vend në trajtën e shqipëruar

Fjala e huaj	Fjala e huaj	Fjala/sintagma shqipe shqipëruar
Approbation	Aprovim	Miratim
Implementation	Implementim	Zbatim
Participation	Participim	Pjesëmarrje
Leader	Lider	Udhëheqës
Revitalization	Rivitalizim	Ringjallje
Conscientious	Koshient	I vetëdijshëm
Indication	Indikacion	Shenjë
Handicap	Hendikep	Mangësi
Shopping	shopping	Pazar

**Tab.2. Shembuj fjalësh kur përshtatja fonetike e lehtëson integrimin e fjalës së huaj**

Siç tingëllojnë të njohura variantet 'shqipe' të këtyre fjalëve të huaja të paraqitura te rendi i dytë i tabelës, aq edhe janë të përhapura, për shkak se theksimi me rregulla fonetike shqipe jep përshtypjen se po i jepet përparësi fjalës shqip, kur në fakt ka vetëm modifikim të vogël shqiptimi. Megjithatë, edhe kur ka leksemë të barasvlershme, atyre mund t'u jepen konotacione për t'i plotësuar zbrazëtitë leksikore e pragmatike. Kështu, anglicizmat jo rrallë përdoren edhe si sociolekte, me ngjyrimë emocionuese shtesë. Mirëpo, veçanërisht kur fjala bashkë me konceptin lindin në një gjuhë, zëvendësimi i saj bën që të duken më të dobëta veçoritë pragmatike. P.sh. fjala facebook të thuhet e përkthyer në shqipe *faqe libri*, ose password: *fjalëkalim*, kompjuter – *llogaritës* – shihet qartë se nuk përcillen përmasat semantike njësoj. E për t'i sistemuar e organizuar më saktë konceptet, duhen ndarë edhe në formë të shkruar e shkencore shtresat e panevojshme leksikore që të mos prishet bërthama e gjuhës. Në sajë të punës së begatshme dhe përkushtimit të folësve, mund të ndalet përthithja e vazhdueshme dhe e pavend e tyre.

### **Përfundime**

Për fund mund të thuhet se ndryshimet drastike në ekonomi, përhapja e furishme e informacioneve, ndikimi kulturor në leksik, i kanë pasuruar gjuhët me fjalë e rrjedhimisht, koncepte të reja, të cilat gjejnë përdorim në sfera profesionale e përditshmëri. Studimi tregon se të rinjtë i njohin relativisht mirë konceptet e huaja, kryesisht nga ekspozimi ndaj tyre. Ato kanë depërtuar në shqipe thellë, edhe te diskursi i përditshëm. Purizmi i skajshëm natyrisht se është i pamundur, me gjithë përpjekjet e shumë autorëve që kanë bërë propozime për t'i ndryshuar fjalët e huaja gjegjëse. Kur një anglicizëm vjen bashkë me konceptin, pra s'ka korresponduese në shqipe, atëherë plotësohen zbrazëtitë leksikore, rrjedhimisht është plotësisht e arsyeshme hyrja e tij. Megjithatë, mospërfillja apo përtacia e folësve për t'i ruajtur leksemat shqipe dëshmon se ka mungesë vetëdijesimi për krijimin e imazhit botëror në dëm të ruajtjes së gjuhës. Çdo 'tolerim' do të shkaktonte ngulitjen e fjalës së huaj, dhe shmangie të burimeve autoktone të cilat e forcojnë qenësinë e gjuhës. Terminologjia duhet të përditësohet, riformulohet, të bëhet zëvendësim i pjesshëm aty ku ekziston mundësia, e të kontribuohet në nivel popullor për një fjalor gjithëpërfshirës, pa e cenuar aftësinë shprehëse. Paraprakisht duhen hartuar parimet e kriteret që do t'u përmbaheshin të gjitha proceseve të nevojshme për ta bërë fjalën funksionale, e që nuk e prish rendin fjalëformues.

### **BIBLIOGRAFIA:**

- CABRÉ M. T., (1999): *Terminology: Theory, methods, and applications* (Vol. 1). John Benjamins Publishing, Amsterdam.
- HIRS W., (1993): XV. The use of Terminological Principles and Methods in Medicine. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam.
- MAURAS J., (1993): IX. Terminology and Language Planning. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam.
- MUNISHI SH., (2015): *Shqipja në epokën e globalizmit*. ZeroPrint, Prishtinë.
- NUHIU V., (2013): *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- PAVEL S., (1993): Neology and phraseology as terminology-in-the-making. *Terminology: Applications in interdisciplinary communication*, 21, 34. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
- REED D., (1993): VII. Some terminological Problems of Translating Common Law Concepts from English to French. In *Terminology*. John Benjamins, Amsterdam.
- THOMAS P., (1993): Choosing headwords from language-for-special-purposes (LSP) collocations for entry into a terminology data bank (term bank). *Terminology. Applications in Interdisciplinary Communication*. John Benjamins, Amsterdam, 43-68.

# ROLI KUPTIMOR I GRUPIT TË FJALËVE NË TERMINOLOGJINË E DREJTËSISË

**Prof. Asoc. Dr. Shkëlqim Millaku**

Fakulteti i Filologjisë  
Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren  
E-mail: shkëlqim.millaku@uni-prizren.com

**Prof. Asoc. Dr. Dardan Vuniqi**

Fakulteti Juridik  
Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren  
E-mail: dardan.vuniqi@uni-prizren.com

## PËRMBLEDHJE

Përdorimi i grupit të fjalëve në *Fjalorin e termave të drejtësisë* ka një rol mjaft përmbajtësor dhe gjenerues. Grupi i fjalëve është i pasur në gjuhën shqipe dhe si i tillë është i shtrirë në gjitha sferat e jetës dhe në veçanti në atë të fushës së drejtësisë, kurse terminologjia e drejtësisë është një çështje interesante dhe e nevojshme për ta studiuar dhe analizuar. Në këtë punim do të analizohen grupet e fjalëve dhe kompozitat në *Fjalorin e termave të drejtësisë*, të cilat janë mjaft produktive dhe si të tilla kanë pasuruar, por edhe sfiduar kodifikimin tonë gjuhësor.

Fjala *kod* ka kuptimin e përmbledhjeve të sistemuar të normave juridike dhe si e tillë është gjeneruar edhe dhjetëra grup të fjalëve të tjera, si tipe të ngurosura p.sh: *Kodi Civil; Kodi Civil francez; Kodi Civil i Mbretërisë shqiptare; Kodi i procedurës civile; Kodi i procedurës penale; Kodi i sigurisë së llogarisë; Kodi penal; Kodi Penal Francez* etj., apo edhe fjala *kontratë* (lat. *contactus*) që është një veprim juridik, marrëveshje e dy a më shumë personave fizike apo juridike dhe si e tillë kanë krijuar grupe të fjalëve të tjera të ngurosura, pra fjala *kontratë* ka mundësi të gjenerimit me mbi *tetëdhjetë grupe të fjalëve*. Kjo fjalë në përdorimin e terminologjisë juridike dhe në aspektin e grupit të fjalëve ka bërë një shtrirje të madhe dhe të pranueshme, si: *Kontratë abstrakte, kontratë aderimi, kontratë adezioni, kontratë administrative, kontratë agjencioni, kontratë aksesore, kontratë autorizimi, kontratë bamirësie, kontratë bilaterale, kontratë bilaterale ndërkombëtare, kontratë dërgimi, kontratë dhurimi, kontratë detyrimi, kontratë huasë* etj. Në këtë studim kemi disa objektiva për t’i studiuar dhe analizuar dhe ato janë rolin e grupit të fjalëve dhe të kompozitave me përmbajtje të terminologjisë së drejtësisë.

**Fjalët çelës:** Grupet e fjalëve, kompozita, terminologjia e drejtësisë

## THE SEMANTIC ROLE OF THE WORD GROUPS IN THE JUSTICE TERMINOLOGY

### ABSTRACT

The use of the group of words in the Dictionary of Justice terms has a very substantive and generative role. The group of words is rich in the Albanian language and, as such, is extended to all spheres of life, especially in the justice field. In contrast, justice terminology is an exciting and

necessary issue to study and analyze. In this paper, the word groups and composites in the Dictionary of Justice terms will be analyzed, which are productive and have enriched but also challenged our linguistic codification. The word code has the meaning of systematic summaries of legal norms. As such, dozens of other words have been generated as complex types, for example, the Civil Code, the French Civil Code, the Civil Code of the Kingdom of Albania, the Code of Civil Procedure, the Code of Penal Procedure, the Account Security Code, the Penal Code, the French Penal Code, or even the word contract (lat. *contactus*), which is a legal action, an agreement between two or more natural or legal persons, and as such, they have created groups of other difficult words, so the word contract has possibilities of generation with over eighty groups of words. This word, in the use of legal terminology and terms of the group of words, has made a significant and acceptable extension, such as abstract contract, accession contract, adhesion contract, administrative contract, agency contract, accessory contract, authorization contract, charity contract, bilateral contract, international bilateral contract, delivery contract, donation contract, obligation contract, or loan contract. In this study, we have several objectives to study and analyze, and they are the role of the group of words and composites with the content of justice terminology.

**Keywords:** Word groups, composites, legal terminology

Objekti i studimit në fjalë është që të hulumtojmë dhe analizojmë grupet e fjalëve ose togfjalëshat, ashtu siç njihen në komunitetin shoqëror dhe qëllimi i dytë është hulumtimi dhe analiza e fjalëve të përbëra apo kompozitat. Dy objektivat në fjalë, punimin do ta mishërojnë në aspektin përmbajtësor e shkencor, kështu që punimi theksin e veçantë e ka për terminologjinë e drejtësisë.

Ky punim do të kompletohet duke i analizuar disa fjalorë të fushës së drejtësisë e gjuhësisë, mirëpo me theks të veçantë do të analizojmë një fjalor, i cili ofron grupe të fjalëve dhe kompozita të mirëfillta të shqipes.

Gjuha shqipe është e pasur në gjitha disiplinat, mirëpo për këto dy çështje do të zgjedhim fushën e drejtësisë për ta parë gjendjen reale të grupit të fjalëve të ngurosurat apo të lira dhe për t'i analizuar kompozitat këpujore dhe përcaktore.

Fjalorin që e kemi përzgjedhur është ai i Sylë Kasumajt, *Fjalor i termave të drejtësisë, i botuar në Prishtinë, në vitin 2019*. Ky Fjalor “përmban rreth 6000 terma, shprehje, rregulla dhe emërtime të institucioneve të rëndësishme juridike që nga zanafilla e tyre e deri me sot, të vjela nga fjalorë të ndryshëm shpjegues, fjalorë enciklopedikë, pastaj terma nga legjislacioni në fuqi (kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore etj.)”<sup>1</sup>. Ky Fjalor krahas ndihmës që e ka për fushën e drejtësisë, ai është i rëndësishëm edhe për studiuesit e ndryshëm, të cilët merren me antropologjinë juridike dhe për gjuhëtarët e studiuesit që merren me terminologji juridike.

Në gjuhën shqipe, njësitë sintaksore të dallueshme janë: *fjalialia, periudha, gjymtyra e fjalisë dhe togfjalëshi*. **Togfjalëshi ose grupi i fjalëve** është njësi strukturore sintaksore i formuar nga bashkimi i dy a më shumë *fjalëve kuptimplota*

---

1 Kasumaj S., *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, fq. 7.

në raporte të caktuara kuptimore e gramatikore midis tyre. Fjalët që mund të bashkohen dhe që formojnë togfjalësha janë: *emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet dhe ndajfoljet*, kurse parafjalët dhe lidhëzat janë mjete për bashkimin e fjalëve kuptimplota në togfjalësha, si p.sh. akt administrativ detyrues,<sup>2</sup> ose edhe shembuj të tjerë të huazuar nga Fjalori i Kasumajt, si: Akt administrativ dobiprurës (fq. 27), akt administrativ kundërligjshëm (fq. 27), akt administrativ i ligjshëm (fq. 27), akt administrativ i shkruar (fq. 27), akt administrativ individual (fq. 28), akt administrativ kolektiv (fq. 28), akt administrativ përfundimtar (fq. 25), akt administrativ sipas detyrës zyrtare (fq. 28), akt administrativ sipas kërkesës së palës (fq. 28), akt arbitrar juridik (fq. 28), akt deklarativ juridik (fq. 28), akt en brevet (fq. 28), akt gjyqësor (fq. 28), akt i administratës shtetërore (fq. 28), akt i brendshëm i punëdhënësit (fq. 29), administratë komunale (fq. 20), administratë publike (fq. 20), administratë shtetërore (fq.20), administrim i drejtësisë (fq. 21), administrim i rrezikut (fq. 21), administrim i u jërave (fq. 21), administrim publik (fq. 21), afat i ankimit (fq. 22), afat i parashkrimit të padisë kundër veprimtimit juridik (fq. 22), afat ligjor (fq. 22), afat parashkrimi (fq. 21), afat prodhimi (fq. 23), afat zgjidhësi (fq. 23), afat zyrtar në procedurë (fq. 23), aftësi e kufizuar (fq. 23), aftësi pagese (fq. 24), aftësi pune (fq. 23) etj., por edhe fjala kod krijon grupe të fjalëve të drejtësisë, si: Kodi Civil; Kodi Civil Francez; Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare; Kodi i procedurës civile; Kodi i procedurës penale; Kodi i sigurisë së llogarisë; Kodi penal; Kodi Penal Francez e ndonjë shembull tjetër që do t'i prezantojmë në këtë punim.

Terminologjia e drejtësisë ka një rol të veçantë për pasurim e gjuhës. Për ta fuqizuar këtë fjali marrim shembullin e fjalës kontratë, e cila në fjalorët tonë shpjegues, që ju kemi referuar deri me tani, e kemi fjalë me një kuptim dhe për shembuj e prezantuar nuk përshkruhen kuptimet e tyre, kurse në *Fjalor i termave të drejtësisë* për fjalën kontratë e kemi me tetëdhjetë versione kuptimore, pra fjala kontratë në Fjalorin shpjegues të shqipes e ka një kuptim, si: KONTRATË f. sh. drejt. Marrëveshje me shkrim ndërmjet dy ndërmarrjeve a dy palëve, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të tyre; dokumenti që përmban këtë marrëveshje. Kontratë vjetore. Kontratë kolektive. Kontrata e punës. vjet. Kontrata e furnizimit (e grumbullimit të prodhimeve bujqësore). Kontrata e qirasë. Bëj (lidh, nënshkruaj) kontratën. Zbatoj (shkel, prish) kontratën.

Në *Fjalorin e termave të drejtësisë*, për fjalën kontratë, ashtu si e kemi thënë edhe më lart, kjo fjalë ka tetëdhjetë modele apo versione kuptimore e juridike, kurse disa nga ato janë: Kontratë abstrakte<sup>3</sup>, kontratë aderimi<sup>4</sup>, kontratë adezioni, kontratë

2 Kasuma S., *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, fq. 27.

3 Kontratë abstrakte – kontratë në të cilën nuk është caktuar qëllimi për të cilën palët marrin detyrim. Baza e kontratës ekziston në këto kontrata, por shkakun nuk është i njohur për personat e tretë se çfarë detyrohen palët kontraktuese p.sh. në kambialin se veprim juridik më tipike abstrakte, nuk duket baza e detyrimit (Kasumaj S., fq. 313).

4 Kontratë aderimi – kontrata në të cilat njëra palë që më përpara cakton elementet dhe kushtet e kontratës nëpërmjet një oferte të përhershme dhe të përgjithshme, ndërsa pala tjetër vetëm i aderohet ofertës së bërë (paraqitur). Kushtet dhe elementet e kontratës përpilohen vetëm nga njëra palë me mundësinë e pranimit të

administrative<sup>5</sup>, kontratë agjencioni, kontratë aksesore, kontratë autorizimi, kontratë bamirësie, kontratë bilaterale, kontratë bilaterale ndërkombëtare, kontratë dërgimi, kontratë dhurimi, kontratë detyrimi. Kjo çështje do të vazhdohet në mbarështrim të këtij punimi, kurse në vazhdim e përshkruajmë edhe rolin e kompozitës. Në gjuhësi, fjalët e përbëra apo kompozitat studiohen në morfologji dhe leksikologji.

Përkufizimi i termit apo nocionit kompozitë është thënë në forma të ndryshme, nga studiuesit të ndryshëm, p.sh. “kompozitë,-a f. (it. composito) *gjuh.* fjalë e përbërë, e formuar nga bashkimi i dy a më shumë temave ose fjalëve në një njësi të vetme fonetike, leksikore e gramatikore”<sup>6</sup>.

A. Xhuvanit ka pohuar: “Mbi këtë çështje ka shkruar se pari N. Jokli në broshurën Naim Frashri të botuar në Gratz më 1925. Se dyti pas tij, ka shkruar i ndjeri K. Cipo të Buletini i Institutit të Shkencave të vitit II nr. 2 - 3”<sup>7</sup>.

“Kompozitë,-a. sh,-a, -at gjuhë. Fjalë e përbërë, e formuar nga bashkimi i dy a më shumë temave ose fjalëve në një njësi të vetme fonetike, leksikore e gramatikore (p.sh. asnjëherë, ballafaqe, bashkatdhetar, domosdo, kurdoherë, zemërgur etj.). Kompozitat përcaktuese (këpujore, pronësore, dëshirore)”<sup>8</sup>. “Kompozitë-a, -at. Fjalë të përbëra, janë të formuar nga bashkimi i dy e më shumë temave në procesin e krijimit të fjalëve të reja. Pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore, si: **zemërgur, belhollë, buzëqesh, keqkuptoj, fjalëshumë**”<sup>9</sup>.

“Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi, me anë të cilës krijohen fjalë të reja, që kanë në përbërjen e tyre dy e më shumë tema motivuese, njëra nga këto (tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër është e asnjënjësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore, p.sh. **bregdet, botëkuptim, marrëdhënie, juglindje, veriperëndim, vendbanim, syzi, mësimor-edukativ ...**”<sup>10</sup>.

“Kompozitë-a, f. sh. -a, -at gjuh. Fjalë e përbërë, e formuar nga bashkimi i dy e më shumë temave ose fjalëve në një njësi të vetme fonetike, leksikore e gramatikore (p.sh. **akullthyes, ballafaqe, bashkatdhetar, asnjëherë, domosdo,**

---

thjeshtë nga pala tjetër. Pala kontraktuese që dëshiron të lidhë këso kontratash mund të lidhë me nënshkrimin e kontratës ose ta refuzojë në tërësi lidhen e saj. P.sh. kontratë huaje nga banka (Kasumaj S., fq. 313).

5 Kontrata administrative – marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas të drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik. P.sh. kontratë ndërmjet një kompanie ndërmjet dhe ministrisë së arsimit për ndërtimin e një objekti shkollor (Kasumaj S., fq. 313).

6 Grup autorësh, *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë, 1988, fq. 315.

7 Xhuvani A., “Kompozitat”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972, fq. 69.

8 *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980, fq. 856.

9 Thomaj J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, fq. 90.

10 Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, fq. 70.



**kurdoherë, ndonjëherë etj.)”<sup>11</sup>.**

“Shumica e mbiemrave të panyjshëm hynë në këto grupe të derivateve: Kompozitat mbiemërore si zemërgur (**zëmër + gur,-i**), **sylesh (sy + lesh,-i)**. Në fillim ato ishin kompozime që u paraqitën si cilësor - emëror dhe që më kohë e morën pikërisht kuptimin e kompozitave bahuvrihe: **trimi zemërluan (zëmër + luan,-i)**. **Kompozitat mbiemërohesh fatkeq, -e (fat,-i + keq)** që janë edhe ato të tipit bahuvrihi”<sup>12</sup>. Termi komponent që e kemi evidencuar nga **Fjalori për Pastrinë e Gjuhës**, në të cilin thuhet: “Komploti, -i, m. Fjalë e huazuar nga italishtja. FGjSSH e ka përfshirë me shpjegim, por jep si sinonim edhe fjalën shqipe përbërës, si dhe shprehjen pjesë përbërëse, që mund ta zëvendësojnë në të shumtën e përdorimeve, p.sh. Përbërës i rëndësishëm. Përbërësit kimikë të tokës ...”<sup>13</sup>.

Në *Fjalorin e termave të drejtësisë*, të autorit Sylë Kasumaj, për shkronjën a ka përdorur dyqind e tridhjetë (230) grupe të fjalëve dhe nëntëmbëdhjetë (19) kompozita.

Të gjitha grupet e fjalëve dhe kompozitat janë përshkruar me kuptimet e tyre.

**Grupet e fjalëve për shkronjën /a/ janë:** Abuzim pushteti (fq. 14)<sup>14</sup>, administratë komunale (fq. 20), administratë publike (fq. 20), administratë shtetërore (fq. 20), administrim i drejtësisë (fq. 21), administrim i rrezikut (fq. 21), administrim i ujërave (fq. 21), administrim publik (fq. 21), afat i ankimit (fq. 22), afat i kërkueshmërisë së detyrimit (fq. 22), afat i parashkrimit të padisë kundër veprimit juridik (fq. 22), afat ligjor (fq. 22), afat parashkrimi (fq. 21), afat paricioni (fq. 23), afat vezullues (fq. 23), afat prekluziv (fq. 23), afat prodhimi (fq. 23), afat zgjidhësi (fq. 23), afat zyrtar në procedurë (fq. 23), aftësi e kufizuar (fq. 23), aftësi pagese (fq. 24), aftësi pune (fq. 23), ager publicus (lat.) apo tokë publike (fq. 24), Agjencia Kosovare e Pronës (fq. 24), Agjet detar (fq. 25), agjent i shlyerjes të pagesave (fq. 25), aksident në punë (fq. 26), aksident rrugor (fq. 25), aksionar influencues (fq. 25) etj.

Fjala akt si fjalë e thjeshtë në *Fjalorin shpjegues* ka tri kuptime:

1. libr. Veprim i njëhershëm i njeriut, që bëhet për një qëllim të caktuar; veprë, punë. Akt heroik (i guximshëm). Akt i kundërligjshëm (kriminal, barbar, i shëmtuar). Akt miqësor (armiçësor). Akt agresioni (sulmi). Akti i të folurit. Kryen (bën) një akt.

2. zyrt. Vendim nënligjor me vlerë shtetërore ose shoqërore; shkresë zyrtare,

11 *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, fq. 596.

12 Cimochofski W., *Për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2004, fq. 441.

13 Akademia e Shkencave e RSH-Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë, *Për pastrinë e gjuhës shqipe-Fjalor*, Tiranë, 1998, fq. 113.

14 Kasumaj S., *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, fq. 14.

dokument që pasqyron një vendim të organeve të drejtësisë, të gjendjes civile etj. dhe që vërteton se një veprim i caktuar është kryer zyrtarisht. Akt zyrtar. Akti i lindjes (i martesës, i vdekjes). Akt kontrolli. Akt marrëveshjeje. Akt kapitullimi. Mbajtëse aktesh. Përpijoj (nënshkruaj) një akt. 3. teatër. Pjesë e një vepre dramatike ose e një shfaqjeje teatrale, që përbëhet nga disa skena dhe që përfshin një veprim të plotë. Akti i parë (i fundit). Pjesë me një akt (me shumë akte).

Fjala akt në *Fjalor i termave të drejtësisë* dhe në atë të cituar në fjalë ka dyzet e tetë grupe kuptimore të fjalëve të ngurosura, si:

Akt administrativ (fq. 26), akt administrativ absolutisht i pavlefshëm (fq.27), akt administrativ detyrues (fq.27), akt administrativ dobiprurës (fq.27), akt administrativ kundërligjshëm (fq.27), akt administrativ i ligjshëm (fq.27), akt administrativ i shkruar (fq.27), akt administrativ individual (fq.28), akt administrativ kolektiv (fq.28), akt administrativ përfundimtar (fq.25), akt administrativ sipas detyrës zyrtare (fq.28), akt administrativ sipas kërkesës së palës (fq.28), akt arbitrar juridik (fq.28), akt deklarativ juridik (fq.28), akt en brevet (fq.28), akt en minute (fq.28), akt gjyqësor (fq.28), akt i administratës shtetërore (fq.28), akt i brendshëm i punëdhënësit (fq.29), akt i dhënies e i marrjes së deklaratave (fq.29), akt i evidencimit ose i dokumentacionit (fq.29), akt i garancisë (fq.29), akt i gjendjes civile (fq.29), akt i kumtimit ose i lajmërimit (fq.29), akt i kuvendit komunal (fq.29), akt i paligjshëm juridik (fq.29), akt i pavarur juridik (fq.29), akt i përbërë juridik (fq.30), akt i përgjithshëm juridik (fq.30), akt i qeverisë (fq.30), akt juridik I (fq.30)<sup>15</sup>, akt juridik II (fq.30), akt juridik administrativ i pavlefshëm (fq.30), akt juridik i administratës (fq.31), akt juridik individual (fq.31), akt juridik konstitutiv (fq.31), akt kriminal (fq.31), akt kushtetues (fq.31), akt ligjor (fq.31), akt ligjvënës (fq.32), akt material i administratës (fq.32), akt negativ administrativ (fq.32), akt nënligjor (fq.32), akt normativ (fq.32), akt noterial (fq.32), akt plotësues normativ (fq.32), akt pozitiv administrativ (fq.32), akt themelor (fq.32).

Të gjitha grupet e ngurosura të fjalëve të cituara kanë kuptime përmbajtësor e juridike në vete dhe në këtë rast e veçojmë grupin *akt juridik I dhe akt juridik II* në aspektin përmbajtësor e homonimik.

**Akt juridik (I)** – akt formal i miratuar nga një organ kompetent, me të cilën rregullohet ose vendoset një çështje e caktuar. Aktet juridike mund të jenë të përgjithshme dhe individuale. Aktet e përgjithshme përmbajnë norma të përgjithshme juridike dhe sipas hierarkisë së fuqisë juridike të tyre ndahen: kushtetutë, ligje, dekretligje, urdhëresa, rregullore, udhëzime, vendime etj., ndërkaq aktet individuale janë akte të organeve shtetërore dhe të subjekteve të tjera juridike (personave fizikë ose juridikë) dhe ndahen në: aktgjykime (vendime të gjykatave), vendime (akte të gjykatave dhe organeve të administratës ose e

---

15 Sqarim: Numrin romak I dhe II e kemi plotësuar ne, sepse është grup i fjalëve homonimike, kurse në *Fjalor* nuk janë të shënuara.

organeve me autorizime publike), konkluzione (akte të organeve administrative), veprime juridike, padi, ankesa, deklarata etj<sup>16</sup>.

**Akt juridik (II)** – veprim njerëzor, vendim me të cilën krijohet e drejta; veprim njerëzor, qëllimi i të cilit është krijimi i rregullave juridike dhe rregullimi i marrëdhënieve shoqërore. Aktet juridike mund të jenë: akte juridike të përgjithshme dhe aktet juridike individuale. Të para krijojnë norma të përgjithshme juridike me të cilën rregullohen marrëdhënie të caktuara shoqërore (p.sh. të gjithë qytetarët që realizojnë të hyra nga pasuria janë të detyruar që të paguajnë tatimin. Të dytat krijojnë normë juridike individuale. Akti individual nxirret në bazë të një norme të përgjithshme dhe me qëllim të zbatimit të saj (p.sh. nga norma e përgjithshme që të gjithë qytetarët që realizojnë të hyra nga pasuria janë të detyruar të paguajnë tatim, nxirret norma juridike individuale që përcakton saktësisht për çdo person lartësinë e detyrimit tatimor. Lit. E.Statvileci, Fjalori shpjegues i termeve administrative, Prishtinë, 2013)<sup>17</sup>.

Për të njëjtën shkronjë ka edhe grupe të tjera të fjalëve, si: Aktakuzë e drejtpërdrejtë (fq.33), aktakuzë penale private (fq.33), aktgjykim detyruës (fq.34), aktgjykim dënues (fq.34), aktgjykim fajësues (fq.34), aktgjykim formal (fq.34), aktgjykim i ndërmjetshëm (fq.35), aktgjykim i pjesshëm (fq.35), aktgjykim i plotë (fq.35), aktgjykim lirues (fq.35), aktgjykim ndryshues (fq.35), aktgjykim në bazë të heqjes dorë (fq.35), aktgjykim në bazë të pohimit (fq.35), aktgjykim në mungesë (fq.35), aktgjykim penal (fq.35), aktgjykim penal meritior (fq.36), aktgjykim përfundimtar (fq.36), aktgjykim plotësues (fq.36), aktgjykim procedure kundërvajtëse (fq.36), aktgjykim refuzues (fq.36), aktgjykim vërtetues (fq.36), aktivitet ekonomike (fq.37), aktuar i sigurimeve (fq.37), aktvendim gjyqësor (fq.38), aktvendim lirues (fq.38), aktvendim përmbarimi (fq.38), aktvendim trashëgimi (fq.38), akuzë penale (fq.39), akuzues privat (fq.40), alieni iuris (fq.40), alteri stipulari nemo potest (lat. fq.41), amendament kushtetues (fq.42), analogji e ligjit (fq.44), analogji juridike (fq.44), anëtar i familjes (fq.45), anëtar i familjes së ngushtë (fq.45), anije lufte (fq.45), anije spitalore (fq.45), anije tregtare (fq.46), ankand publik (fq.47), ankesë kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve të tjera (fq.47), ankesë kundër aktgjykimit në procedurën civile (fq.47), ankesë kundër aktgjykimit në procedurën penale (fq.48), ankesë kundër aktgjykimit në procedurën kundërvajtje (fq.49), aktgjykim në procedurë administrative (fq.50), aktgjykim në procedurë jashtëkontestimore (f. 50), aktgjykim në procedurë përmbaruese (fq.50), antropologji juridike (fq.53), anulim i aktgjykimit (fq.53), anulim i martesës (fq.54), anulim i veprimit juridik i kryer nga përfaqësuesi (fq.55), anulim i veprimit juridik për shkak të kanosjes (fq.55), anulim i veprimit juridik për shkak të lajthimit (fq.55), anulim i veprimit juridik për shkak të mashtrimit (fq.55), anulim i veprimit juridik për

16 Kasumaj S., *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, fq. 30.

17 Po aty, fq. 30.

shkak të situatës së rëndë (fq.55), anulim i veprimit juridik sipas mirëbesimit apo keqbesimit (fq.55), aparat shtetëror (fq.56), ardhura bazë (fq.58), ardhura bruto (fq.58), ardhura neto (fq.58), ardhura publike (fq.58), ardhura të dedikuara (fq.58), armë e ftohtë (fq.60), armë e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe akustikë (fq.60), armë eksplozive (fq.60), armë elektroshtok (fq.61), armë gjahu (fq.61), armë për përdorim të agjentëve kimikë (fq.61), armë pneumatike (fq.61), armë zjarri (f.61), armëmbajtje pa leje (f.61), arsyeja e shtetit (fq.62), arsyetim vendimi (f.62), arratisje jashtë shtetit (f.62), arrest shtëpie (f.62), arrestim në flagrancë (fq.63), asamble kushtetuese (fq.64), Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (fq.64), Asambleja Parlamentare të Evropës (f.64), asocion i komunave (fq.65), atribut i personit fizik (fq.66), autonomi e vullnetit (fq.67), autonomi funksionale (fq.67), autonomi personale (fq.67), autonomi territoriale (fq.68), autor i shpikjes (fq.68), autor i veprës (f.68), autoritet portal (fq.69), autoritet shtetëror përgjegjës për mbrojtje të fëmijëve (fq.69), autorizim i kufizuar (fq.69), autorizim i njëfishtë (fq.69), autorizim i pakufizuar (fq.69), autorizim i përgjithshëm (fq.69), autorizim i shumëfishtë (fq.70), autorizim i veçantë (fq.70), autorizim publik (fq.70), autorizim shtetëror (fq.70), avokat i popullit (fq.71), avokat publik (fq.71), avokator shteti (fq.72), azil diplomatik (fq.72), azil politik (fq.72), azil territorial (fq.73).

Shkronja A i ka 230 grupe të fjalëve dhe si të tilla e kanë pasuruar gjuhën.

Për shkronjën në fjalë vazhdojmë me hulumtimin dhe rolin e kompozitave të ndryshme, të cilat përmes bashkimit të dy ose më shumë fjalë motivuese kanë krijuar fjalë të re me kuptim të ri, në këtë rast me kuptim juridik, si: Administrativo-tokësor<sup>18</sup> (fq.20), agreement (fq.24), aktvendime (fq.28), aktakuzë (fq.33), aktgjykime (fq.28), aktmarrëveshje (f.37), aktpadi (fq.37), aktvdekje (fq.37), aktvendim (fq.38), aktzotërimi (fq.39), antiglobalizëm (fq.52), antikrezë (fq.52), antikushtetues (fq.52), antimon (fq.52), antisemitizëm (fq.52), antropologji (fq.52), armëmbajtje (fq.61), armëpushim (fq.61), azilkërkues (fq.73).

Në *Fjalorin e termave të drejtësisë*, të autorit Sylë Kasumaj, në shkronjën a, kemi gjetur gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) kompozita.

Në vazhdim i analizojmë, studiojmë dhe i citojmë disa nga grupet e fjalëve dhe të kompozitave, sipas radhitjes alfabetike.

## Shkronja B

Po në të njëjtin Fjalor për shkronjën B kemi grupe të fjalëve me terminologji juridike dhe ato janë **gjithsej gjashtëdhjetë e pesë (65)**, si: Buxhet i Republikës së Kosovës (fq.101), bashkëpronësi e detyrueshme (fq.83), bashkëjetesë

---

18 Administrativo-tokësor, administrimi i vendit sipas ndarjes tokësore në njësi organizative shtetërore. P.sh. ndarja e vendit në komuna, prefektura, rrethe, ndërkaq te shtetet e përbëra dhe në njësi federale ose konfederate ( Kasumaj S., fq. 20).

jashtëmartesore (fq.81), borxh trashëgimi (fq.79), barrë trashëgimi (fq.78), besa shqiptare (fq.91), **kurse kompozita janë tridhjetë e katër (34)**, si: bashkëpadi (fq.82), bashkëpërgjegjës (fq.82), bashkëpronar (fq.82), bashkëpronësi (fq.82), bashkëfajtor (fq. 80), bashkëdebitor (fq.80), bashkëjetesë (fq.81), bashkëdorëzan (fq.80).

### Shkronja C


Për shkronjën në fjalë kemi gjithsej **tridhjetë e tetë (38)** grupe fjalësh për terminologjinë juridike, të cilat e pasurojnë gjuhën e shkruar dhe disa nga ato janë: Cak dënimi (fq.102), caktim dënimi (fq.102), caktim trashëgimtari (fq.102), cenim i ligjit material (fq.103), certifikatë e lindjes (fq.105), certifikatë automjeti (fq.105), certifikatë pronësisë (fq.105), certifikatë e pasurisë së paluajtshme (fq.105), certifikatë e shtetësisë (fq.105), certifikatë vdekjes (fq.105), cilësim i veprës penale (fq.107) etj., kurse për këtë shkronjë **nuk kemi gjetur kompozita**.


Duke bazuar në punën që është prezantuar më lart, në vazhdim e prezantojmë në mënyrë tabelore rezultatet:

Shkronja	Numri i grupit të fjalëve, sipas radhitjes alfabetike	Kompozita
A	230	19
B	65	34
C	38	0
Ç	11	1
D	65	9
Dh	10	2
E	152	5
F	66	10
G	10	2
Gj	43	5
H	30	5
I	79	4
J	4	4
K	372	29
L	91	6
Ll	6	1
M	144	7
N	83	1
Nj	13	0
O	71	5
P	365	19
Q	26	2

R	63	1
Rr	13	0
S	149	2
Sh	84	2
T	82	4
Th	2	0
U	22	10
V	174	15
Xh	0	1
Y	0	0
Z	47	0
Zh	2	0
<b>Totali</b>	<b>2612</b>	<b>205</b>

Mbi bazën e rezultateve të tabelës së dhënë, i paraqesim diagramet për grupin e fjalëve dhe për kompozitat:





## Përfundime

Për të përfunduar objektivin e punimit mund t'i veçojmë apo prezantojmë disa nga pikat thelbësore që i kemi trajtuar në këtë punim dhe që janë rezultate me interes për zhvillimin e terminologjisë së drejtësisë, pastaj të gjuhës dhe sigurisht edhe të përdoruesve të saj.

Objekti i studimit në fjalë ishte që të hulumtohet dhe analizohen grupet e fjalëve ose togfjalëshat, ashtu siç njihen në komunitetin shoqëror dhe qëllimi i dytë ishte hulumtimi dhe analiza e fjalëve të përbëra apo kompozitat. Dy objektivat në fjalë, punimin e kanë mishëruar në aspektin përmbajtësor e shkencor, kështu që punimi theksin e veçantë e ka për terminologjinë e drejtësisë.

Ky punim është kompletuar duke i analizuar disa fjalorë të fushës së drejtësisë e të gjuhësisë, mirëpo me theks të veçantë kemi analizuar Fjalorin që e kemi përzgjedhur është te Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë, i botuar në Prishtinë, në vitin 2019*. Ky Fjalor “përmban rreth 6000 terma, shprehje, rregulla dhe emërtime të institucioneve të rëndësishme juridike që nga zanafilla e tyre e deri me sot, të vjela nga fjalorë të ndryshëm shpjegues, fjalorë enciklopedikë, pastaj terma nga legjislacioni në fuqi (kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore etj.)”<sup>19</sup>.

<sup>19</sup> Kasumaj S, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, fq. 7.

Ky Fjalor krahas ndihmës që e ka për fushën e drejtësisë, ai është i rëndësishëm edhe për studiuesit e ndryshëm, të cilët merren me antropologjinë juridike dhe për gjuhëtarët e studiuesit që merren me terminologji juridike.

Në këtë punim janë trajtuar 2612 grupe të fjalëve dhe 205 kompozita, të cilat janë analizuar nga Fjalori në fjalë. Duke e kuptuar shtrirjen e punimit, në këtë rast nuk do të zgjerohem në ndërtimin e brendshëm të grupit të fjalëve dhe të kompozitave, mirë kjo mbetet të analizohet në një punim tjetër, i cili mund të trajtohet në aspektin morfo-sintaksor.

### **BIBLIOGRAFIA:**

- (1890): FGJSSH - *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- (1954): FGJSH - *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- (1980): *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë.
- (1988): GRUP AUTORËSH, *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë.
- (2002): *Fjalori i shqipes së sotme*, botimi i dytë i ripunuar, Tiranë.
- (2002): *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë.
- (2002): *Gramatikë e gjuhës shqipe I, II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.
- (2002): GRUP AUTORËSH, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë.
- AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, (1973): *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- BEJTA M., (1988): *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë.
- GOJANI S., (2013): *Fjalor i terminologjisë juridike*, Prishtinë.
- ISLAMAJ SH., (2004): *Gjuha ligjërimit dhe fjala*, Prishtinë.
- KASUMAJ S., (2019): *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë.
- KOSTALLARI A., (2016): *Vepra I, Studime në fushën e gjuhës letrare kombëtare*, Tiranë.
- KOSTALLARI A., DOMI M., ÇABEJ E., LAJE E., (1967): *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*, Tiranë.
- KOSTALLARI A., DOMI M., ÇABEJ E., (1974): *Kongresi i Drejtshkrimit*, Prishtinë.
- LEKA F., (1989): *Udhëzues për përpunimin e terminologjisë*, Tiranë.
- MILLAKU SH., (2011): *Strukturat sintaksore*, Prishtinë.
- MILLAKU SH., (2011): *Studime gjuhësore I*, Prishtinë.
- MILLAKU SH., (2015): *Kërkime gjuhësore*, Prizren.
- MILLAKU SH., (2017): *Tekst ushtrimesh për lakimin e emrave dhe zgjedhimin e foljeve*, Prishtinë.



MILLAKU SH., (2019): *Kërkime gjuhësore 2*, Prishtinë.

NUSHI P., (2010): *Fjalor shpjegues i psikanalizës*, Prishtinë.

*Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, AShRSh, Tiranë.

STANECI J., (2004): *Fjalor i gjeomorfologjisë*, Prishtinë.

THOMAJ J., (1974): *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

XHUVANI A., (1972): "Kompozitat", *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë.

# KOHEZIONI LEKSIKOR NË DISKURSIN POLITIK SHQIPTAR

**Dr. Ardita Dylgjeri**

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

E-mail: arditadylgjeri@live.com

## PËRMBLEDHJE

Ligjërimi politik, ashtu si çdo lloj tjetër ligjërimi, bëhet subjekt dhe objekt kyç i analizës së elementeve gjuhësore që i falin atij cilësi kohezive. Përgjatë këtij artikulli do të analizohen raste të ndryshme të kohezionit leksikor që realizohet përmes: përsëritjes, parafrazës, sinonimisë, antonimisë, meronimisë, hiponimisë dhe lidhjeve bashkëvjajtëse. Më konkretisht, janë marrë në konsideratë pesë copëza fjalimesh politike të mbajtura nga figura të rëndësishme të Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste në Republikën e Shqipërisë. Tematikat kryesore e këtyre pasazheve janë çështjet e zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë, madje dy prej tyre janë mbajtur në periudhë fushate zgjedhore, ku të tilla probleme bëhen më delikate dhe të rëndësishme për t'u analizuar dhe për të premtuar zgjidhje në të ardhmen. Përveç kësaj, elementet e kohezionit leksikor që janë marrë në shqyrtim gjatë analizave të parashtruara në artikull mishërohen dukshëm dhe në mënyrë interesante në shembujt e marrë në analizë.

**Fjalë çelës:** kohezion, leksik, ligjërimit politik, analizë, koherencë.

## LEXICAL COHESION IN THE ALBANIAN POLITICAL DISCOURSE

### ABSTRACT

Political discourse, like any other kind of discourse, becomes the key subject and object of analysis of the linguistic elements that give it cohesive properties. Throughout this article, we will analyze different cases of lexical cohesion that is realized through: repetition, paraphrase, synonymy, antonymy, meronymy, hyponymy and conjunctions. More specifically, five fragments of political speeches given by important figures of the Democratic Party and the Socialist Party in the Republic of Albania have been taken into consideration. The main topics of these passages are issues of economic and social development of Albania, even two of them were held during the election campaign period, where such problems become more delicate and important to be analyzed and to promise solutions in the future. In addition, the elements of lexical cohesion that were considered during the analysis presented in the article are clearly and interestingly embodied in the examples taken in the analysis.

**Keywords:** cohesion, lexicon, political discourse, analysis, coherence.

### HYRJE

Nocioni i kohezionit, si nocion kyç në disiplinat e Analizës së Ligjërimit dhe Pragma-linguistikës, shërben për të përcaktuar nëse një fjalë, thënie apo fjali është e përshtatshme të përdoret në një kontekst të caktuar. Kohezioni i jep

ligjërimin atributin e të qenit njësi. Përpos këtij arsytimi, analiza e ligjërimin e shoh ligjërimin si një sjellje sociale që përcaktohet nga funksioni i tij qendror: të argumentojë, të bindë, të përligjë, të përshkruajë etj. Pra, vlerë e rëndësishme e analizës së ligjërimin është përdorimi, pasi ligjërimi nuk është gjë tjetër veç “një njësi e tekstit në përdorim”.

Përgjatë këtij punimi, jo vetëm do të evidentohen raste interesante të kohezionit leksikor i manifestuar në disa forma të ndryshme si: përsëritja, parafraza, sinonimia, antonimia, meronimia, hiponimia dhe lidhjeve bashkëvjajtëse, por njëkohësisht do të analizojë rëndësinë që të tilla elemente kanë në përmbushjen e misionit dhe qëllimit parësor që diskursi politik mbart, argumentimi dhe bindja e audiencës, politikë bërja dhe forca e fjalës në këtë proces.

Rrjedhimisht dy pyetjet kërkimore që do të parashtrohen janë:

- Si manifestohen elementet e kohezionit leksikor në diskursin politik shqiptar?

- Cili është synimi kryesor i përdorimit të kohezionit leksikor në copëza të ndryshme diskursive?

### **Kohezioni leksikor, përkufizime dhe format kryesore të tij**

Analiza e diskursit ka për synim kryesor të saj ndërtimin e modeleve që vendosin tekstet apo diskutet në kontekste specifike sociale, duke marrë në konsideratë mënyrën se si ato bashkëveprojnë dhe integrohen me njëri-tjetrin. Po ashtu, *tekstura* është një aspekt i studimit të koherencës, e cila merr në konsideratë kontekstin social. Tekstura e një pasazhi tekstor apo ligjërimor realizohet përmes pranisë së marrëdhënieve kohezive mes fjalive aty. Marrëdhëniet e kohezionit lëvizin përtej strukturës së fjalisë / thënies. Ato mund të identifikohen si brenda një fjalie/thënieje, si midis fjalive/thënies të ndryshme në një tekst të caktuar.

Koncepti i *kohezionit* shfaqet, së pari, te Halliday dhe Hassan-i, sipas të cilëve ai konsiderohej si një marrëdhënie semantike “por, si të gjithë përbërësit e sistemit semantik, realizohet me anën e sistemit leksiko – gramatikor<sup>1</sup>”. Ata përfshinë brenda konceptit të kohezionit mjetet gjuhësore që kemi në dispozicion për të krijuar teksturën, pra aftësinë e një teksti për t’u interpretuar në tërësi. Marrëdhëniet kohezive janë marrëdhënie semantike mes një elementi të një teksti apo diskursi dhe një elementi tjetër që është shumë i rëndësishëm për interpretimin

1 Halliday M. & Hassan R., “Cohesion in English”, Longman, 1976, fq. 4.

e tij, pavarësisht kufizimeve gramatikore ose strukturore<sup>2</sup>. Por, këta elemente nuk mund të dekodohen me efektivitet, pa ditur më parë burimin nga i cili vijnë<sup>3</sup>.

*Kohezioni leksikor* shfaqet atëherë kur marrëdhënia kohezive realizohet përmes elementeve që i përkasin së njëjtës fushë leksikore, por niveleve të ndryshme të organizimit të kësaj fushe. Halliday dhe Hassan-i e konsiderojnë kohezionin leksikor si një ndër elementet jo gramatikore më interesante të marrëdhënieve kohezive. Ai i referohet “efektit koheziv të realizuar me anën e përzgjedhjes së fjalorit”<sup>4</sup>. Gjithashtu, këta dy studiues e ndajnë *kohezionin leksikor* në kategoritë e përsëritjes dhe të rendit. Të tilla lidhje realizohen përmes rimarrjes, parafrazës, sinonimisë, antonimisë, hiponimisë, meronimisë (që nënkupton një pjesë që përfaqëson të tërën apo me bashkëvajtje, kur dy elemente leksikore janë të lidhura me njëri-tjetrin). Më poshtë gjenden pasazhe të ndryshme të diskursit politik në Shqipëri dhe raste tipike të kohezionit leksikor dhe mënyrave të tij të shprehjes.

### **Përsëritja / Rimarrja në diskursin politik**

Përsëritja/Rimarrja shfaqet atëherë kur i njëjti element leksikor përdoret në fjali që pasojnë njëra-tjetrën, ose në fjali që edhe pse nuk pasojnë drejtpërdrejt njëra-tjetrën, gjenden në të njëjtin tekst. Sipas Salkie-s<sup>5</sup>, përsëritja nuk përfshin vetëm përsëritje të fjalëve të veçanta, por, sidomos në ligjërimin e folur, ajo përfshin edhe përsëritje të modeleve të organizimit të fjalëve. Xh. Lloshi (1999) “me rimarrja/përsëritje parakupton:

1. Përsëritje e organizimit parësor që ka të bëjë me aktualizimin e sistemit gjuhësor përmes rimarrjes së elementeve.

2. Përsëritje si përftesë shprehëse, kur rimarrja bëhet për të përftuar shprehësi intensifikimi, ose për të përçuar emocion.

3. Përsëritje si faktor stilformues; në këto raste rimarrja na sinjalizon karakteristika stilistike.

- *Është fakt* që infrastruktura në vend që të përmirësohet dhe ta ndihmojë biznesin, po përkeqësohet dhe e pengon atë.

*Është fakt* që qeveria nuk e dëgjon zërin e biznesit, zërin e ekonomisë dhe se

---

2 Halliday M. & Hassan R., “Cohesion in English”, Longman, 1976, fq. 8.

3 Halliday Hassan. “Cohesion in English”, 1976, Longman, 1976, fq. 4.

4 Halliday M. & Hassan R., Cohesion in English, Longman, 1976, fq. 280.

5 Salkie R., “Text and discourse analysis”, Routledge, London, 1995, fq. 7.

6 Lloshi Xh., “Stilistika dhe Pragmatika e gjuhës shqipe”, SHBLU, Tiranë, 2001, fq. 47- 49.

asnjë politikë fiskale apo e natyrës ekonomike nuk është dakordësuar me biznesin.

*Është fakt* që ka evazion qeveritar dhe shpërdorim të fondeve publike ku vetëm në vitin 2015 mungojnë mbi 1.2 miliard euro, 400 milionë në pikën e mbledhjes, 777 milionë në pikën e shpenzimit<sup>7</sup>.

Në përgjithësi, në momentin kur ligjëruesit politikë kërkojnë që të fitojnë besueshmëri, tentojnë që opinionet e tyre t'ia pasqyrojnë audiencës si të ishin fakte. Në disa raste, tendenca për të përshkruar një opinion në mënyrë anaforike e bën ligjëruesin të tentojë të rreshtojë një sërë elementesh, të cilët në vlerësimin e tij nuk tregojnë veçse të drejtën e tij morale për të kundërshtuar një sistem vlerash apo antivlerash, në fuqi në momentin në fjalë. Kështu, ligjëruesi (Lulzim Basha), në këtë fjalim me përsëritjen e togfjalëshi “është fakt”, synon të përcjellë mesazhin e tij nëpërmjet një orientimi drejt sistemeve logjike, të cilat në sytë e audiencës do të shfaqen si vlerësime *apriori* për të parapëlqyer një zgjidhje në raport me një tjetër. Faktet, të cilat përbëjnë edhe fjalën kyçe në këtë fjalim, pasqyrohen në formën e përshkallëzimit, të renditura në mënyrë të vazhdueshme nga më pak i rëndësishmi tek ai më i rëndësishmi.

Përgjatë një ligjërate politike/diskursi politik, në mënyrë të veçantë në momentin e paraqitjes së programeve politike, për të nxitur etosin, shpesh ligjëruesi tenton ta realizojë këtë nëpërmjet dhënies së stimuljeve negativë përkundrejt palës kundërshtare. Kështu, jo rrallë, opinione të ligjëruesit ose opinione të pranuar nga audienca, listohen në formën e paraqitjes së fakteve. Nëpërmjet përballjes mes dy të kundërtave, asaj që është e mirë dhe asaj që është e keqe, asaj që është e drejtë dhe jo, të vërtetës dhe gënjeshtres ngre premisa për zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Këto probleme premtohen të zgjidhen në të ardhmen nga ligjëruesi dhe pala politike që ai përfaqëson.

Për të ilustruar këtë logjikë, përmendim dy aspekte të nevojshme të bindjes, të cilat që vihen në dukje nga Poggi<sup>8</sup>: *dashamirësia* dhe *kompetenca*. Aspekti i parë lidhet me besueshmërinë morale të bindësit, ndërsa i dyti lidhet me besueshmërinë intelektuale, ekspertizën dhe aftësinë për të arritur synime. Për të demonstruar kompetencat e tij, bindësi mund të rendisë arritjet e tij; dhe për të demonstruar dashamirësi, ai mund ta vendosë theksin tek fakti se ai dëshiron më të mirën për dëgjuesit.

7 Prezantimi i programit ekonomik të PD dt. 07.04. 2017, <https://pd.al/2016/04/programi-i-pd-se-per-daljen-nga-kriza-ekonomike-punesim-permes-ulje-taksash-investime-publike-liri-per-sipermarrjen-dhe-barazi-para-ligjit/>, vizituar më 30.05.2022.

8 Poggi I., “The goals of persuasion”, in “Pragmatics and Cognition”, Vol. 13:2, Benjamin Publishings, 2005, fq. 297–335.

Ndaj, pak më poshtë, në të njëjtin fjalim, do të gjejmë një pasazh të tillë:

- Partia Demokratike ka sot një alternativë zhvillimi, *ky është një projekt* me objektiv rritjen ekonomike që garanton punësimin dhe mirëqenien për të gjithë shqiptarët.

*Ky projekt* vendos në qendër të tij qytetarin dhe sipërmarrjen, iniciativën e tyre të lirë dhe prandaj ka në fokus modelin e zhvillimit që rrit prodhimin e kapitalit fizik dhe njerëzor dhe jo modelin e rritjes së konsumit të ezauruar tashmë.

*Ky projekt* garanton ristrukturim dhe transformim cilësor ekonomik. Ky program ekonomik garanton rritjen e të ardhurave për qytetarët dhe në veçanti për pensionistët<sup>9</sup>.

Një manovrim i tillë strategjik, i realizuar përmes dikotomisë mes së mirës dhe së keqes, diskutohet edhe nga Vincze, e cila, në artikullin e saj, analizon se të tillë komponente argumentuese rrisin etosin e ligjëruesit.

Përmes përzgjedhjes tematike, përshtatjes ndaj dëgjuesve dhe mjeteve prezantuese, ajo e konsideron dikotominë si një “operacion ku një koncept A, ndahet në dy koncepte të tjera, B dhe C që përjashtojnë njëri-tjetrin, por që lidhen drejtpërdrejt me konceptin origjinal A”<sup>10</sup>. Kështu, ligjëruesi përkundrejt elementeve negative të përshkruar në formën e një antiteze, paraqet një projekt pozitiv për të ardhmen, duke i kërkuar audiencës që të zgjedhë mes së tashmes apo së shkuarës së zymtë dhe të ardhmes, të karakterizuar nga një frymë pozitive. Ja pse, siç bën renditjen e antivlerave, ai realizon edhe renditjen e vlerave që do të karakterizojnë këtë të ardhme. Ai zgjedh të përdorë leksemën “projekt”, në mënyrë që të nxisë audiencën të imagjinojë një sërë ndryshimesh pozitive (në këndvështrimin e tij), që priten të ndodhin në momentin kur ligjëruesit do t’i jepet mundësia reale për t’i realizuar ato. Synimet dhe objektivat e ligjëruesit për të ardhmen përmblihen brenda konceptit të “projektit”. Është ky projekt që do të përmirësojë jetën e njerëzve në të gjitha aspektet e zhvillimit ekonomik, social e kulturor.

---

9 Prezantimi i programit ekonomik të PD dt. 07.04. 2017, <https://pd.al/2016/04/programi-i-pd-se-per-daljen-nga-kriza-ekonomike-punesim-permes-ulje-taksash-investime-publike-liri-per-sipermarrjen-dhe-barazi-para-ligjit/>, vizituar më 30.05.2022.

10 Dascal M., “Dichotomies and types of debate” In: F. H. van Emeren and B.Garsen (red.), *Controversy and Confrontation: Relating Controversy Analysis with Argumentation Theory*, Amsterdam, John Benjamins, 2008, fq. 27-49.

## Parafraza si element i kohezionit leksikor

*Parafraza* parakupton përdorimin e një njësie leksikore, sintagme apo fjalie për të shprehur të njëjtin koncept të shfaqur më përpara në tekst apo në diskurs, me anë të një njësie tjetër leksikore. Ndryshe nga *perifraza*, parafraza nënkupton një lidhje jo të qëndrueshme referenciale, lidhje e cila vepron vetëm brenda kontekstit të dhënë<sup>11</sup>. Po ashtu, parafraza dallon nga sinonimia, lidhjet e së cilës ekzistojnë brenda sistemit leksikor. Ndërsa te parafraza, çdo lidhje qëndron vetëm brenda kontekstit të caktuar. Pra, këto njësi leksikore marrin vlerë të veçantë në rastet kur përdoren në një përftesë të caktuar ligjërimore, e inskenuar në rrethana të caktuara.

- *Edi Rama* po mundohet ta shpërfillë me shpirt duke transferuar kriminelët nga institucionet tek *partia e tij*. Por si e bën këtë? Duke shtypur instrumentin e vetëm që ka një *familje politike*, atë të zgjedhjes me votë të lirë, atë të zgjedhjes nga anëtarët me votë të lirë e të drejtpërdrejtë të kursit, vendimeve politike dhe të njerëzve më të aftë.

Ky është ndryshimi i madh sot midis një Partie Socialiste që është katandisur në një *çiflig i satrapit oriental*, në një fole të personave kriminalë që diktojnë çdo vendim.<sup>12</sup>

Në këtë rast bëhet fjalë për identifikimin e një individi specifik, me tipare që i atribuohen, si rregull, asaj kategorie të udhëheqësve politikë, të cilët kanë një pushtet më të madh se ai që buron nga votimi i lirë, një pushtet të pakufizuar, i cili karakterizon jo një drejtues dhe politikan modern perëndimor, por një të tillë sipas modelit lindor. Interesant është përdorimi i termit “satrap”, i cili në origjinë tregon drejtuesin e një province në Persinë e lashtë;

*SATRAP m. sh.*

*1.his. Sundimtar me pushtet të pakufizuar i një krahine në Perandorinë e vjetër Persiane dhe në Indi*<sup>13</sup>.

Satrapët, në realitet vareshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pushteti perandorak. Mirëpo, duke qenë se distancat mes provincave dhe qendrës së perandorisë ishin të mëdha, ata vepronin në mënyrë autonome, edhe pse duhej të zbatonin deri në fund kërkesat e autoritetit suprem, perandorit.

11 Dauti L., “Hyrje në gjuhësi teksti”, ILAR, Tiranë, 2017, fq. 125.

12 <https://www.pd.al/2016/02/shqiptaret-perballen-sot-me-tiranine-e-varferise-krimet-dhe-korrupsionit/>

13 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri satrap.

Në vlerësimin e folësit, organizimi politik të cilit i referohet, ka humbur kuptimin e një grumbullimi vullnetar të shtetasve të një vendi, por ka rënë në nivelin e një prone feudale, të administruar në mënyrë despotike nga drejtuesi i saj. Një element interesant në rastin në fjalë përbën dhe nënkuptimi i individit, duke iu referuar jo atij drejtpërdrejtë, por duke e identifikuar në kuadrin e udhëheqësit të grupimit politik. Në shprehjen e mesazhit ligjëruesi zgjedh të kombinojë në diskursin e tij elementë që lidhen me mënyrën lindore të qeverisjes dhe jo me destinacionin perëndimor të mënyrave të politikëbërjes. Nuk duhet të harrojmë se që në fillimin e jetës politike në shtetin shqiptar, konflikti politik ishte mes orientalizmit dhe oksidentalizmit. Bashkëshoqërimi i nënkuptuar me vlera politike tipike orientale synon që të bëjë dallimin mes një grupimi politik, në thelb europianist dhe tjetrit oriental.

Në fillim të shekullit XXI, në fjalorin politik shqiptar filloi të shmangej dukshëm përdorimi i termit “parti”. Kjo tendencë ishte pasojë e reminishencave të së kaluarës njëpartiake, duke tentuar të tregonin evoluimin nga një organizëm tipik diktatorial, ku të gjithë ishin të përfshirë me dhunë ose të detyruar nga rrethana të tjera në një grupim ideologjik, në një organizëm vullnetar, ku të gjithë janë pjesë integrale dhe aktive në jetën e tij.

### **Sinonimia dhe rëndësia e saj**

Politikanët shqiptarë, si ligjërues që janë vënë në qendër të studimit tonë, në shumicën e rasteve kanë tendencën të kumtojnë një koncept fillestar në një moment të caktuar të aktit ligjërues, dhe më pas kanë për ta përforcuar atë, ata i rikthehen në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm nëpërmjet sinonimisë, por edhe nëpërmjet përshkrimit të fenomeneve, të cilat ndodhin si pasojë ose lidhen ngushtë me fenomenin fillestar.

Në fakt në kontekstin e ligjërimit politik, mund të gjemë të përdorura jo vetëm atë që konsiderohen sinonimi në konceptin tradicional të fjalës, por edhe sinoniminë stilistike. Këto të fundit mbartin ngjyrim shprehës-emocionues dhe sillen në tekste a nëntekste politiko-shoqërore, si stilemë për të ngjallur ose për të përforcuar edhe ndjenja keqësuese, përbuzëse, ironizuese, shpërfillëse etj.<sup>14</sup>

Në pasazhin e mëposhtëm: fjalët sinonimike të marra në konsideratë janë: *diktaturë, tirani, oligarki*, por edhe togefjalëshat: *byro politike* e *byro mafioze*. Në

---

14 Samara M., “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008, fq. 198.



këtë drejtim duhet të konsiderojmë se në konceptin modern diktaturat nuk janë thjesht me tipare ideologjike. Ato janë në thelb të përcaktuara nga ndikimi me mënyra ekstra ligjore në politikat dhe aftësinë vendimmarrëse të organizmave politikë legjislativë. Kështu, në perceptimin e gjendjes politike, raporti mes dikturës dhe oligarkisë nuk duhet marrë në kuptimet tradicionale të tyre.

- Ajo kërcënohet përsëri nga një *diktaturë* e re, nga një *tirani* e varfërisë, e korrupsionit dhe e krimit që ka instaluar sot në vend nga *oligarkia* e Edi Ramës, Ilir Metës dhe kriminelëve dhe bandave të lidhur me ta. Kjo është *oligarkia, sundimi i pakicës* por tashmë jo si një *byro politike*, por si një *byro mafioze* njerëzish të cilët duan të marrin të gjitha vendimet në emër të shqiptarëve, por jo për shqiptarët...<sup>15</sup>

Në rastin e sipërpërmendur bie në sy përkujdesja që në momentin e parë të shpjegimit të kuptimit që kumti bart. Kjo shoqërohet me identifikimin e grupit, i cili qëndron pas zhvillimit të ndikimit jo ligjor/kushtetues në procesin e vendimmarrjes. Në përgjithësi, ekziston tendenca që me diktaturën të identifikojnë pushtetin e pakufizuar të një njeriu, diktatorit, mirëpo si në rastin e dikturës, ashtu dhe në rastin e oligarkisë dhe tiranisë pushteti i individit nuk mund të kishte kuptim pa mbështetjen e një klase të caktuar.

### **DIKTATURË f.**

1. *Pushtet i pakufizuar shtetëror, që shpreh e mbron interesat e klasës sunduese dhe që ushtrohet me dhunë nga një njeri ose nga një grup njerëzish; pushteti i diktatorit.*

2. *hist. Sundimi i diktatorit në Romën e Vjetër; pushteti i tij i pakufizuar; koha gjatë së cilës ai e ushtronte këtë pushtet.*

3. *fig. libr. Sjellja e veprimet e atij që u jep urdhra të tjerëve e u dikton vullnetin e vet pa përfillur mendimin, dëshirat e interesat e tyre, sjellje prej diktatori<sup>16</sup>.*

### **OLIGARKI f.**

1. *hist. Formë qeverisjeje në kohën e vjetër e në mesjetë, kur pushtetin e kishte në duart e veta një rreth shumë i ngushtë skllavopronarësh e aristokratësh të pasur,*

15 Lulzim Basha fjalim në Shkodër dt. 13.02.2019, <https://pd.al/2016/02/shqiptaret-perballen-sot-me-tiranine-e-varferise-krimit-dhe-korrupsionit/>, vizituar më 22.12.2022.

16 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri diktaturë.

*të cilët shtypnin e shfrytëzonin pa mëshirë robërit e shtresat e varfra; përmb. grupi i vogël sundues në këtë formë qeverisjeje.*

*2. Sundimi politik dhe ekonomik i një grupi të vogël miliarderësh në vendet imperialiste, të cilët përfaqësojnë diktaturën e kapitalit financiar dhe të monopoleve; përmb. pronarët e monopoleve të mëdha që bëjnë pjesë në këtë grup dhe që nxjerrin fitime të shumta duke shfrytëzuar egërsisht masat e gjera punonjëse në vendet kapitaliste, si edhe vendet e prapambetura. Oligarkia financiare<sup>17</sup>.*

Ndërkohë që pushteti dhe mënyra e ushtrimit të tij është e një forme të ngjashme vetëm me atë të tiranëve të antikitetit.

### **TIRAN m.**

*1. hist. Sundimtar i vetëm e me pushtet absolut në Greqinë e vjetër ose në Itali gjatë shekujve XIII-XV...  
2. Sundimtar; që qeveris me dhunë e me të egërdhe që shtyp popullin pa mëshirë; despot.  
3. fig. Ai që shpërdoron autoritetin e tij, duke marrë nëpër këmbë dëshirat e vullnetin e të tjerëve; ai që shtyp e mundon dikë; despot.<sup>18</sup>*

Në pamje të parë, dhe më tej, në analizimin e këtyre termave, kemi të bëjmë me koncepte politike të ndryshme, për arsye se në një diktaturë, pushteti ushtrohet nga një person i vetëm, kurse në oligarki pushteti ushtrohet nga një grup personash. Mirëpo, në sytë e audiencës, pak rëndësi ka dallimi midis koncepteve në vetvete, ajo që i lidh këto koncepte është mënyra e ushtrimit të pushtetit.

*Diktatura, oligarkia, tirania dhe despotati janë të gjitha forma të qeverisjes të cilat karakterizohen nga pushtete të pakufizuara, ku parimet e përfaqësimit, kontrollit dhe balancës së pushtetit nuk aplikohen. Këto lloje sistemesh janë autokratike, ku pushteti nuk i njihet individit me vullnet të lirë të shtetasve, por pushteti rrëmbehet me forcë e dhunë apo në mënyra të tjera jologjore dhe/ose kur kushtet dhe situata politike dhe sociale kërkonin kufizim të të drejtave dhe lirive të individit, duke marrë parasysh edhe kontekstin historik në të cilin është zhvilluar ngjarja. Ajo që i bashkon këto elemente është dhuna me të cilën shoqërohet zbatimi i pushtetit dhe i vullnetit politik. Ligjëruesi synon që nëpërmjet përdorimit të termave sinonimikë në thëniet e tij, të përqendrohet më tepër te pasoja (dhuna) dhe jo mbi formën politike dhe ideologjinë e saj.*

---

17 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri oligarki.

18 Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri tiran.

Më tutje, dhënia e një përkufizimi të tyre, si pushtet i pakicës (klasës, shtresës, kastës) realizon në mënyrë më të qartë përçimin e mesazhit të synuar. Interesante është dhënia e kuptimit sinonimik të termit *byro politike* dhe *byro mafioze* që synon krijimin e paralelizmit mes organit më të lartë politik të Partisë së Punës, sipas modelit sovjetik, dhe kupolës mafioze, organi më i lartë vendimmarrës të Cosa Nostrës.

Edhe në këtë rast, përdorimi i këtyre togfjalëshave në këtë formë dhe në këtë mënyrë synon drejt kuptimit sinonimik. Më tutje, është *modus operandi* e ligjëruesve politikë që të pasurojnë pohimin e tyre me emra specifike të grupit që, sipas tyre, kryesisht në formë të hamendësuar, ushtrojnë një ndikim të supozuar jashtëligjor në vendimmarrjen politike. Në të dy kampet politike, ky grupim përfshin persona që realisht janë në qeveri ose pranë tyre.

Në këndvështrimin e Miço Samarës, në konceptin leksikografik, këto terma renditen në fushën e *Pushtetit* dhe të *strukturave të shoqërisë* sipas nën fushave përkatëse. Kështu, këto koncepte gjejnë renditje si përrshkrime të *pushtetit të qeverisë* ose/dhe *shtresave a klasave shoqërore, pikëpamjeve të tyre etj.* Përdorimi i këtyre termave shmanget nga kjo fushë, duke krijuar një përzierje edhe me fushën e historisë së përgjithshme apo politologjisë dhe filozofisë<sup>19</sup>.

### **Antonimia dhe vlerat e saj shprehëse**

Fjalët dhe strukturat gjuhësore që ndërtohen në bazë të marrëdhënieve antonimike u japin mundësi të pafundme zgjedhjeje ligjëruesve, duke e bërë ligjërimin politik sa më shprehës dhe me vlera stilistikore. Më lart, përveç të tjerave, parashtruam qasjen për sinoniminë stilistike dhe rëndësinë e saj në analizën dhe interpretimin e ligjërimit politik, duke e pasuruar leksikun në kontekstin politik, por edhe duke kontribuar në marrëdhëniet koherente e kohezive që duhet të ekzistojnë në brendësi të aktit ligjërimit.

Në të njëjtën logjikë shkon edhe përdorimi i antonimisë stilistike. Ajo shërben për t'i dhënë audiencës (lexues apo dëgjues) një efekt të veçantë, duke theksuar në mënyrë tërheqëse idenë që duam të shprehim<sup>20</sup>. Edhe pse antonimet stilistike kanë rëndësi dhe pasurojnë të folurin politik, sipas I. Goçit, ato përdoren më shumë si mjete stilistike “periferike”, sepse ato nuk i japin ligjëruesit aq shumë mundësi

19 Samara M., “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe”, Akademia e Shkencave, Tiranë 2008, fq. 14-19.

20 Samara M., “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe”, Akademia e Shkencave, Tiranë 2008, fq. 175.

zgjedhjeje sa sinonimet<sup>21</sup>.

Për këtë çështje, interesant është edhe studimi i Ch. Bally-së, i cili analizon se “vlerat shprehëse të fjalëve kushtëzohen edhe nga prejardhja shoqërore dhe nga pozita e personit që flet”<sup>22</sup>. Studiues të tjerë të mëvonshëm e kanë rimarrë këtë ide, duke theksuar se “janë faktorët shoqërorë ato që kushtëzojnë antonimet stilistike”<sup>23</sup>.

- E pra, në 23 qershor nuk është një zgjedhje mes çfarë jemi në emër të së shkuarës, vijmë nga e djathta apo vijmë nga e majta, nuk është një zgjedhje për gjyshin, a ka qenë gjyshi me Nacionalçlirimtaren apo ka qenë gjyshi me Ballin, nuk është një zgjedhje për çfarë ne ruajmë brenda vetes si pasoja të një të shkuare dasie, mllefi, urrejtjeje, që e ka futur komunizmi dhe e ka ushqyer Saliu në tërë këto vite, por është një zgjedhje mes *rrënim* dhe *Rilindjes*. *Rrënim* të vendit, *rrënim* të biznesit, *rrënim* të ekonomisë të vendit, *rrënim* të arsimit, *rrënim* të shëndetësisë, *rrënim* të fshatit ose *Rilindjes*, *Rilindjes*, *Rilindjes*, *Rilindjes*, *Rilindjes*.<sup>24</sup>

Pasazhi i mësipërm është i shkëputur nga një fjalim i Edi Ramës, në fushatën elektorale të vitit 2013. Fjala kyçe e kësaj fushate për Partinë Socialiste ishte “Rilindja”, e cila gjendet e përmendur dhe e përsëritur kudo, në çdo takim elektorale, në çdo mesazh apo fjalim politik të kohës. “Rilindja”, duke qenë motoja e fushatës, mund t’i shërbente lehtësisht propagandës së asaj kohe për të rritur forcën e përcjelljes së mesazhit. Prej kohësh, opozita e atyre viteve dhe në mënyrë të veçantë ligjëruesi kishin theksuar gjendjen e keqe, rrënimin etj. të vendit dhe të popullatës, si pasojë e keqeverisjes. Në këtë kuadër, ligjëruesi (Rama) tenton të vendosë në kontrast të vazhdueshëm të tashmen problematike “të rrënim”, me të ardhmen “e rilindur” të popullit, që do të vinte si pasojë e mirëqeverisjes nga ana e tij dhe qeverisë së tij.

Siç thekson edhe B. Budini, në diskursin e tij Rama synon të nxisë reagime “pozitive, mbështetëse” nga të gjitha anët e politikës; për këtë arsye, përdorimi i antonimeve stilistikore duhet parë në funksion të retorikës populiste të tij<sup>25</sup>. Kështu, në pasazhin e mësipërm, do të vëmë re një kombinim të antonimeve mes koncepteve antagonistë, siç është rasti i Ballit dhe Nacionalçlimentares, ku bëhet dallimi mes dy grupimeve haptazi antagonistë gjatë Luftës së Dytë Botërore: Frontit

---

21 Goçi I., “Antonimet e gjuhës së sotme shqipe”, Institut i Albanologjik i Prishtinës, Seksioni i Gjuhësisë, Prishtinë, 1985, fq. 110.

22 Bally Ch., “Le language et la vie”, Geneve, 1952, fq. 79.

23 Goçi I., “Antonimet e gjuhës së sotme shqipe”, Institut i Albanologjik i Prishtinës, Seksioni i Gjuhësisë, Prishtinë, 1985, fq. 112-113.

24 <http://ps.al/fjalime/rilindja-nis-nga-kthimi-ishqiperisenepune/>, vizituar më 10.12.2022.

25 Budini B., “Edi Rama, politikani pop(ulist)-star, UET Press, 2009, fq. 28-30.

Nacionalçlirimtar, i dominuar nga komunistët, dhe Ballit Kombëtar, organizatë republikane nacionaliste e djathtë<sup>26</sup>. Por, ligjëruesi i referohet dekodimit që lind në pjesën më të madhe të audiencës së cilës i referohet, ku anëtarët e Ballit shiheshin si pasojë e indoktrinimit gjatë monizmit, si:

**BALLIST**, ~I m. sh. ~E, ~ET.

Anëtar i “Ballit Kombëtar” (organizatë politike tradhtare e borgjezisë dhe e çifligarëve, që bashkonte rryma të ndryshme reaksionare në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare dhe që me një program demagogjik nationalist iu kundërvu Frontit Nacionalçlirimtar e bashkëpunoi me pushtuesit fashistë e nazistë)<sup>27</sup>

Një rast tjetër është kur përballë vendosen *rilind* e *Rilindja*:

**RILIND** *jokal*.

1. *Lind përsëri, vjen përsëri në jetë diçka e shkatërruar a e zhdukur, ringjallet.*<sup>28</sup>

dhe *rrënimi*

**RRËNOJ** *kal*.

1. *Shemb përdhe diçka të ndërtuar, kthej në gërmadhë, shkatërroj, prish krejt.*

2. *fig. I sjell humbje të rënda materiale, e shkatërroj ekonomikisht, e varfëroj krejt.*

3. *fig. Dëmtoj rëndë, i sjell dëm të madh, shkatërroj, prish. I rrënoi shëndetin. I rrënoi jetën.*<sup>29</sup>

Le të marrim në konsideratë tani një pasazh nga një fjalim i mbajtur nga një lider demokrat (Lulzim Basha), ku do të evidentojmë raste të tjera interesante të strukturave antonimike. Fjalimi është i shkëputur gjatë fushatës së ligjëruesit, kur kandidonte për kryetar bashkie. Në mënyrë të vazhdueshme ai synon të dëshmojë

26 “Historia e popullit shqiptar në katër vëllime”, Vëllimi i katërt, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, Botimet Toena, Tiranë, 2008, fq. 58-59.

27 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri Ballist.

28 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri rilind.

29 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave, 1980, zëri rrënoj.

që është i interesuar që të ndjekë vija politike që eliminojnë dallimet mes elektoratit të majtë dhe atij të djathtë (ndasitë). Ai synon votat e shtresave të mesme, votuesve të pavendosur dhe të rinjve. Për këtë arsye, ai zgjedh t'i vërë ata përpara opsioneve që kishin: në rast se zbatoheshin parimet e politikës së vjetër dhe një rrugë të re që shkonte përtej konceptimit të kampeve ideologjike apo parapëlqimeve politike tradicionale. Ndaj, antonime stilistikore të përdorura nga ligjëruesi në këtë mënyrë e bëjnë ligjërimin, shprehës, plot jetë, e tërheqës në të njëjtën kohë.

- Njëra rrugë na kthen tek *politika e vjetër e ndasive, akuzave, konfliktit dhe pesimizmit* dhe kjo rrugë na lë në vend. Rruga tjetër na udhëheq drejt *mundësisë, bashkimit, shpresës, progresit dhe optimizmit* ku në qendër jeni ju dhe zgjidhjet e problemeve tuaja, dhe kjo rrugë na çon drejt mundësive të reja për secilin, drejt zgjidhjeve të mëdha për Tiranën<sup>30</sup>.

Rrjedhimisht, në këtë pasazh, gjenden të kundërvërna ndaj njëra – tjetrës dy forma botëkuptimore antagonistike në thelb, dhe të ngritura sipas sistemeve morale të ndryshme. Ligjëruesi nuk bën gjë tjetër veçse vendos audiencën para zgjedhjes së një prej vlerave përmes antonimisë së drejtpërdrejtë të vlerave me konotacion negativ, *ndasi, akuza, konflikt dhe pesimizëm*, nga njëra anë, dhe vlerave me konotacion pozitiv, *mundësi, bashkim, shpresë, progres dhe optimizëm*. Pra, nga njëra anë kemi stanjacionin, nga tjetra progresin.

### **Hiponimia dhe meronimia, si të kundërta të njëra tjetrës**

*Hiponimia* është lloji i kohezionit leksikor, e cila nënkupton përfshirjen e një termi të veçantë në një term më të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, konceptet më të përgjithshme, që i referohen një klase më të madhe apo më gjithëpërfshirëse, përfshijnë brenda vetes konceptet më të veçanta.

*Meronimia*, si një lloj tjetër i kohezionit leksikor, nënkupton një pjesë që përfaqëson të tërën. Pra, kuptimisht, ajo është e kundërta e hiponimisë, së përmendur më lart. Për pasojë, për analizimin e shembujve të hiponimisë dhe meronimisë, të marra së bashku, po iu referohemi pasazhit të mëposhtëm.

- Unë s'kam ardhur të flas për *Ben Blushin*, unë nuk flas në publik për këtë, e kam parim. Çfarë kam me *deputetët*, çfarë kam me *njerëzit e familjes sonë politike*,

---

30 Basha shpall kandidaturën, 25 mars 2011, <http://www.lajme.gen.al/2011-03-25/lulzim-basha-fjalimi-i-plote-ne-shpalljen-e-kandidatures.html>, vizituar më 01.12.2022.

ua them në sy dhe në *forumet tona*<sup>31</sup>.

Në këtë pasazh, vihet re një përshkallëzim i informacionit dhe krijim i distancave në mënyrë të shkallëshkallshme. Fillimisht, ligjëruesi i referohet subjektit të pyetjes me emrin e tij (*Ben Blushi*) dhe menjëherë krijon distancë, duke e njësuar me emërtimin e përgjithshëm *deputet*. Në këtë mënyrë, nëpërmjet manipulimit semantik të konceptit të deputetit, ligjëruesi shpalos qëndrimin e tij personal ndaj personit në fjalë. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me meronimi: Ben Blushi-deputet, ndërsa në të kundërt, e anasjella e këtij çifti do të konsiderohej si hiponimi.

Në vazhdim, ligjëruesi unifikon në një koncept të vetëm anëtarësinë dhe simpatizantët, duke i cilësuar ata si familje politike dhe njëkohësisht bën dallimin e familjes politike nga organet e ligjshme të partisë. Kështu, në shumicën e rasteve, familja politike përveç anëtarësisë, përfshin edhe aktivistë, vullnetarë apo persona të tjerë, të cilët në mënyrë të vazhdueshme ose të përkohshme mbështesin partinë apo veprimtarinë e saj. Ndërkohë, *forumet*, përfshijnë seksionet, grup-seksionet, degët, kryesinë dhe organet e tjera kolegjiale.

### Lidhjet bashkëvuajtëse element i kohezionit leksikor

*Lidhjet bashkëvuajtëse* i përgjigjen raporteve të caktuara logjike dhe konjitive mes fjalive apo thënieve të ndryshme. Halliday dhe Hassan-i mendojnë se efekti koheziv i të tilla lidhjeve nuk bazohet në ndonjë raport sistematik semantikor, por ato priren të shfaqen në bashkëvuajtje me njëra-tjetrën, në përputhje me atë që konsiderohet si njohja jonë për botën<sup>32</sup>. Për të ilustruar efektin e lidhjeve bashkëvuajtëse në ligjërimin politik, le të marrim në konsideratë këto thënie.

- Ata që fishkëllyen në sallën në Elbasan ishin 2800 *kriminelë* të mbledhur të gjitha moshave dhe grupeve me shtresa të ndryshme. Të gjithë ishin mbledhur nga *skutat e krimit*<sup>33</sup>.

Në fjalitë e mësipërme, lidhjet bashkëvuajtëse ekzistojnë midis dy koncepteve *kriminel* dhe *skutat e krimit*. Në ligjërimin e tij, ligjëruesi synon të vendosë një marrëdhënie bashkëvuajtëse mes konceptit të kriminelit, person i cili në fshehtësi vepron në kundërshtim me ligjin, si dhe vendit ku ai në fshehtësi vepron duke emërtuar atë “skutë”. Po shkëpusim edhe përkufizimin e fjalës “skutë” sipas Fjalorit

31 <https://www.gazeta-shqip.com/2016/03/11/rama-fjalimi-i-blushit-i-ngjashem-si-ne-varrim/>, dt. 11.03.2016, vizituar më 24.12.2022.

32 Halliday Hassan, vep. e cit., 1976, fq. 286.

33 Ben Blushi fjala në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë më 21.01.2016, tek: “Punime të Kuvendit Legjislativa e 8-të”, Viti 2016, nr. 1, fq. 74 – 75, <http://www.parlament.al/Files/Informacione/libri-1-2016.pdf>.

të Gjuhës së Sotme Shqipe:

### **SKUTË** I f.

1. *Cep i futur, vend i mënjanuar dhe i fshehtë; kënd, qoshe.*

2. *fig. Ana e panjohur, e thellë ose e fshehtë e diçkaje.*<sup>34</sup>

Përdorimi i koncepteve “kriminel” dhe “skutë”, në funksionin e lidhjeve bashkëvjatëse, në mënyrë të tërthortë mund të lidhet edhe me trashëgiminë që ligjërimi aktual ka marrë nga ligjërimi gjatë diktaturës komuniste, ku mund të hasen struktura të tilla si: “armiqtë e klasës” nxirrin kokat nga skutat e tyre; “armiqtë e klasës” fshiheshin në skutat më të errëta etj.

### **Përfundime**

Konceptet e *koherencës* dhe *kohezionit* zënë një vend të rëndësishëm në analizën e diskursit politik, pasi janë këto elemente që e bëjnë përftesën ligjërimore të mirë strukturuar, tërheqëse, shtjelluese dhe argumentuese në të njëjtën kohë. Për të analizuar dhe interpretuar diskursin politik nga pikëpamja e koherencës dhe e realizuar përmes mjeteve kohezive, kemi marrë në shqyrtim kryesisht fjalime politike të mbajtura nga drejtues politikë në periudha të ndryshme kohore. Ajo që vëmë re, është se fjalimet politike, si pasojë e përmbajtjes dhe mënyrës së organizimit të tyre, janë përgjithësisht të mirë strukturuar. Kjo është arsyeja pse ligjëruesit politikë tentojnë të shfaqen si koherentë, dhe fjalimet e tyre përmbajnë mjete të ndryshme të kohezionit leksikor. Të tilla mjete ndihmojnë në ngjizjen konceptuale mes thënieve të ndryshme, të cilat çojnë drejt argumentimit të saktë dhe përfundimeve të qarta, duke formësuar një tekst apo diskurs kuptimplotë.

Siç e kemi përmendur edhe më parë, diskursi politik është një produkt i faktorëve që lidhen ngushtë me realitetin ideologjik që karakterizon një shoqëri. Në varësi të ideologjisë mbizotëruese, në momentin e caktuar historik, gjejmë të përdorura leksema të ndryshme, të cilat i nënshtrohen modifikimeve thelbësore të kuptimit. Shembuj interesantë interpretimi përbënin emërtime të tilla si: *demokraci, proletar, oligarki*, por edhe *Rilindje e projekt*.

### **BIBLIOGRAFIA:**

---

34 Fjalori i gjuhës së sotme shqipe : (me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tirane : Akademia e Shkencave, 1980, zëri skutë.



“Historia e popullit shqiptar në katër vëllime”, (2008): Vëllimi i katërt, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, Botimet Toena, Tiranë.

BALLY CH., (1952): “Le language et la vie”, Geneve .

BUDINI B., (2008): “Edi Rama, politikani pop(ulist)-star, UET Press.

DASCAL M., (2008): “Dichotomies and types of debate” In: F. H. van Eemeren and B. Garsen (red.), Controversy and Confrontation: Relating Controversy Analysis ëith Argumentation Theory, Amsterdam, John Benjamins.

DAUTI L., (2017): “Hyrje në gjuhësi teksti”, ILAR, Tiranë.

Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (1980)(me rreth 41.000 fjalë), Akademia e Shkencave, Tiranë : Akademia e Shkencave,.

GOÇI I., (1985): “Antonimet e gjuhës së sotme shqipe”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Seksioni i Gjuhësisë, Prishtinë.

HALLIDAY M. & HASSAN R., (1976): “Cohesion in English”, Longman.

LLOSHI XH., (2001): “Stilistika dhe Pragmatika e gjuhës shqipe”, SHBLU, Tiranë.

POGGI I., (2005): “The goals of persuasion”, in “Pragmatics and Cognition”, Vol. 13:2, Benjamin Publishings.

SALKIE R., (1995): “Text and discourse analysis”, Routledge, London.

SAMARRA M., (2008): “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

## BURIME NGA INTERNETI:

<http://ps.al/fjalime/rilindja-nis-nga-kthimi-i-shqiperise-ne-pune/>

Basha shpall kandidaturën, 25 mars 2011, <http://www.lajme.gen.al/2011-03-25/lulzim-basha-fjalimi-i-plote-ne-shpalljen-e-kandidatures.html>

Ben Blushi fjala në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë më 21.01.2016, tek: “Punime të Kuvendit Legjislativa e 8-të”, Viti 2016, nr. 1, fq. 74 – 75, <http://www.parlament.al/Files/Informacione/libri-1-2016.pdf>

<https://www.pd.al/2016/02/shqiptaret-perballen-sot-me-tiranine-e-varferise-krimit-dhe-korrupsionit/>

<https://www.gazeta-shqip.com/2016/03/11/rama-fjalimi-i-blushit-i-ngjashem-si-ne-varrim/dt.11.03.2016.>

Prezantimi i programit ekonomik të PD dt. 07.04. 2017, <https://pd.al/2016/04/programi-i-pd-se-per-daljen-nga-kriza-ekonomike-punesim-permes-ulje-taksash-investime-publike-liri-per-sipermarrjen-dhe-barazi-para-ligjit/>.

Lulzim Basha fjalim në Shkodër dt. 13.02.2019, <https://pd.al/2016/02/shqiptaret-perballen-sot-me-tiranine-e-varferise-krimit-dhe-korrupsionit/>

# NJË PASQYRË MBI POLISEMINË NË TERMINOLOGJI SI TË REFLEKTUAR NË FJALORIN ENGLISH-SHQIP

**Dr. Fatma Shijaku**

Departamenti i Gjuhës Angleze

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: fatma.shijaku@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Ky punim trajton çështje të polisemisë së termave të ilustruar me shembuj të marrë kryesisht nga gjuha ligjore dhe fusha e ekonomisë si dhe të trajtimit që këto çështje gjejnë në fjalorët dygjuhësh english-shqip. Punimi hedh dritë mbi kontekstin e përkthimit të terminologjisë dhe të ndikimit që ky ka në leksikografinë dygjuhëshe apo dhe në analizën e termave në përgjithësi. Ai do të cekë se si është kuptuar tradicionalisht termi dhe lidhja e tij me poliseminë. Disa prej shembujve të polisemisë në termat ekonomikë dhe ligjorë janë trajtuar dhe analizuar sipas zgjidhjeve leksikografike që u janë dhënë dhe disa zgjidhjeve të tjera që mund të reflektohen më vonë.

**Fjalët çelës:** term, terminologji, leksikografi dygjuhëshe, terma ligjorë, terma ekonomikë, etj.

## A GLIMPSE ON POLYSEMY IN TERMINOLOGY AS REFLECTED IN ENGLISH-ALBANIAN DICTIONARIES

### ABSTRACT

This paper focuses on issues of polysemy in terminology with examples depicted mostly from the language of law, economics and the treatment of these issues in the bilingual “English-Albanian dictionaries”. It throws light on the context of the translations of terminology and its impact upon bilingual lexicography in general or in its analysis of terms. There is a touch upon the traditional understanding of what a term is and its relation to polysemy. Some examples of polysemy in legal and economic terminology are discussed and some of the lexicographical solutions being given and some other ones to be considered.

**Keywords:** term, terminology, bilingual lexicography, legal terms, economic terms, etc.

### 1. INTRODUCTION

Gjithashtu, fjalorët terminologjikë janë të rëndësishëm për studentët në kuptimin e materialeve të mësimdhënies në fusha të ndryshme studimi, duke ndihmuar në përdorimin e terminologjisë së duhur dhe në zgjerimin e fjalorit dhe kuptimin e koncepteve të rëndësishme për mbarëvajtjen e njohurive. Prezantimi i terminologjisë ka për synim të zgjojë njësi kuptimore në mendjen e përdoruesit që lidhen me reflektimin e realitetit (**Karaulov, 1976**). Për studentët e gjuhëve të huaja fjalori terminologjik është miku më i mirë, duke i shpjeguar atyre me detaje të gjitha kuptimet e mundshme të fjalëve dhe duke i bërë ata më të aftë në profesion.

Ndër arsyet e tjera mund të përmendet ndihma që fjalorët terminologjikë ofrojnë në përmirësimin e komunikimit midis specialistëve dhe publikut të gjerë, duke ofruar komunikim të qartë dhe të saktë, si dhe në zhvillimin e fushave të ndryshme të studimit, duke ndihmuar në krijimtari dhe inovacion.

## **SFIDAT DHE VËSHIRËSITË E STUDENTËVE NË MËSIMIN E FJALORIT TEKNIK**

Mësimi dhe përvetësimi i fjalorit teknik është aspekt shumë i rëndësishëm në studimet e larta dhe në shkollat e mesme teknike, por një pjesë e madhe e studentëve përballet me vështirësi në mësimin e termave. Në këtë artikull do të shqyrtojmë disa nga arsyet pse mësimi i fjalorit teknik shkakton vështirësi për studentët. Sipas një pyetësoi me studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në degën e gjuhës angleze, rezultoi se studentët përballen me disa sfida gjatë mësimin të fjalorit të përgjithshëm por kryesisht me atë teknik. Të pyetur për vështirësitë që hasin gjatë mësimin të fjalorit të përgjithshëm dhe terminologjik, si dhe për mënyrën e studimit dhe përvetësimit të tij, studentët listuan disa arsye.

Një nga arsyet kryesore pse mësimi i termave është proces i vështirë për studentët është se fjalori teknik është tepër kompleks dhe i gjerë, edhe pse brenda një disipline ose fushe të caktuar. Fushat e ndryshme të studimit kanë terminologji të veçantë dhe kjo bën që numri i fjalëve dhe shprehjeve të jetë i madh për studentët. Në këtë mënyrë ata mund të humbasin motivimin dhe durimin për të mësuar, duke anashkaluar mësimin e këtyre termave.

Një tjetër arsye është se ekzistojnë shumë terma të ngjashëm dhe të lidhur me njëri-tjetrin, të cilët mund të krijojnë ngatërrim ose konfuzion. Gjithashtu një term mund të përdoret në fusha të ndryshme studimit, duke marrë kështu kuptime

të ndryshme.

P.sh: complementary/complimentary

Një arsye tjetër pse mësimi i një terminologjie të caktuar është i vështirë lidhet me mungesën e kontekstit. Nëpërmjet përdorimit të fjalorit terminologjik, studentët mund të mësojnë fjalët dhe shprehjet, por pa pasur kontekst do të hasin vështirësi me mënyrën si ato fjalë përdoren në praktikë. Kjo do i bënte studentët të ndihen të pasigurt në lidhje me përdorimin e këtyre termave në praktikë.

Së fundmi, sipas studentëve, një arsye tjetër pse përvetësimi i fjalorit teknik është i vështirë ka të bëjë me mënyrën e të mësuarit dhe të fiksuarit. Terminologjia e një fushe të caktuar mësohet përmes leximeve dhe përkthimeve të vazhdueshme. Kjo bën që procesi i mësimit të jetë i gjatë dhe i lodhshëm, duke krijuar vështirësi në fiksimin e një liste me fjalë të reja.

## **SUGJERIME PËR NJË MËSIMDHËNIE EFEKTIVE TË FJALORIT TERMINOLOGJIK**

Duke marrë shkas nga sfidat dhe vështirësitë me të cilat studentët përballen gjatë mësimit të terminologjisë së fushës së tyre të studimit, do të prezantojmë disa sugjerime për mësimdhënie më efektive lidhur me mësimin e fjalorit terminologjik. Në këto kushte edhe studentët do të përfitojnë duke mësuar më mirë dhe më shpejt fjalorin.

Fillimisht konteksti luan rol shumë të rëndësishëm në kuptimin e qartë të fjalorit terminologjik. Një mënyrë efektive për të ndihmuar studentët të kuptojnë fjalët terminologjike është të shpjegohen në kontekstin përkatës. Për shembull, nëse studentët po mësojnë terminologjinë gjuhësore, atëherë duhet të paraqiten raste kur këto fjalë përdoren në praktikë, si për shembull në sintaksë në një fjali.

Përdorimi i shembujve konkretë është një tjetër mënyrë për t'i ardhur në ndihmë studentëve në mënyrë që të kuptojnë fjalorin terminologjik. Kjo mund të bëhet duke treguar imazhe, modele ose raste të vërteta të përdorimit të fjalëve në praktikë. Kjo do të krijonte një panoramë më të qartë të termave, duke e bërë kuptimin dhe fiksimin e tyre më të thjeshtë.

Metodat e ndryshme të mësimdhënies, të përshtatura sipas rastit, problematikës ose natyrës së leksionit e ushtrimit janë kyçe për të marrë kuptimin e asaj çfarë profesorët kërkojnë të përcjellin tek studentët. Është e rëndësishme që mësimdhënia

e fjalorit terminologjik të bëhet në mënyra të ndryshme për të përshtatur më mirë me nevojat e studentëve. Për shembull, disa studentë mund të jenë më të përkushtuar në mësimin e fjalëve duke i shpjeguar ato, ndërsa të tjerë mund të kenë më shumë përfitime duke i praktikuar nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve të ndryshme.

Gjithashtu për të arritur një mësimdhënie efektive për fjalorin terminologjik, fokusi duhet të vendoset edhe tek përsëritja e fjalëve, jo vetëm tek prezantimi dhe shpjegimi i tyre për herë të parë. Gjithashtu, përsëritja është mënyrë e fuqishme për të ndihmuar studentët të mësojnë fjalorin terminologjik. Është shumë e rëndësishme që fjalët të përsëriten në mënyra të ndryshme dhe në intervale të ndryshme kohore për të ndihmuar studentët të ruajnë informacionin dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë më vonë.

Së fundmi një sugjerim tjetër lidhet me kohën që studentët kanë nevojë për të përthithur informacionin e ri që lidhet me natyrën e mësimit të termave. Në disa raste, studentët mund të kenë nevojë për më shumë kohë për të mësuar fjalorin teknik. Në një situatë të tillë, profesorët duhet të ofrojnë pak më shumë kohë për studentët që të mësojnë dhe fiksojnë informacionin e ri.

Fjalëformimi është aspekt i rëndësishëm në mësimin e terminologjisë. Ky proces përfshin përdorimin e elementëve të caktuara për të krijuar fjalë të reja që kanë një kuptim specifik. Përmes fjalëformimit, mund të krijohen fjalë të reja nëpërmjet përdorimit të parashtesave ose prapashtesave, duke i dhënë një kuptim të veçantë ose të tjetërsuar. Në këtë mënyrë, mund të mësojmë një numër të madh të terma të rëndësishëm në fusha të ndryshme, duke i kuptuar më mirë dhe duke i përdorur ato me lehtësi. Fjalëformimi është mjet i rëndësishëm për të zgjeruar fjalorin dhe për të kuptuar më mirë terminologjinë në fusha të ndryshme të dijës.

Teknologjia është një aspekt i pranishëm në jetën e njerëzve. Një avantazh i rëndësishëm i teknologjisë është se ajo mund të na ndihmojë në mësimin e fjalëve teknike në mënyra të ndryshme. Në internet, gjenden faqe dhe aplikacione të dedikuara për mësimin e fjalëve teknike, me shpjegimet dhe shembujt që ndihmojnë të kuptojmë se si ato përdoren në kontekstin e duhur. Një tjetër mjet i rëndësishëm është mësimi online dhe trajnimi në distancë. Me teknologjinë e video - konferencave dhe platformat e mësimit online, mund të marrim pjesë në kurs online dhe seminare ku mund të mësojmë fjalët dhe terminologjinë në lëndë të ndryshme nga shtëpia ose vendi i punës.

Gjuha dhe fjalët teknike janë thelbësore në shumë fusha të njohura dhe të reja, dhe teknologjia na mundëson të arrijmë këtë njohuri në mënyra të ndryshme dhe të përshtatshme për ne.

## **BIBLIOGRAFIA:**

- AVERBUH K.YA., (2004): General theory of the term. Ivanovo: Ivanovo State University.
- BUDIN G. & ZOCK M., (Eds.), (2002): Specialized dictionaries for learners. John Benjamins Publishing.
- CABRÉ M. T., (1999): Terminology: Theory, methods, and applications. John Benjamins Publishing.
- ËILLIAMS J.L., (Ed.), (1991): Geiriadur Termaw/Dictionary of Terms, 1st ed. reprinted; University of Wales Press: Cardiff, UK.
- WRIGHT S. E. & BUDIN G., (Eds.), (2011): Handbook of terminology management: Volume 1: Basic aspects of terminology management (Vol. 1). John Benjamins Publishing.
- FATKULLINA F. G. & SULEYMANOVA A.K., (2014): Term in the terminological system: theoretical basis and analysis principles.
- FATKULLINA F., MOROZKINA E. & SULEYMANOVA A., (2015): Modern Higher Education: Problems and Perspectives.
- FELBER H. & KOCKAERT H., (Eds.), (2015): Handbook of terminology (Vol. 1). John Benjamins Publishing.
- GRINYOV S.V., (1993): Introduction to Terminology.
- L'HOMME M. C. & DAILLE B., (Eds.), (2009): Terminology in Texts and Contexts. John Benjamins Publishing.
- PICHT H. & DRASKAU J., (2005): Terminology: An introduction. John Benjamins Publishing.
- SUE-A-QUAN C., (Ed.), (2017): Terminology in the changing world of communication. John Benjamins Publishing.
- TEMMERMAN R., (2000): Towards new ways of terminology description: The sociocognitive-approach. John Benjamins Publishing.

# GJUHA DHE TERMINOLOGJIA TË NDIKUARA NGA KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR DHE GLOBALIZMI

**Dr. Miranda Veliaj – Ostrosi**

Departamenti i Gjuhës Angleze

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

E-mail: mveliaj@yahoo.com

## **PËRMBLEDHJE**

Ky punim do të fokusohet kryesisht në disa aspekte dhe përvojë praktike gjatë procesit të mësimdhënies së anglishtes për qëllime specifike për studentët e shkencave ekonomike dhe njerëz të biznesit, duke u përpjekur të nxjerrim në pah ndikimin e globalizimit dhe komunikimit ndërkulturor për mësimin e gjuhës dhe përvetësimin e fjalëve të reja. Disa momente vendimtare se si prejardhja kulturore dhe përvojat e jetës së përditshme luajnë një rol në të mësuarit e gjuhës dhe përvetësimi për identifikimin e mënyrave për të mësuar terminologjinë në rastin më të mirë dhe për të gjetur zgjidhjet për të kapërcyer disa vështirësi në përvetësimin e terminologjisë gjuhësore janë paraqitur dhe ndarë në kuadër të këtij punimi. Ajo që vjen si një përvojë personale, përmes prejardhje të ndryshme kulturore dhe profesionale, duhet të transmetohen dhe të ndahen me të tjerë në mënyrë që të arrihet një proces më efikas i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Futja dhe zhvillimi i mjeteve teknologjike inovative në dekadën e fundit ka ndikuar gjithashtu dhe paraqitur mundësi të gjera që do të duhet të merren në konsideratë nga studiues dhe mësues të gjuhëve të huaja. Ndërsa përpigëni të mësoni fjalë dhe koncepte të reja në një gjuhë të huaj, forma të reja shpjegimi ose përkufizimi, interpretimi duhet të hulumtohet dhe zbatohet në mjedisin mësimor të ESP-së duke synuar të rrisë jo vetëm ruajtjen e fjalorit por edhe të nxisë lehtësisht konceptet dhe procese të reja.

**Fjalët çelës:** formim kulturor dhe profesional, mjedis mësimor, mësimi i gjuhës, anglishtja e biznesit, komunikimi ndërkulturor, përvetësimi i gjuhës, mjetet mësimdhënëse inovative.

## **LANGUAGE AND TERMINOLOGY AFFECTED BY INTERCULTURAL COMMUNICATION AND GLOBALIZATION**

### **ABSTRACT**

This paper will mainly focus on some aspects and practical experience during the process of teaching English for Specific Purpose to students of economic sciences and other business people, trying to highlight the impact globalisation and intercultural communication on language learning and new words acquisition. Some crucial moments of how cultural backgrounds and everyday life experiences play a role in language learning and acquisition for identifying ways to teach terminology at best and find solutions to overpass certain difficulties in language terminology acquisition are presented and shared within this paper. What comes as a personal experience, through different cultural and professional background, needs to be transmitted and shared with others so that a more efficient teaching and learning process can be achieved. The introduction and development of innovative technological tools in the recent decade has been also influencing and presenting broad opportunities which will need to be addressed by scholars and teacher of foreign languages. While trying to teach new words and concepts in a foreign language, new forms of explanation or definition interpretation should be explored and implemented in the ESP learning environment aiming to increase not only vocabulary storage but also to easily foster concepts and new processes.

**Keywords:** cultural and professional background, learning environment, language learning, business English, intercultural communication, language acquisition, innovative learning tools.

## HYRJE

Mësimi i Anglishtes si gjuhë e huaj dhe veçanërisht asaj për qëllime specifike ka zënë gjithnjë e më shumë një vend të rëndësishëm në kurrikulat e programeve të gjuhëve të huaja jo vetëm në Shqipëri por edhe më gjerë, qoftë në Evropë apo kontinente të tjera. Me globalizimin e ekonomisë botërore, anglishtja është bërë më shumë se kurrë gjuha e përbashkët e bisedimeve diplomatike, juridike, sportit dhe veçanërisht e biznesit. Nëse do t'i referoheshim eksperiencave nga vendi ynë por dhe atyre në vende të tjera sidomos ato evropiane të dala nga diktatura komuniste e lindjes, do të thoshim se ekziston një perceptim dhe praktikë sipas të cilës “shumë mësime të gjuhës angleze shpeshherë merren me të mirë, nxiten ose thjesht caktohen të japin mësim nëpër klasat e anglishtes për Qëllime Specifike (AQS) pa pasur ndonjë eksperiencë apo kualifikim paraprak, kur në të vërtetë me pak përgatitje dhe vullnet mësime të AQS-së me të vërtetë mund të bëhet interesante dhe sfiduese për këdo që merr përsipër një detyrë të tillë”<sup>1</sup>. Duke pasur parasysh faktin se sa të rëndësishme janë njohuritë bazë, aftësitë komunikuese dhe lehtësueset të mësuesit apo instruktorit në krijimin e një atmosfere të përshtatshme për të nxënësit në klasë, do të ishte me vend të theksonim rëndësinë e këtyre tipareve që i mundësojnë studentëve të nxënësit e gjuhës për ta përdorur atë më vonë si mjet komunikimi për të ndërvepruar me njeri-tjetrin në mjedisin akademik ashtu edhe jashtë tij në jetën dhe veprimtarinë profesionale të tyre.

Në shumë raste mësuesi apo instruktori mund të jetë i vetmi person anglisht folës që u ofrohet studentëve, dhe duke pasur parasysh faktin që ajo/ai mund të ketë një kohë të kufizuar për të qëndruar pranë tyre, përpjekjet duhet të jenë maksimale me qëllim që komunikimi që u prezantohet studentëve brenda mjedisit akademik të jetë i frytshëm dhe i dobishëm për të ndikuar në të nxënësit e gjuhës së huaj. Në mënyrë që procese të tilla të jenë të suksesshme, gjithmonë gjatë ndërveprimit me studentët është e rëndësishme të dëgjohet me vëmendje ajo që ata thonë dhe shprehim si dhe t'u jepet përgjigje konkrete dhe analizohet drejtpërsëdrejti të kuptuarit apo të keqkuptuarit nga ana e tyre. Ata që studiojnë dhe mësojnë gjuhë të huaja janë në të njëjtën kohë edhe mbartës të një rreziku apo sfide pasiqë gjatë këtij procesi të gjatë nuk mund t'i shmangen dot bërjes së gabimeve para se të arrijnë qëllimin e tyre final dhe të kenë sukses, prandaj dhe kur bëhet fjalë për klasat ku mësohet Anglishtja për Qëllime Specifike ata mund ta kenë edhe më të vështirë dhe të gjatë këtë rrugë, pasi këtu veç të tjerash ata frenohen nga përdorimi kompetencës së gjuhës së tyre anëtare për të prezantuar veten si të rritur të mirë informuar.

1 Master P., "Responses to English for Specific Purposes" Washington DC: US State Department, 2000.

Edhe në rastet kur gjuha anëtare mund t'i ndihmojë, për arsye të prejardhjeve të ndryshme kulturore mund të jetë e vështirë të shpjegohet kuptimi i disa fjalëve ose shprehjeve sidomos në fusha të tilla si ajo e biznesit apo dhe ajo juridike.

Mund të themi se për sa më sipër, është e domosdoshme që mësuesi apo instruktori të përpiqet që të krijojë një atmosferë në mjedisin ku mësohet AQS për të mbështetur dhe inkurajuar nxënësit me qëllim që këta të fundit të ndjehen të sigurt dhe të zotërojnë besim dhe mirëkuptim me qëllim komunikimin e mesazheve në një mënyrë të përshtatshme dhe të kuptueshme për ata vetë por dhe për pjesëmarrësit e tjerë në këtë mjedis. Mësuesi duhet që gjithmonë të marrë përgjegjësinë për të forcuar besimin tek nxënësit kryesisht duke inkurajuar një qasje të të qenit aktiv dhe duke lejuar njëkohësisht hapësira që secili nga pjesëmarrësit të kontribuojë në mësim jo vetëm dukë marrë dije dhe njohuri por edhe duke ndarë dhe transmetuar tek pjesëmarrësit njohuritë dhe eksperiencat personale. Nëse do të niseshim nga eksperiencat praktike do të thoshim se për t'i paraprirë dhënies së mësimin në një kurs të anglishtes së Biznesit dhe Ekonomisë do të ishte mirë familjarizimi me terminologjinë e fushës dhe mbase do të duhej të fillonim të lexonim seksionin e ekonomisë dhe financave të gazetës apo revistave lokale me tema ekonomike, po kështu edhe nëse bëhej fjalë për një mjedis të anglishtes ligjore apo asaj shkencore e inxhinierike. Kuptohet dhe në fund të fundit gjëja më e mirë do të ishte dhe ndjekja e kurseve në finance, marketing, jurisprudencë apo inxhinieri për një periudhë qoftë edhe afat-shkurtër nëse kjo do të ishte e mundur për të gjithë ata që synojnë të investojnë apo përfshihen në mësimdhënien e gjuhës së huaj për qëllime specifike.

Në lidhje me këtë, do të dëshiroja të sillja më poshtë disa momente nga eksperiencia në fillim të karrierës në mësimdhënie, duke e ndjerë vetën pjesë të këtij procesi që lëviz pareshtur dhe që kërkon nga secili prej nesh të bëhemi pjesë e tij. Duke pasur parasysh faktin se sa të varfra kanë qenë dhe janë hera-herës faqet e shtypit tonë të përditshëm me artikuj dhe analiza nga bota e biznesit, e quaj veten me fat që mu dha mundësia të ndjek vërtet një kurs, por disi më të gjatë dhe mbase më të vështirë se sa e kisha menduar në lidhje me fushën e biznesit në fillimet e karrierës sime akademike. Ishte pikërisht periudha dy-vjeçare e ndjekjes së programit Master në Trajnime Biznesi që më mundësoi vërtet të kaloj frikën dhe pavendosmërinë e punës me shifra dhe terma ekonomike aq më tepër kur bëhej fjalë që një pjesë të njohurive duhet të ndaheshin edhe në auditor me studentët. Gjatë kohës kur zhvillonim seminarin e programit master, në kontaktet e përditshme me biznesin e vogël dhe të mesëm, por ende të brishtë shqiptar, pata rastin të komunikoj me shumë specialistë të fushës së financës, biznesit e marketingut, por jo të gjithë ishin specialistë të gjuhës angleze. Detyra jonë ishte të mësonim fillimisht vetë dhe më pas të trajnonim biznesmenët për të kuptuar dhe zbatuar praktikën e biznesit ndërkombëtar me qëllim lehtësimin e hyrjes së Shqipërisë në komunitetin e biznesit dhe tregut ndërkombëtar. Ishte vërtet një sfidë pasi nuk ishte e lehtë t'iu shpjegoje ose t'i bëje biznesmenët që të merrnin vesh kuptimin e



vërtete të shumë prej koncepteve bazë të biznesit. Problemi më i madh qëndronte në faktin se biznesmenët shqiptarë kishin idetë e tyre mbi kuptimin e koncepteve të veçanta të biznesit dhe ishin disi rezistent ndaj përshtatjes së koncepteve të tyre me standardet ndërkombëtare.

Ndërkohë që programi vazhdonte, falë njohurive dhe shprehive të mësimdhënies dhe praktikës me studentët e fakultetit të Ekonomisë, fillova të kuptoj se ajo që na mungonte gjatë procesit të dhënies së trajnimit ndaj biznesmenëve tanë ishin krijimi ose aktivizimi i disa skemave të përshtatshme në lidhje me terminologjinë dhe aspekte të caktuara biznesi, gjë që fillova ta praktikoj në fillim me studentët dhe më vonë edhe gjatë punës në grupe me kolegët e programit të masterit. Duke pasur parasysh se nga praktika jemi mësuar dhe dalëngadalë bindur se mënyra më e mirë për të ushqyer të kuptuarit dhe entuziazmin e një koncepti të ri, është që ta lidhim këtë të fundit me një eksperiencë personale të studentit ose në rastin tonë të klientit apo studentit. Duke rrahur mendime dhe diskutuar mbi koncepte bazë, terminologji të fushës dhe të domosdoshme me të cilat hasin vështirësi si studentët por edhe klientët e biznesit, mund të mendojmë se si ato mund të lidhen me fenomene të jetës sonë të përditshme. Pa dashur të hyj thellë në përmbajtjen e gjithë problematikës së kësaj fushe do të doja të sillja këtu disa prej atyre koncepteve që mendoj se mund të krijojnë vështirësi në kuptim dhe si rrjedhojë edhe në zbatimin e tyre në praktikë. Le të shohim si shembuj terminologjike katër prej tyre dhe më konkretisht; marketingu (marketing), drejtim personeli (personnel management), zotërimi ose aktive (assets) dhe partner i huaj (foreign partner)

1. *Marketing-u* (marketing) është përkufizuar në një fjalorth të Spring-Wallace (1993) <sup>2</sup>si “identifikimi i nevojave të konsumatorit dhe zhvillimi i një produkti për të plotësuar këto nevoja. Kjo ndiqet nga një strategji e përcaktimit të çmimeve, promovimit dhe shpërndarjes së mallrave apo shërbimeve për të përmbushur kërkesat si të blerësve ashtu edhe ato të shitësve”. Kurse nëse do t’i referoheshim fjalorit Longman Business English Dictionary i njëjti term përkufizohet si “veprimtaritë për dizajnimin dhe tregtimin e produkteve ose shërbimeve duke marrë parasysh nevojat dhe dëshirat e blerësve si për shembull ku dhe si do të blejnë ata, sa do të dëshironin ata të paguanin, etj.” <sup>3</sup>

Këtij përkufizimi mund t’i shtojmë edhe një mendim abstrakt të cilin marketingu ia ofron perceptimit që kanë njerëzit për një produkt. Kjo shpesh vjen nëpërmjet tërheqjes së vëmendjes apo bërjes së apelit ndaj fantazive të të ashtuquajturit konsumator potencial (p.sh përmes reklamave, dhe në këtë rast i babagyshit të vitit të ri me slitën në reklamën e Coca-Cola-s mund të merret si shembull). Por gjatë praktikës në disa prej SME-ve shqiptare, u vu re se për shumicën e biznesmenëve merrej si e mirëqenë që termi marketing do të thoshte

2 Spring-Wallace J., *English for corporate communications: Cases in International Business*. Regents/Prentice hall, (Enlewood Cliffs, N.J. 1993), fq. 165.

3 *Longman Business English Dictionary*, Pearson Education Limited, 8<sup>th</sup> impression 2004, fq. 293.

vetëm një gjë konkrete, thjesht ‘akti fizik i shitjes së produktit’ (mallit). Pra, për ta shpeshherë me marketingu nënkuptohej vendosja e një tezge (tavoline) dhe ekspozimi i mallrave të tyre në një vend të dukshëm dhe të lehtë për tu arritur. Kjo pikëpamje mund edhe të shpjegohet pjesërisht me mungesën e ekonomisë së tregut gjatë periudhës shumëdekadëshe të regjimeve komuniste në shume vende të bllokut lindor përfshi edhe vendin tone. Marketing-u i stilit përëndimor është rritur dhe zgjeruar në këto vende që prej asaj kohe, por gjithsesi mungesa e eksperiencës e një ekonomie tregu është ende një pengesë serioze. Mënyra më e mirë që mund të mendonim, do të ishte lidhja e konceptit të gjerë të marketingut me eksperiencat personale të biznesmenëve shqiptarë, dhe me konkretisht do të ishte lidhja e tij me përdorimin e kozmetikës. Duke përdorur makijazhin një person mundohet të tregojë më të mirën e vetes së vet (paketimin) duke iu përgjigjur fantazisë së partner-es/it të dëshiruar (nevojës së konsumatorit). Sa më tepër që “shitësi” parashikon nevojat dhe fantazitë e “blerësit” aq më e suksesshme do të jetë “shitja”.

2. *Drejtimit personeli* (personnel management) Spring-Wallace <sup>4</sup>(1993) e përkufizon si “procesi i planifikimit, organizimit, udhëheqjes dhe kontrollimit të burimeve - njerëzore, materiale dhe financiare në një organizatë”, kurse Longman Business English Dictionary e përkufizon si “marrja në punë, kualifikimi dhe ofrimi i ndihmës për njerëzit që punojnë në një organizatë”<sup>5</sup>

Pra drejtimi (menaxhimi) i personelit vë theksin mbi mirë-administrimin e burimeve njerëzore. Një mirë-administrimin apo drejtimit i mirë personeli shpesh do të thotë t’i lejosh punonjësit të përdorin krijimtarinë dhe iniciativën e tyre në bërjen e punës apo përbushjen e detyrës. Pra, ekziston një përbërës më abstrakt në drejtimin e personelit sesa thjesht organizimi, udhëheqja, dhe kontrolli i punonjësve të një kompanie. Punonjësit duhet të organizohen për të pasur një rendiment të efektshëm, duhet të udhëhiqen në një mënyrë të tillë që të frymëzohen për të prodhuar me cilësi sa më të lartë dhe të kontrollohen në një mënyrë të tillë që të mos u ndrydhen krijimtaria dhe iniciativa. Mbase jo çuditërisht, disa biznesmenë e kuptojnë drejtimin e personelit thjesht si dhënie urdhrash ndaj punonjësve të tyre duke i treguar këtyre të fundit çfarë të bëjnë pa kuptuar nevojën për t’i motivuar punonjësit që të kujdesen për punën e tyre. Mënyra më e mirë për të gjetur një mënyrë që ta lidhim këtë koncept kaq të gjerë të drejtimit të personelit me përvojën tonë të përditshme ishte referimi tek fenomeni i rritjes së një fëmije. Prindërit janë përgjithësisht të vetëdijshëm se ata nuk mund t’i kontrollojnë fëmijët e tyre thjesht duke i treguar atyre çfarë të bëjnë dhe në vazhdim të mund ta mbajnë vatrën familjare në harmoni. Për më tepër prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për sa i përket pikave të forta dhe të dobëta të fëmijëve të tyre me qëllim që ata të mund të rriten të shëndetshëm, të ekuilibruar, dhe të bëhen pjesëtarë të denjë të shoqërisë. Në të njëjtën mënyrë, një drejtimit personeli i efektshëm ruan moralin e gjithë grupit

4 Spring-Wallace J., *English for corporate communications: Cases in International Business*. Regents/Prentice hall, (Enlewood Cliffs, N.J. 1993), fq. 168.

5 *Longman Business English Dictionary*, Pearson Education Limited, 8<sup>th</sup> impression 2004, fq. 286.

që drejtohet apo udhëhiqet.

3. *Zotërimet, aktive* (assets) sipas Spring -Wallace përkufizohet si: “gjishshka që ka një vlerë ekonomike dhe zotërohet nga një kompani ose një individ<sup>6</sup>, kurse sipas Longman Business English Dictionary përkufizimi paraqitet si: “diçka me vlerë apo me potencial për të sjellë të ardhura që i përket një individi apo biznesi”<sup>7</sup>

Zotërimet apo aktivet përfshijnë jo vetëm pajisje dhe pronësi të tjera fizike (aktivet fizike) por gjithashtu edhe forcat e individëve apo të kompanisë ku përfshihen artikuj të zotëruar tërësisht si p.sh teknologjia me patentë apo edhe, njohuritë dhe aftësitë e punonjësve (aktivet njerëzore). Shumë prej klientëve i kuptojnë zotërimet si diçka që u jepet atyre (p.sh nga qeveria) dhe që sigurisht nuk e përfshijnë personelin (aktivet njerëzore) në konceptimin e tyre për këtë term. Një paralelizëm i mundshëm në këtë rast do të ishte një kopsht me zarzavate. Prodhimet e kopshtit kanë një vlerë thjesht ekonomike, por të tilla janë edhe njohuritë e kopshtarëve që rrisin këto prodhime, pa përmendur këtu bletët që pllenojnë sythat e çelur dhe krimbat e tokës që mirëmbajnë dheun. Këto që përmendëm janë të gjitha pjesë të zotërimeve apo aktiveve në kontekstin e biznesit të një kopshti.

4. *Partner i huaj* (foreign partner) përkufizohet nga Longman Business English Dictionary si “një kompani që punon së bashku me një kompani tjetër për një aktivitet të veçantë ose që investon në të njëjtin aktivitet”<sup>8</sup>

Kuptimi i shprehjes partner i huaj, u fut si një koncept i ri gjate dekadës së fundit të shekullit të 20-të në komunitetin e biznesit të krijuar rishtazi në Shqipëri dhe të sapo-çliruar nga diktati i ekonomisë së centralizuar. Si i tillë ai nuk para kuptohej mirë nga shumë prej biznesmenëve shqiptarë, për të cilët një partner i huaj do të thoshte thjesht një kompani apo individ që mund të investonte para në një kompani vendase vetëm për interesat dhe përfitimet e veta. Në fakt një partner i huaj kërkon reciprocitet dhe përfitim dypalësh, që do të thotë shkëmbim idesh, teknologjish dhe trajnime. Si një paralelizëm të mundshëm nga jeta e përditshme e njerëzve të biznesit mund të marrim nga mënyra si e trajtojmë një mik apo shok të ri kur ky lëviz nga një lagje apo vendbanim në tjetrin. Sigurisht që kërkohet një reciprocitet i dyanshëm nëse të dyja palët duan që të ruajnë dëshirën e mirë për vazhdimin e miqësisë. Nuk mjafton që njëri të jetë dhuruesi dhe tjetri të jetë marrësi. Prandaj dhe një partner biznesi nuk mund të shihet si një shfrytëzues se përndryshe bashkëpunimi ose partneriteti do të dështonte. Në këtë rast edhe bashkëshortët apo martesat mund të trajtohen fare mirë si një një tjetër shembull i partneritetit.

E ndërsa sa më sipër lidhet direkt me mënyrën tradicionale të të mësuarit dhe

6 Spring-Wallace J., *English for corporate communications: Cases in International Business*. Regents/Prentice hall, (Enlewood Cliffs, N.J. 1993), fq. 165.

7 *Longman Business English Dictionary*, Pearson Education Limited, 8<sup>th</sup> impression 2004, pg. 23.

8 *Longman Business English Dictionary*, Pearson Education Limited, 8<sup>th</sup> impression 2004, fq. 341.

procesit të të nxënit, ndërkohë që diskutojmë jetojmë në epokën e transformimit digjital dhe dominimit të teknologjisë së informacionit në shumë aspekte të jetës. Nëse do t'i referohemi zhvillimeve dhe përparimit që ka ndodhur falë zhvillimit të teknologjisë në epokën e globalizmit, informacioni është lehtësisht i disponueshëm në kohë reale për të gjithë falë qasjes në internet. Si e tillë edhe gjuha e huaj dhe mësimi i saj janë ndikuar më së shumti nga ky zhvillim dhe studentet apo mësuesit e kanë bërë atë pjesë të pandashme të përditshmërisë së tyre si për të marrë ashti edhe shpërndarë informacion. Megjithatë, në një botë shumëgjuhëshe, shpesh ndodh që informacioni i disponueshëm të jetë në një gjuhë tjetër nga gjuha amtare e përdoruesit. Për shembull, një numër i madh studentësh dhe shkencëtarësh në mbarë botën në mënyrë rutinore lundrojnë në faqet e internetit në anglisht. Ndërsa shumë prej tyre kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze për të marrë informacionin që u nevojitet, një numër i konsiderueshëm mund të hasin vështirësi për sa i përket terminologjisë.

Mjetet e disponueshme të përkthimit me makinë në internet, të tilla si Babel Fish në faqen e motorit të kërkimit AltaVista, mund të jenë të dobishme për ata përdorues me pak ose aspak njohuri të gjuhës përkatëse. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të përkthimit me nëpërmjet makinerisë (kompjuterit) rreziku i përkthimit të pasaktë, apo edhe të ngatërruar është i tillë që shumica e përdoruesve që mund të flasin rrjedhshëm gjuhën përkatëse por kanë disa boshllëqe në terminologji, do të bënin mirë do të lexonin dokumentin në formën e tij origjinale nëse do të kishin një ndihmë adekuate të disponueshme për sa i përket terminologjisë.

Bazat aktuale të të dhënave të terminologjisë dygjuhëshe on-line mund të plotësojnë këtë nevojë dhe si shembull mund të përmendim Eurodicautom – baza e të dhënave të terminologjisë evropiane ose për gjuhët frëngjisht-anglisht, “Le grand dictionnaire terminologique de l’Office québécois de la langue française” ndër të tjerët, por vetëm pjesërisht, pasi ata reflektojnë disa nga mangësitë e mëposhtme:

- Kërkimet e të dhënave dygjuhëshe on-line kanë tendencë të jenë “të zhurshme”, në kuptimin që ato janë të mundshme për të ofruar një numër të madh kuptimesh dhe përkthimesh për një fjalë të dhënë por shumë prej tyre janë të parëndësishme në kontekstin e dhënë.

- Qasje e lehtë (p.sh. duke klikuar ose zgjedhur një fjalë ose një shprehje) do të jetë e mundshme për fjalët që shfaqen ose përdoren në formën bazë.

- Shprehjet me shumë fjalë (MËËs) janë të trajtuara shumë dobët/përciptash. Edhe pse shumë shprehje janë të renditura në fillore dygjuhësh të mire, ato mund të jenë të vështirë për t’u gjetur, sidomos kur përdoruesi zgjedh apo fokusohet vetëm në një aspekt të veçantë dhe të shkëputur nga konteksti.

Mangësia e dytë (mungesa e lemantizimit<sup>9</sup>) dhe pjesërisht e para janë trajtuar nga sisteme më të sofistikuar të përpunimit të një gjuhë natyrore sikurse janë ato të komercializuara nga korporatat Babylon dhe Xerox , por që sipas njohurive tona asnjëri prej tyre nuk mund të trajtojë shprehje të ndara në mënyrë të kënaqshme dhe të saktë.

### **Përfundime**

Nëse do t'i referoheshim shembujve të mësipërm, mund të themi se një nga metodat mjaft efikase për të gjithë ne, gjatë procesit të mësimdhënies së gjuhës së huaj, do të ishte aktivizimi i disa skemave të përshtatshme për të shpjeguar koncepte të ndryshme tek studentët tanë qofshin këta të rinj apo të vjetër në moshë, që duke i lidhur edhe me fenomenet kulturore e profesionale të gjithsecilit prej nesh, dhe kryesisht të vetë studentëve të përfshirë, do ta bënin më të lehtë të nxënit dhe mësimin e gjuhës në përgjithësi. Konceptet e biznesit të përmendura më sipër si dhe nocionet përkatëse nga jeta e përditshme mendoj se shërbejnë si një shtysë për të trajtuar disa nga këto çështje dhe të ngjashme që i hasim jo vetëm në botën e biznesit por edhe në auditorë me studentë të shkencave ekonomike, por edhe degëve të tjera, kur bëhet fjalë për mësimdhënien e gjuhës angleze për qëllime specifike. Dikush mund të pyesë nëse është e mundur që ne të mund ta bëjmë këtë për çdo koncept biznesi apo për çdo fjalë ose shprehje të re që ne mund tu mësojmë studentëve, dhe unë do të them- “Pse jo!”. Sa më shumë të mund t'i lidhim gjërat për të cilat jemi të mirë informuar apo i kemi të përvetësuar mire me momente apo ngjarje nga jeta e përditshme dhe kultura e secilit prej nesh, aq më e lehtë është për ne të mund të mësojmë dhe kujtojmë një fjalë apo koncept të ri.

### **BIBLIOGRAFIA:**

(2003): [https://www.academia.edu/66500201/Translation\\_of\\_words\\_in\\_context](https://www.academia.edu/66500201/Translation_of_words_in_context) as seen on 05 May.

(2004): Longman Business English Dictionary, Pearson Education Limited, 8<sup>th</sup> impression.

CHOMSKY N., (1995): The Minimalist Program, Cambridge, MIT Press.

GOLDMAN J.-PHILIPPE, NERIMA L. AND WEHRLI E., (2001): Collocation Extraction Using

9 Lemmatizimi lidh fjalët me kuptim të ngjashëm si një fjalë, duke i bërë motorët e kërkimit më efektive dhe të sakta. Qëllimi i lematizimit është të reduktojë një fjalë deri në formën e saj rrënjësore, e quajtur lemë. Për shembull, folja “running” do të identifikohet si “run”. Lematizimi studion analizën morfologjike, ose strukturore dhe kontekstuale të fjalëve. Për të identifikuar saktë një lemë, mjetet analizojnë kontekstin, kuptimin dhe pjesën e synuar të të folurit në një fjali, si dhe fjalën brenda kontekstit më të madh të fjalisë përreth, fjalive fqinje apo edhe të gjithë dokumentit. Me këtë kuptim të thellë, mjetet që përdorin lematizimin mund të kuptojnë më mirë kuptimin e një fjalie apo togfjalwshi.

a Syntactic Parser. In Proceedings of the ACL, pp. 61-66.

HOWARD R., BROWN G., (1997): "Teacher Education for Languages for Specific Purpose", Multilingual Matters.

Master P., (2000): "Responses to English for Specific Purposes" Washington DC: US State Department.

SPRING-WALLACE J., (1993): "English for corporate communications: Cases in International Business". Regents/Prentice Hall, Enlewood Cliffs, N.J..

WEHRLI E., (1997): *L'analyse syntaxique des langues naturelles: problèmes et méthodes*, Paris, MASSON E., WEHRLI. (2000): Parsing and Collocations. In D. Christodoulakis (ed.) *Natural Language Processing NLP*, Springer Verlag, pp. 272-282.

## FJALA E MBYLLJES NGA PROF. EMERITUS - EMIL LAFE

*Kolege e kolegë të nderuar!*

*Kaluam sot së bashku një ditë pune intensive dhe patëm rastin jo vetëm të dëgjojmë mendime me vlerë, po edhe të diskutojmë e të shkëmbejmë ide e pikëpamje me kolegë e kolege për një problem të rëndësishëm e të mprehtë shkencor, siç është terminologjia e gjuhës shqipe. Kam bindjen se konferenca i përmbushi synimet e organizimit dhe e pasuron mendimin gjuhësor në fushën e terminologjisë me ide e vështrime të reja.*

*Dua të përgëzoj, së pari, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për organizimin e kësaj konference dhe veçanërisht ata dhe ato që janë marrë drejtpërdrejt me të gjitha punët që kërkon një veprimtari e tillë. Në programin e kësaj konference shkencore janë renditur pesëdhjetë kumtesa, pjesa më e madhe e të cilave u referuan sot. Tematika e kumtesave rrok një gamë të gjerë çështjesh të terminologjisë dhe terminografisë. Krahas vështrimeve të përgjithshme për gjendjen e përpunimit të terminologjisë në gjuhën shqipe, u trajtuan edhe probleme të terminologjisë në fusha të veçanta, si në veprimtarinë juridike e ekonomike, në shkencat filologjike, në psikologji e pedagogji, në degët e ndryshme të sporteve etj. U prekën gjithashtu çështje të tilla si marrëdhëniet e leksikut terminologjik me leksikun e përgjithshëm, përkthimi i termave nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe e anasjelltas, hartimi i fjalorëve terminologjikë shpjegues ose dygjuhësh, nevoja e përditësimit të fjalorëve terminologjikë; u trajtuan edhe një numër çështjesh të veçanta nga përvojat e vetë studiuesve.*

*Terminologjia njihet si degë e leksikografisë, pra një shkencë gjuhësore. Sipas mendimit tim gjithnjë e më shumë si në leksikografi, e aq më tepër në terminologji, në terminologji e në leksikografi pesha e komponentes shkencore po mbizotëron mbi komponenten gjuhësore. Këtu gjuhëtari pa specialistin e degëve të ndryshme të shkencës e të teknikës nuk ia del dot në krye. Në këtë kuptim unë do të doja që në këtë konferencë të merrnin pjesë edhe specialistë të tillë, që kanë punuar në fushën e terminologjisë, që njohin kriteret, po edhe vështirësitë. Në veprimtarinë për kodifikimin dhe standardizimin e terminologjisë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe, krahas kriterëve të përgjithshme të përpunuara nga shkollat terminologjike, gërshetohet edhe një kriter tjetër themelor: ndërtimi i termave sa të jetë e mundur me brumin e gjuhës shqipe dhe pastrimi i terminologjisë nga ngarkesa e tepërt e termave të huaj.*

*Më 1955, kur në Institutin e Shkencave u krijua sektori i posaçëm i terminologjisë dhe nisi puna e organizuar për terminologjinë e gjuhës shqipe,*

u përcaktuan edhe disa kritere të përgjithshme, që vlejnë edhe për sot. Si kriter udhëheqës u kërkuar të shfrytëzoheshin sa më shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalë terma, duke krijuar terma të rinj ose duke u dhënë kuptime terminologjike fjalëve nga leksiku i përgjithshëm, ashtu siç ka qenë edhe tradita e hapur nga rilindësit. Fjalët nga brumi i shqipes në terminologji (përveç lehtësisë së përdorimit dhe qartësisë së kuptimit) ndryshe nga fjala e huaj, janë treguar mjaft prodhuese duke sjellë pasurimin e gjuhës me çerdhe të plota fjalësh. K. Kristoforidhi dhe N. Frashëri krijuan dikur fjalët sinonime ndërgjegje dhe vetëdije. Pak nga pak këto fjalë shqipe lëshuan filiza dhe sot nga ndërgjegje kemi: i (pa) ndërgjegjshëm, ndërgjegjshëmëri, ndërgjegjësohem e ndërgjegjësoj, ndërgjegjësim, i ndërgjegjësuar; nga vetëdije kemi: i (pa)vetëdijshëm, vetëdijësohem e vetëdijësoj, i vetëdijësuar, vetëdijësim. Fjalët e huaja koshiencë e koshent, që i përdorin ende disa krejt pa nevojë, kanë mbetur të izoluara, shterpa.

Një çështje qendrore ka qenë dhe mbetet qëndrimi ndaj termave të huazuar nga gjuhë të huaja. Lidhur me këtë që në vitin 1955 u përcaktua që të bëheshin përpjekje për të shqipëruar termat shkencorë jondërkombëtarë, duke quajtur si ndërkombëtarë ata terma që i kanë jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, por edhe gjuhët e tjera. Kështu p.sh. termi energji nukleare u zëvendësua me energji bërthamore, duke pasur parasysh termin përkatës në disa gjuhë gjermanike e sllave (Kernenergie, ядерная энергия etj.).

Terminologjia, si tërësi termash të një fushe, vërtet vështrohet si gjuhë speciale a gjuhë specialiteti, por pësha e terminologjisë, marrë në tërësi, në një fjalor shpjegues, ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Në hyrjen e fjalorit të frëngjishtes Petit Robert shënohet p.sh. se ndër 50.000 fjalët e atij fjalor (botimi i v. 1969), 30.000 ishin terma. Kjo kërkon që në fjalorët shpjegues terminologjia të hyjë në mënyrë sa më të studiuar, duke u ndërtuar paraprakisht një strukturë terminologjike e fjalorit dhe duke e përditësuar këtë gjithnjë gjatë punës, në mënyrë që fushat e ndryshme terminologjike të paraqiten me përpjesëtimin e duhur.

Meqë kjo konferencë zhvillohet në FGJH, dua të shpreh ndonjë mendim për vendin e terminologjisë në punën e këtij fakulteti. Këtë unë e shoh në dy drejtime:

Së pari, brenda Fakultetit. Këtu shtrohen disa pyetje. A kanë departamentet e këtij Fakulteti ndonjë program për zotërimin e terminologjisë bazë tekniko-shkencore në gjuhën e huaj përkatëse? Cili është vëllimi i termave që mëson studenti në Fakultet. A arrin t'i mësojë në gjuhën e huaj përkatëse termat bazë të shkencave që ka programi i shkollës së mesme? Bie fjala për një emërtim terminologjik mjaft të përgjithshëm: bimë industriale: a e mësojnë studentët si thuhet anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, rusisht, greqisht? A i dinë studentët si quhen katër veprimet elementare të aritmetikës (mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim) në gjuhët përkatëse?

Së dyti, në mësimin e gjuhës së huaj në fakultetet e ndryshme të UT dhe të



Universiteteve të tjera, ç'vend zë leksiku terminologjik? A kanë bashkëpunim katedrat e atyre fakulteteve dhe universiteteve me FGJH? Ka pasur një përvojë të mirë në vitet '70-'80, kur u hartuan një varg fjalorësh terminologjikë mësimorë nga pedagogët e gjuhëve të huaja në fakultete të ndryshme të Universitetit të Tiranës (që përfshinte atëherë edhe të sotmit Universiteti Politeknik dhe Universiteti Mjekësor) në bashkëpunim me specialistët e degëve përkatëse të atyre fakulteteve. Mendoj se kjo përvojë duhet rimarrë.

Një tjetër çështje është shqyrtimi i strukturës terminologjike të fjalorëve gjuhë e huaj – shqip (kam përshtypjen se studentët pak i përdorin prandaj dalin gafa të tilla si të burgosurit e luftës ... në vend të robërit e luftës, duke përkthyer fjalë për fjalë emërtimet përkatëse në anglishte, frëngjishte, italishte, gjermanishte). Mund të jepen tema për master, pse jo edhe për disertacione (kërkoj ndjesë nëse kjo është bërë dhe unë nuk e di) nga kjo fushë.

Duke e vështruar çështjen në një rrafsh më të gjerë, kam bindjen se është e domosdoshme dhe e ngutshme të krijohet një Komitet ndërshtetëror i terminologjisë së gjuhës shqipe (Shqipëri – Kosovë - RMV) me detyrën e përafrimit të terminologjisë deri në njësimin e plotë. Të gjithë kemi vërejtur se ka dallime në terminologji në shumë fusha të dijes e të veprimtarisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Pa hyrë në hollësi, do të përmend vëzhgimin e akademikut të ndjerë të Kosovës Esat Stavileci, i cili, duke bërë fjalë për dallimet në terminologjinë administrative, shkruan: “Shkalla e mosnjësimit ndonjëherë arrin kuotën e moskuptimit dhe nevojën e sqarimit term për term për të kuptuar thelbin e problemit.” (Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – Probleme e detyra. Konferencë shkencore. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 81).

Standardizimi dhe kodifikimi i terminologjisë shqipe, sikundër edhe i çdo terminologjie tjetër, nënkuptojnë një punë të përbashkët ndërmjet gjuhëtarëve dhe specialistët e fushave përkatëse të dijes me autorizimin dhe miratimin e shtetit. Kjo ka qenë rruga që kemi ndjekur edhe ne që nga themelimi i sektorit të terminologjisë në ish Institutin e Shkencave e deri në mbylljen e veprimtarisë së këtij sektori në vitet e fundit në Akademinë e Studimeve Albanologjike. Kjo konferencë le të shërbejë si një rast e si një shtysë që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të bëhet nismëtar për një organizim të punës për terminologjinë në rrafsh mbarëkombëtar. Pedagogët e gjuhëve të huaja në të gjitha universitetet shqiptare, po ashtu edhe pedagogët dhe kërkuesit në fushën e gjuhës shqipe do të jenë një forcë shkencore dhe organizative në këtë veprimtari të ardhshme. Prandaj konferenca si kjo janë të nevojshme herë pas here.

Ju përgëzoj edhe një herë për pjesëmarrjen në këtë konferencë dhe uroj që çështjet që u trajtuan këtu, mendimet që u shprehën e u diskutuan, të jenë pjesë përbërëse e përhershme e mendimit dhe veprimtarisë suaj shkencore.

Mirupafshim në veprimtari të tjera të frytshme si konferenca jonë!













CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë:

Konferencë shkencore ndërkombëtare / Universiteti i Tiranës.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

- Tiranë: Graphic Line - 01, 2023.

344 f. ; 24x17 cm

Tit. edhe angl.: The terminology of human fields and its  
reflection in dictionaries:

The international scientific conference.

**ISBN 9789928470744**

1. Gjuhët e huaja 2. Gjuha shqipe 3. Leksikografia 4. Fjalorë  
terminologjikë 5. Konferenca

821.1/.9 '374.2 : 81 '373. 46 (062)